Viti I | Numër 1 | 2016

# AGORA

pan ALBANICA®

pa kufij në kokat tona



www.panalbanica.net

AGORA
pan ALBANICA
pa kufij në kokat tona

Viti I Numri 1, 2016

Botuar nga ***PanAlbanica***

**PanAlbanica**

Web-faqja: ***panalbanica.net***

Posta elektronike: ***panalbanica@gmail.com***

Facebook: ***PanAlbanica***

Twitter: ***@PanAlbanica***

**Redaktorë të botimit:** Albulena Halili dhe Shemsedin Ibrahimi
**Dizajni dhe radhitja:** Ilir Bajrami
**Ballina:** Mensur Mamuti
**Shtypur në:** Tringa

*©2016 Të gjitha të drejtat autoriale janë në pronësi të PanAlbanica-s. Çdo përdorim i materialeve duhet të mbajë emrin e saj.*

Të nderuar lexues,

Botimi që mbani në dorë është numri i parë i përmbledhjes së shkrimeve të botuara në rrjetin elektronik panalbanica.net, gjatë vitit të parë të jetëgjatësisë së tij.

*Agora PanAlbanica* botohet nga rrjeti *PanAlbanica* dhe ka marrë emrin sipas rubrikës së këtij rrjeti me të njëjtin emër. Në Agorë përballen mendimet e ideologëve, personaliteteve, politikanëve dhe autoriteteve shkencore shqiptare mbi tema të rëndësisë kombëtare. Aty shpalosen edhe mendimet, idetë dhe qasjet e përbashkëta të ekipit të *PanAlbanica*-s përkitazi me këto çështje. Ku janë pikëtakimet? Ku janë dallimet? Kah shkon çështja kombëtare shqiptare? Këto janë disa nga dilemat që do të qartësohen për të ecur përpara, gjithmonë duke shikuar nga e kaluara, duke vepruar në të tashmen dhe duke menduar për të ardhmen.
*PanAlbanica* ka zënë fill si një rrjet njerëzish, botëkuptimet e të cilëve nuk ravijëzohen nga kufijtë, çfarëdo qofshin ata. Thelbi i këtij rrjeti është të menduarit jashtë mureve të vendosura artificialisht në hapësirë dhe në kokat tona njëkohësisht.

*PanAlbanica* është një agorë përsiatjesh e debatesh, që do të përpiqet të japë një dorë në shembjen e këtyre mureve në botën e rrjetëzuar e tejet të ndërvarur në të cilën jetojmë sot. Që nga 17 janari 2016, *PanAlbanica* ka agorën e saj ku shpërfaqen përtejkumtet, përsiatjet, analizat me tejqyrë e shëmbëllimet për mbrothësinë kombëtare pa kufij në kokat tona.
Rrjeti *PanAlbanica* është një gur më shumë në ndërtimin e idesë së shqiptarizmës bashkëkohore. Është ky një projekt modest yni, që mendojmë dhe besojmë njëlloj në kauzën tonë kombëtare.

Në Agora *PanAlbanica* ju do ta ndieni këtë frymë dhe do t'u shpërfaqet i kthjellët ky vizion.

Lexim të këndshëm!

**Rrjeti *PanAlbanica***

# Rrjeti *PanAlbanica*

**Albulena Halili** ka magjistruar për Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me temën "Sistemi i Verajës - një rend ndërkombëtar i paqëndrueshëm". Është doktorante për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës. Fusha e saj hulumtuese është e përqëndruar kryesisht në marrëdhëniet transatlantike . Punon në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë që nga viti 2007. Ndër botimet e saj të fundit shkencore radhiten: "Çështja kombëtare shqiptare – pjesa e fundit e mozaikut të pabërë ballkanik", "Evropa PostLisboniane: Politika e jashtme e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor", "Ndërtimi i sistemit ndërkombëtar sipas doktrinës së Udrou Uillsonit", "Çështjet e pazgjidhura që u zënë rrugën integrimeve Euro-Atlantike: rasti i Ballkanit Perëndimor", etj. Shkruan rregullisht edhe artikuj analitikë në shtypin ditor e atë elektronik.

**Ard Halili** ka mbaruar Lycée Corbon në Paris. Është student në Fakultetin e Administrimit të Biznesit, dega Ekonomiks në UEJL. Ka qenë delegat në edicionin e shtatë të Parlamentit Frankofon të të rinjëve 2015 në Bernë. Në vitin 2013 ka qenë bartës i bursës Erasmus+ për këmbim studentor në Universitetin e Foggia-s në Itali.

**Blerina Demiri**, është studente e vitit të dytë në degën e Komunikimit Ndërkombëtar në Universitetin e Evropës Juglindore. Gjatë kohës kur vijonte mësimet në Gjimnazin e Tetovës, ka qenë kryeredaktore e revistës "Gjimnazisti". Ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e trajnimeve të shumta mbi komunikimin, artin e të folurit dhe politikën. I është bashkangjitur rrjetit PanAlbanica me të njëjtin pasion që ka për fjalën e shkruar shqipe. Aktualisht vijon studimet në Institutin Katolik të Studimeve të Larta (Institut Catholique d'Etudes Superieures) në Francë, në kuadër të programit Erasmus për këmbim studentor.

Aktualisht i punësuar në Universitetin e Evropës Juglindore si përgjegjës i Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtar, **Bujar Sinani** ka punuar si ligjërues i gjuhës frënge që nga viti 2002 në UEJL, ndërsa po këtë detyrë e ka ushtruar edhe në Aleancën Franceze në Tetovë, ku sot mban postin e presidentit. Mban titullin Master nga Universiteti Paris Est-Creteil në Administrim publik dhe këmbime ndërkom-

bëtare. Ka punuar si korrespodent sporti i gazetës “Flaka” dhe si gazetar sportiv në “Radio Tetova”. Është doktorant në Universitetin Nantes në Francë, ndërsa fusha e tij e hulumtimit është e përqendruar në paraqitjen dhe manifestimin e dhunës verbale në media.

**Fatmir Arifi** është doktorant në Universitetin e Tetovës. Ka kryer studimet universitare në Fakulteti Filozofik, dega e historisë në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i ka përfunduar në Universitetin e Evropës Juglindore në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci me tezën e magjistraturës “Sfidat e rendit të ri botëror”. Është autor i shumë studimeve të botuara në revista shkencore vendore e ndërkombëtare. Po ashtu është autor i analizave të ndryshme gjeopolitike e të tjera në gazeta e revista shqiptare. Në PanAlbanica ka kontribuar kryesisht në rubrikën Me tejqyrë.

**Gurakuç Kuçi,** është magjistër në Shkenca Politike: Politikë Ndërkombëtare dhe në Gazetari. Është drejtor në “Independent Institute for Political and Media Studies”. Ai ka punuar një kohë si gazetar dhe është angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm për ndërtimin e zyrave për media. Ka shkruar dhjetëra opinione në mediat shqiptare. Tani është i angazhuar në zhvillimin edhe të shoqërisë civile, qytetarisë aktive dhe diplomacisë publike. Gjithashtu autori ka të publikuar edhe punime shkencore përveç atyre publicistike.

**Kushtrim Bekteshi** ka realizuar dhjetëra shfaqje teatrore në Maqedoni, Shqipëri, Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë, si dhe dy filma të metrazhit të shkurtër dhe një film të metrazhit të gjatë. Ka kryer studimet për regji teatri dhe më pas edhe studimet e magjistraturës për skenar filmi dhe televizioni në Fakultetin e Artit Dramatik-Shkup. Shfaqjet e tij teatrore janë prezantuar në kuadër të disa festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare. Është shpërblyer me disa çmime për regjisor dhe për shfaqje më të mirë, ndër të cilat çmimi “Kult” për regjisor të vitit në Shqipëri (2010), për shfaqjen “Kush ka frikë nga Virginia Wolf”, e realizuar në Teatrin Kombëtar në Tiranë; çmimin për shfaqjen më të mirë të vitit në Kosovë (2015), për shfaqjen “Shërbëtori i dy zotërinjve”, shfaqje e realizuar në Teatrin e Prizrenit. Është autor i dramës “Shpresë në ikje”.  Momentalisht është docent në katedrën për regji teatri në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup.

**Kushtrim Zendeli**, gjatë vitit 2016 ka kontribuar në rubrikën Shëmbëllime në PanAlbanica. Adhurues i artit, posaçërisht atij letrar. Me profesion është mjek stomatolog nga Kërçova. Ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës.
Shkruan poezi dhe prozë. Edhe pse i diplomuar në një fushë krejt të ndryshme, nuk iu nda penës, shkrimeve të ndryshme artistike dhe pjesëmarrjes në evenimente të ndryshme kulturore.

Pas përfundimit të studimeve deridiplomike ne fushën e Shkencave Politike në Universitetin e Evropës Juglindore ne Tetovë, **Liridona Veliu** përfundoi studimet pasuniversitare për Paqe dhe Transformim Konfliktesh në Universitetin e Baselit në Zvicër dhe Universitetin e Innsbruckut në Austri. Ajo ka akumuluar përvojë në analizë diskursi (politik) me një fokus mbi emigracionin dhe integrimin, ndërtimin e paqes, marrëdhënieve ndëretnike dhe 'ballkanizimin', nëpërmjet ndihmës hulumtuese dhënë institucionet si Universitetit të Malmös në Suedi dhe Fondacionit Swisspeace në Bernë. Ajo është aktualisht duke vepruar në kuadër të projektit Erasmus+, për themelimin e një kurrikule universitare në fushën e Studimeve të Paqes në Gjeorgji (PESTUGE). Liridona do të përqëndrohet në hulumtimin mbi 'ballkanizimin' dhe integrimet euro-atlantike të Ballkanit Perëndimor si doktorante në Universitetin e Qytetit të Dublinit (DCU) në Irlandë që nga shkurti i 2017-ës.

**Mensur Mamuti**, redaktor përgjegjës i rubrikës Gjë(ra) egjëza në PanAlbanica është inxhinier i Shkencave Kompjuterike dhe punon në UEJL, në sektorin për Dizajn dhe Multimedia. Që nga 1994 është redaktor kryesor i kuizit të diturisë, "Ramazani". Autor dhe botues i Revistës enigmatike "Rebusi". Autor dhe udhëheqës i programeve "Rebus-Bleta" dhe "Enigma" në radio të ndryshme në Tetovë. Gjatë viti 2004 ka qenë autor dhe regjisor i programit televiziv "Mix Age" në TVM. Që nga viti 2016 është redaktor përgjegjës i rubrikës enigmatike "Koha e lirë" në gazetën "Koha" që botohet në Shkup. Është autor i revistës "100 fjalëkryqe për 100 vjetorin", në 100-vjetorin e Pavarësisë.

Pas studimeve në fushën e përkthimit dhe letërsisë gjermane në Institutin e Gjuhëve dhe Përkthimit në Munih dhe në Universitetin e Prishtinës, **Ramize Ferati** karrierën e saj e ka nisur në vitin 2002, si mësimdhënëse në Shërbimin Gjerman për Shkëmbim Akademik (DAAD) në Prishtinë. Në

kuadër të angazhimit të saj shumëvjeçar si përkthese-interprete në organizata dhe institucione ndërkombëtare, nga viti 2007 është përqendruar në fushën e diplomacisë, politikës si dhe të drejtave të fëmijëve. Së fundmi ka qenë angazhuar si mësimdhënëse në Webster Public Schools në shtetin federal Massachusetts të SHBA-ve dhe i është përkushtuar pedagogjisë me theks të veçantë në rolin e arsimit në zhvillimin e shoqërisë. Ka përkthyer dhe shkruar një sërë artikujsh, studimesh e hulumtimesh nga fusha e diplomacisë dhe publicistikës.

Pas përfundimit të Fakulteti të Gazetarisë në Tiranë, **Shesedin Ibrahimi** profesionin e gazetarisë e ka ushtruar në disa media lokale dhe nacionale. Fillimisht punon në radion lokale "Radio Tetova", radio e cila gjatë Luftës së vitit 2001, luajti rol të rëndësishëm në informimin e drejtë dhe objektiv, jo vetëm në Maqedoni, por ishte burim informacioni edhe për mediat ndërkombëtare. Si korrespodent nga Tetova, ka punuar edhe në disa gazeta të njohura ditore, si "Koha Ditore", "Lajm Maqedoni" dhe më pas edhe si korrespodent kryesor nga Tetova i Televizionit të Maqedonisë - programi në gjuhën shqipe. Aktualisht punon në Zyrën për marrëdhënie me publikun në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Gjatë punës si gazetar, përveç lajmeve ditore ka shkruar edhe reportazhe, komente dhe shkrime hulumtuese. Shkrimet e tij të fundit në PanAlbanica kryesisht trajtojnë tema të aktualitetit politik në hapësirën shqiptare në Ballkan.

**Vjollcë Berisha** është pedagoge e letërsisë shqipe në Universitetin e Tetovës. Ka magjistruar në vitin 2010 për poezinë bashkëkohore, përkatësisht për poezinë e Ismail Kadaresë, me temë "Vëllimi "Shekulli im" i Ismail Kadaresë – gjeneza e frzmëzimit dhe modeli i ligjërimit". Është doktorante në fushën e Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2005 ka botuar përmbledhjen poetike "Në xhep kam një botë". Ka botuar artikuj e studime në revista shkencore e letrare. Jeton në Tetovë.

**Xhemazije Rizvani** është pedagoge e gjuhës dhe letërsisë në Universitetin e Tetovës dhe në Shkollën "Woodrow Wilson" në Tetovë. Aktualisht është në përfundim të tezës së magjistraturës me temë "Intertekstualiteti në poezinë bashkëkohore shqipe". Shkruan poezi e tregime. Është autore e disa artikujve, eseve dhe studimeve të botuara nga fusha e letërsisë.

## Përtejkumte


**Protesta Kosova dhe Shqiptarët**
Shemsedin Ibrahimi 16

**Shenjtërimi i Nënës Terezë – njohje e virtytit bamirës shqiptar**
Ard Halili 18

**Shqiptarët dhe rivaliteti politik maqedonas**
Shemsedin Ibrahimi 19

**Mosfunksionimi shtetëror i Maqedonisë**
Shemsedin Ibrahimi 21


## Përsiatje


**Jokohezioni shoqëror dhe shtetet multietnike**
Gurakuç Kuçi 24

**Viti i ri serb dhe vetja ime kolektive**
Albulena Halili 27

**Fenomeni i vlerës së fryrë**
Kushtrim Bekteshi 30

**Gjenocidi i ftohtë**
Albulena Halili 32

**Pse BE-ja po afron Serbinë dhe mban larg Kosovën**
Gurakuç Kuçi 35

**Mirëmëngjesi nga Brukseli!**
Albulena Halili 37

**Alternativa shqiptare e krizës – refleksion historik i padrejtësive**
Shemsedin Ibrahimi 39

**Reflektime kombëtare pas një loje futbolli**
Shemsedin Ibrahimi 41

**Mercenarizmi i mbështjellë me petkun e patriotizmit**
Kushtrim Bekteshi 43

**Mësimi i atdhedashurisë për yllkat dhe fatosat**
Ramize Ferati 46

**Shlivovica e Carit dhe bakllavaja e Sulltanit**
Kushtrim Bekteshi 50

**Donkishotët dhe mullinjtë e erës**
Vjollcë Berisha 52

## Përsiatje studentore

**Fuqia e shpresës**
Blerina Demiri 55

**Lindur femër...**
Blerina Demiri 57

**Edhe 364 ditë të tjera për vajzat**
Blerina Demiri 59

## Shëmbëllime

**Rrëfim i pazakontë mbi librat**
Kushtrim Zendeli 61

**Me mllef ju flas, me zjarr**
Liridona Veliu 62

## Mbrothësi

**Mbrothësia e përbashkët**
Arbën Xhaferi 69

**Çështja kombëtare shqiptare – pjesa e fundit e mozaikut të pabërë ballkanik**
Albulena Halili 74

## Agora

**Bashkimi**
Mendimet e personaliteteve 79

**Hallka e këputur e politikës shqiptare në Ballkan**
Editorial 81

**Vota shqiptare – për shqiptarët**
Editorial 84

## Me tejqyrë

**Rikthimi në gjeopolitikë**
Fatmir Arifi 88

**Dilema e sigurisë dhe dilema e integrimit**
Fatmir Arifi 92

**Një brez, një rrugë**
Albulena Halili 96

**Dinamika e zhvillimeve globale dhe paradoksi i OKB-së**
Fatmir Arifi 99

**Një NATO e gatshme për një botë të paparashikueshme**
Albulena Halili 102

**Kuajt trojanë të Rusisë brenda strukturave trans-atlantike**
Fatmir Arifi 104

**Sfida e rendit perëndimor në Ballkan**
Albulena Halili 109

## Kult-Ura

**Katër librat që duhet t'i lexojë çdo politikan përpara se të bjerë prej pushteti**
Xhemazije Rizvani 113

**Kadareja poet**
Vjollcë Berisha 116

**Në fillim ishte njëshi**
Xhemazije Rizvani 120

**Na të birtë e shekullit të ri**
Xhemazije Rizvani 122

**Për dashurinë dhe Grujën e parë**
Xhemazije Rizvani 124

**Mbi librin arkitektin gjenial të personalitetit njerëzor**
Vjollcë Berisha 126

**Njerëzimi nuk i meriton poetët**
Xhemazije Rizvani 128

**Në Korçë të shkosh... Për "KoKo Festën" të shkosh...**
Xhemazije Rizvani 133

**Ngashërim në vargje nga krahjeta e babait**
Vjollcë Berisha 136

## Përkoqisje letrare

**Tash po nisemi**
Jusuf Gërvalla 140

**S'kemi pasur vetëm orë të mira**
Vjollcë Berisha 141

**Pasaporta**
Agim Vinca 142

**Këngë Arbëreshe**
Vorea Ujko 143

**Arbëreshi në Ulqin**
Vorea Ujko 145

## Gjë(ra)egjëza

**Pangrami shqip**
Mensur Mamuti 147

**Rebusi**
Mensur Mamuti 148

**Elementet e rebusit**
Mensur Mahmuti 150

**Llojet e rebuseve**
Mensur Mahmuti 152

**Pangrami i përkryer**
Mensur Mamuti 156

## Sport

**Historiku i futbollit dhe topi në Tetovë**
Bujar Sinani 158

**Shqiponjat “pushtojnë” Francën për herë të parë**
Bujar Sinani 160

**Shqipëria, kjo «mace e zezë» për francezët**
Bujar Sinani 162

# PËRTEJKUMTE

# Protesta, Kosova dhe shqiptarët

*Shemsedin Ibrahimi*

Dhuna që përshkallëzoi në protestën e opozitës në Kosovë është dënuar nga të gjithë, por askush nuk i ka identifikuar (në tërësi) ata që kanë shkaktuar dhunë dhe shkakun që ka sjellë deri në këtë përshkallëzim të gjendjes së sigurisë.

Protesta e opozitës në Prishtinë, ka përshkallëzuar me dhunë, një orë pas nisjes, pasi udhëheqësit e opozitës kërkuan largimin e qeverisë. Ky ka qenë subjekti kryesor i të gjitha kumteve, duke përshkruar atë që ndodhi në protestën e fundit në njërin nga kryeqytetet shqiptare, Prishtinën.
Të gjitha lajmet kanë qenë të përqendruara në numrin e protestuesve dhe shumë pak në motivin,  deklaratat, apo analizën e asaj që po ndodhë.
Mediat elektronike, duke përfshirë edhe rrjetet sociale kanë qenë të mbushura me komente përkrahëse dhe kundërshtuese ndaj protestës dhe protestuesve.
Ambasadori amerikan Greg Delawie, duke bërë një koment në Twitter, shkruan:"Dhuna politike e kërcënon demokracinë dhe gjithçka që Kosova ka arritur që nga pavarësia e saj".
Në të njëjtën vijë ka qenë edhe ambasadori britanik në Kosovë, Ruairi O'Conell, i cili ka deklaruar se "Dhuna gjithmonë shkakton më shumë probleme se zgjidh. Shpresoj se liderët politikë, do të dënojnë dhunën dhe do të mundohen t'i zgjidhin problemet me dialog".
Kundër dhunës dhe shkatërrimit të pronës publike ka reaguar edhe Bashkimi Evropian, përkatësisht zyra e saj në Prishtinë.
Kryetarja e Kosovës, AtifeteJahjaga, ka reaguar ngjashëm, duke bërë thirrje që opozita të distancohet nga  dhuna dhe vandalizmi i protestuesve.
Ana tjetër e protestave ishte simbolika e saj. Numër i madh protestuesish, parulla kundër qeverisë dhe flamujt kombëtarë shqiptarë. Një fakt tjetër i parë nga të gjithë ishte edhe pjesëmarrja e disa protestuesve nga Tirana, që disa mediume kumtuan për përdorim dhune ndaj tyre nga ana e policisë.
Gazetaria dhe mediat në përgjithësi kanë një mision edhe pse ai nuk shprehet drejtpërdrejt. Ajo që duhej të bëhet nga mediat do të ishte përfshirja e më shumë informatave nga të gjitha viset shqiptare, e në veçanti nga Shqipëria dhe Maqedonia. Ajo që ndodhë në Kosovë ka ndikim edhe në Shqipëri edhe në Maqedoni. Politika e ekuidistancës, si duket ka bërë që shqiptarët të veprojnë ndaras në shumë çështje të rëndësisë gjithëkombëtare.
Një deklaratë nga zyrtarët e Tiranës dhe faktorët politikë shqiptarë në Maqedoni, do të ishte një ndihmesë për të kuptuar atë që ndodhë në Kosovë dhe anasjelltas në Shqipëri, apo Maqedoni, Luginë dhe viset tjera shqiptare.
Ekuidistanca është e arsyeshme në politikën ndaj fqinjëve, por jo edhe ndaj vetë kombit. Nuk mund të ketë politikë të tillë brenda një kombi. Kjo e shkatërron atë, ose së paku e ç'orienton nga rruga natyrale e zhvillimit të tij.
"Është shumë lehtë të shkatërrosh Shqipërinë dhe Kosovën, mjafton të sajosh

një vrasje të një lideri të tyre dhe të akuzosh palën kundërshtare ata janë të gatshëm të luftojnë deri në shfarosje", deklaroi ish shefi i sigurimit kombëtar serb. Kjo deklaratë sikur ishte maja e një mozaiku të krijuar nga vetë shërbimet e shteteve fqinje, të cilët mendojnë se me nxitje të politikës vëllavrasëse dhe përhapjes së defetizmit, do t'i gjunjëzojnë shqiptarët edhe atë në momentin më të favorshëm të tyre në skenën ndërkombëtare dhe kombëtare.
Kokat e kombit, duhet të flasin, të thonë mendimin e tyre pa u frikësuar se kjo do t'ua ulë rejtingun, ose do të keqkuptohen. Gjendja është serioze dhe koha kërkon mendje të pastra, të kulluara të mendimit dhe veprimit politik shqiptar, pa ekudistancë, pa hatërmbetje dhe pa përçarje.

*Botuar më: 26 janar 2016*

# Shenjtërimi i Nënës Terezë – njohje e virtytit bamirës shqiptar

*Ard Halili*

Në të gjitha viset shqiptare lajmi për shenjtërimin e Nënë Terezës është pritur si një ogur i mirë, duke e vlerësuar këtë si një njohje që i bëhet shenjtërisë dhe virtytit bamirës, që buron nga prejardhja dhe gjenetika e saj shqiptare.

"Nëna Terezë, për më pak se një vit do të jetë shenjtorja më e re botës, ndërsa shqiptarët do ta kenë edhe një përfaqësuese të tyre në tempullin e të shenjtëve, duke iu bashkuar shenjtorëve tanë ilirë, si Shën Asti i Durrësit, Shën Flori dhe Lauri i Ulpianës, Dardanisë, Shën Niketa dhe Shën Jeronimi", ka deklaruar Dom Lush Gjergji, njëri nga biografët kryesorë të Nënës Terezë.

"Nëna Terezë është e parëlindura shenjtore shqiptare e shekullit të ri dhe me siguri, një uratë për lumturimin e 40 martirëve shqiptarë.", theksoi kryeministri Edi Rama.

*Papa Françesku ka nënshkruar të martën, më 15 Mars, dekretin për shenjtërimin e Nënës Terezë, Nobelisten e Paqes dhe figurën botërore të bamirësisë, e cila do të shpallet shenjtore më 4 shtator të këtij viti, njoftoi Vatikani*

"Nëna Terezë e kaloi një jetë tërë në shërbim të njerëzve nevojtarë, duke u bërë simbol i mirësisë, dashurisë dhe solidarizimit me njerëzit e vuajtur në gjithë globin", ka shkruar presidenti i ardhshëm i Kosovës Hashim Thaçi.

Vendi i kremtimit ende nuk është bërë i njohur. Kisha e Indisë ka insistuar që për këtë festë Papa argjentinas të vijë në Kalkutë, por në ditët e fundit shumë burime në Vatikan kanë siguruar se një udhëtim i tillë nuk ishte në rendin e ditës dhe se shenjtërimi do të ndodhë në Romë.

E lindur më 26 gusht të vitit 1910, Anjezë Gonxhe Bojaxhiu u bë murgeshë kur ishte tetëmbëdhjetë vjeçe dhe u dërgua për mësimdhënie në Indi. Pastaj, në vitin 1950, ajo themeloi urdhërin e saj të murgeshave, të quajtur Misionaret e Bamirësisë, i cili tani ka plot 4500 murgesha. Nobeliste e Paqes në vitin 1979, Nëna Terezë vdiq në Kalkutë në vitin 1997. Ajo vazhdon të jetë një shembull i përkryer i shërbimit për humanizëm.

*Botuar më: 17 mars 2016*

# Shqiptarët dhe rivaliteti politik maqedonas

*Shemsedin Ibrahimi*

Dëshira për të mposhtur me çdo kusht rivalin politik ka krijuar një mjedis të paqartë në politikën e shqiptarëve në Maqedoni, duke i larguar partitë politike nga problemet reale që kanë shqiptarët. Krijohen kauza të huaja që në shikim të parë, duket se janë për të mirën e përgjithshme të "qytetarëve", por në fakt janë kauza që i shërbejnë vetëm idesë së mbajtjes së status quo-së lidhur me pozitën e shqiptarëve dhe përdorimin e tyre si hipoteka dhe argatë që i kryejnë punët e pista.

Që ky mjedis të mjegullohet edhe më shumë, disa individë, analistë, udhëheqës emisionesh dhe udhëheqës organizatash, po përpiqen t'u thonë shqiptarëve të Maqedonisë se e keqja më e madhe e tyre është qeveria Gruevski. Sipas tyre, tani është e rëndësishme që Gruevski të "bjerë" e pastaj do të "flasim" për çështjen tuaj dhe përgatituni për të ardhmen, që është Zaevi.

Bëjnë thirrje për të protestuar për mbrojtjen e Kushtetutës së Maqedonisë, për atë kushtetutë, të cilën ne me vite e kemi konsideruar si burim të të gjitha padrejtësive, që u janë bërë shqiptarëve dhe kauza të ngjashme. Realiteti bëhet edhe më i paqartë, kur ndjek edhe mediumet shqiptare në Maqedoni, të cilat debatin e përgjithshëm e kanë kthyer në një debat bardh e zi, ku dominon dyshja Gruevski-Zaev, kurse politikanët shqiptarë cilësohen si persona të padenjë për t'u matur në agorën e mendimeve të kësaj dysheje të fryrë nga popullariteti virtual. Në përgjithësi dominojnë temat me kërkesat e opozitës maqedonase dhe prokurores speciale.

*Idetë neoliberale të shpalosura nga partitë maqedonase me orientim të majtë kanë krijuar një klimë të tillë, ku të flasësh për kërkesat reale dhe pozitën e shqiptarëve në Maqedoni të cilësojnë si nacionalist, ose me ide të tejkaluara.*

Në kushte të këtilla, në Maqedoni, mediumet shqiptare ngrisin tema debatesh, që nuk çojnë askund përveç se e përforcojnë popullaritetin e politikanëve maqedonas, të cilët, me dallime në nuancë kanë të njëjtin qëndrim sa u përket veprimeve të tyre pushtetare ndaj shqiptarëve. Përdoret terminologji ngatërrestare politike, për të krijuar bindje se vërtet këtu ka veprim opozitar ose veprim politik të pozitës shqiptare, si "opozita e bashkuar shqiptare", "partneri shqiptar në pushtet", "me ardhjen tonë në pushtet", e ngjashëm.

E gjithë kjo do të ishte në rregull në qoftë se do të kishte një përkufizim tjetër të shtetit, ku shqiptarët do të kishin pushtet të vërtetë dhe fuqi vendimmarrëse.

Maqedonia me kushtetutë është e përkufizuar  si shtet i maqedonasve dhe pastaj i të gjithë të tjerëve. Ky përkufizim vetvetiu krijon varshmëri institucionale nga maqedonasit si popull shtet-formues  dhe në kushte të tilla shqiptarët gjithmonë janë ata që kërkojnë dhe kontestojnë. Maqedonasit janë zotëruesit e shtetit dhe ata që japin e marrin, ata të cilët e kanë përvetësuar dokumentin e pronësisë së shtetit.
Debati politik zhvillohet vetëm në një drejtim, duke anashkaluar debatin e vërtetë, sa i përket kërkesave të shqiptarëve, të cilët historikisht kanë qenë të qëndrueshëm dhe këmbëngulës në atë që e kërkojnë për pozitën e tyre në këtë shtet.

*Botuar më: 23 mars 2016*

# Mosfunksionimi shtetëror i Maqedonisë, shqiptarët dhe zgjedhjet

*Shemsedin Ibrahimi*

Një gjë është e sigurt, se kjo Maqedoni, siç e kemi ditur dhe njohur më parë, nuk ekziston ose nuk do të mund të ekzistojë më në të ardhmen.

Deklaratat e fundit, në të cilat theksohet jofunksionaliteti i institucioneve e plotësojnë vetëm edhe një pjesë të mozaikut, për të cilin shqiptarët po flasin me vite të tëra. Pra, një shtet, i cili nuk mund të garantojë pronën, jetën dhe privatësinë është shtet, i cili në të drejtën ndërkombëtare cilësohet si shtet jofunksional.

Ambasadori ShBA-ve në Shkup, Xhes Bejli, në një deklaratë për media, duke përmendur disa nga kushtet që Maqedonia duhet t'i plotësojë për të dalë nga kriza institucionale (zgjedhje të besueshme, reformat mediale, puna e prokurorisë speciale dhe çështja e emrit), tha se nëse këto kushte nuk plotësohen tërësisht, atëherë "Maqedonia mund që ta humbë përkrahjen e SHBA-ve dhe vendeve të tjera anëtare të NATO-s.".

*Nëse kriza politike në Maqedoni kërkon zgjidhje, atëherë kjo zgjidhje nuk duhet kërkuar vetëm te dialogu ndërpartiak. Për të përfunduar i tërë procesi me zgjidhjen përfundimtare të shumë çështjeve të hapura, duhet që dialogu të zhvillohet edhe me shqiptarët dhe për çështje shqiptare.*

Ambasadori i BE-së në Shkup, Aivo Orav, duke folur për kapacitetet institucionale kërkoi nga të gjitha palët e përfshira, angazhim maksimal që zgjedhjet të mbahen, pasi sipas tij: "Shteti juaj s'ka llogari të ketë zgjedhje të dështuara herën e ardhshme. Dita e ardhshme pas zgjedhjeve është jashtëzakonisht  e rëndësishme" – theksoi ai.

Zgjidhja e krizës politike të krijuar në Maqedoni nuk është vetëm krizë pozitë – opozitë, por është krizë gjithëpërfshirëse dhe këtë e dëshmojnë edhe ekspertët e huaj. Në momentin kur e tërë lufta zhvillohej rreth mbajtjes së zgjedhjeve me 24 prill, XhejmsPetifer, njohës i mirë i çështjeve të Ballkanit, është shprehur se "vendi ndodhet në teh të thikës". Këtë fakt, shumë më herët e kanë konstatuar shqiptarët e Maqedonisë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre politikë, por edhe nëpërmjet nismave të ndryshme, duke filluar që nga referendumi për një autonomi territoriale e kulturore (i mbajtur në janar të vitit 1992), bojkotimi i regjistrimit të parë të popullsisë dhe kuptohet në vitin 2001, me luftën e armatosur. Maqedonia që nga themelimi e deri më sot ka dëshmuar se është shtet institucionalisht jofunksional, jo se nuk ka institucione, por se ato institucione nuk përfaqësojnë edhe pjesën tjetër të popullsisë e që janë shqiptarët.

Që i tërë procesi të përfundojë me zgjidhjen e shumë çështjeve të hapu-

ra, që kryekëput kanë të bëjnë me shqiptarët, duhet edhe dialogu të zhvillohet me shqiptarët dhe për çështje shqiptare. Dialogu që po zhvillohet aktualisht, do ta bëjë vetëm zgjidhjen e disa çështjeve të pjesshme, por jo edhe të funksionalitetit të shtetit.

*Botuar më: 5 prill 2016*

# PËRSIATJE

# Jokohezioni shoqëror dhe shtetet multietnike

*Gurakuç Kuçi*

Shoqëritë jokohezive pësojnë kolaps ashtu siç pësoi Jugosllavia.
Më 25 janar ishte ditëlindja e largpamësit Arbën Xhaferi. Njeriut pikëpamjet e të cilit, teksa lexoja tek intervistat e bëra me Rudina Xhungën, e cila i ka mbledhur në një libër, nuk mund të mos i rilexoja deri sa nuk i kuptova dhe i mësova përmendësh.
Në njërën nga intervistat e tij, Xhaferi kishte thënë kështu:"Ne nuk ndikuam që të shpërbëhet Jugosllavia, as Austro-Hungaria, as Perandoria Osmane. Këto shtete u shpërbënë për shkak të tendencës historike që i dromcon këto shtete heterogjene pasi ato nuk janë ekonomikisht funksionale dhe nga aspekti shoqëror janë jokohezive. Shoqëritë jokohezive pësojnë kolaps ashtu siç pësoi Jugosllavia. Shoqëritë multietnike mund të funksionojnë nëse krijohet shteti multietnik, pra krijohen mekanizma që kontrollojnë mënyrën sesi funksionon diversiteti brenda atij shteti."

*Evropa në përgjithësi, por edhe Ballkani në veçanti, asnjëherë nuk kanë pasur një kohezion shoqëror, politik apo kulturor e madje as bashkëpunues, andaj edhe pikërisht në kontinentin e Evropës sot gjejmë lindjen e nacionalizmit dhe lindjen e balancës së fuqisë.*

Evropa në përgjithësi, por edhe Ballkani në veçanti, asnjëherë nuk kanë pasur një kohezion shoqëror, politik apo kulturor e madje as bashkëpunues, andaj edhe pikërisht në kontinentin e Evropës sot gjejmë lindjen e nacionalizmit dhe lindjen e balancës së fuqisë. Mirëpo, nacionalizmi dhe balanca e fuqisë nuk ishin gjëra edhe gjithaq të këqija, pasi ato krijuan unitetin, afruan popujt, secili popull krijoi identitetin, ekzistencën dhe mbijetesën e vet. Madje Xhaferi për nacionalizmin fliste me nota gjithmonë pozitive duke e quajtur atë "diga që lëviz popujt, që i çon ata përpara".
Ndërkaq, balanca e fuqisë arriti të krijojë një rend, të cilin duhej ta respektojë secili sepse kishte dinjitetin e mbijetesës dhe vetëmbrojtjes me aleatët e vet.Nëse kërcënohej aleanca apo rendi sigurisht që pasonte lufta. Kërcënimi i këtij rendi e sidomos i rendeve jokohezive, tregoi që aleancat joparimore nuk mbijetojnë, andaj pasuan luftërat e njëpasnjëshme.
Edhe perandoritë, të cilat duke u fryrë dhe duke mos pasur kohezion shoqëror, përveç që viheshin në pah shumë kërkesa, ato e prishnin edhe centralizimin e shtetit, pasi krijonin aq shumë shpërndarje të pushtetit saqë secili bëhej shtet brenda shtetit, e kështu paaftësia e kontrollimit të tyre, prishte kohezionin shoqëror dhe frynte perandoritë nga dekonspirimi i pushtetit deri në shpërbërje e luftëra të reja.
Jugosllavia, poashtu u shpërbë për shkak të interesave të mëdha dhe

diversitetit të papajtueshëm mes vendeve dhe popujve, e kjo papajtueshmëri e arriti kulmin kur Serbia kërkoi që të prishë një jokohezion për të krijuar një jokohezion tjetër me forcë.
Shqiptarët asnjëherë nuk e kanë gjetur veten në këto zgjidhje të problemeve për e mbrojtjen e interesave të tyre njëtrajtshëm dhe si pasojë çdo herë kanë qenë viktimë e projekteve të të tjerëve. Shqiptarët kurrë nuk kanë pasur një projekt madje as për të mbrojtur aspiratat e tyre, dhe doktrinë që do na bënte aleat me Perëndimin në bazë të parimeve të përbashkëta.
Si pasojë e mungesës së kësaj doktrine, sot shqiptarët po detyrohen të jetojnë dhe pranojnë projekte të multietnicitetit, projekte këto që janë treguar joefektive edhe në perandoritë e shtetet më diktatoriale.
Të njëjtat projekte në demokracitë e zhvilluara dhe moderne shfaqen nën petkun e multikulturalizmit, por së fundmi po duket qartë dështimi për jetësimin e tyre. Edhe vetë kancelarjaMerkel rishtas pati deklaruar se multikulturalizmi ka vdekur.
Krijimi i mekanizmave për funksionimin e multietnicitetit duhet të ketë disa baza.
Funksionimi i një shteti multietnik mund të jetësohet vetëm në vendet, të cilat kanë një traditë shtet-ndërtimi dhe mbi të gjitha nuk kanë një të kaluar të përgjakshme, e cila i bën armiq mes veti.
Shteti multietnik mund të funksionojë vetëm në vendet me stabilitet politik dhe kohezion shoqëror dhe jo në Ballkan, pasi shtetet multietnike në Ballkan janë të ndërtuara mbi shumë padrejtësi historike dhe si të tilla i bënë jofunksionale dhe jo unike pasi çdo herë theksohen padrejtësitë.
Shteti multietnik nuk mund të funksionojë në Ballkan përderisa armiqësitë në mes popujve janë gjithmonë në kërkim të diçkaje që i bën ngadhënjyes dhe etnikë, duke i larguar nga multietniciteti.
Nuk mund të funksionojë një shtet multietnik kur vetë etnitë e atij shteti nuk kanë një kohezion të brendshëm.
Paqja ka arritur kulmin e vetë vetëm kur secili komb ka arritur qëllimin e vet kombëtar brenda kufijve të tij dhe është larguar nga synimet ekspansioniste përtej kufijve kombëtarë apo etnikë.
Shtetet multietnike në Ballkan do të jenë madje edhe për një kohë jofunksionale, pasi janë të ndërtuara mbi baza të forcës, mos-konsensusit mes popujve dhe nëpërmjet pazareve politike që i ka mbajtur jashtë interesat e popujve pa përjashtim.
Duke mos funksionuar politikisht, sigurisht që vendet e tilla nuk mund të funksionojnë as ekonomikisht, pasi politika dhe institucionalizimi politik i qëndrueshëm, liberal-demokratik, ashtu siç pohojnë DaronAcemoglu dhe JamesRobinson në librin e tyre “Përse kombet dështojnë”, i lë popujt e Ballkanit në varfëri si pasojë edhe të politikave të imponuara nga jashtë, të cilat janë jofunksionale dhe i lënë këto vende të pazhvilluara ekonomikisht.
Pra, duke mos qenë të pjekur politikisht dhe institucionalisht, duhet së pari që të ndiqet rruga e stabilitetit të vendeve perëndimore, pra, kalimi nga uniteti etnik dhe stabiliteti etnik, pastaj institucionalizimi etnik e deri tek bashkëpunimi fqinjësor.
Vetëm arritja e një paqeje konsensuale dhe drejtësia e mirë-drejtuar nga Perëndimi në bashkëpunim të thellë dhe të hollë me elitën politike të Ballkanit dhe pa

imponime mund ta stabilizoj këtë rajon. Përndryshe me imponime të projekteve të tyre që nuk i shkojnë aspak për shtati Ballkanit nuk mund të arrihet askund, pasi duke vazhduar kështu asnjëherë nuk do të shuhen etjet e shteteve fqinje për t'i realizuar projektet e tyre për tokat shqiptare e sidomos projektet e Serbisë.
Por, pranimi i gabimit dhe vazhdimi i rrugëtimit drejt krijimit dhe realizimit të interesave me negociata të drejta dhe jo të imponuara me restrikcione nga bashkësia ndërkombëtare do të ishin opsionet fitimtare.
Bashkësisë ndërkombëtare, nëse do t'i interesoj vetëm paqja dhe jo drejtësia ashtu siç pohonte dikur edhe vetë Lordi Grey, nuk do të arrihet që asnjëherë të krijohet paqja, dhe si i tillë Ballkani gjithmonë do të mbetet një vatër e krizave. Mjetet multietnike për funksionimin e shteteve etnike, do të vazhdojnë të mungojnë dhe ato po vazhdojnë t'i bëjnë vendet e Ballkanit jofunksionale, përderisa kërkohet që brenda shteteve multietnike të krijohen instrumente politike etnike. Sot, në kohën kur qytetaria po ngrihet dhe po bën pjesë në vendimmarrje çdo herë e më shumë dhe në të njëjtën kohë bashkësia ndërkombëtare tenton që projektet e veta t'i imponojë pa pëlqimin e popullit, ato do të vazhdojnë të zgjojnë zemërimin e publikut dhe kundërshtimin e tyre, meqenëse duke mos qenë pjesëmarrës në informacionet e drejtpërdrejta ata kanë të drejtë të dyshojnë në projektet e të tjerëve për ta.
Veprime të tilla nuk është e thënë që të mos mund të fillojnë edhe nga vetë vendet e Ballkanit në përgjithësi apo shqiptarët e sidomos klasa akademike dhe intelektuale shqiptare në veçanti.

*Botuar më: 18 janar 2016*

# Viti i ri serb dhe vetja ime kolektive

*Albulena Halili*

Në një nga portalet serbe, i cili sipas të gjitha gjasave dukej të ishte nacionalist, në krye të tij shkruante: "7 године, 7 године, 10 месеци, 23 дана, 7 сати, 57 минута, и 29 секунди од како су нам отели Косово и Метохију", që në përkthim do të thotë "7 vjet, 10 muaj, 23 ditë, 7 orë, 57 minuta dhe 29 sekonda që kur na e kanë marrë Kosovën dhe Metohinë", dhe sekondat vazhdonin të ecnin… M'u qesh! Pastaj më erdhi keq për ta. Pastaj ndjeva krenari për veten time kolektive.
M'u qesh sepse ma kujtoi numërimin mbrapsht, zakonisht të vitit të ri. Për dallim nga ai, minutat e sekondat këtu s'po iknin. Ato po vinin për të mos shkuar më kurrë. Kjo ishte një klepsidërfunebre për ta, ndërkaq një klepsidër triumfi drejtësise për ne. Për fatin më të keq të një populli, që moti ishte kthyer në mallkim për ta, ata akoma besonin në rrenën e tyre të madhe. "Rrena është institucioni ynë, është arsyeja e mbijetesës sonë", kishte thënë njëri nga intelektualët e ideologët e tyre – Qosiq. Numërimi i tyre për humbjen e diçkaje që s'ishte e tyrja, vetvetiu më bëri të mendoj për mos-numërimin tonë për rikthimin e diçkaje që na përkiste neve. E kjo më dhimbte! Rikthimi i Kosovës është ndërmarrja më gjigante e kombit shqiptar që mund të tejkalohet vetëm nga lëvizja e Rilindjes Kombëtare Shqiptare që çoi në pavarësimin e Shqipërisë në vitin 1912. Është  lëvizja dhe njëkohësisht sakrifica më e madhe e një kombi për lirinë që i takon. Është vetëndriçimi i një kombi të vetëdijshëm për veten e vet. Është Rilindja jonë e dytë! Rikthimi ndodhi. Klepsidra serbe e përkthyer në atë shqiptare do të thotë 7 vjet, 10 muaj, 23 ditë, 7 orë, 57 minuta dhe 29 sekonda që kur Kosova është e pavarur dhe është shteti i dytë shqiptar. Por, a është Kosova e pavarur? Dhe a është shteti ynë? S'di pse më erdhi ndërmend Hobsi me Leviatanin e tij të famshëm dhe zajednica serbe brenda Kosovës.

*"Zgjohu, Kosovë, flakë e hershme e ashtit tim t`pelcitur.*
*Bota në ty le të kallet!"*

*Ali Podrimja*

## *Leviatani dhe Zajednica*

Në kohën kur u krijua rendi botëror, që pranohet të jetë krijuar pas Paqes së Vestfalisë në vitin 1648, njëri ndër mendimtarët më të njohur të këtij modeli, TomasHobs, shkroi veprën e tij të njohur "Leviatani". Vizioni i Hobsit mbi botën qe vendimtar për kohën, ndërkaq që krahasonte shtetet sovrane me garën mes gladiatorëve. Ai thoshte se shteti apo sovrani ofron siguri në këmbim të lirive individuale nga të cilat të cilat qytetarët kanë hequr dorë, me synimin e mbrojtjes së tyre nga

shteti. Kjo është arsyeja pse shteti duhet të jetë sovran. Të qenët sovran nënkupton se shteti nuk i nënshtrohet asnjë rregulli që mund t'i imponohet kundër vullnetit të tij.
Meqenëse bota akoma është e farkëtuar sipas sistemit vestfalian, atij ku subjekte kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare janë shtetet, sovraniteti vazhdon të jetë njëri ndër parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, përderisa akoma s'kemi një rend të ri që do ta relativizonte apo edhe suprimonte këtë parim.

### *Pavarësia dhe sovraniteti hibrid i Kosovës*

Pavarësia dhe sovraniteti shpesh, dhe do të duhej, të nënkuptonin binomin e pandashëm në rrethana normale dhe te shtetet normale, por kjo gjë s'ndodh në Kosovë. Kosova de facto nuk është as e pavarur, as sovrane.
Sovraniteti në radhë të parë nënkupton të drejtën e Kosovës për kontrollin e vijës së saj kufitare dhe tërë territorit, nënkupton ta ketë të mbyllur derën e shtëpisë në pjesën veriore të saj.
Së dyti, nënkupton kontrollin e resurseve natyrore dhe të kapaciteteve ekonomike, trashëgimisë së saj kulturore, nënkupton të drejtën e Kosovës për ushtri, nënkupton mospasjen brenda saj të strukturave paralele të Serbisë dhe integritetin e saj territorial.
Dhe së fundmi, sovraniteti nënkupton të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, që nënkupton edhe të drejtën për t'u bashkuar me Shqipërinë. Kjo, përveç që është e natyrshme, në të njëjtën kohë, siç e thotë madje Zhizhek: "çon në një konstelaciongjeostraegjik pak më logjik në Ballkan".
Përpjekjet për territorializimin e interesave etnike serbe në Kosovë përmes krijimit të bashkësisë së komunave serbe në Kosovë janë veprimi më jologjik dhe jokonstruktiv që është realizuar nën tutelën e BE-së. Këto përpekje pashmangshëm çojnë te procesi i bosnjëzimit të Kosovës, përjetësimit të shtetit paralel serb brenda saj dhe në fund deri te realizimi i doktrinave nacionaliste institucionale serbe për Serbinë e madhe në Ballkan.

## *Vetja ime kolektive*

Kadare përshkruan opsesionin që ka Serbia me Kosovën me fjalët: "Trualli ku është bërë një betejë, qoftë edhe fatale për një popull, nuk mund të përcaktojë, qoftë edhe pjesërisht "djepin" e tij". Megjithëse është një conditio sine qua non që Serbia ta pranojë faktin që Kosovën e ka humbur dhe të njohë Kosovën si shtet të pavarur, akoma më e rëndësishme se kaq është që ajo ta respektojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës dhe të mos angazhohet për ta bërë të pamundur funksionimin normal të këtij shteti fqinj. Kjo do ta çlironte dhe shëronte atë vetë, por edhe paqen e brishtë ballkanike. Procesi i çmitizimit dhe dekonstruktimit të historisë në Ballkan nuk duhet të nisë me shqiptarët. Përkundrazi ky proces duhet të nisë me serbët. Ata kanë më shumë punë se kaq, dhe e kanë me veten e tyre.
Vetja ime kolektive duhet të përmendet e ta kuptojë rolin dhe rëndësinë që ia ka dhënë kjo epokë. Ajo duhet ta kuptojë që koha po ecën për të, ndaj duhet të

punojë fort e pa kthyer kokën prapa në projektin dhe vizionin e saj. Ndërkaq fqinjët tanë duhet të mësohen një herë e mirë me praninë tonë të pash-mangshme e të njëmendët në këtë gadishull problematik.

*Botuar më: 18 janar 2016*

# Fenomeni i vlerës së fryrë

*Kushtrim Bekteshi*

Kur donin ta thumbonin ose ta përqeshnin dikë që i ishte 'rritur mendja', i thoshin: je fryrë si buka e furraxhisë. "Syrin ta ngop, por jo dhe barkun" – shpesh më sillet nëpër mend kjo thënie kur mendoj për fenomenin e një gjëje tjetër të fryrë në shoqërinë tonë – vlerën.

Gjatë kohës kur Kosova ishte nën okupimin serb dhe thuajse gjithë shqiptarët e Kosovës ishin larguar nga puna e mezi mbijetonin, gjëja që më së shumti e kujtoj gjatë qëndrimeve të mia atje është era e bukës së blerë. Çdo ditë familjarët e mi në Kosovë blinin nga dy qese përplot me bukë të sapopjekur, thuajse po shtronin sofrën për pesëdhjetë mysafirë të ftuar. Por, e vërteta ishte se gjithë ato bukë bliheshin për nevojat e një porcioni ditor për shtatë-tetë persona. Atë bukë aq shumë e fryeninfurraxhinjtë, aq sa po ta shtypje të mblidhej e tëra në grusht. Aq ishte vlera e vërtetë e asaj buke – sa një grusht, por receta enigmatike që përdornin mjeshtrit furraxhinj e bënte të dukej sikur të kishte dhjetëfishin e sasisë së vërtetë dhe me atë vlerë edhe e shisnin. Familjarët e mi shpesh bënin ironi me këtë fenomen të kohës duke thënë "kjo bukë syrin ta ngop, por jo dhe barkun". Kur donin ta thumbonin ose ta përqeshnin dikë që i ishte 'rritur mendja', i thoshin: je fryrë si buka e furraxhisë. "Syrin ta ngop, por jo dhe barkun" – shpesh më sillet nëpër mend kjo thënie kur mendoj për fenomenin e një gjëje tjetër të fryrë në shoqërinë tonë – vlerën. Vlera të fryra që shfaqen si kërpudhat pas shiut dhe promovohen me ngulm si të tilla, qoftë në politikë, gazetari, kulturë apo art. E pastaj fryhen e fryhen nëpër media, portale, kuluare, rrjete sociale, biseda kafenesh e besa edhe biseda akademike, sa thua ti ke të bësh me individë që kanë dhunti gjenialitetin. Mjafton t'ua heqesh fasadën, gjithë bujën që ua krijojnë mjeshtrit e propagandës, dhe si puna e bukës së fryrë, sheh se vlera e vërtetë e tyre është aq e vogël sa nuk vlen as të matet në kandar.

Po ku i ka rrënjët fenomeni i vlerës së fryrë që vjen gjithmonë i imponuar në mesin tonë!? "Furraxhinjtë" e këtij fenomeni gjithmonë janë të punësuar në furrat e pushteteve që për qëllim kanë kahëzimin e mendimit dhe shijes së masës aty ku ata duan. Ta kujtojmë pak sistemin monist të ish-Jugosllavisë. Në raport me shqiptarët pushteti në mënyrë sistematike, me direktiva të qarta ka investuar në krijimin e vlerave të fryra ndër shqiptarë, me qëllim që këta individë me idetë dhe qëndrimet e tyre mëpastaj ta ç'orientojnë masën nga aspiratat për të qenë të barabartë me kombet tjera që e përbënin federatën Jugosllave. Me një fjalë, nëpërmes këtyre vlerave të fryra, pushteti është përpjekur që t'ua lajë trurin me akull shqiptarëve dhe t'ua krijojë iluzuonin se jetojnë në një sistem që as me parajsën s'ka të krahasuar. Pushteti, me aparaturën e tij propagandistike impononte këto vlera të fryra që në librat shkollorë për filloristë, duke ua servuar fëmijëve heronjtë e kamufluar dhe autorët mediokër shqiptarë si modele të arritjeve më të mëdha të historisë dhe kulturës tonë. E njëjta metodologji aplikohej edhe në teatër ku aktorë të patalentuar promovoheshin si talentë të jashtëzakonshëm dhe "talentin" e tyre e kishin për detyrë ta shpërfaqnin kryesisht nëpër manifestime kombëtare, duke çjerrë zërin gjatë leximit të poezive patriotike dhe duke parakaluar si palaço rrugicave, të maskuar me petkun e heronjve kom-

bëtarë (imazhe të cilat kemi pasur rastin t'i shohim edhe në kohën e sotme). Sistemi monist, në anën tjetër, me të njejtën aparaturë propagandistike shfrytëzonte metoda çnjerëzore për t'i mbajtur nën hije dhe për t'i heshtur gjithë ata individë që përfaqësonin vlera të mirëfillta në fushën e profesionit ku ata vepronin, por që nuk i përshtateshin qëllimeve të pushtetit. Sigurisht, asgjë nuk arriti t'i heshtë në vendosmërinë e tyrë për t'i shërbyer kauzës kombëtare, edhe përkundër masave të tmerrshme represive që i ushtronte pushteti ndaj tyre. Fatmirësisht ai sistem dështoi në përpjekjen për zhbërjen e indit tonë kombëtar, gjë që e tregon realiteti historik i kohës së sotme. Por, edhe përkundër shpërbërjes së atij sistemi monist, jo se nuk mbetën fosile që ende edhe sot përpiqen të klonojnë e indoktrinojnë ndër të rinjtë idetë e një kohe të shkuar duke i përshtatur me rrethanat e sotme – por gjithmonë me të njejtin qëllim të sistemit të shkuar monist. Dallimi është vetëm tek metodologjia e propagandimit, mënyra e plasimit të ideve dhe servimit të "vlerave". Derisa në sistemin monist propagandimi bëhej në mënyrë direkte nëpërmes kanaleve shtetërore televizive dhe gazetave (që në atë kohë ishin të pakta në numër dhe i nënshtroheshin një cenzure të rreptë), prapseprapë qëllimet e kësaj propagande ishin më lehtë të identifikueshme dhe jorastësisht shumica dërrmuese e shqiptarëve të asaj kohe shumë shpejt dhe pa hamendje u rreshtuan në anën e intelegjencës që luftonte për kauzën kombëtare. Ndërsa sot, kur cenzura totale dhe masat represive duken çështje të një kohe të shkuar, propagandimi vjen i mbështjellë me letër të bukur zbukuruese dhe plasohet me elegancë nëpërmes mediave të shumta elektronike dhe të shkruara, sidomos nëpërmes "port-haleve" elektronike dhe rrjeteve sociale, duke krijuar kështu një mjegullinë për syrin e rëndomtë në identifikimin e informaconit të vërtetë nga dezinformacioni, gënjeshtrës nga e vërteta, vlerës nga antivlera. Prandaj sot, si kurrë më parë, na duhet prezenca e mendimit të thellë analitik dhe kritik, debateve përmbajtësore nëpër mediat elektronike dhe të shkruara, qoftë për politikën, historinë, gazetarinë, kulturën apo artin, me qëllim që mos t'i lihet shteg servimit të vlerave të fryra që për qëllim kanë kontaminin e ambientit tonë politik e kulturor. Në të kundërtën, në këtë kakafoni debatesh të çorientuara e inatçore që po mbizotrojnë në mesin tonë, në gjithë këtë lëmsh idesh, orientimesh dhe vizionesh për të ardhmen, në gjithë këtë arrogancë konfrontimesh në politikë, në gjithë këtë formë pa përmbajtje që kryesisht po mbizotëron në kulturë dhe art, rrezikojmë që "vlera e fryrë" të bëhet lehtë e pranueshme dhe si e tillë të arrijë ta kahëzojë mendimin dhe shijen e masës së gjerë. "Vlerave të fryra" që proklamojnë idetë neokomuniste ku shqiptarët duhet t'i rikthehen mandolinës e t'i bien çiftelisë, apo atyre që proklamojnë idetë neotomane ku shqiptarët duhet të rishkruajnë historinë dhe të zhyten në ujërat e turbullta të debateve ekstreme religjioze, u duhet dhënë një përgjigje e vendosur kolektive e mbarëkombëtare që ato ide përfundimisht duhet të flaken me rrënjë e farë nga realiteti ynë. Kjo përgjigje duhet të jetë e prerë, pa pardon dhe pa rezerva.

Po i kthehem përsëri bukës së fryrë nga kujtimet e fëmijërisë time. Familjarët e mi kursyen xhepin dhe ngopën barkun kur e kuptuan se duhej të fillonin vetë ta gatuanin bukën, e mos të lejojnë të mashtrohen nga furraxhinjtë e panjohur që iu shisnin bukën e fryrë që vetëm syrin ta ngopin, por jo dhe barkun.

# Gjenocidi i ftohtë

*Albulena Halili*

E pata lexuar "Mosmarrëveshjen" e Kadaresë me një frymë kur u botua për herë të parë. Atëherë, e mahnitur nga mënyra mjeshtërore e sjelljes së të vërtetave tona, e pata cilësuar si kryevepër shqiptare, libër të shenjtë shqiptar. Kohë pas kohe i kthehem këtij kryelibri për gjërat që më kanë dalë mendsh.
Kështu, tek po rilexoja kreun për shqiptarët e Maqedonisë, fetarizmin atipik shqiptar të tyre, për veprën makabre të shpërnguljes së tyre dhe shqiptarëve të tjerë të ish-Jugosllavisë për në Turqi, në një nga fusnotat e këtij libri hasa në konceptin "gjenocid i ftohtë". Kështu e emërton kryeshkrimtari këtë tretje të kombit shqiptar, siç vazhdon ai më tej. Koncept i dëgjuar, por kurrë i shkoqitur fill e për pe nga vetë ne.
Duke qenë se politikat gjenocidale kanë veprimtari shumëdimensionale, është e nevojshme që të bëhet një hulumtim i kujdesshëm për të dekonstruktuar thelbin e këtyre politikave dhe varianteve të implementimit.
Kuptimet tradicionale mbi gjenocidin i gjejmë te përkufizimet për Holokaustin. Për herë të parë termin gjenocid e përkufizoi juristi polako-hebrejRafaelLemkin, në vitin 1944, sipas të cilit, "Gjenocid është shkatërrimi i një grupi etnik. Gjenocidi nuk do të thotë patjetër shkatërrim i menjëhershëm i një kombi, përveç se kur kryhet përmes vrasjeve masive të të gjithë pjesëtarëve të një kombi. Gjenocidi mund të nënkuptojë një plan të koordinuar të veprimeve të ndryshme që kanë për qëllim shkatërrimin themeleve thelbësore të jetës së grupeve kombëtare, me qëllim të asgjësimit të vetë grupeve. Qëllimet e një plani të tillë janë ç'integrimi nga institucionet politike dhe shoqërore, nga kultura, gjuha, ndjenjat kombëtare, religjioni dhe qenia ekonomike e grupeve kombëtare, si dhe shkatërrimi i sigurisë personale, lirisë, shëndetit, dinjitetit, madje edhe jetët e individëve që u përkasin grupeve të tilla. Gjenocidi drejtohet kundër grupit kombëtar si tërësi dhe veprimet ndërmerren kundrejt individëve, jo në cilësinë e tyre individuale, por në cilësinë e pjesëtarit të grupit kombëtar." (Axis Rule in OccupiedEurope: LawsofOccupation – AnalysisofGovernment – ProposalsforRedress, Washington, D.C.: CarnegieEndowmentforInternationalPeace, 1944)
Megjithëse ky term, është konceptuar që në fillim për të përkufizuar dy procese të njëjta për nga qëllimi përfundimtar, të ndryshme vetëm nga kohëzgjatja dhe mënyra e realizimit, termi gjenocid s'është përdorur

*Nevoja e studimit të përkufizimit juridik të gjenocidit, sidomos nga studiues shqiptarë është e menjëhershme. Po aq e menjëhershme shfaqet edhe domosdoshmëria e shpjegimit të gjenocidit sipas kuptimit të dytë të dhënë nga Lemkin, gjegjësisht gjenocidi i ftohtë, të cilin ndonjëherë mund ta hasim në literaturë edhe si gjenocid i ngadalshëm.*

kurrë për të pasqyruar të dy kuptimet e tij. Gjenocidi në diskursin politik por edhe shkencor ka përfaqësuar vetëm veprimet sipas kuptimit të parë. Veçanërisht në rastin e çështjes dhe historisë shqiptare, ku akoma s'është pranuar ndërkombëtarisht as përdorimi i termit gjenocid sipas kuptimit të parë. Gjenocidi çam dhe ai i kryer në Luftën e Kosovës nuk janë pranuar akoma si të tillë. Nevoja e studimit të përkufizimit juridik të gjenocidit, sidomos nga studiues shqiptarë është e menjëhershme. Po aq e menjëhershme shfaqet edhe domosdoshmëria e shpjegimit të gjenocidit sipas kuptimit të dytë të dhënë nga Lemkin, gjegjësisht gjenocidi i ftohtë, të cilin ndonjëherë mund ta hasim në literaturë edhe si gjenocid i ngadalshëm.
Veprimet që karakterizojnë gjenocidin e ftohtë janë përfshirë padrejtësisht në kornizat ligjore brenda kuadrit të të drejtave të njeriut, qofshin kombëtare apo ndërkombëtare, por kurrë s'kanë arritur të pasqyrojnë faktorët kyçë që dallojnë dhunimin e të drejtave të njeriut nga gjenocidi i ftohtë: shkaqet dhe qëllimi përfundimtar. Në të gjitha rastet e gjenocidit të ftohtë shkaku është përkatësia kombëtare, ndërkaq qëllimi përfundimtar – asgjësimi i tërë grupit etnik.
Përveç planeve dhe operacioneve ushtarake serbe për spastrim etnik siç ishte Operacioni Patkoi e ngjashëm, gjenocidi i ftohtë është kryer ndaj shqiptarëve pa përjashtim, në kohë të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm. Ky gjenocid është mbështetur mbi një motiv – atë të inferioritetit të shqiptarëve në çdo fushë të jetës. Antishqiptarizmi ka qenë mënyrë e përshtrirjes së tyre, mënyrë e sundimit, mënyrë e krijimit të shtetit të tyre, mënyrë e jetesës dhe mbijetesës. Antishqiptarizmi i tyre është patologjik dhe është justifikimi i vetë ekzistencës së tyre. Andaj çështja kyçe ka qenë dhe mbetet jo çlirimi i shqiptarëve nga sllavët, por çlirimi i sllavëve nga fantazma e vetësajuar shqiptare. Kështu koncepti dhe programi koherent e ambicioz i spastrimit etnik ka ecur në histori paralelisht me gjenocidin klasik të realizuar në Luftën e Kosovës dhe atë të ftohtë të kryer në mënyrë sistematike ndaj popujve jo serbë në Ballkan dhe shqiptarëve në veçanti. Ky gjenocid i ftohtë i planifikuar përmes doktrinave dhe projekteve zyrtare nacionaliste serbe, të hartuara nga Akademia e Shkencave dhe institucione të tjera shkencore e shtetërore është shndërruar në mendësi dhe ndjesi e cila fatkeqësisht jeton edhe sot në të gjitha shtetet e Ballkanit ku sllavët jetojnë me shqiptarët.
Më shumë se një milionë shqiptarë të Maqedonisë kërkohet të jenë lojalë të një shteti i cili lëre që s'përfaqëson asnjë shqiptar dhe asgjë shqiptare, por madje është antishqiptar që në gjenezën e krijimit të tij. Lojaliteti i shqiptarëve të Maqedonisë i shprehur përmes politikave integruese dhe parimit të "pranisë së papranishme" nëpër institucione, qëllim final ka etnicizimin e një nocioni thjesht gjeografik dhe krijimin e një kombi politik maqedonas bashkë me shqiptarët si një e keqe e domosdoshme.
E habitshme se si një rajon ndërkombëtarisht, politikisht dhe ekonomikisht strategjik si Lugina e Preshevës, sipas Strategjisë për zhvillimin ekonomik afatgjatë të komunave të jugut të Serbisë Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, përbën zonën më të pazhvilluar të Serbisë. Sipas përcaktimit të nivelit të zhvillimit ekonomiko-social, këto tri komuna më shumë se tri dekada e mbajnë statusin e komunave më të pazhvilluara. Popullata shqiptare këtu jeton në një gjendje okupimi. Marrja e të drejtës së shtetësisë, moslejimi i librit shqip, si edhe instrumente të tjera të dhunës strukturore, të ngadalshme duke pozicionuar shqiptarët si qytet-

arë inferiorë, përbëjnë thelbin e gjenocidit të ftohtë që kryhet në këtë territor. Në kohën kur aktorë të ndryshëm vendorë e ndërkombëtarë, studiues e politikanë po punojnë për ndriçimin dhe pranimin ndërkombëtar të masakrave ndaj çamëve si gjenocid, shqiptarët e Malit të Zi po përballen me rrezikun e asimilimit përmes margjinalizimit të tyre politik, ekonomik e institucional.
Jashtë Shqipërisë viabël, shqiptarët jetojnë në gjendje emergjente e të jashtëzakonshme. Jo gjithmonë vetëm qëllimi i shkatërrimit apo asgjësimit, mund të përkufizohet si gjenocid. Sipas Lemkin, edhe planet e koordinuara me qëllimin e shkatërrimit të themeleve thelbësore të jetës së grupeve kombëtare merren për gjenocid. Dhe ky është një gjenocid i ftohtë, i rrënjosur thellë në doktrinat dhe ideologjitë tradicionale antishqiptare që jetojnë paradoksalisht edhe sot.

*Botuar më: 21 mars 2016*

# Pse BE-ja po afron Serbinë dhe mban larg Kosovën?!

*Gurakuç Kuçi*

Gjatë luftërave ballkanike të viteve 1912-13, Serbia pushtoi një pjesë të trojeve shqiptare me synimin që të siguronte dalje në Detin Adriatik, veçanërisht
në portin e Durrësit. Kjo u pa si një kërcënim për perandorinë e atëhershme të Austro-Hungarisë. Me përfundimin e Luftës së Dytë Ballkanike, Serbia mbeti aleati më i denjë i Rusisë në Ballkan dhe praktikisht, porti i Durrësit shihej si port i Rusisë.
Kjo, sigurisht se nuk u lejua nga fuqitë e shekullit të kaluar, të cilat ndërhynë për të krijuar Shqipërinë Londineze, me ç'rast gjysma e trojeve shqiptare mbetën jashtë Shqipërisë. Ishte e domosdoshme që Serbia të ndalej, sepse kishte një marrëveshje sekrete më Greqinë, që kufijtë e tyre të takohen në Shkumbin. Pavarësisht shumë konferencave ndërkombëtare, paqja në Ballkan, mbeti e brishtë përfundimisht sepse të gjitha strategjitë e fuqive të mëdha të kohës pasqyronin raportin e forcave dhe jo të drejtën historike të popujve.
Përkundër kësaj hapësire shumë të gjatë kohore, zona ballkanike nuk po arrin ta krijojë diferencën nga e kaluara e saj e largët. E gjithë kjo, nga një pjesë e komunitetit akademik po konsiderohet si "rikthimi në gjeopolitikë" që përshkruhet kështu:"Në mungesë të sistemit ndërkombëtar, shtetet e fuqishme kanë tendencë ti rikthehen vizioneve gjeopolitike para se të ulen në tavolinën për formësimin e sistemit ndërkombëtar, ku të gjithë do të mundohen të influencojnë sa më shumë hapësira." Këtu nuk mbetet jashtë as Ballkani.

*Në kuadër të këtij vakumi strategjik, Serbia po përdor një strategji të rafinuar, duke e mbajtur një këmbë në Moskë dhe tjetrën në Bruksel. Me këmbën e Moskës, Serbia po përfiton aksione politike, me këmbën e Brukselit, po i zbaton ato.*

Rusia më nuk është ajo e pas rënies së Bllokut Sovjetik. Strategjia e saj për t'u rikthyer fuqishëm në skenën ndërkombëtare po shoqërohet me destabilitet në shumë zona. Për më tej, Rusia historikisht ka qenë pjesë e sistemit ndërkombëtar. Rëndësia e saj as nuk mund të neglizhohet, por as nuk është e thënë që të tolerohen ambiciet e saj gjeopolitike. Preokupimi i SHBA-ve, i ndarë mes luftës kundër terrorizmit global dhe krizës në Lindjen e Mesme, e kanë zvogëluar rolin e saj në menaxhimin e disa fushave në Ballkan, duke prodhuar një vakum strategjik. Bashkimi Evropian po synon që ta plotësojë këtë vakum strategjik, por në mungesë të kapaciteteve të saj nuk po arrin të luajë një rol dominues në rivalitetet gjeopolitike kundrejt Rusisë. Kështu, ajo veç sa po e komplikon situatën, duke i trajtuar kundërshtarët historikë si partnerë thelbësorë, ndërsa partnerët historikë si pengues të paqes. Në kuadër

të kësaj strategjie, Bashkimi Evropian, për ta tërhequr Serbinë në orbitën e vet, si aleatin më të rëndësishëm të Rusisë, po e dëmton jashtë mase Kosovën në procesin e paqes në mes të Serbisë dhe Kosovës.
Nëse i referohemi një deklarate të dikurshme të Lordit Grey, i cili thoshte: "se nëse unë të paktën për një vit e kam siguruar paqen në Ballkan, nuk më interesон për drejtësi", atëherë kemi të bëjmë me një strategji të vjetër e të bërit politikë, jo në kuadër të konventave ndërkombëtare, por  bërja e paqes mbi bazën e raportit të forcave. Kur e bëjmë analizën e mungesës së forcave të BE-së, atëherë vijmë në konstatimin se rikthimi i SHBA-ve në plotësimin e vakumit strategjik në Ballkan është mëse e domosdoshme për të krijuar një paqe të qëndrueshme. Në kuadër të këtij vakumi strategjik, Serbia po përdor një strategji të rafinuar duke e mbajtur një këmbë në Moskë dhe tjetrën në Bruksel. Me këmbën e Moskës, Serbia po përfiton  aksione politike, me këmbën e Brukselit, po i zbaton ato.  Kjo politikë e rafinuar shumë shpejt ka për ta futur BE-në në një qorrsokak, ku duke synuar që ta heqë ndikimin rus mbi Serbinë, kësaj të fundit po i jep koncesione në dëm të Republikës së Kosovës.
Ne jemi të vetëdijshëm që Serbia nuk mund të ri-kthehet ushtarakisht në Kosovë, por presioni i Bashkimit Evropian kundrejt Kosovës për krijimin e Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, institucion me kompetenca ekzekutive, i cili do ta mbajë të paralizuar zhvillimin e Kosovës; themelimi i Gjykatës Speciale, me pretekstin e hetimeve të krimeve të luftës, që kinse i paskan bërë shqiptarët, e cila u themelua për t'i ekuilibruar krimet serbe dhe shumë gjëra të tjera, kryesisht janë koncesione të qëllimshme nga Bashkimi Evropian me synimet për ta tërhequr Serbinë nga orbita ruse.
Nga ana tjetër, vetë BE-ja: nuk ka përdorur asnjë lloj presioni për mos deklarimin e  qindra varrezave masive të të ekzekutuarve shqiptarë në luftën e Kosovës, nuk i kërkohet as ndëshkimi dhe llogaria për mijëra gra të dhunuara në Kosovë, nuk i bëhet presion as edhe për një kërkim-falje për pesë tragjeditë ballkanike, që i shkaktoi, e lëre më të kuptojë se strategjia e Bashkimit Evropian në Ballkan, do ta fusë përsëri Ballkanin në një krizë pothuajse të njëjtë me atë të vitit 1912-1913.

*Botuar më: 27 Mars, 2016*

# Mirëmëngjesi nga Brukseli!

*Albulena Halili*

Më 19 prill u bënë tre vite nga negocimi i Marrëveshjes së Brukselit, e cila kishte për qëllim integrimin e serbëve në institucionet e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Kosovës e pati ratifikuar këtë marrëveshje me gjithë rezistencën e madhe të opozitës, duke e integruar në legjislacionin vendor me statusin e marrëveshjes ndërkombëtare. Përkundrazi, Serbia as nuk e ka konsideruar marrëveshjen si ndërkombëtare, aq më pak e ka ratifikuar atë si ligj. Në qarqet nacionaliste serbe, kjo marrëveshje është konsideruar si marrëveshje tradhtare që ka pranuar shtetësinë e Kosovës.

Në të njëjtën datë të këtij viti, në Bruksel vazhduan bisedimet e ashtuquajtura teknike për gjërat jetike të Republikës së Kosovës.

Akoma pa gdhirë mirë, Marko Gjuriq, drejtori i Zyrës për Kosovën, nga Brukseli uroi: mirëmëngjesi! Me një buzëqeshje dhe kënaqësi që s'e mbante dot, para mediave ai foli për arritjet serbe në bisedat maratonike që kishin zgjatur më shumë se tetëmbëdhjetë orë. Suksesi ishte arritur në katër sferat kontestuese. E para, pas kësaj marrëveshje serbët do të mund të shkonin në Kosovë me letërnjoftimet e lëshuara nga Republika e Serbisë, kamionët që bartin materie të rrezikshme do të mund të hyjnë pa ndalesë në Kosovë, zgjedhjet e Serbisë do të mbahen edhe në Kosovë dhe e fundit, nuk do të ketë më ndalesa për vizitat e zyrtarëve serbë në Kosovë. Gjatë gjithë deklaratës së tij, Kosovës i referohej me emërtimin "krahina jonë jugore" ose "Kosova dhe Metohia".

*Gjithë kjo po ndodh para syve dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Këto porosi që vërtetojnë praninë e Serbisë në Kosovë apo Kosovën brenda Serbisë, mu siç shkruan në kushtetutën e saj, nuk po vijnë nga Beogradi, por nga Brukseli.*

Rroftë autonomia e Kosovës dhe Metohisë!

Gjithë kjo po ndodh para syve dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Këto porosi që vërtetojnë praninë e Serbisë në Kosovë apo Kosovën brenda Serbisë, mu siç shkruan në kushtetutën e saj, nuk po vijnë nga Beogradi, por nga Brukseli.

Në anën tjetër, në hapësirën mediatike në Kosovë, vendin kryesor kishte zënë liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, i cili do të bëhej me kushte, sikur edhe gjithçka tjetër. Flitej për Shtabin e Milionerëve, për koalicionin e ri opozitar të cilit i hiqeshin e ndërroheshin shkronjat sa hap e mbyll sytë, shkruhej për deklaratën e presidentit të ri i cili thoshte se "dialogu dhe normalizimi mes shteteve dhe popujve nuk ka alternativë". Për cilat shtete e kishte fjalën? Gjuriq kishte transmetuar krejt diçka tjetër në mëngjes. Ai thoshte se asgjë s'mund ta pengojë lëvizjen e lirë të njerëzve e mallrave, qoftë edhe atyre të rrezikshme në territorin serb. Po, po, territor serb e quante Kosovën, madje "krahina jonë rrugore".

Tek të nesërmen u zgjuan nga ëndrrat e bukura që kishin parë në Bruksel negociatorët shqiptarë të Kosovës dhe folën me popullin e vet. Tahiri deklaroi se "shumica e serbëve janë pajisur me letërnjoftime të Kosovës dhe përmes dialogut të Brukselit kemi arritur dhe po arrijmë integrimin e komunitetit serb sidomos nga pjesa veriore e vendit tonë duke shuar strukturat paralele ashtu siç është rasti me shuarjen e policisë paralele serbe, pastaj të ashtuquajturën mbrojtja civile, strukturat paralele të drejtësisë."
Cila palë po sheh ëndrra? Gjykoni vetë.
A janë krizat aktuale ballkanike shembëlltyrë e gjendjes në të cilën gjendet vetë BE?!
Presim e shohim.

*Botuar më: 21 prill 2016*

# Alternativa shqiptare e krizës – refleksion historik i padrejtësive

*Shemsedin Ibrahimi*

Është e qartë, Maqedonia po kalon nëpër një krizë e thellë politike, në të cilën është vështirë të krijosh një pasqyrë të qartë të gjithë asaj që po ndodh. Kush dhe kujt i bën lajka? Kush me kë po bashkëpunon? Kush ka realisht përkrahjen më të madhe te populli? Kush flet drejt, e kush bën propagandë?

E gjithë kjo ndodh kur e vendos veten në pozitën e një banori që jeton në Maqedoni. Nëse mendon si shqiptar i Maqedonisë, atëherë gjërat sikur qartësohen.

Duke filluar që nga pavarësia e Maqedonisë, e cila asnjëherë si e tillë nuk është pranuar nga shqiptarët e Maqedonisë (kujtoj këtu referendumin për pavarësi, i cili u bojkotua nga shqiptarët), agjenda shqiptare ka qenë pjesë e çdo bisede, konference, takimi ose thjesht fushate zgjedhore ose politike.

Elita politike dhe intelektuale e shqiptarëve të Maqedonisë deklarativisht e ka shprehur çdo herë këtë si pjesë e zgjidhjes së problemeve në këtë shtet, si diçka të domosdoshme ose pa të cilën ky shtet s'do të funksionojë.

Agjenda shqiptare ka qenë dhe është e vetme, unike dhe pjesë e zgjidhjes së krizës dhe problemeve të këtij shteti, pavarësisht se në shikim të parë duket se lufta po zhvillohet në "kampin e tyre" dhe brenda tyre. Nga takimi i dështuar i Vjenës u përvijua edhe një fakt i pamohueshëm, se shqiptarët janë pjesë e zgjidhjes së problemit dhe jo krijues të problemit. Derisa maqedonasit akuzonin njëri-tjetrin, përfaqësuesit shqiptarë, pa përjashtim, shprehën brengosjen e tyre për ardhmërinë e këtij vendi.

*E gjithë kjo që po ndodh në këtë vend nuk e lëkund agjendën shqiptare, sepse ajo është e konsoliduar dhe përvijuar nëpërmjet një procesi të natyrshëm historik dhe politik. Prandaj alternativa shqiptare e zgjidhjes së problemeve nuk është e zymtë, nuk është e pashpresë, por ajo është refleksion historik i padrejtësive dhe do të ngadhënjejë më në fund.*

Bashkësia ndërkombëtare, duket se po punon në qetësimin e gjendjes, duke lëshuar deklarata kërcënuese për bartësit e institucioneve kryesore maqedonase, se nëse nuk respektojnë marrëveshjet , Maqedonia do të izolohet. Në këtë drejtim është edhe emërtimi i përfaqësuesit special gjerman për Maqedoninë, JohannesHaindl , i cili do të duhet të ndërmjetësojë në zgjidhjen e krizës politike.

Në Shkup, nga ana tjetër po zhvillohen të ashtuquajturat revolucione dhe kontrarevolucione. Kurse përfaqësues të ca lëvizjeve dhe organizatave shqiptare sikur e prishën këtë atmosferë "revolucionare", duke protestuar kundër pushtetit.

Qasja shqiptare ndaj Takimit të Vjenës, dëshmoi edhe njëherë se shqiptarët janë faktor konstruktiv, i pjekur dhe vizionar. Futja e agjendës shqiptare në çështje të "huaja ideologjike" rrezikon të gllabërohet, asimilohet dhe zhbëhet, duke u bërë pjesë e agjendave me ngjyra në njërën anë apo "antiko-maqedonase" në anën tjetër.
Pas dështimit të takimit të Vjenës, partia shqiptare në pushtet, BDI, ftoi të gjitha subjektet politike të marrin përgjegjësitë që kanë para qytetarëve dhe të sjellin vendime në interes të tyre. Bashkimi Demokratik për Integrim kërkon që t'i jepet shans çdo procesi të mundshëm për tejkalimin e krizës që do ta kthejë vendin në agjendën e integrimit.
Partia Demokratike Shqiptare, edhe ajo pjesëmarrëse në bisedimet e Përzhinos, vlerëson se dështimi i takimit të Vjenës dëshmon qëndrimin e kësaj partie se qasja e subjekteve që përbëjnë aktualisht qeverinë është joserioze në raport me marrëveshjen politike të verës së kaluar.
Partitë e vogla shqiptare, të cilat akoma nuk kanë marrë legjitimitet nga votat e shqiptarëve po përpiqen që nëpërmjet protestave, qoftë vetanake apo duke marrë pjesë në protestat e opozitës maqedonase, të masin potencialin e tyre për zgjedhjet e ardhshme.
E gjithë kjo që po ndodh në këtë vend nuk e lëkund agjendën shqiptare, sepse ajo është e konsoliduar dhe përvijuar nëpërmjet një procesi të natyrshëm historik dhe politik. Prandaj alternativa shqiptare e zgjidhjes së problemeve nuk është e zymtë, nuk  është e pashpresë, por ajo është refleksion historik i padrejtësive dhe do të ngadhënjejë më në fund.
Marrë në përgjithësi asnjë nga partitë shqiptare, qoftë këto më të mëdha edhe ato më të voglat në thelb flasin në emër të shqiptarëve dhe kjo detyrimisht i lidh me kërkesat historike të shqiptarëve të Maqedonisë.
Ka huti në gjithë këtë katrahurë institucionale dhe është e vështirë të pozicionohesh, ta kesh qartësinë e duhur dhe të kuptosh se çfarë po ndodh, por një gjë është e sigurt – shqiptarët e kanë agjendën e tyre dhe ajo nuk është vetëm agjendë shqiptare në Maqedoni, ajo është agjendë mbarëkombëtare për shqiptarët e tërë rajonit.
E shqiptarët e Maqedonisë nuk kanë përse të jenë përjashtim!

*Botuar më: 5 maj 2016*

# Reflektime kombëtare pas një loje futbolli

*Shemsedin Ibrahimi*

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ai i Kosovës dhe liderët e shqiptarëve në Maqedoni, por edhe shqiptarët kudo nuk patën asnjë moment të brengosen për veprimet individuale të personave të caktuar (sepse veprime te tilla nuk kishte), gjatë pjesëmarrjes së shqiptarëve në Kampionatin Evropian të futbollit. Shqipëria dhe tifozët kuq e zi dëshmuan edhe njëherë se kanë zemër, se nuk ushtrohen as për vandalizëm e as për t'u treguar të tjerëve se sa të fortë e të ashpër janë. Për herë të parë komentuesit e sportit bënë më shumë komente për tifozët, për sjelljen e tyre, për pamjen e tyre. Fitues të këtij kampionati këtë vit janë shqiptarët, sepse ata mbushën titujt kryesor të gazetave dhe portaleve evropiane e botërore në dy aspekte: me lojën kundër Zvicrës, ku në fushë nga të dy ekipet kishte 16 shqiptarë, kur në një ndeshje luanin kundër njëri-tjetrit dy vëllezër, ku flamuri shqiptar merrte përmasa gjigande dhe në aspektin e dytë: në lojën kundër Francës, tifozët kuq e zi i dëshmuan botës se si duhet të mbështet ekipi kombëtar, se tifozët kundërshtarë nuk janë armiq po se janë miq që luajnë kundër njëri-tjetrit dhe ekipi kombëtar i futbollit dëshmoi se është i fortë, i konsoliduar dhe se mund të përballet më këdo, qoftë edhe me Francën.

Po të reflektohet esëll, kuptohet se kjo nuk u organizua, nuk u bë për t'u treguar të tjerëve se çfarë jemi, por se ne jemi këta, pra pjesa më vitale e Evropës. Ajo pjesë që Evropa që moti e ka humbur në karakterin e saj.

*Po të reflektohet esëll, kuptohet se kjo nuk u organizua, nuk u bë për t'u treguar të tjerëve se çfarë jemi, por se ne jemi këta, pra pjesa më vitale e Evropës. Ajo pjesë që Evropa që moti e ka humbur në karakterin e saj.*

Në fushën e futbollit ekipi shqiptar përfaqësohet me potencialin tërësisht unik, të pa importuar, të pa natyralizuar. Të gjithë futbollistët janë shqiptarë. Kur përballesh me Kombëtaren Shqiptare nuk përballesh me të tjerët, por thjesht me kombin shqiptar.

Gazetat franceze shkruajnë "Shqiptar ejani kur të doni". Pra shqiptarë, jo Shqipëri, jo tifozë. Të gjithë. Ky është imazhi ynë i vërtetë. Kështu na do Evropa, ashtu si jemi në të vërtetë e jo ashtu si duan ca të tjerë.

Disa nga gazetarët dhe opinionistët e njohur nga të gjitha trojet shkruan me tone pozitive për të gjithë atë që ndodhi dhe po ndodh në Francë. Jo se ata nuk janë profesionistë dhe të paanshëm, por se vërtet ishte ashtu.

Kemi një unison në shpërndarjen e imazhit të kombit shqiptar në botë. Një frymë e re po shfaqet dhe këtë po e dëshmojnë shqiptarët.

Kjo frymë, pritet të kaplojë edhe politikën shqiptare, e cila di të përshta-

tet për të qëndruar atje ku është, pra në pushtet, ose në opozitë, por gjithsesi diku në sistemin politik. Nuk zhbëhet, nuk hiqet kujtesa kolektive. Ky kampionat do të jetë pjesë e kolektivizmit tonë dhe individualitetit të theksuar.
Tani mbetet vetëm të presim! PO, në dreq le të shkojë gjithçka, mjaft kemi pritur. Shqipëria jonë po përvijohet ashtu si duam ne, me të gjitha tiparet dhe futbolli ishte ai që përçoi këtë energji kombëtare.
Në fillim të kampionatit evropian u bënë kalkulime se sa para iu duhet tifozëve të secilit shtet për ta ndjekur në stadium ekipin e tyre kombëtar. Shqiptarët ishin më me pak të ardhura. Kaq, askush më nuk e përmendi këtë sepse shqiptarët nuk pyesin për para, kur është në pyetje Shqipëria. Në të gjitha ndeshjet e futbollit, stadiumet e Francës u veshën me ngjyrën kuq e zi.
Tani presim! Kjo pritje si duket do të jetë e gjatë, por në fund sërish do të ngadhënjejë Shqipëria dhe shqiptarët. A nuk ishte kështu deri më tani?

*Botuar më: 20 qershor 2016*

# Mercenarizmi i mbështjellë me petkun e patriotizmit

*Kushtrim Bekteshi*

Tezat e sajuara për ekzistimin e fobisë ndaj islamit te shoqëria shqiptare, e së fundmi edhe fobisë ndaj kombit turk, nuk janë gjë tjetër pos manipulime të radhës që këta mercenarë e kanë për detyrë ta servojnë për debat dhe ta aktualizojnë ditë për ditë nëpër mediat e shkruara dhe elektronike. Gjithsesi, nuk mund t'u mohohet suksesi që kanë arritur në jetësimin e kësaj agjende, dhe fajin për këtë e kemi të gjithë ne që kemi lejuar të kapemi në kurthin e këtij debati të imponuar, që nuk po arrijmë dot ta çrrënjosim e ta shuajmë. Ishim shumë më mirë pa këto debate që vetëm ndasi krijojnë e kurrfarë dobie nuk sjellin. Ishim shumë më të përqëndruar në prioritetet tona si shoqëri, si komb dhe sigurisht shumë më të relaksuar, më paqësorë dhe më të drejtorientuar në përcaktimin fetar, cilido qoftë ai. E tani, kemi lejuar që të katandisemi si mos më keq.

Besoj të gjithë i kemi ndjekur komentet, statuset, opinionet, debatet agresive për religjionin që po zhvillohen tash e sa kohë dhe që janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë. Por, sa nga komentuesit, opinion-bërësit, gazetarët e status-shkruesit nëpër rrjetet sociale ndalen pak për ta analizuar zanafillën e debatit religjioz te ne?! Kush po e imponon këtë debat dhe kush po përfiton nga ky debat? A e kujton ndonjëri prej jush, se a kanë ekzistuar këto debate ndërmjet shqiptarëve jo me larg se para çlirimit të Kosovës? Unë me sa e kujtoj: NUK KANË EKZISTUAR FARË! Përkundrazi, për religjionet as që është debatuar, sepse në shoqërinë shqiptare gjithmonë çështja e besimit është trajtuar si e drejtë e pakontestueshme. Përveç kësaj, çfarë është edhe më e rëndësishme, përkatësia kombëtare asnjëherë nuk është ngatërruar me religjionin nga vetë fakti se kombi dhe religjioni përfaqësojnë dy çështje të ndryshme: e para është kolektive dhe e dyta është individuale, dhe duke qenë të tilla, nuk varen e as nuk rrezikohen nga njëra-tjetra. Ashtu është edhe sot dhe kështu do të mbetet çdoherë, pavarësisht asaj që çdo ditë e më shumë 'intelektualët mercenarë' po ngacmojnë ndjenjat e njerëzve dhe po përpiqen me ngulm që t'i bindin disa shqiptarë të konfesionit islam se qarqe të ndryshme islamofobe duan t'ua cenojnë lirinë e besimit, se duan t'i zhdukin nga faqja e dheut, e prandaj shqiptari mysliman i devotshëm duhet t'ia dëshmojë besimin Zotit duke përqafuar ekstremizmin e fanatizmin fetar që ta mbrojë fenë dhe nderin e familjes.

*Ngjarjet e fundit në Turqi, përveç se shkaktuan debate e komente të pafundme, shumica pa sens logjik, nxorën në pah edhe tendencat e 'intelektualëve mercenarë' të instaluar në shoqërinë tonë, detyra primare e të cilëve ka qenë dhe është, që sa herë që t'iu jepet rasti, të krijojnë ndasi e të shkaktojnë konflikte ndërshqiptare.*

Të gjitha këto deklarata e fakte të kamufluara që na servojnë këta mercenarë janë gjepura, po ja që shumë njerëz po bien pre e kësaj propagande konflikt-nxitëse. Prandaj, secili nga ne, para se te bëhet pjesë e këtyre debateve, duhet ta pyesë veten kujt i shkon për shtati ky debat religjioz ndërshqipar? Përgjigjen e gjeni tek pyetja: kush janë kundërshtarët e përbetuar të mirëqenies së shqiptarëve në Ballkan, e në historinë tonë më të re – kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës dhe të drejtave kolektive të shqiptarëve të trojeve? Duke e gjetur këtë përgjigje (që besoj se secili e di), do ta kuptoni lehtë edhe kush janë nxitësit, sponsoruesit dhe mbështetësit e 'intelektualëve mercenarë' që na mbijnë si bar i keq në çdo sistem e epokë. Ndryshojnë kapelat e ngjyrat si kameleonë dhe duan të na fusin vazhdimisht në vorbullat e debateve të turbullta, me të vetmin qëllim, krijimin e konflikteve dhe ndasive ndërshqiptare dhe devijimin e shqiptarëve nga orientimi i tyre i natyrshëm pro-europian. Të jesh pro-europian nuk do të thotë se do ta humbasësh të drejtën dhe lirinë e besimit, përkundrazi, është garanci dhe forcim i asaj të drejte dhe lirie. Të jesh kundër ekstremizmit fetar nuk do të thotë se ke fobi ndaj fesë, përkundrazi dëshmon se je kundër keqinterpretimeve dhe keqpërdorimit të fesë për qëllime të pista. Të jesh kundër ideologjisë neo-otomane ku islami shfrytëzohet për arritjen e qëllimeve politike (i ashtuquajturi islam politik), nuk do të thotë se je kundër kombit turk.

Tani, pas ngjarjeve të fundit në Turqi, sikur nuk na mjaftoi rënia në kurthin e debatit religjioz, por lejuam të katandisemi edhe në debate pro e kontra erdoganiste, në etiketime turkofile e turkofobe. Duke shfletuar portalet e faqet e gazetave të ndryshme, hasa në etiketime të tilla edhe në shkrim-komentet e Kim Mehmetit. Sapo lexova komentet e tij për ngjarjet e fundit në Turqi, sesi  më erdhi sikur dëgjova një tingull meteliku që hidhet në një xhep dhe bën 'crrring', tingull i ftohtë i një lire ari 24 karatëshe që i mbanin nuset dikur e që  besoj se edhe sot ende shiten nëpër dyqanet e Stambollit. E tani, pse na e nxori kokën Kimi Mehmeti në këtë debat pro e kontra erdoganist? Siç nuk e kujtoj të kenë ekzistuar debatet fetare te shqiptarët para çlirimit të Kosovës, ashtu edhe nuk e kujtoj që Kim Mehmeti para dhe pas shpërbërjes së federatës jugosllave të jetë shquar ndonjëherë për ndonjë veprimtari patriotike. Po me që ne shqiptarët harrojmë shpejt, përveç tij mund edhe dikush tjetër të bëj bé e rrufe se ai gjithmonë ka qenë patriot. Mund të gabohem, ndoshta edhe ka qenë pak patriot, anipse nuk iu dëgjua asnjëherë zëri i protestës në periudhat më të zymta për shqiptarët e Maqedonisë pas shkëputjes nga ish federata jugosllave, kur pushteti policor i Gligorovit dhe Cërvenkovskit diskriminonte, rrihte, burgoste e vriste shqiptarë për çdo ditë. Ndoshta po t'i kishte Kimi portalet që i kontrollon sot, do ta kishte ngritur zërin!!! Ndoshta!!! Po, nejse. Nëse nuk ka qenë fare patriot më parë, mund edhe t'i falet, meqë u bë patriot i madh pas konfliktit të 2001- shit në Maqedoni, atëherë kur gati sa nuk e bëri tatuazh emblemën e UÇK-së e sa nuk i çjerri kordat e zërit duke folur në superlativ për Ali Ahmeti-n. Po çfarë ndodhi pastaj me dashurinë që shprehte ndaj Abaz Xhukës?! Pse pas disa vitesh doli publikisht e i kërkoi gjithë shqiptarisë falje që i kishte thurrur lavde Ali Ahmeti-t, e ai e paska zhgënjyer thellë?! A e kishte zhgënjyer thellë Aliu sepse e kishte lënë duarthatë, apo e kishte zhgënjyer thellë sepse e kishte tradhtuar idealin kombëtar me aktin e këputjes se lidhjeve të pushtetit me LSDM-në e Cërvenkovski-t?! Cila është e

vërteta, mbetet të shihet!
Që Kim Mehmeti ka qenë “druzhe Kim”, e pastaj koha ia imponoi të quhet “zotëri Kim”, për këtë ai s’ka faj, ndryshimi i sistemeve ia imponoi. Por që Kimi do të na bëhet edhe “efendi Kim”, kush do ta kishte parashikuar?! Kush, pashë perendinë, do ta besonte që Kimi na paska qenë mysliman i devotshëm dhe mbrojtës i të gjithë myslimanëve shqiptarë nga islamofobët botërorë e shqiptarë. Si ka arritur për aq shumë vite ky martir i heshtur ta mbajë e ta ruajë përbrenda me kaq fanatizëm këtë dashuri për Zotin dhe islamin dhe ta shfaqë mu tani në kohën dhe momentin e duhur historik, kur islami nuk na paska qenë kurrë më i rrezikuar nga islamofobët shqiptarë, që shkojnë aq larg sa marrin guximin edhe të komentojnë e të kritikojnë veprimet e Erdoganit. “Kanë sharë baba sulltanin, HEEEJ” – sikur dëgjoj klithjet e Kim Efendi Mehmetit drejtuar militantëve fanatikë, e mëpastaj lëshon alarmin “përgatisni turrën e drurëve e t’i djegim heretikët e kombit”. Duke analizuar devotshmërinë e tij ndaj Zotit, ndoshta erdha në një konkluzion të saktë: me siguri këtë dashuri për Zotin e ka ruajtur në heshtje me dekada, njëlloj siç e ka ruajtur në heshtje me dekada edhe patriotizmin që e ka shfaqur pikërisht në kohën kur kombi ka pasur më së shumti nevojë për të. Vërtet të ngazëllehesh nga martirizimi i këtij shpirti të vuajtur ndër dekada për komb e për fé. Pirolla të qoftë o Kim Efendi Mehmeti! Po të thellë e të fortë i paske pasur ata xhepa durimtarë, që në karrierën tënde prej “intelektuali të pavarur” u torturuan me dinarë e denarë, euro e dollarë, e tani edhe me lirat e Turqisë! Çudi si po të durojnë ende e nuk po të shqyhen ato xhepa!
Për ju që nuk i keni lexuar shkrim- komentet e Kim Mehmetit, ja një shkëputje citatesh: “Disa qendra me ndikim të madh opinionbërës në “Shqipëritë” tona, e veçanërisht në Kosovë, mbetën në duart e antifetarëve, të cilët vazhdojnë që – njësoj si në socializëm, kur çdo gjë e kontrollonin qarqet antishqiptare ideologjike sllave – patriotizmin shqiptar ta ndërtojnë mbi parimet antifetare, e kryesisht mbi ato antiislame! ”, dhe në një shkrim tjetër: “…të jesh i vetëdijshëm se po ua hoqe antiturqizmin dhe antiislamizmin, ata nuk do mundë ta sigurojnë as bukën e gojës, e le më të bëjnë karrierë politike, apo të shkruajnë analiza politike dhe të dalin në debate televizive!” E unë tani po pyes: çka do të mbetet nga Kim Mehmeti po ia hoqe mercenarizmin? Kur hajni akuzon për hajni, tradhtari për tradhti, komunisti për komunizëm, e mercenari për mercenarizëm, s’ka ku të shkojë më keq. Pirolla të qoftë o Kim Efendi Mehmeti!

Kim Efendi Mehmeti nuk po ndalet në ofenzivën e tij “patriotike”, po i fryen me të madhe zjarrit të debatit religjioz, po e etiketon si islamofob e turkofob çdo shqiptar që nuk pranon ta përziejë e ta shkrijë traditën shqiptare me ndonjë traditë të huaj, po luan me të madhe me ndjenjat e sinqerta të atyre që vërtet besojnë në Zot e fatkeqësisht bien në grackën e manipulimit të tij. Me shkrimet e tij po i jep kurajo rritjes së ekstremizmit fetar dhe po e favorizon me të madhe instalimin e islamit politik në shoqërinë shqiptare. E deri ku dëshiron të arrijë me këtë ofenzivë jeniçere kundër fortifikatave të kombit të vet, këtë do ta tregojë koha. Por që është duke i fryrë me të madhe zjarrit, po i fryen e s’po ndalet asnjë ditë. Por, thotë urtësia popullore: “kush i fryen zjarrit, digjet vetë në të”!

*Botuar më: 20 korrik 2016*

# Mësimi i atdhedashurisë për yllkat e fatosat

*Ramize Ferati*

Çdo mëngjes të secilës ditë pune, pesë minuta para fillimit të mësimit, nxënësit amerikanë ngihen në këmbë dhe të drejtuar nga flamuri me vija kuq e bardh
e me yje në sipërfaqen e kaltër, bëjnë betimin e flamurit. Pastaj, me dorën e djathtë të vendosur mbi zemër, këndojnë me zë himnin kombëtar. Këtë gjë e bëjnë si yllkat, të cilat zor se i kuptojnë fjalët që i thonë, ashtu edhe fatosat, të cilët tanimë kanë filluar t'i shtjellojnë konceptet e para të mësimit të kësaj simbolike.

Kjo traditë mund të perceptohet si jo e zakonshme për kohën, e çuditshme, madje edhe e tepruar, por për amerikanët është gjëja më normale në botë. Një ritual i rëndësishëm, nëpërmjet të cilit çdo ditë demonstrohet respekti për simbolet e historinë kombëtare, si dhe dashuria ndaj atdheut.

Nëpërmjet portretizimit të personaliteteve të shquara dhe përshkrimit të ngjarjeve që kanë përcaktuar rrjedhën e historisë së vendit, në mënyrë teorike dhe brenda aktiviteteve të tjera shkollore, nxënësve u mësohen shtyllat e atdhetarizmit.

Duke mbajtur të gjallë historinë e vendit, duke ua ngulitur në mendje se të drejtat e njeriut janë të drejta natyrale dhe jo të drejta që atyre ua jep qeveria, duke ua shpjeguar atyre detyrat që qytetarët kanë ndaj atdheut, duke i mësuar se si të jenë qytetarë të devotshëm dhe rëndësinë e trashëgimit të kësaj ideje (patriotizmit kushtetues), në sistemin amerikan të arsimit janë inkorporuar strategji përkatëse për t'u siguruar se fëmijët i kanë përvetësuar njohuritë mbi vlerat dhe virtytet që i karakterizojnë ata si qytetarë patriotë.

Mësimi mbi historinë e qytetërimit amerikan, por edhe simbolikën dhe kuptimin e saj, shtrihet edhe në lëndët e tjera, qoftë në lëndët hibride, ku përfshihen, për shembull, historia, gjeografia dhe edukata qytetare, por edhe në lëndën e artit figurativ, muzikës dhe aktiviteteve sportive. Vetëm sa për ta ilustruar: të alarmuar nga anketat, sipas të cilave, megjithatë, shumë amerikanë nuk e dinë tekstin e himnit kombëtar, Asociacioni Kombëtar Amerikan i Edukimit Muzikor para disa vitesh kishte rikthyer "Projektin e himnit kombëtar", me qëllim që të nxisë vetëdijen për nevojën e edukimit muzikor në shkolla dhe rolin e tij në të mësuarit e himnit kombëtar dhe të këngëve të tjera patriotike.

*Në Kosovë kjo temë bëhet edhe më e ndërlikuar për arsye të polarizimeve që janë shfaqur në shoqëri pas pavarësisë dhe që pa mëdyshje ndikojnë në opinionin publik lidhur me relacionin komb-shtet, gjë që pa pasur fare nevojë, por qëllimshëm është duke u imponuar si krizë e identitetit kombëtar.*

E gjithë kjo ndodh duke u nisur nga mendimi se fëmija nuk lind i

shkëputur nga historia, por lind në histori. Se njeriu, ndonëse në momentin e lindjes nuk ka kujtime për të kaluarën e tij, gjendet midis një tregimi të filluar para se ai të vinte në jetë dhe para se të bëhej një nga personazhet e atij tregimi. Me gjithë faktin se sistemi arsimor amerikan nuk është i centralizuar, se edhe vetë shtetet federale kanë autonomi arsimore, shumë shkolla kanë inkorporuar këto rituale të cilat është dëshmuar që janë frymëzuese për të qenë qytetarë të lirë dhe qytetarë atdhedashës. Ato janë përqafuar edhe më fort nga emigrantët me prejardhje nga vende ku janë shkelur në mënyrë të vazhdueshme të drejtat dhe liritë e njeriut.

Duke ua mësuar fëmijëve historinë dhe sakrificat e mëdha që individët, apo grupet e individëve, kanë bërë për të fituar dhe mbrojtur lirinë e tyre, ngrihet vetëdija se vlerat dhe liritë që fëmijët i gëzojnë sot, nuk janë arritur rastësisht dhe pikërisht mësimi për domethënien e këtyre simboleve kontribon në kuptimin e idesë së të qenit i lirë. Në qoftë se fëmijët mësojnë ta duan dhe ta çmojnë atdheun e tyre nëpërmjet aktiviteteve për vetëdijësim, ata do të jenë më të prirë të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, qytetarë aktivë në bashkësinë e tyre, në shtetin e tyre dhe në botë. Për më tepër, mësimi i atdhedashurisë është çështje kolektive, sado jetik të jetë vetëdijesimi individual për të.

Bashkëshortja e zëvendëspresidentit amerikan Dick Cheney, Lynne V. Cheney, në një raport të publikuar gjatë kohës që kishte shërbyer si udhëheqëse e Fondacionit Kombëtar për Studime Humane, kishte paralajmëruar për pasojat e mosbartjes në shkolla të njohurive për të kaluarën, duke theksuar se: "Një sistem arsimor, i cili dështon në mëkimin e kujtesës për të kaluarën, u mohon nxënësve të tij gjëra thelbësore: kënaqësinë e një mendimi të pjekur, lidhjen me brengat e vazhdueshme, këndvështrimin mbi ekzistencën njerëzore." Të qenit qytetar patriot sipas këtij botëkuptimi nuk e nënkupton në asnjë mënyrë lartësimin e vetes mbi të tjerët, siç keqkuptohet dhe keqinterpretohet kjo (jo rrallë qëllimshëm) sidomos në vendet ku kujtimi për luftën është akoma shumë i freskët. Në hapësirën ballkanike, të banuar me kombe e popuj të ndryshëm, të cilat kanë një histori të mundimshme për shkak të luftërave të vazhdueshme midis tyre, është pothuajse e pamundur të tematizohet çështja e atdhedashurisë, pa u interpretuar me automatizëm dhe në mënyrë të gabueshme si nacionalizëm ekskluziv.

Në Kosovë kjo temë bëhet edhe më e ndërlikuar për arsye të polarizimeve që janë shfaqur në shoqëri pas pavarësisë dhe që pa mëdyshje ndikojnë në opinionin publik lidhur me relacionin komb-shtet, gjë që pa pasur fare nevojë, por qëllimshëm është duke u imponuar si krizë e identitetit kombëtar.

Shikuar përtej simbolikës, si u duhet mësuar, pra, fëmijëve historia dhe dashuria ndaj atdheut – për shembull në Kosovë – kur gjysma e fëmijëve të këtij vendi e ka përjetuar vetë luftën e popullit për të qenë i lirë? Thjesht duke ua treguar të vërtetën. Pa zbukurime. Pa zmadhime. Pa demonizime. Të vërtetën lakuriqe. Të vërtetën, mohimi i së cilës do të na ndiqte si mallkim! Në vazhdim vetëm disa ide:

Fëmijëve u duhet mësuar historia jo vetëm si lëndë mësimore me orientim nga kompetencat e arritura, por duke iu ofruar nxënësve hapësirë për të nxitur dhe formuar mendimin kritik. Duke marrë parasysh faktin se mësimi i historisë mundëson, ndër të tjera, edhe shqyrtimin e ambivalencave të vendimeve politike, efekti i të cilave në të ardhmen është vështirë i parashikueshëm, kjo del të

jetë shumë e rëndësishme në kohëra krizash të mëdha politike.
Fëmijëve u duhet mësuar se historia nuk rishkruhet sipas nevojave politike të kohës dhe është detyrë e historianëve që të kujdesen që shënimet mbi të vërtetat e tanishme (historisë të së ardhmes) të mbahen mbi bazën e fakteve, në mënyrë që tregimet për të kaluarën të mos mbesin gojëdhëna, ose në rastin më të keq të shndërrohen në mite. Fundja ne mjaft jemi ankuar se historinë na e kanë shkruar të tjerët, apo se për zhvillime të caktuara në të kaluarën mungojnë të dhënat e shkruara.
Duhet mësuar fëmijët të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dhe të devotshëm, duke ua demonstruar me vepra dhe jo vetëm duke ua shpjeguar me fjalë se duhet treguar respekt dhe mirënjohje për njerëzit e shquar të shoqërisë, të cilët kanë kontribuar në lirinë dhe të drejtat që i gëzojmë ne sot.
Fëmijëve u duhet demonstruar me vepra se vota në një demokraci është e lirë dhe e drejtë legjitime që duhet shfrytëzuar, ashtu sikurse është legjitim kërkimi i llogarisë nga përfaqësuesit e zgjedhur, në mënyrë që të funksionojë demokracia dhe shteti i së drejtës.
Fëmijëve u duhet demonstruar me vepra që ligjet dhe rregullat e vendosura nga qytetarët që ne i kemi zgjedhur për të na udhëhequr duhen respektuar.
Fëmijët duhet mësuar se mund të mos pajtohen me qëndrimet apo veprimet e udhëheqësve të zgjedhur të institucioneve, por që institucioni duhet respektuar, sepse gjenerata të tëra para nesh ia kanë dedikuar gjithë veprimtarinë e tyre jetësore, madje edhe vetë jetën, ngritjes së atyre institucioneve.
Fëmijët duhet mësuar që në kuadër të një vizite në komunë, të mos kënaqen vetëm me faktin që e kanë parë zyrën e kryetarit, por edhe të kërkojnë përgjegjësi nga ai nëse rruga që ata përshkojnë për të shkuar në shkollë nuk ka shteg për këmbësorë dhe nuk ofron sigurinë e domosdoshme për fëmijë.
Duke u shkëputur nga mendimi individual dhe duke nxitur ndjenjën kolektive, fëmijëve u duhet demonstruar se të bëhesh qytetar i përgjegjshëm do të thotë që, së bashku me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, të kontribosh, për shembull, në ndërtimin e pullazit të një shkolle publike, pasi shkolla si godinë mund të jetë në pronësi ligjore të Komunës, por si institucion i shërben qytetarëve të saj.
Duhet t'i mësojmë fëmijët se trashëgiminë kulturore të një populli nuk e përbëjnë ekskluzivisht monumentet fetare; se traditat dhe zakonet popullore, edhe pse në kohëra të caktuara duken të dala mode, kanë një domethënie dhe duhen kultivuar, për arsye se janë dëshmi e zhvillimit tonë qytetar.
Atyre duhet t'u sqarohet hapur se pse Kosova, për shembull, ka një flamur shtetëror të ndryshëm me atë kombëtar. U duhet shpjeguar pse flamujt, pavarësisht të cilit komb janë, nuk shqyhen, nuk përdhosen.
Fëmijët duhet mësuar se gjithashtu atdhedashuri do të thotë që për detyrat, zgjidhja e të cilave i kapërcen mundësitë tona, duhet kërkuar mbështetje, pa u hamendur në mënyrë kryeneçe se u duhet vënë kapak vetëm sa për të qenë.
Kur të kemi kuptuar konceptin e kohës, do të jemi vetëdijesuar se e tashmja jonë është rezultat i bëmave tona në të kaluarën. Koha, popullit të Kosovës i ka përcaktuar fatin që përpjekjet shekullore për liri (tregim i filluar shumë më përpara) t'i kurorëzojë me shpalljen e pavarësisë dhe vënien e themeleve të shtetit. Të rinjtë shqiptarë e kanë këtë potencial dhe për këtë nuk duhet të ketë dyshime. Në vend të kësaj, me vigjilencë dhe me fuqi intelektuale, duke ndjekur politika kohezive, ata duhet udhëhequr dhe shoqëruar drejt arritjes së aspiratave

shtetërore.
Përcaktimi i kahes politike është shumë më e lehtë, krahasuar me rrugën që dëshirojmë të ndjekim si shoqëri përparimtare. Nuk duhet lejuar që fëmijët të krijojnë përshtypjen e gabueshme se hapja ndaj botës, pjesëmarrja në ekonominë globale dhe integrimi në strukturat euro-atlantike nënkuptojnë shkrirjen e identitetit kombëtar a kulturor.
Përkundrazi, vlerat gjuhësore, kulturore dhe sociale për një shoqëri moderne janë të paktën njëjtë të rëndësishme sa vlerat e përgjithshme ekonomike, demokratike dhe ligjore, të cilat janë shtuar si detyra për t'i integruar në sistemin e vlerave të përgjithshme. Mirëpo, nuk duhet harruar se ato, sikurse edhe liria e arritur nëpërmjet sakrificave të mëdha, nuk janë të garantuara përjetësisht. Ato vlera duhet promovuar dhe përsosur në vazhdimësi, duhen ruajtur dhe duhen mbrojtur për të mos rënë në grackën e vetëmohimit dhe për mos lejuar që historia e dhimbshme të përsëritet.
Fëmijëve, në radhë të parë, u duhet mësuar respekti për veten dhe kultura për punë të vazhdueshme për Shtetin, duke e rikujtuar parimin që e ka vënë Herderi duke thënë me të drejtë: „Ta ndjekim rrugën tonë… Le të flasin njerëzit mirë apo keq për kombin tonë, për letërsinë tonë, për gjuhën tonë: ato janë tonat, janë vetja jonë, e kjo është e gjitha".

*Botuar më: 4 tetor 2016*

# Shlivovica e Carit dhe bakllavaja e Sulltanit

*Kushtrim Bekteshi*

Është sa paradoksale, po aq edhe e neveritshme lufta e këtyre port-(h)aleve që tërë kohën proklamohen si media që janë kundër kontrollit të mediumeve nga politika, e në anën tjetër vetë janë futur me kokë e këmbë në shërbim të një partie politike, duke përdorur shantazhin e shpifjen si armën e vetme për të luftuar jo vetëm kundërshtarët politikë, por edhe çdo individ që ua 'shanë' ndonjë të preferuar të tyrin ose e demaskon publikisht mercenarizmin e pronarëve të tyre, të cilëve u ka ngelur meraku te shlivovica e Carit e tani me të njëjtin lezet janë duke ngrënë edhe nga bakllavaja e Sulltanit.

Shantazhi, i njohur si armë e fuqishme psikologjike e udb-së jugosllave, nuk është e huaj për nënqiellin tonë dhe pasojat e kësaj lufte psikologjike i kemi përjetuar të gjithë. U deshën shumë vite e shumë sakrificë nga një gjeneratë e tërë që t'u bëjë ballë këtyre agjendave shkombëtarizuese dhe ta rikthejë në kahen e duhur të rrjedhave të historisë orientimin tonë mbarëkombëtar pro-evropian.

Fatkeqësisht, është e vërtetë se kjo fitore e madhe historike u manipulua dhe u degradua nga individë të ndryshëm të politikës, por kjo aspak nuk e vë në pikëpyetje gjithë atë sakrificë dhe atë luftë të drejtë kolektive, e aq më pak nuk e vë në pikëpyetje orientimin tonë të natyrshëm pro-evropian. Vetëm për faktin që disa "intelektualë" (që kurrë nuk kanë qenë të rreshtuar drejt në binaret e çështjes kombëtare) kritikojnë manipulantët e luftës, kjo nuk duhet të na bëjë që ne symbyllur t'u besojmë e t'i përjetojmë si analistë me vlerë, intelektualë me taban kombëtar e heronj të kohës.

*Periudha parazgjedhore në Maqedoni ka krijuar ambient tejet të volitshëm për popullarizimin e port-(h)aleve që, në mungesë të skajshme të etikës dhe profesionalizmit gazetaresk, dinë vetëm të "godasin" me shpifje e shantazhe.*

E kaluara e tyre duhet të na rrijë gjithmonë parasysh e të na bëjë koshient që mos të manipulohemi nga fjalët e mëdha e nocionet autentike shqiptare që kujdestarojnë tërë kohën në fjalorin dhe shkrimet e tyre nëpër port-(h)ale. Këta megafonë të agjendave antishqiptare përmes port-haleve të tyre, duke marrë si adut kriminalizimin e një pjese të individëve të politikës shqiptare, duan ta kthejnë kokëposhtë rrjedhën e historisë dhe të na bindin se gjithë ajo luftë dhe sakrificë për kauzën kombëtare ka qenë e pavlerë dhe e dëmshme për mirëqenien tonë. Të na bindin në mënyrë shumë perfide se nuk duhet më ta kemi për zemre thënien e rilindësit Naim Frashëri se "dielli për shqiptarët lind nga perëndimi", por duhet të fillojmë të besojmë në një "rilindje"

tjetër: se dielli për shqiptarët lind nga lindja.
Nuk është për t'u befasuar që kjo luftë psikologjike e disa port-(h)aleve është bërë shumë aktuale pikërisht në këtë kohë kur misioni për degradimin e luftërave çlirimtare të shqiptarëve është aktivizuar me gjithë kapacitetet e saj nga ana e Serbisë dhe aleatëve të saj. Disa port-(h)ale të tjera, duke u nisur nga inatet personale, e kanë marrë në qafë veten dhe janë bërë pavetëdijshëm pjesë e këtij misioni, vetëm për faktin se e kanë marrë me shumë seriozitet thënien "për inat të resë, më vdektë djali".
Prandaj, të jemi me mendje të zgjuar e mos të lejojmë që bakllavaja e sulltanit dhe shlivovica e carit të na imponohen si racion i përditshëm, sepse shumë shpejt do të na godasë në kokë, do të na e helmojë stomakun e shpirtin e, si pasojë, do ta marrim në qafë edhe një gjeneratë tjetër, duke e detyruar të luftojë e të sakrifikojë gjithçka vetëm për ta përmirësuar naivitetin tonë dhe paaftësinë tonë për të lexuar midis rreshtash, për të parë përtej lajmit, përtej shantazhit, përtej shpifjes, përtej interesave tona personale, përtej frikës sonë për ta thënë publikisht dhe zëshëm të vërtetën për gjithë ata "intelektualë" e "gazetarë" që na shiten si mendimtarë të mëdhenj për çështjen tonë kombëtare e që, nga ana tjetër, tërë jetën janë ushqyer dhe vazhdojnë të ushqehen në kuzhinat e huaja.

*Botuar më: 1 dhjetor 2016*

# Donkishotët dhe mullinjtë e erës

*Vjollcë Berisha*

Disa orë para fillimit të "heshtjes zgjedhore" më rivjen shiriti i fushatës me të tëra detajet, me sllloganet shterpa që s'të bëjnë të mendosh e as t'i kujtosh më kurrë, me qindra kandidatë për deputetë, të shpërndarë në sa e sa lista partish, me mizëri tubimesh të vogla e të mëdha, me "bilborde" e fotografi kandidatësh, me programe të paguara politike, me biseda kryeneçe kafenesh, me tituj të mprehtë artikujsh gazete e portalesh e me gjithfarë xhingla-minglash të tjera që e bëjnë një fushatë parazgjedhore, nëpër të cilën kalon pastaj fati i akëcilit prej nesh.

Ai fat ndaj të cilit jemi mësuar të shfryejmë me dekada, sa herë dhe jo rrallë, ia ka ndërruar kahen historisë kombëtare apo zhvillimit të procesit që quhet çështje e shqiptarëve të Maqedonisë, e cila çështje mbijeton në një terren të vështirë, për të mos thënë në më të vështirin në Europë, midis një urrejtjeje patologjike, viktimë e së cilës ka qenë përherë, midis vazhdimësisë së doktrinave e programeve sllave që synojnë zhbërjen e saj. Mu kjo shfryerje e vonshme ndaj fatit, që vjen ekskluzivisht nga një numër i rrethuar dhe i hedhur (pa)diktueshëm në kutinë e votimit, është gënjeshtra më e madhe që mund t'ia bëjmë vetes kur jemi të prirur të votojmë symbyllur, pa u shkuar gjërave deri në fund apo, edhe më keq, për inate të vogla personale a për forcë zakoni. Është kënga e njëjtë që luhet sot e gjithë ditën në të ashtuquajturën "oazë  e paqes" e që në të vërtetë është "varka e Noes" që shpëton të gjitha llojet e albanofobisë  serbe për t'i riatdhesuar e për t'i vazhduar edhe më tej midis Evropës.

Është mu ajo kënga që përsëritet në çdo cikël zgjedhor e që ka në barkun e saj gjuhën e vrazhdë politike, urrejtjen e hapur ndaj shqiptarëve, arkëtimin e votave në llogari të sofistikimit të mekanizmave për shtypjen e shqiptarëve, madje edhe, në rastet më të mira, për zhdukjen e plotë të tyre.

*Për habinë e shumicës, njëra strofë e këngës kësaj radhe erdhi e re, pothuajse e ëmbël, trumbetonte shoqërinë qytetare, të drejtat që ne i merituakemi, shtetin që u dashka ta gëzojmë të gjithë së bashku e të tjera e të tjera. Po them për habinë e shumicës, pasi për disa që i zënë gjërat në eter, që i parandjejnë situatat, herët kishin rënë këmbanat.*

Për habinë e shumicës, njëra strofë e këngës kësaj radhe erdhi e re, pothuajse e ëmbël, trumbetonte shoqërinë qytetare, të drejtat që ne i merituakemi, shtetin që u dashka ta gëzojmë të gjithë së bashku e të tjera e të tjera. Po them për habinë e shumicës, pasi për disa që i zënë gjërat në eter, që i parandjejnë situatat, herët kishin rënë këmbanat. Ata e kanë ndjekur zhvillimin e kësaj ideje që para disa vitesh nga baballarët e opozitës maqedonase dhe pastaj kishin parë se si po jetësohej ideja përmes lëvizjeve qytetare, përmes organizatave joqeveritare e përmes krijimit të kauzave të vogla "të përbashkëta" që çonin ujë në të njëjtin

mulli, në mullirin e vjetër komunist, ku qe bluar imët doktrina për përvetësimin e shtetit dhe margjinalizimin e plotë të shqiptarëve. Tanimë, sa më shumë që rritej numri i atyre që, kush të paguar e kush në mënyrë vullnetare, e kanalizonin ujin në këtë mulli të vjetër, aq më donkishotë na shfaqnin ne të tjerëve që u dilnim ballë.
Dita e diel është momenti për ta thënë JO-në e madhe kundër mashtrimit të përsëritur. Sa herë që jemi gënjyer e u jemi përgjigjur ftesave për barazi, për bashkim forcash në luftë kundër armikut të përbashkët; sa herë që jemi gënjyer e kemi hipur në trena të gabuar, nuk kemi zbritur veçse në stacione të largëta, armiqësore, nga s'jemi kthyer më, apo kemi paguar tagre të rënda rrugës në kthim. Ata që sot ftojnë t'i mbështesim për të nesërme të përbashkët janë shefat e vjetër të shtetit që jo vetëm na zhvatën, por edhe na vranë e na fyen pa mëshirë. Tani kur u duhemi për ta mbajtur frymën, po bëjnë pjesën e vet të lojës: "Pakt edhe me djallin deri në arritje të qëllimit më të madh që kanë".
Ata që dje na quajtën me bishta, ata që këkuan dhoma gazi për ne, ata që na i helmuan fëmijët, na i përdhosën simbolet e na i mbyllën shkollat, ata që e ndërtuan shtetin monoetnik më jotolerant të Ballkanit, ata që të gjitha institucionet e larta të shtetit i quajtën me emrin e vet dhe me përcaktorët decidë të pronarëve të vetëm (kujto: Makedonski Teatar – Teatri Maqedonas, Televizioni Maqedonas dhe jo i Maqedonisë, Biblioteka Maqedonase, Opera Maqedonase, shteti maqedonas etj), sot po shfaqen me ngjyra laramane, me të gjitha nuancat e mashtrimit. Po dhe në qofshim të gabuar, dhe në e pastë ndërruar hujin bashkë me qimen ujku, s'kemi pse votojmë për subjekt të njëjtë. Secili le t'i masë forcat vetë, le t'i caktojë prioritetet e e së nesërmes dhe le të zhvillojmë debate konstruktive postzgjedhore për jetë më të mirë, për jetë të barabartë. S'ka pse e huqim qoftë edhe një votë. Në një shtet ku përdoren të gjitha mekanizmat për defaktorizim të fuqisë politike shqiptare, për përçarje sa më të madhe të trupit votues shqiptar, duke krijuar terrene të përshtatshme për mbirjen si kërpudha të partive politike (disa të aktivizuara me një buton të vetëm nga qarqe tejet armiqësore) sa herë që ndjehet nevoja e përçarjes më të madhe, në një shtet ku votohet në gjashtë njësi zgjedhore konform programit të humbjes së numrit të deputetëve shqiptarë, s'kemi pse i vëmë pikat mbi "i" me dorën tonë, me votat tona. S'ka vend për ëndrra laramane, përderisa s'ka pasur kurrë hapësirë për zgjidhjen e problemeve tona që janë të një natyre krejt tjetër nga ato maqedonase e që nuk zgjidhen përmes platformave të përbashkëta, përpos se përmes dialogut konstruktiv midis koalicionesh postzgjedhore nga subjekte me kërkesa e prioritete të qarta politike.
Kjo që po ndodh me trumbeta deri të dielën është zhurma. Druaj që heshtja vjen më pas.

*Botuar më: 9 dhjetor 2016*

# PËRSIATJE STUDENTORE

# Fuqia e shpresës

*Blerina Demiri*

Tani që po hedh hapat e parë si një studente rikthehem në fëmijëri për të parë edhe një herë ato ëndrra të projektuara mbi kornizat e surealitetit që tejkalonin çdo lloj perfeksioni dhe ktheheshin në iluzione, duke besuar se një ditë realiteti do i ngërthejë brenda vetes.
Me keqardhje kuptoj se ëndrrat mbetën aty, ndërsa realiteti vazhdon të jetojë me mua. E di që jam me vite dritë larg imazhit të jetës së ëndërruar. E di që s'mund të jem gjë tjetër veç pasqyrë e realitetit të kulluar.
Është e kotë ta mohoj sa e vështirë është jeta brenda kufijve ku unë dhe shumë studentë kemi fatin të jetojmë.
Një jetë, pastërtia e së cilës është e turbullt, mirësia e kërcënuar, bukuria e saj një mirazh, e ne thjesht të humbur brenda një mozaiku problemesh.
Unë nuk mundem të bëj gjë tjetër veçse të rend, të rend mes dallgëve të trazuara, të rend e të kërkoj dritën në fund të tunelit, në fund të kësaj errësire e cila po mjegullon çdo fije shprese.
Unë jam ndër qindra e mijëra studentë të cilët japin gjithçka në këmbim të asgjësë. Zvarritemi së bashku pa ditur ku shkojmë, çfarë kërkojmë ose më sakt ku ndodhet e ardhmja jonë?
Jeta na është shndërruar në një pyll të degraduar ku mezi depërton një copëz dritë, errësira ka mbuluar gjithçka, jetojmë si të vdekur mbi dhé, vrapojmë për të gjetur thesarin e jetës, por jo, gjithçka përfundon aty, tek interesi, gjithçka e lidhur me të madje edhe gjërat më të shenjta e shtrenjta tonat.
Të rinjtë kanë vizion për të ardhmen, kanë ëndrra të cilat dalin në jetë dhe meqë nuk gjejnë një vend për t'u jetësuar përplasen mbi truallin e ushqyer me tradhëti, mashtrim, pastaj zhduken përgjithmonë.

*Për të dalë prej "botës së errësuar" drejt një bote më të civilizuar, drejt botës së artit, drejt asaj bote ku kultivohet dija, duhet rikthyer vullneti dhe dinjiteti i rinisë universitare. Përderisa ajo paraqet fortifikatën bazë të dijes dhe zhvillimit, ndaj duhet vënë në ballë të proceseve të një kombi.*

Tani që po shkruaj, ndjej një shtrëngim brenda vetes kur kuptoj se duhet të shprehem me kaq pesimizëm por sado që mundohem të reflektoj e vërteta më shfaqet më e pastër se vet loti.
Është fakt që po jetojmë në një rreth struktura e të cilit është drejtpërsëdrejti e instaluar në kornizat e kriminalitetit, nuk funksionon as ligji e as ndëshkimi, përkundrazi të kesh problem me ligjin nuk ndodhesh prapa grilave, por fiton autoritet.
E si ta bëj veten të heshtë?
Si të duroj, kur më buçet si jehonë uturima e mijëra studentëve që i bashkohet zhgënjimit tim?!
Ushqehemi çdo ditë me të keqen. Nuk ka më ideal drejt të ardhmes. Jetë që bëhet normë e përditshmërisë sonë.

Gjendja e rëndë e moralit shoqëror duket qartë, ajo serviret në forma të ndryshme: nëpërmjet mediumeve të censuruara, arsimit të falsifikuar, politikës devijuese. Shpresat për një të ardhme më të mirë, përpara se t'i mbysim ne, po i shkel vetë koha!
Alternativat për shpresa të reja janë tretur e copëtuar për të mos u bashkuar kurrë në një shpresë të përbashkët, në një të ardhme më të ndritur.
Unë nuk kërkoj idealen, as që e synoj të mirën absolute. Dua thjesht të rrëzojmë murin që kemi ngritur rreth vetes, sepse jeta e secilit nga ne është betonizuar , ndërkaq egoizmi është i përhapur edhe jashtë kufijve të tij. Jemi në kërkim të një bote intelegjente, përpiqemi të shpikim armë bërthamore, përderisa akoma nuk e kemi zbërthyer bërthamën brenda vetes sonë.
Sado që sillemi si "elektrone të lira" ne jemi tërësi atomesh të posalindur, që me ngulm kërkojmë të jemi pjesë e bërthamës universale.
Është e rëndë të thuhet se numri i studentëve që largohen nga ky vend rritet çdo ditë e më shumë, sepse dëshirat e tyre nuk përputhen me atë se çfarë ky vend ofron. Largohen sepse këtu mungon kultura e mirëfilltë politike, parimet intelektuale e moralizuese, shoqëria e mirëfilltë demokratike dhe rruga civilizuese me parime të sigurta.
Largohen, por harrojnë se jeta bëhet akoma më e vështirë në një vend të huaj, atje s'të pret askush krahëhapur, gjithçka fillon të ndërlikohet. Ata lundrojnë vazhdimisht të frikësuar mos ndoshta dallgët do marrin drejtimin e gabuar e ata kurrë s'do përfundojnë aty ku kanë dëshiruar.
Dita-ditës kuptojmë se jeta nuk është plot dritë dhe neon, egozimi ka mbyllur gjithkënd në vetvete dhe nuk dimë më se çfarë kërkojmë, nuk dimë të dallojmë çfarë është e bukur dhe nuk bëjmë asgjë me ideal e pasion.
Vjen një moment kur i thua stop imagjinatës, e cila vazhdimisht kërkon rrugëdalje në labirinthin e realitetit sepse forca e dijes dhe dëshira s'do jenë kurrë çelës për të hapur dyert e së ardhmes. Të paktën këtu. Ti e di se për të jetuar e mbijetuar duhet të zhysësh duart në korrupsion, prandaj heq dorë me mendimin se ne kështu kemi qenë e kështu do vazhdojmë të rrojmë, s'kemi fuqi asgjë të ndryshojmë. Eh… në djall dëshirat dhe mendimet e mia!
Për të dalë prej "botës së errësuar" drejt një bote më të civilizuar, drejt botës së artit, drejt asaj bote ku kultivohet dija, duhet rikthyer vullneti dhe dinjiteti i rinisë universitare. Përderisa ajo paraqet fortifikatën bazë të dijes dhe zhvillimit, ndaj duhet vënë në ballë të proceseve të një kombi.
Ne si studentë do të duhej të bartim mbi supe pjesë të peshës së rëndë të një kombi, ndaj duhet shfrytëzuar energjia dinamike që kemi, për të krijuar vlera kulturore dhe shkencore, të cilat do jenë shtysë e përparmit dhe barazimit me kombet e zhvilluara të botës.
Ne kemi nevojë për përkrahje dhe besim që të krijojmë një intelekt sa më të kthjellët e më të shëndoshë. Pra, ne kemi nevojë për një ideal të përbashkët mbi të cilin do derdhim tru për ta arritur dhe jetësuar.
Të krijojmë një profil sa më përfaqësues i cili do personofikojë çdo student shqiptar, për ta mbrojtur, mbështetur dhe mbi të gjitha për t'i dhënë forcën e këmbëngulësisë.
Ne jemi ata tek të cilët përfundojnë sytë dhe shpresat e çdo qytetari: rinia universitare – kjo fije shprese që do mbajë ndezur çdo dritë mbijetese.

# Lindur femër…

*Blerina Demiri*

Ardhur në jetë nga dashuria, e dashurinë s'e njohu kurrë, shkelur e nënshtruar nga mungesa e vetëdijes, nga pamundësia e të qenit burrë, sepse lindi femër.
Dyshimi mbi ekzistencën e saj lindi bashkë me të, e bota u kthye përmbys si shenjë revolte. Askush nuk gëzoi, askush nuk uroi, në zi e gjithë familja, në zi e gjithë shoqëria… nuk ishte djalë.
Sidoqoftë erdhi në jetë, për të vërtetuar se femra lind dhe do të lindë aq sa bota të ndjejë shijen e njerëzimit.
E pavetëdijshme për fatin e saj, zbaton çdo ditë urdhërat dhe detyrimet që burrat e shtëpisë japin pa lëvizur qepallat e rënda, ulur në kolltuqe si "agallarë". E shkreta, akoma e re për të kuptuar se femra së pari është njeri dhe gjinia nuk ia mohon të drejtën e të qenit e lirë.

*Fakti që femra bën thirrje për barazi gjinore nuk përkrah seksizmin, aq më pak synon të fshijë nga piktura e botës figurën e mashkullit, ekzistenca e të cilit është e domosdoshme, thjesht kërkon respektimin e ndërsjellë të së drejtës esenciale për të jetuar dhe vepruar.*

E detyruar të lajë, të pastrojë, të gatuajë si parakusht për të rritur nderin e familjes kur të shkelë në "derë të huaj". Roli i saj si femër është të përgatitet për të qenë një grua e devotshme, pra të qenit femër është thjesht proces tranzicioni i frustruar dhe ndikuar nga ligjet e traditës që përjashtojnë çdo mundësi për të jetuar si e tillë, si femër.
E mohuar nga çdo gjë, e mohuar nga shkollimi, shoqëria e dashuria, sepse e tillë është vetë qenia e saj, e mohuar. E izoluar në një shtëpi, e cila nuk paraqet asgjë më shumë se një kornizë robërie brenda së cilës asaj i takon vetëm heshtja dhe bindja ndaj të tjerëve. E fjala? Ajo është për burrat.
Për ata "burra" që nuk u bënë burra kurrë, që nuk arritën në asnjë moment të kuptojnë se femra është thelbi i ekzistencës së tyre dhe jo makineri prodhimi, se femra është burim i pashtershëm i dashurisë, jo objekt dhunimi, se femra është vetë forca që ata burracakë ushtrojnë mbi të.
E si mund ta kuptojë esencën e të qenit femër ai që vetëm si mashkull e njohu veten, ai i cili dëshirën e femrës për t'u shkolluar e koncepton si një iluzion, realizimi i të cilit nuk është në përputhje me parimet e fanatizmit.
"S'ka ç'të duhet shkolla ty, nuk të kemi rritur të bëhesh "kurvë", fundja burrit nuk i duhesh si intelektuale, por si grua"- përgjigjet patriarku i shtëpisë sa herë që ajo femër kërkon të hedhë dritë mbi mendjet e errësuara.
E në fakt ajo është e vetmja dritë në kopshtin e mendjeve të shuara.
Të gjitha këto janë pjellë e imagjinatës patriarkale të një pjese të mad-

he të shoqërisë shqiptare, e cila vazhdon të jetë e izoluar dhe e mbërthyer nën kthetrat e kanunit. E ç'të duhet kanuni kur nuk di ta lexosh, ç'të duhet mendja kur nuk di racionalisht të mendosh, ç'të duhet jeta kur nuk mund ta jetosh? Sepse fundja jeta nuk mbahet vetëm nga fryma, përderisa atë e merr edhe kafsha, përderia injoranca vazhdon në paturpësi të dhunojë lirinë e femrës. Të kërcënojë dukshëm qenien e saj individuale e cila jeton për të dhuruar, punon për të jetuar dhe në fund, thjesht mbetet e gjykuar. E gjykuar për pamjen e saj, për veprimet që bën, e gjykuar për ndjenajt e saj personale, e gjykuar për gjithçka madje edhe për ekzistencën e saj. E skalitur nën ëndrra rinore, e udhëhequr nga dëshira vajzërore, nxit brenda vetes intelektin i cili lufton për tu shpërfaqur, për ti bërë ballë botës mashkullore,asaj bote që ka humbur arsyen dhe në pavetëdije rrotullohet rreth femrës si një proces jetësor i egër në pamje e primitiv në dukje.
E dhunuar e përdhunuar për të kënaqur egot e atyre që rriten me ndjenja kafshërore dhe në fund bota drejton gishtin duke e fajësuar për 'kopilin" që nxjerr në jetë! E lëkundur gjithë jetën mbi identitet të dyzuar, si vajza e dikujt e gruaja e një tjetri, ose pronë e secilit. E si mund njeriu të jetë pronë, aq më shumë objekt (seksual)? Kjo ndodh atëherë kur femra konsiderohet vetëm si konstrukt trupor, mendja, dëshirat dhe ndjenjat janë detaje meshkujsh. I quaj meshkuj, sepse duhen vite për t'u bërë burra, duhet kohë për ta bindur veten se të drejtat e grave janë të drejtat e njerëzve dhe të drejtat e njerëzve janë të drejtat e grave, sot e përgjithmonë.
Meshkuj, e ju o burra, jam femër, por jam dhe njeri dhe fakti që po sillem si e tillë nuk do të thotë se imitoj mashkullin, thjesht tentoj të jem vetvetja, tentoj të jem e lirë. Mjaft e pamë botën bardhë e zi, le ta ngjyrosim gradualisht përditshmërinë tonë, duke synuar barazinë gjinore. Mjaft na udhëhoqën paragjykimet dhe stereotipet që lënë mbrapa gruan, le të ndërtojmë bashkërisht një realitet të ri, i cili hap dyert e emancipimit, nëpërmjet shkollimit të femrës. Sado që dëshira për të ndërtuar të ardhmen, mbështetur në traditë, mjegullon çdo shenjë emancipimi, forca e femrës duhet të rrezatojë. Fundja femra nuk lufton për forcë, sepse e tillë është krijuar, ajo thjesht tenton të ndryshojë perceptimin e botës mbi të. Tenton në të njëjtën kohë t'i bëjë ballë diskriminimit që familja si institucioni i parë patriarkal e zbaton, duke mbrojtur me çdo kusht rolin e saj si individ.
Fakti që femra bën thirrje për barazi gjinore nuk përkrah seksizmin, aq më pak synon të fshijë nga piktura e botës figurën e mashkullit, ekzistenca e të cilit është e domosdoshme, thjesht kërkon respektimin e ndërsjellë të së drejtës esenciale për të jetuar dhe vepruar.
Duhet kuptuar një herë e përgjithmonë se femra dhe mashkulli janë sinonim i njëri-tjetrit, me gjini të kundërta, të cilët domosdoshmërisht të bashkëpunojnë për të mbijetuar.
Përderisa ndërvarësia gjinore është nevojë natyrore, të drejtat dhe barazia janë bindje njerëzore.
Jam femër, je mashkull.
Jam njeri, je njeri.
Vetëm kjo ka rëndësi.

*Botuar më: 26 maj 2016*

# Edhe 364 ditë të tjera për vajzat

*Në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave*

*Blerina Demiri*

Sa e lehtë është të thuhet: Urime Ditën Ndërkombëtare të Vajzave! E çfarë u urojmë ne atyre? Çfarë i urojmë ne vetes? Liri, lumturi, dashuri? Jo, nuk ka nevojë për urata, s'ka nevojë për ta ndarë të mirën e përbashkët, kur ne akoma nuk e gëzojmë atë.
S'do mend që solidarizimi me të tjerët në një ditë si kjo, ndez një dritë tek secila vajzë, por që mëngjesin e së nesërmes, pavarësisht se lind dielli, kjo dritë do të zbehet. Do të shuhet në momentin kur ti vajzë e dashur gjithandej nëpër botë, do të përballesh me realitetin që ta krijojnë të tjerët, do të përballesh me mohimin e fjalës dhe veprimit, do përballesh me idenë e pamposhtur të botës se ti je femër dhe asgjë më shumë.
E dini kur mund të flasim për një ditë ndërkombëtare të vajzave? Atëherë kur kauza rreth saj të mbrohet me mendje e jo me trup, kur lapsi të zëvendësojë penelin e buzëkuqin, kur guximi dhe besimi i femrës të mbrohen nga dinjiteti i saj, kur fillimisht femra ta njohë veten si përmbledhje vlerash dhe jo si një konstrukt marketingu.
Atëherë kur femra renditet gjithmonë më poshtë se të tjerët, atëherë kur të etiketohet vetëm si robëreshë për xhentëlmenët, nuk mund të flasim për një botë më të mirë.
Motoja "Ajo mund të bëjë gjithçka", nuk mund t'i referohet çdokujt, përderisa akoma hasim mohim të tejskajshëm të së drejtës themelore që një femër mund të ketë. Po, ajo mund të bëjë gjithçka. Ajo mund të jetë në piedestalin më të lartë të Olimpiadës, ajo mund të udhëheqë sektorë të ndryshëm të jetës sociale, nesër ajo mund të jetë presidente e SHBA-ve, por kur të festojmë ndërkombëtarisht ditën e vajzave tona, duhet marrë parasysh edhe vrimat e fundit të fyejve. Duhen marrë parasysh ato 29 shtete ku femrës i mohohet e drejta e shfrytëzimit të organeve gjenitale, duhen marrë parasysh ato 120 shtete ku nuk ekziston ligji kundër përdhunimit martesor që ju bëhet vajzave që nga mosha 6 vjeçare duke iu mohuar edukimin dhe vetëdijësimin, duhet marrë parasysh se ajo dhunë do e shoqërojë atë qoftë si vajzë, si grua, apo si pasardhëse e një gjenerate të tërë. Duhet kuptuar se këto vajza të privuara nga gjithçka, të papërgatitura fizikisht dhe mendërisht sjellin në jetë, jetë të reja dhe të pafajshme, duhen marrë parasysh të gjitha përpjekjet që hedhin baltë mbi këtë ditë ndërkombëtare.
Nuk është e rëndësishme një ditë, një festë ose një përvjetor, ajo që ka rëndësi është ambicia që ndodhet pas saj.
Prandaj, përderisa "Ajo mund të bëjë gjithçka", ne le të bëjmë së bashku "diçka"!

*Botuar më: 11 tetor 2016*

# SHËMBËLLIME

# Rrëfim i pazakontë mbi librat

*Kushtrim Zendeli*

Është ndoshta e çuditshme të shkruash për librat, jo për librat si libra, si përmbajtje, si ide e kështu gjërash intelektuale, por për librat si objekte… që rrinë në raft. Teksa i shoh më duken të gjithë si ushtarë të një ushtrie jo fort të disiplinuar, së paku këto të mitë kështu janë – të padisplinuar. Disa rrinë mirë, drejt e në vijë, disa të tjerë kanë anuar majtas e disa djathtas, si ushtarë të këqinj që janë mërzitur nga urdhërat. Ka edhe ushtarë qe rrinë krejt shtrirë, bëjnë pallë çunat. Nuk u shkon mendja fare për disiplinë e as për oficerë e gjeneralë.
Më interesantë janë ata që rrinë shtrirë mbi kokat e këtyre të bindurve. Ata duken sikur zgërdhihen me të nënshtruarit, kurse vetë bëjnë qejf dhe ndonjëherë kur hapet dritarja, ajrosin fletët të pashqetësuar. Ca te tjerë kane dalë krejt jashtë raftit apo vijës ushtarake të disiplinës dhe janë shtrirë në tavolinë të shkapërderdhur si mos më keq. Nja dy a tre në dyshek afër jastëkut, njëri poshtë krevatit… rrinë ashtu në fshehtësi të plotë. Një tjetër rri ulur në çantën e udhëtimit, i trazuar nga rrokullusjet dhe hapjet e mbylljet e shpeshta nëpër autobusë e kafene.
Është interesante kjo gjendje e tyre, herë-herë duken sikur po protestojnë, kërkojnë ndërrim vendesh, ndihen të pabarabartë, fatkeqë… Dhe kur ta mendosh që gjithçka është në dorën tënde, gjithë ato shkrime, germa, fjalë, fjali të tëra, të shkruara nga pena të mëdha, kërkojnë të arrijnë të bindin kokën tënde për të drejtat e tyre. Disa protestojnë me anë të kopertinës, ata me kopertinë të trashë thonë që ne jemi më seriozët, më të bujshmit, prandaj edhe na kanë mbeshtjellur kaq mirë. Jemi të rëndësishëm, nuk është punë e vogël të të vënë një kapak kaq të trashë. Këta të tjerët që kanë kopertina të zakonshme, justifikohen me thjeshtësinë e tyre. S'është nevoja të mbështillesh aq trashë për të qenë i rëndësishëm, ne jemi modestë por themi gjëra te mëdha. Ashtu hollë-hollë depërtojmë në mendje dhe të mbushim me melhem, jemi të brishtë, të ëmbël, ashtu si kopertina.
Pastaj të tjerë që lavdërohen me trashësinë, me numrin e faqeve. Të tjerë që gati s'vihen re fare në raft, të ligshtë, të zënë ngusht nga dy trashaluqë që ia kanë zënë frymën… Të tjerë mesatarë, me kopertina të bukura, të vizatuar nga piktorë të njohur e të panjohur, të tjerë fare të vjetër, të grisur, që mezi mbahen… Të gjithë kërkojnë vëmendje. Të gjithë duan t'i ajrosin fletët dhe të të nxjerrin sytë me germat e tyre që në fillim duken aq të pafajshme, atëherë kur veç sa s'kanë filluar të kërcejnë si të tërbuara para syve, të futen thellë tyre dhe të ta helmojnë trurin me plot histori, trillime, fantazi, që të lënë pa mend fare.

Dhe i ditur mendoje që ishe para se ato germa të çmendura të të kaplojnë qenien, me plot dyshime dole për veten, e për botën, për librin vetë, e për të gjitha.

Eh librat… Këta djaj që të mësojnë që S'DI!

*Botuar më: 18 tetor 2016*

# Me mllef ju flas, me zjarr

*Liridona Veliu*

Si mound të ndihmojm denisen?“ – pyeste polici shqiptar përderisa partneri i tij shkruante dënimin për shkeljen që i kishim bërë ligjit atë natë me veturë. Më erdhi keq ngaqë nuk e besoj dot që një 1000 denarësh që do ta zhvishte plotësisht nga çfarëdo lloj dinjiteti njerëzor, krenarie apo profesionalizmi (të cilën kushedi se a e kishte, po të marrim parasysh hallat, dajallarët, miqtë dhe familjarët që i ati është dashur të lusë, tundë e shkundë për të bërë të birin polic, me arsyetimin se polic të jesh është punë e mirë, e duke lënë të birin të pyetet deri në fund të jetës se ç’nënkuptonte i ati me „mirë“) do t’i shtojë ndonjë rehati afatgjate jetës së tij të trishtë, këtij shteti të trishtë, popullit tonë të trishtë. Turpi do të ishte i imi po të besoja. Më erdhi edhe keq kur azgani shpatullgjerë i babit dhe më i miri i mamit, me targa të Cyrihut, që sapo kishte ardhur në Atdhe ia bëri „Shkruje si t’moundesh! Din tej kush jem?“, të cilit polici duhej t’i jepte vëmendjen maksimale dhe ta pyeste aspak ironikisht së kush ishte, vetëm për të kuptuar nëse miku i tij ishte edhe miku i atit të tij, ai që e futi në punë, e po i njëjti që mund ta nxirrte nga aty. Më erdhi keq që shoku polic nuk dinte se kush ishte ai vetë: ai që i tremben, apo ai që e qeshin; ai që mbron, apo ai që vjedh. „Shkrirje dikotomish“ – mendova. S’kishte as edhe një orë që kisha arritur në Maqedoni e më mori aq pak kohë të rikujtohesha se erdha aty ku lindin dhe shkrihen dualitetet, ku e mira dhe e keqja, e sakta dhe gabimi, e bardha dhe e zeza, theksohen po aq sa edhe asgjësohen.

Duhej të takoja një shok në Shkup. „Vendtakimi“ – tha, – „te kali“. „Babi që duhej t’më sillte aty, pyeti: „Tek cili kalë?“ Qeshëm të dy. Kur arrita tek Leka m’u duk disi i çuditur, sikur donte të ikte që aty. S’kishte kah lëvizte prej luanëve. „Te Babi i Aleksandrit takohemi“ – tha Babi. „Po mamin ku e ka Aleksandri“ – pyeta veten. Femrat si mami i Aleksandrit dhe shumë të tjera, kishin dy funksione brenda Shkupit 2014: O të mbajnë çantën në krahë, o të lindin fëmijë dhe t’u japin gjinë. Pra femrat që ishin vetëm zbukurime përreth figurave mashkullore, të objektifikuara skajshmërisht, ishin vetëm roli mbështetës i burrave dhe bijve që kishin rritur. Jo që kjo s’mund të jetë e bukur, por ja që s’është vetëm kjo ajo që të mund të bëjë një femër. Kur kalova anën tjetër të lumit, pashë dy shqiptarë që ishin zënë ngaqë njëri i kishte sharë nënën tjetrit. Ky tjetri vazhdonte t’i shante nënën atij të parit. Ata që po i ndanin ua shanin nënat të dyve. „Shkrirje dikomotmish“ – mendova, – „po aq sa murëzim i tyre“.

Në Tetovë vizitova “Alba-s” – in. Pyeta për botimet më të fundit. Kishte kohë që nuk kisha rifreskuar përdorimin e ë-së tonë. Mendoj që ekziston një farë rreziku në përzgjedhjen e gjithmonë të jo komerciales dhe në barazimin e saj me jo konvencionalen, andaj mora Kandidatin e shumë përfolur të Ben Blushit. Një natë më herët, teksa dilnim vonë nga “Shend e Verë”, në qytetin e studentëve le t’i themi, lexova „Mesarnica“ diku në rrugë. Pa mos e kuptuar mirë edhe vetë, thashë se fjala „mishtore“ harmonizohej shumë me gjithçka në atë çast. Ndonëse për shkak se brenda natës, me miq kishim biseduar për shkallitjet

e shumëllojshme që ndjenim të gjithë, pra intelektuale, shtetërore, kulturore, shpirtërore të shqiptarëve, të rinisë, të vullnetit. Andaj, kur hapa "Kandidatin" dhe lexova për kasapin e Blushit, qesha dhe për një çast të shkurtër kuptova se pse gjyshja ime besonte në besëtytni. „Shqiptarët kanë qejf t'i ushqejnë gratë me mish, sepse kështu, besojnë se, pjelloria e tyre rritet" – thoshte Blushi. „Ah, prandaj kaq shumë mishtore" -mendova.

Krahas "Kandidati" – t, mora edhe "Letër një Socialisti", po ashtu shkruar nga Blushi. Nuk e kisha ndërmend, por ja që pashë kopertinën e cila në vend të një titulli dhe emrit të autorit siç rastis zakonisht, ishte e mbushur e tëra me fjalë dhe pikëpyetje. Ndjeva (apo konstruktova) piskëllimën e Blushit për t'u lexuar, për t'u parë, për t'u dëgjuar. U duk sikur nuk kishte mundur të priste faqen e parë të librit dhe kishte filluar nga kopertina, se përndryshe pëlciste. Aty diku ai pyeste: „A e di se Shqipëria po zvogëlohet?" M'u duk i etur Blushi, i fkolluar po aq sa i ngopur. S'kishte se si t'ishte ndryshe. Edhe Blushi ishte shqiptar pra, përfaqësues dhe denoncues i dikotomive.

Të nesërmen takova shoqen. Më tha të shkojmë më mirë te lumi, aty pranë "Cufi"-t. Ndonëse gati tre vite kisha qëndruar në Tetovë, për herë të parë e pyeta veten se ç'kishte menduar ai që e kishte quajtur Cuf-in Cuf. „Kam sjellë një shoqe këtu më herët" – më tha ajo, – „doja ta qetësoja, por kur pa mbeturinat që qëndronin në lumë që pas përmbytjeve, e zemërova ende më tepër". Mbeturinat ishin ende aty. Në mos gabofsha ishin tri copa plastike apo të ndonjë materieje tjetër: e kuqe, e verdhë dhe e gjelbër. „Ironike" – mendova, „semafori të shkelë ligjin".

Tek sa kaloja gjyqin, madje bukur më herët se të arrija aty, jehonte zëri i një gruaje: „Sa-da-ka". Ishte aq monotonik saqë për një moment m'u duk se dikush kishte lëshuar radio nga vetura, andaj edhe mendova me vete se asnjëherë s'do të ndaloj së habituri nga shija muzikore e disave. Është bërë e zakonshme të gjesh rrugëve tenda të mbushura me libra fetarë, mbulesa femrash, kësula haxhish dhe ligjërata apo këngë kushtuar Zot(it)(rave) e ku kërkohet e jepet lëmoshë. Ndonjëherë ne i flasim Zotit (atij, pra), ndonjëherë ai na flet neve (përmes nesh), nejse. S'isha gabuar edhe aq shumë, sidoqoftë. Sadaka-ja jehuese ishte e një gruaje në moshë që qëndronte ulur mbi një karton afër tendës së njërit prej zotërave. Asnjëherë më herët nuk e kisha shqiptarizuar sadakanë. Ketë radhë dëgjoja vetëm, „sa ka", andaj më erdhi të pyesja: Kush ka, çka ka, sa ka, pse (e) ka, deri kur e ka, kujt ja ka marrë, kush ia ka dhënë, kur do ta kthejë, a do ta kthejë, kurrë s'do ta kthejë?! Mirëpo, duke parë gruan që kishte ngecur në mes të Zotit dhe gjyqit, e shpërfillur nga të dy instancat e drejtësisë fiktive, nuk e pyeta.

Në Ohër kërkoja perla. „Merhaba, bujrum" – më thanë. Nga hutia e përnjëhershme pata një reagim automatik dhe fola maqedonisht. Duhej të ishte ngaqë të dyja janë të huaja për mua. M'u kujtuan rrëfimet e pleqve që shkonin kah Shqipëria për pushime të cilëve kur iu flitej në gjuhën letrare atje, përgjigjeshin me automatizëm në maqedonisht. „Ndoshta edhe shqipja ka qenë njëjtë e huaj për shqiptarët" – mendova, dhe mendimi ishte aq i shëmtuar saqë

më duhej ta gënjeja veten me diçka tjetër për të shpëtuar. U mendova për një çast se ç'ndikim mund të kishte Sulltan Sylejmani në përzgjedhjen e stolive që bënte pronari për shitoren e tij. Kisha dëgjuar se gratë në Maqedoni kërkonin tashmë stoli të stilit të këtij seriali, e në veçanti të Hürremit, gruas së Sulltanit (njëra ndër të shumtat, marrë nga haremi i virgjëreshave, po nejse, ç'rëndësi ka). „Kujt race qensh tjetër, përveç një race turke, mund t'i shijonte aq shume Akti i Pavarësisë së Shqipërisë" – pyeste Blushi kur rrëfente se si qeni kangall i Fan Nolit kishte ngrënë dokumentin qelizë të Shqipërisë sovrane. „Një vend si Shqipëria nuk meriton të jetë i pavarur" – thoshte Blushi. „Prej shiut, në breshër" – mendova.

Pas një kohe, në njërin prej këndeve të shitores, vërejta një flamur të vogël shqiptar. Tek më dëgjoi se flisja shqip, „mund të folish shqip" – tha pronari. M'u kujtua "Poçari" i Agollit dhe mendova se ndonëse pronari u fliste perlave në shqip. I besova që ishte shqiptar, themelues dhe shkatërrues i dikotomive, adhurues i vetes edhe i pushtuesit njëkohësisht. Nuk është ndonjë çudi e madhe. Kur Frantz Fanon shkroi "Lëkurë e Zezë", "Maska të Bardha" dhe tentonte t'i hapte sytë Afrikës mbi historinë kolonialiste, shqiptarët s'kanë pse të jenë përjashtimi. Mirëpo, nuk është të qenit çështja, as edhe përgjigjja s'është çështja. Është të verbuarit ndaj të qenit çështja, pra: kush je, çka je, pse je, deri kur do të jesh, kush të tregoi se kush je, kur do të jesh, a je, a do të jesh, kurrë s'do të jesh, pse s'do t'ia dish?

U nisa për në Dibër. „Sa i vogël Skënderbeu!" – thashë. Kisha ngecur në temën a hartimit me shkrim ku volla tërë kreativitetin fëmijëror, patriotizmin klasik e të trashëguar, urrejtjen me shumicë ndaj pushtuesve, naivitetin e një të riu, impresionizmin shekullor, romantizmin, melankolinë dhe hiperbolën tmerrësisht të tepruar, lirikën e gjakut dhe shqiptarizmit, simbolet që nga lulëkuqja e deri tek plisi, pasthirrmat e kreshnikëve të tipit „Heu„, „Ohu", apo „E zeza". Disa herë e pata lexuar në klasë dhe përpara familjarëve të mi. Më dukej se secili rritej disa centimetra sa herë që e dëgjonte, përfshirë veten time. Po të doja të shtoja edhe pak rritje a fryrje, mjaftonte një intonacion pak ma i dhimbshëm në atë pjesën ku shpjegoja se si Gjergji ngushëllonte një nënë Dibre për djalin qe kishte humbur në luftë. Ky ishte kulmi i emocionalitetit (ndonëse vdekja e Hürremit mund ta sfidonte).

M'u duk i vogël këtë radhë po ai Gjergj. „Aq ka qenë" – më thanë, – „i vogël". „Gjergji, i vogël?!" – pyeta. „Jo de, përmendorja e tij. Ja, si shkurtabiq e kanë bërë". Duke qenë se personalitetet e betonuara ka kohë që më duken çështje sekondare për popujt, nuk është që u shqetësova ashtu siç duhej të shqetësohej dikush që dikush ia kishte zvogëluar personazhin e hartimit historik. Kemi dhe na kanë zvogëluar shumë më shumë se buste dhe përmendore. Vetëm pak më poshtë pashë edhe dy buste të tjerë, atë të Josif Bagerit dhe Said Najdenit. „Veç për buste jemi" – thashë dhe më erdhi turp nga vetja. Edhe unë isha shqiptare pra, krenare po aq sa e neveritur nga përmendoret: Pse aq te vogla, e pse kaq shumë?!

Përgjatë pushimit tim të shkurtër, një zonjë që më vendoste baltën shëruese, iu luta t'm'i linte duart jashtë që të mundja të lexoj në ndërkohë. „Mojr" – tha.

Kishte një shqipe të bukur dhe „mojr-a“ që i ngjante „mëjr-ës“ kërçovare si përnjëherë më shtoi simpatinë ndaj saj. Kur tretmani mbaroi, pa “Kandidatin” e Blushit dhe tha që edhe asaj i pëlqente të lexonte libra. E pyeta se çfarë librash i pëlqenin. „Histori dashurie“ – tha dhe përgjigjja do të ishte shumë e bukur, do t’i shkonte aq mirë fytyrës së saj të njomë e pa rrudha dhe duarve aq femërore (se dashuria u shkon të gjithëve fundja), po të mos shtonte – „se politika s’është për femra“. Shumë shpejt pas kësaj pyeti se ç’kisha studiuar. „Si t’i them shkencat politike“ – thashë me vete. Sigurisht do t’më ishte përgjigjur sërish me „mojr“ dhe do të kishte tentuar të modifikonte atë që më parë kishte thënë. Kështu të dyja do të kishim përfunduar në një situatë të pakëndshme që do të na e kishte bërë shumë të vështirë të takoheshim të nesërmen sërish. Ishte shumë e shkathët saqë si duket s’kishte durim t’më priste të thurja diçka që tingëllonte më bukur, andaj edhe vazhdoi t’më thoshte t’mos mërzitesha për vathët që mbaja atë ditë dhe se nëse ishin argjend mund lehtë të pastroheshin nga sulfuri i ujit. Shpëtova. „Mojr“ – i thashë.

Nuk e dija nëse zonja, të cilës i dukej vetja e papërshtatshme për politikë, e mendonte këtë për shkak se qëndronte për vlera të pasfidueshme morale dhe besimin e pakontestuar në imperativën kantiane për t’u përlyer më një ‘pisllëk’ të atillë si politika; për shkak se ndiente që nuk kishte kapacitetin e mjaftueshëm biologjikisht si grua, si një ultra-deterministe e bindur me traumë të vetë-flijimit, vetë-nënshtrimit dhe vetë-asgjësimit të cilin ia linte si trashëgimi familjare së bijës, në mos edhe mbesës, për të parë nëpër shekuj veten si qenie të shkallës së dytë; për shkak se zonja kishte vërejtur dinakërinë e saj të pakontrolluar dhe me shpresën për t’iu ngritur një bust mirësie karshi atij të Skënderbeut ndonjë ditë, kishte vendosur të qëndronte larg me etjen e një përbindëshi që robëron veten për të mos i bërë dëm njerëzimit („Ma kanë përdhunuar lirinë dhe tani e kam rrëmbyer dhe po e mbaj në shtëpi“ – do të thoshte Blushi); për shkak se zonja s’kishte pasur kohë të vërejë se Gruevski dhe kangallët e tij (pra, t’tonit) zëvendësonin netët intime të dhomës së gjumit me rënkime mbi pamundësinë për të paguar studimet e vajzave të tyre që s’duhej assesi të bëheshin shkencëtare politike; ose, për shkak se zonja kurrë ndonjëherë nuk e kishte menduar se pse ajo ishte e papërshtatshme për politikë.

Blushi do të kishte qeshur llahtarshëm nga e gjitha kjo katrahurë, ndërsa mua më erdhi keq që zonja nuk e dinte që ndonëse edhe mund të ishte një mikeshë e mirë e Blushit. Gratë (si kjo zonja, si unë) në Kandidatin e Blushit paraqiten si krijesa vetë-përcaktimi i së cilave varet thelbësisht nga njohja eksterne (që i bie të mos jetë vetë-përcaktim), sepse brendësinë e paskëshim boshe. Femrat sipas Blushit (si unë, si nëna ime) frymojnë përmes strategjive të brishta e dhelparake që i ndërtojnë për të zënë meshkujt në grep dhe të cilat përpos vetë grave, të gjithë burrat i kanë kristal të qarta (janë strategji vetë-gënjyese, të bëra nga gra të pa afta). Femrat (si ti, si nëna, motra jote), për Blushin, njëkohësisht janë shembulli klasik i politikës Makiaveliane për atë që duan të arrijnë, saqë mashtrojnë Simon Shuterin që ai të mashtronte popullin e që populli të votonte një të vdekur. „Gratë e njohin seksin vetëm në moshën e tretë, të tradhtisë. Kush nuk tradhton, nuk ka seks. Dhe grua pa seks, nuk mund të ketë“ – thote Blushi. Ajo që kishte ngelur pa ndodhur, ishte që Ollga Sedini dhe e ëma të ndizeshin të

gjalla duke u denoncuar për magji në mes te bulevardeve dhe po s'patëm bulevarde, atëherë të digjeshin në majë te kalit të Aleksandrit apo Skendërbeut.

Por, Blushi nuk mund të mendonte kështu, sepse edhe Blushi duhej të kishte nënë. Ktheva pas librin dhe pashë fotografinë e tij më një përshkrim të shkurtër veprimtarie. Fotografinë që ai kishte përzgjedhur ishte bardhë e zi. Blushi dikotomik s'dukej rehat. Ai kishte gjysmën e fytyrës në hije dhe madje nuk shihte dot lexuesin e tij në sy. Syri i majtë që i dukej (socialisti pra), shikonte majtas (socialisht) dhe poshtë (dëshpërimisht). Blushi kishte marrë mbi supe cinizmin e një letrari dhe kishte shumëfishuar budallakun e një shoqërie për t'ia bërë eksplicite asaj, për ta nguacmuar atë, për ta zgjuar atë. Etimologjikisht fjala „cinik" rrjedh nga greqishtja e vjetër dhe përmban fjalën „qen" në vete. Besohet që cinikët e parë të Greqisë së lashtë të ishin quajtur qen për shkak të paturpësisë së tyre për të sfiduar normat konvencionale të kohës. Nëse lirika cinike e Blushit kishte për qëllim që të shqetësonte dikë, atëherë ia arriti qëllimit. Blushi e di mirë që shqetësimi i çfarëdo lloji, madje edhe cinizmi i çfarëdo lloji, është më mirë së një popull i heshtur, i vdekur pra. Andaj edhe Blushi kishte 'lehur' atëherë kur gjithë të tjerët kishin heshtur dhe heshtin. Blushi me mllef u kishte folur, me zjarr, Shqipërisë e shqiptarëve, neve.

„... [D]he mendova se shqiptarët ishin një popull me fat. Ata e kishin shpikur të parët ilaçin kundër mendimit" – përfundon ai. Simon Shuteri shtrihet në plazh i vendosur që kurrë më të mos mendonte për shqiptarët. Atëherë i bie që Blushi të ishte vullnetarisht i pafat, sepse ai mendonte. Ndërkaq, ne mund të flasim sa të duam për dëshpërimin deri në qelizë që të merr frymën që nga fillimi e deri te përfundimi i romanit. Ne mund të diskutojmë për nuancat nihiliste që tundin çdo sistem vlerash dhe çorientojnë edhe atë pak që ndoshta e kemi ditur (ndoshta); për shijen narcisiste të autorit për t'u ndjerë i denjë për të gjeneralizuar një popull kaq lehtë e thjeshtë, i shoqëruar me supremacinë e të shkolluarit që manevron cinikisht me çështje që masat ndonëse as mund t'i kuptojnë; për mungesën e historive që na fryjnë, të tilla si ajo e Mic Sokolit, por Blushi qëndron pa u shfajësuar, sepse Blushi është i lodhur dhe i zemëruar. Megjithatë, Blushi nuk hesht, andaj Blushi ende beson.

Blushi s'ka pse, absolutisht, të jetë i kujdesshëm se sa dhe si të ishte i dëshpëruar. Blushit s'ka se pse t'i vijë keq pse libri i tij s'ka bërë dikë të lumtur, sepse Blushi s'është i lumtur kur lexon portalet tona të shkruajnë „Lum farmerkat për Kim Kardashian-in"; „Një vjehërr si Shyhrete Behluli"; „Si ta bëni një mashkull të çmendet pas jush", apo „I takoni këtyre shenjave të horoskopit? Një ditë do të bëheni milionerë". „E pse shkruan Blushi atëherë? Ç'arrin ai? Ç'bëri Blushi për atdhe?" („Ku janë krenat qi kanë pre, librat shqip qi kanë botue? " – do të pyeste Fishta). Ja librat shqip që Blushi boton dhe kjo, në vete, është një akt rebelimi, gjallërie, është një shenjë jete, një thirrje për të qenë ndaj atyre që bëjnë të pendohen edhe zotërat më fatalistë që mbase dikur krijuan fjalën „fat". „Me pak fjalë, sa herë që nuk na ka pëlqyer e vërteta e fytyrës, ne ia kemi hedhur fajin pasqyrës. Ende këtu jemi. Jemi duke thyer pasqyrën për të mbrojtur fytyrën. Unë këtë nuk e pranoj. Dua që të detyroj fytyrën të shohë pasqyrën" – thotë Blushi. „Si mound të ndihmojm denisen?" – pyeste polici shqiptar. Po, mund të ndihmo-

jmë atëherë kur unë, ti, tezja apo daja që të futi në punë, miq dhe familjarë, ai miku yt që shkruan dënimin të cilin miku i shqiptarit shpatullgjerë do t'ia grisë para syve pa arritur në komisariat, shqiptarët dhe nënat e tyre të shara në anën tjetër të Vardarit (andej pra, jo këndej Lekës së Madh), Drinit a Shkumbinit, kasapët e mishit dhe të popullit, Cufianët dhe myshterinjtë që notojnë mbi mbeturinat e lumenjve të tharë, Zoti yt dhe i imi, Gjyqi yt dhe i imi, pronari shqiptar i shitores së perlave në Ohër a.k.a. Sulltan Sylejmani i Madhërishëm, busti shkurtabiq a gjigant i Gjergjit, Bagerit, Najdenit, Lekës, madje edhe ai i Justinianit, e kështu me radhë (të cilët ne i kemi vendosur e kushedi si u tunden eshtrat nën tokë), zonja e baltës dhe historive të dashurisë që s'do t'ia dijë për politikë dhe që s'dinë se dinë, Ollga Sedini dhe i ati i saj që u votua edhe i vdekur, këta 'të vdekurit' tanë që i ngjallim çdo katër vite së paku (pra bukuroshet e fjetura), madje edhe Blushi vetë, të detyrojmë fytyrën të shohë pasqyrën dhe të thyejmë 'fatin' e të mos menduarit. Vetëm atëherë do të mund të ndihmonim disi, shoku polic.

Haj, për t'mojr.

*Botuar më: 20 tetor 2016*

# MBROTHËSI

# Mbrothësia e përbashkët

*Arbën Xhaferi*

*Skicë për mbrothësinë e përbashkët*

## Platforma

Tashmë është bërë e pamundur që të zhvillohet një debat racional për nacionalizmin. Pas zhvillimeve tragjike gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, pas konflikteve të ndryshme etnike, kulturore, religjioze etj., anekënd botës është anatemuar nacionalizmi si faktor luftënxitës, atavist dhe jo human. Krahas këtij percepcioni negativ të fenomenit të nacionalizmit nuk mungojnë deklaratat mbi interesin nacional si vlerë parësore. Bie fjala rusët apo kinezët thonë se në Kosovë mbrohet interesi i tyre nacional, prandaj kanë qëndrim refuzues për pavarësinë e saj. Nëse kosovarët do të thoshin se në Kosovë mbrohen interesat e shqiptarëve, atëherë ky përcaktim, pa dyshim do të anatemohej si nacionalizëm, si një ideologji retrograde, ataviste që duhet të çrrënjoset. Shpeshherë si kontrapunkt i nacionalizmit të popujve të vegjël, që bëjnë rezistencë kundër trajtimit të tyre kolonial, ose asimilimit jepet shembulli europian, ai i tolerancës, mendësisë inkluzive, kozmopolite. Gjatë përdorimit të këtyre argumenteve, megjithatë harrohet një fakt i pamohueshëm: vendlindja e nacionalizmit është Europa. Në kuadër të qytetërimit europian konfliktet etnike janë tejkaluar falë zgjidhjes përfundimtare të çështjeve etnike, përkatësisht në sajë të arritjes së kongruencës ndërmjet përmbajtjes etnike dhe kufijve politik të shteteve. Aty ku mungon kongruenca, përkundër mirëqenies ekonomike, ende shfaqen fërkime mbi baza etnike. Sociologu amerikan, BenediktAnderson, me të drejtë konstaton se nacionalizmi u shfaq në skenën historike europiane në shekullin XVI kur popujt e Europës humbën besimin në librat e shenjtë, përkatësisht në të "vërtetat" e shenjta që dolën se ishin lajthitje. Rrënimi i besimit në religjion shtoi kërkesën që të gjendet një ideologji kompensuese. Së këndejmi kompensimi u gjet te nacionalizmi, te zëvendësimi i hyjnores me njerëzoren. Kështu edhe në sferën e politikës depërtoi fryma e Renesansës dhe e Humanizmit.

*Ideologu Arbën Xhaferi, në vitin 2007 përgatiti një platformë të posaçme mbi mënyrën e bashkëpunimit mes Kosovës, Shqipërisë dhe trevave shqiptare. Ai e ka titulluar atë "Skicë për mbrothësinë e përbashkët". Kjo mund të shërbejë si "dekalog" për mënyrën dhe rrugët e bashkëpunimit mes dy shteteve të të njëjtit komb.*

Çdo njeri ashtu si edhe çdo shoqëri ka nevojë inherente për siguri, për përkatësi ndaj një grupi, për adhurim, për krenari, si dhe për manifestime të fisnikërisë, të devotshmërisë ndaj një ideali. Zëvendësi-

mi i hyjnores me njerëzoren ishte produkt europian që ndikoi në formimin e shteteve kombëtare. Ky proces kulminoi në Francë ku nacionalizmi kishte rol emancipues, përkatësisht çlirues: duke krijuar shtetin komb, shtetin nacional, njëkohësisht u arrit barazia në mes të qytetarëve, pa marrë parasysh dallimet e ndryshme ndërmjet tyre. Qytetari më nuk ishte pronë e monarkëve, por individ i cili ishte i barabartë me të gjithë të tjerët. Shpërbërja e Jugosllavisë hapi një kapitull të ri në zgjidhjen e çështjeve etnike. Në Jugosllavi, sipas modelit rus, funksiononte ideja e kombit që ka të drejtë të udhëheqë me shoqërinë, prandaj bëheshin kategorizime të ndryshme, komb, kombësi, pakicë. Ky gradacion ishte shpeshherë në kontradiktë me realitetin. Kombësitë apo pakicat shpeshherë ishin më të mëdha sesa kombet. Bie fjala shqiptarët në ish-Jugosllavi, për kah numri, përqindja ishin në vendin e tretë, pas serbëve dhe kroatëve, por ata trajtoheshin si kombësi apo pakicë, ndërkaq malaziasit, maqedonasit, numerikisht shumë më të vegjël se shqiptarët trajtoheshin si kombe. Ky kategorizim natyrisht nuk buronte nga realiteti, por nga teoritë hegjemoniste, nacionaliste apo raciale. Kjo padrejtësi krijonte hapësirë për fërkime ndëretnike që përfundimisht ndikuan në shpërbërjen e Jugosllavisë. Këto fërkime janë imanente për shoqëritë heterogjene, multietnike. Ashtu si u shpërbë Perandoria Osmane, Austro–Hungareze, apo Rusia cariste u shpërbë edhe Jugosllavia, Çekosllovakia. Sociologu zviceran, UrsAltermatt, në librin e tij "Etnonacionalizmieuropian" me të drejtë konstaton se nacionalizmi në Europë pat dy lloj funksionesh kontradiktore: – ndikoi në shpërbërjen e shteteve, perandorive, formacioneve multietnike shoqërore, siç ishte Austro–Hungaria dhe ndikoi në bashkimin e shteteve të vogla feudale në një shtet kombëtar të popujve me origjinë të njëjtë siç ishin gjermanët apo italianët. Sot, askush nuk mohon rolin pozitiv të nacionalizmit në krijimin e shteteve moderne. Populli shqiptar, pas shthurjes së Perandorisë Osmane u fragmentarizua, u nda në disa shtete: në Shqipëri, në Greqi, në Jugosllavi dhe brenda saj në shumë republika. Aktualisht, pas pavarësimit të Kosovës, pas miratimit të Planit të Ahtisaarit, shqiptarët janë ndarë në disa shtete të pavarura: në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës. Me këtë rast, me keqardhje mund të themi se në Greqi, pas një politike shkombëtarizuese antishqiptare është ngulfatur kauza shqiptare. Fragmentarizimi i shqiptarëve, detyrimi që ata të jetojnë jashtë shtetit amë krijon një varg problemesh dhe statusesh të shqiptarëve brenda këtyre shteteve. Në Shqipëri bie fjala ata kanë liri dhe të drejta të palimituara nga aspekti kombëtar, në Kosovë shqiptarët kanë liri, por jo edhe mëvetësi në qeverisje, ngaqë sovraniteti do ta ndajnë një kohë të gjatë me faktorët mbikëqyrës, në Maqedoni edhe një kohë të gjatë do të zhvillohet procesi konfliktual i përcaktimit të statusit të shqiptarëve, ndërkaq në Luginën e Preshevës dhe në Mal të Zi shqiptarët definitivisht do ta kenë statusin e pakicës kombëtare. Këtë situatë vetë shqiptarët nuk mund ta ndryshojnë, prandaj paraqitet nevoja që të gjejnë rrugë të tjera për t'i tejkaluar pengesat që objektivisht e ngulfatin zhvillimin ekonomik, kulturor, arsimor dhe sigurinë e tyre. Nëse merret parasysh roli vazhdimisht kompensues i nacionalizmit, pas humbjes së besimit në të "vërtetat" fetare, në hierarkinë shoqërore, të dhënë nga Zoti dhe në barasvlerësimin e kohës kozmike me atë historike, ashtu si pohon Andersoni, atëherë duhet shfrytëzuar forcën ngjeshëse, kohezive të nacionalizmit për ta ngritur mirëqenien e qytetarëve, pjesëtarëve të një kombi, prodhimin e vlerave kulturore dhe mbi të gjitha instalimin e standardeve kom-

bëtare, gjithnjë në vijë të tejkalimit të pasojave rrënuese, zvetënuese të pasojave nga fragmentarizimi i indit kombëtar.
Kombet e formuara, ato që kanë krijuar shtetet e tyre kombëtare kanë arritur që të instalojnë si ide prijatare, intencën kombëtare apo eskatonin kombëtar që i fokuson të gjitha kapacitetet, burimet njerëzore dhe natyrore, në një drejtim, në atë të zhvillimit, të mbrothësisë kombëtare. Kjo intencë është përcaktim i çdo populli të qytetëruar, madje për arritje të interesave kombëtare janë zhvilluar dhe luftëra për zgjerim të territorit, gjithnjë në vijë të interesit ekonomik, të mirëqenies, së sigurisë së përbashkët kombëtare. Nocioni i interesit gjeostrategjik është eufemizëm që përdoret për ta zëvendësuar nocionin e profanizuar të nacionalizmit. Nëse nuk do të gjendet një rrugë e lejueshme, qytetëruese që do t'i bashkonte të gjitha kapacitetet e shqiptarëve në kuadër të një intence, eskatoni të përbashkët kombëtar, atëherë këto kapacitete do të shfrytëzoheshin nga të tjerët. Popujt e qytetëruar siç janë francezët apo britanikët në vijë të afirmimit të interesave kombëtare, madje kanë formuar organizma mbinacionale vullnetare siç është projekti i Frankofonisë apo Commonëealthit. Projekti i parë krijon relacione kohezive me popuj të ndryshëm mbi bazë të zgjerimit të përdorimit të gjuhës frënge, ndërkaq ky i dyti mbi baza të mirëqenies së përbashkët. Edhe shqiptarët të fragmentarizuar në disa shtete duhet ta përkufizojnë intencën, eskatonin kombëtar në vijë të shfrytëzimit racional të të gjitha kapaciteteve dhe burimeve. Nëse kjo nuk do të ndodhë atëherë do të kemi zhvillime shoqërore që do të shkërmoqin identitetin unik kombëtar dhe ndasi mbi interesa të kota. Duke marrë si shembull Commonëealth–in britanik, imponohet një ide e ngjashme, ajo, bie fjala e Mbrothësisë së Përbashkët Kombëtare.
Qëllimi parësor i këtij projekti duhet të jetë shndërrimi i handikapit në përparësi, përkatësisht i fragmentarizmit molisës në begati, ose në vend që të shfrytëzohen kapacitetet e shqiptarëve nga të tjerë, të gjenden modalitete qytetëruese të organizimit shoqëror, gjithnjë në vijë të intencës kombëtare, që do të jenë në interes, jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve me të cilët ata bashkëjetojnë. Popujt më të qytetëruar të botës tashmë kanë përkufizuar dhe instaluar standardet kombëtare në çdo fushë, duke filluar prej çështjes së abortit e deri tek ajo e ushqimeve gjenetikisht të modifikuara, prej çështjes së demokracisë e deri te manifestimet sportive. Shoqëritë shqiptare janë të pastandardizuara, sidomos nga aspekti i vlerave kombëtare. Kjo mungesë ndikon që standardet dhe vlerat e popujve të tjerë të depërtojnë lehtas, madje edhe të bëhen barrierë për pranimin e standardeve moderne perëndimore. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në marrëveshje me faktorët relevantë botërorë, mbyllet një proces i dhembshëm historik dhe hapet një dilemë e nivelit tjetër: çka dhe si më tutje? Nga kjo periudhë shqiptarët dolën me imazh të rrënuar, me ekonomi jo kompatibile me sistemet moderne shoqërore, me dilema qytetëruese, me identitet ende të pastabilizuar kombëtar, me dallime të rrezikshme kulturore, në varësi nga sistemet shoqërore ku janë formuar botëkuptimet e tyre, me sistemin e vjetruar arsimor, me koncepte dhe standarde labiale demokratike, me thellim të korrupsionit, nepotizmit, krimit të organizuar që nënkupton suspendimin e parimeve të shtetit ligjor, me shkapërderdhjen e bashkëkombësve në shumë shtete të botës si pasojë e krizës ekonomike, etj. Pa krijuar standarde unike kombëtare, pa bashkërenditje të kapaciteteve, të sinergjisë kombëtare nuk mund të tejkalohen vetvetiu këto probleme. Pa standardizim nuk mund të mbrohet asnjë vlerë,

veçmas ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar. Në vazhdim parashtrohet një skicë e mundshme për krijimin e një institucioni, organizate e Mbrothësisë së Përbashkët, punuar sipas projekteve të ngjashme në botë, veçmas Commonwealthit britanik.

# Mbrothësia e Përbashkët

## *I Përkufizimi*

Mbrothësia e Përbashkët është organizatë jopolitike vullnetare. Në këtë projekt do të përfshihen shtetet, përkatësisht bashkësitë shqiptare që jetojnë në shtete të ndryshme të botës.

## *II Qëllimet e themelimit*

"Mbrothësia e Përbashkët" është organizatë ndërkombëtare në të cilën do të marrin pjesë bashkësitë shqiptare, mundësisht edhe shtetet ku ata jetojnë pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik. Baza mbi të cilën do të ndërlidhen interesat e përbashkëta ka të bëjë me afirmimin e demokracisë, të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, të drejtat individuale, barazinë, tregtinë e lirë, multilateralizmin dhe paqen në botë.

## *III Udhëheqja*

Udhëheqja e Mbrothësisë duhet të jetë e emëruar(dominuar) me marrëveshje konsensuale ndërmjet anëtarëve të organizatës. Nominimi, pavarësia nga elektorati krijon kushte për marrje të vendimeve të guximshme dhe eliminon vetinë, shpeshherë bllokuese të vardisjes së politikanëve ndaj elektoratit dhe opinionit në përgjithësi. Mbrothësia udhëhiqet nga sekretariati i përgjithshëm që ka ingerenca edhe ekzekutive. Sipas shembullit të Commonëealthit, ku udhëheqja simbolike i takon mbretëreshës, si kod bashkues, mund të ofrohet një rol i këtillë edhe oborrit mbretëror shqiptar.

## *IV Anëtarësimi*

Kriteret për anëtarësim në Mbrothësi janë të bazuara në një sërë dokumentesh të veçanta.

## *V Objektivat dhe aktivitetet*

"Mbrothësia…" karakterizohet si organizatë ndërkombëtare që synon t'i zgjidhë problemet me të cilat tash e tutje do të ballafaqohen bashkësitë shqiptare të shkapërderdhura në shumë shtete.
Objektivat kryesorë janë: Çështjet e identitetit;  Unifikimi i standardeve kombëtare: demokracia, ekonomia, arsimi, barazia gjinore,

Shekularizmi, të drejtat njerëzore, gjyqësori, sporti, ndërveprimi, rinia.

## *VI Struktura udhëheqëse*

Sekretariati i "Mbrothësisë" vendoset në Tiranë, ndërkaq degët në kryeqendrat ku jetojnë shqiptarët. Sekretariati organizon konferenca, takime të ministrave, takime konsultative teknike, e ndihmon zhvillimin e politikave dhe jep këshilla politike, profesionale, harton projekte për tejkalim të vështirësive në përputhje me objektivat e paracaktuara. Sekretariati udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm i "Mbrothësisë". Ai mund të ketë vetëm dy mandate me nga 4 v. Sekretari i Përgjithshëm dhe dy zëvendësit e tij i udhëheqin seksionet e sekretariatit. Subjektet anëtare të "Mbrothësisë" krijojnë edhe shumë lidhje sekondare në lëmin e sportit, të arsimit, të bamirësisë etj. Asociacioni i universiteteve të "Mbrothësisë" shërben si mjet për lidhjet (komunikim) akademik(e). Po ashtu, ekzistojnë edhe shoqata të tjera jozyrtare, të cilat ndihmojnë individë që punojnë në fushën e gjyqësorit dhe në institucionet e tjera qeveritare, siç janë, shoqata e juristëve dhe shoqata e parlamentaristëve të "Mbrothësisë". Në të parë ideja duket sa e guximshme po aq edhe e parealizueshme, por rrugëdalje tjetër nuk ka nëse dëshirojmë t'i vëmë në kontroll proceset që i degjenerojnë kapacitetet tona kombëtare dhe shoqërore në përgjithësi. Nëse ky propozim të paktën do të nxisë përsiatjen për nevojën e gjetjes së një shtegu të ri që do të na shpijë në nivel më të lartë të organizmit shoqëror, atëherë guximi do të jetë i arsyeshëm.

*Botuar më: 18 janar 2016*

# Çështja kombëtare shqiptare – pjesa e fundit e mozaikut të pabërë ballkanik?

*Albulena Halili*

## *Historiku i çështjes kombëtare shqiptare*

Formësimi i idesë dhe i vetëdijes kombëtare shqiptare fillon në gjysmën e dytë të shekullit XIX, nga një lëvizje intelektuale e njohur si Rilindja Kombëtare Shqiptare. Kjo lëvizje është katalizatori kyç i proceseve shumë të rëndësishme të organizimit të shqiptarëve. Rilindja Kombëtare Shqiptare bëri organizimin intelektual, politik e ushtarak mbarëkombëtar shqiptar me synim çlirimin, bashkimin dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar. Shteti shqiptar u krijua në vitin 1912 e me këtë edhe shqiptarizma politike, siç e emërton për herë të parë publicisti dhe idealisti shqiptar, themeluesi i shkollës së neo-shqiptarizmës, Branko Merxhani.

Në përmasa të tejkombëtares, gjeneza e çështjes shqiptare paraqitet në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, kur Bismarku mohon ekzistencën e një kombi shqiptar në Ballkan, ndonëse Ambasadori i Britanisë së Madhe në Stamboll, Goschen, në korrik të 1880 shkruan për domosdoshmërinë e afirmimit të një kombi shqiptar dhe krijimin e një Shqipërie të fortë e të bashkuar.

*"Në rast se Fuqitë e Mëdha do ta dënojnë këtë popull trim dhe liridashës të mbetet në robëri dhe ca më keq të copëtohet midis shteteve fqinje, Gadishulli Ballkanik nuk do të ketë kurrë qetësi, sepse shqiptarët nuk do të rreshtin kurrë së luftuari për të fituar pavarësinë e tyre kombëtare. Përkundrazi, në rast se shqiptarëve do t'u njihen të drejtat e tyre kombëtare, Shqipëria do të bëhet faktor i paqes në Gadishullin Ballkanik." – Abdyl Frashëri.*

Pas luftërave ballkanike, Konferenca e Ambasadorëve në Londër qe një përpjekje për përjetësimin e një gjendjeje absurde, një mozaiku të dhunshëm ballkanik, i paraqitur nga fqinjët e Shqipërisë si klishe për popuj të pabarabartë. Ishte ky një mozaik i çoroditur, sajuar keqas nga propagandat dhe doktrinat përshtrirëse zyrtare të vendeve ballkanike dhe lejuar shkujdesshëm nga Fuqitë e Mëdha të kohës.

Gjatë farkëtimit të rendit ndërkombëtar të Versajës, parimi i vetëvendosjes së popujve dhe diplomacia publike përbënin pjesën më thelbësore të Katërmbëdhjetë pikave të Presidenit amerikan Uillson. Ai proklamonte që zgjidhja e të ashtuquajturës Çështje e Adriatikut të bëhej në linja të qarta të kombësisë. Përgjatë tërë shekullit XX, mozaiku s'rreshtte së ndërtuari keqas. Duke vijuar kështu me radhë nëpër kongrese, konferenca e forume ndërkombëtare, epoka njëshekullore e

kombit shqiptar mund të cilësohet vetëm si epokë e mbijetesës, dhe sa herë që shqiptarët kërkonin rishikimin e korrigjimin e kësaj tablloje, ata cilësoheshin si nacionalistë agresivë.

## *Nacionalizmi sui generis shqiptar*

Nacionalizmi nuk është një ide arkaike dhe anakronike siç cilësohet shpesh. Ajo është ideja që i mobilizon dhe mbron popujt. Ky nacionalizëm ka ndikuar drejtpërsëdrejti në zgjimin kombëtar të popujve, çlirimin e tyre nga sundimet, çfarëdolloji qofshin, dhe i ka shpier në stadet më të larta të zhvillimit të tyre. Ai ka qenë diga lëvizëse e të gjithë popujve evropianë për të krijuar kombet e tyre dhe si i tillë s'do mend se është i natyrshëm dhe në vijë me çdo tendencë historike.
Nacionalizmi shqiptar përbën një nacionalizëm sui generis, i cili përgjatë kohës ka pësuar transformime. I krijuar si nacionalizëm intelektual e kulturor përmes një lëvizjeje mbarëkombëtare, sot nacionalizmi shqiptar është tejet i moderuar. Fatkeqësisht ai s'përfaqëson asgjë më shumë se një nacionalizëm të herëpashershëm popullor e folklorik, për dallim nga të gjithë fqinjët, të cilët tradicionalisht dhe vazhdimisht paraqesin nacionalizëm që mbështetet në doktrina dhe politika zyrtare shtetërore si "Naçertanije" serbe apo "Megali-idea" greke. Ligji mbi gjendjen e luftës është akoma i plotfuqishëm mes Shqipërisë e Greqisë. Shqiptarët kurrë nuk kanë pasur ndonjë projekt zyrtar për "Shqipërinë e Madhe" ashtu siç shpesh referohet. Ky është një term i shpikur nga serbët dhe i përdorur nga jo-shqiptarët.

## *Çfarë përfaqëson sot çështja kombëtare shqiptare*

Në Evropën e vlerave, popujt do të duhej të zhvilloheshin natyrshëm, pa rregulla e kufizime për popuj të caktuar. Gjeniu i letrave shqipe, Kadare, shkruan "duke pritur, në qoftë se është e domosdoshme kohë më të qeta e më të emancipuara, për aplikimin e parimit të vetëvendosjes së popujve, Evropa nuk duhet gjithsesi, në mënyrë arrogante të përpiqet ta varrosë këtë ide shpëtuese." Përndryshe populli shqiptar do të vazhdonte të ishte, siç edhe u shpall praktikisht nga akademiku Rexhep Qosja, "Populli i ndaluar".
Çështja kombëtare shqiptare është çështje reale dhe kjo nuk duhet mospërfillur. Ajo është një çështje e rëndësishme për shkak të numrit të shqiptarëve, autoktonisë, gjuhës, gjeografisë, historisë dhe prejardhjes së tyre unike. Kjo çështje po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për shkak të faktorizimit të shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik. Ata tashmë kanë dy shtete të tyre. Shqipëria, deri dje pjesë e Evropës gjeografike, sot është pjesë vitale e lidhjes transatlantike mes Evropës e Amerikës dhe po rikthehet ngadalë e sigurt në Evropën politike. Kosova, megjithëse me një sovranitet pothuajse të cunguar, është po ashtu faktor i rëndësishëm gjeopolitik.
Çështja kombëtare shqiptare përbën vetë një nënmozaik në mozaikun e pabërë ballkanik. Çështja e shqiptarëve të Maqedonisë, atyre të Luginës së Preshevës, Malit të Zi dhe çështja çame që të gjitha janë pjesë të këtij nënmozaiku, që të gjitha janë çështje reale, të drejta dhe të pazgjidhura. Ato nuk janë produkt i

nacionalizmit shqiptar, por pasojë e pakuptimësisë së politikave zyrtare dhe nacionalizmave institucionale përshtrirëse të fqinjëve, legjitimuar nga fuqitë evropiane të shekullit të kaluar. Si e tillë, do të duhej të brejë dhe ndërgjegjen evropiane.
Kërkesat e shqiptarëve s'kanë qenë kurrë jashtë realitetit dhe në kundërshtim me normat ndërkombëtare. Ato kanë qenë të natyrshme, të arsyeshme e të drejta. Të cilësuar më shumë se cilido popull ballkanik si nacionalistë, shqiptarët janë komb që vuajnë nga kozmopolitizmi. Politika zyrtare shqiptare gjithandej është panevojshëm dhe jashtëkohshëm (në kuptimin futurist) e moderuar.
Njëra nga figurat më të shquara shqiptare, Arbën Xhaferi, thoshte: "Ka kultura që jetojnë në një kohë dhe ka kultura që jetojnë në të ardhmen".
Shqiptarët janë komb që jetojnë në të ardhmen!

## *Çështja kombëtare shqiptare – Quo Vadit?*

Rënia e murit të Berlinit dhe shembja e komunizmit kanë sjellë ndryshime radikale në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në rendin ndërkombëtar. Pothuajse gjithçka shkoi mbrapsht në rendin ndërkombëtar të Versajës, ashtu qe rasti edhe me krijesat multi-etnike artificiale: Bashkimi Sovjetik, Çekosllovakia dhe Jugosllavia. Ato u shpërbënë. Shtete-kombe u krijuan dhe u rikrijuan mëpastaj. Çështje të vjetra dhe të pazgjidhura janë ringjallur.
Sot, rikonstruktimi gjeopolitik është mozaik i vështirë për t'u zgjidhur. Riskajimi i gadishullit Ballkanik është një proces pothuajse i papërfytyrueshëm në kontekstin aktual historik, kur integrimi euro-atlantik është baza e prosperitetit dhe stabilitetit të tij. Kriza financiare e BE-së dhe lodhja nga zgjerimi si dhe kontestet bilaterale mes shteteve të Ballkanit kanë ngadalësuar procesin. Përderisa ekziston një gjendje time-out, imponohet nevoja për qasje të reja. David L. Phillips flet për "Fqinjërinë shqiptare – komunitet që ndan të njëjtat vlera e që bazohet në përkushtimin ndaj demokracisë, të drejtave të njeriut dhe tregjeve të hapura". (…) "Është e bazuar në faktin se grupet kanë cilësi të natyrshme të cilat pasqyrojnë historinë, kulturën dhe marrëdhëniet e tyre të përbashkëta tregtare. Të lejuarit e lulëzimit të këtyre cilësive organike mund të luajë rolin e valvulës-siguresë, duke iu mundësuar grupeve që ta nxjerrin avullin jashtë. Frustrimet paraqiten natyrshëm kur aspiratat pengohen ose nga gjeografia ose nga politika irredentiste" – shkruante ai në një artikull mbi këtë ide në vitin 2012. Ai po ashtu shkruan për realitetin e "Solidaritetit etnik shqiptar në Ballkan", por ky koncept nuk është i përshtatshëm as në kontekstin historik e as në atë gjeografik. Solidariteti etnik është koncept ku etnia pasqyron vetëdijesimin e përkatësisë në një grup, ashtu sikur edhe detyrat e solidaritetit të cilat ua imponon anëtarëve brenda dhe jashtë, kundrejt sfidave të mbijetesës së grupit. Është një koncept i përdorur gjerësisht për diasporat dhe fqinjërive të emigrantëve në mbarë botën. Lidhjet midis shqiptarëve jo vetëm që janë organike dhe të natyrshme, por ato janë edhe të lidhura historikisht me territore etnike kompakte. Në vend që të nxiten dhe ndërtohen lidhje të interesave të përbashkëta të cilat veçse ekzistojnë, ajo që nevojitet është integrimi kombëtar shqiptar i bazuar në standardet perëndimore dhe në parimet dhe idealet evropiane. Bashkëpunimi ndër-kufitar dhe rajonal, integrimi ekonomik, arsimor dhe kulturor, zhvillimi i infrastrukturës rajonale dhe projektet e veprimtaritë e përbashkëta që lidhen me mediat dhe

komunikimet përbëjnë thelbin e integrimit kombëtar shqiptar. Ky integrim e plotëson dhe i sjell dobi integrimit rajonal në strukturën euro-atlantike.

*Botuar më: 30 dhjetor 2016*

# AGORA

# Bashkimi

*Të mëdhenjtë për bashkimin kombëtar*

## Adem Demaçi

"Bashkimin Kombëtar e shoh si një proces të ligjeve të jetës, i cili gjërat i çon përpara. Bashkimin e shqiptarëve nuk mund ta ndalë asnjë forcë. Bashkimi i shqiptarëve do të dështonte vetëm sikur shtetet, të cilat e copëtuan korpusin, trupin, territorin dhe kombin shqiptar, sikur të mbërrinin t'i eliminonin shqiptarët, atë nuk arritën ta eliminonin, pavarësisht që kanë pasur deri diku sukses në zvogëlimin e numrit të shqiptarëve. Dhe, vetë qëndresa e shqiptarëve, mbijetesa e shqiptarëve, është faktori kryesor, i cili me kalimin e kohës do t'i çojë në bashkimin kombëtar, po me anë të futjes në Bashkimin Evropian, ku do të krijohet klima që ata të bashkohen pa e lënduar askënd, pa e shkelur askënd, dhe pa mundësinë që dikush ta pengojë një gjë të tillë, sepse të gjithë do të jemi brenda BE-së, nën kulmin evropian. Si të tillë, shqiptarët s'do t'i ndalojë askush që të qarkullojnë lirisht, të punojnë lirisht, të krijojnë ide, të marrin kredi, të kenë bashkëpunim edhe me njëri-tjetrin, po edhe nga bota tjetër që dëshiron të na ndihmojë."

## Ukshin Hoti

"Shqipëria është vendi i vetëm në Evropë që kufizohet pothuajse nga të gjitha anët me vetveten, d.m.th. me popullin e vet dhe me trojet e veta historike . (...) Populli shqiptar duhet bashkuar. Këtë e dijnë të gjithë dhe askush më nuk e konteston. Ai duhet të bashkohet për shkak se është i njësuar në planin shpirtëror: e ka një gjuhë, një kulturë dhe një histori. Për shkak se është një popull i vjetër evropian i Ballkanit, i cili që herët e ka demonstruar pjekurinë e vet shtetformuese; për shkak se gjithashtu që herët e ka arritur nivelin e duhur të vetëdijes politike për veten, për vendin dhe për interesat e veta në regjion, dhe për shkak se e ka dëshmuar në mënyrë të lavdishme dobishmërinë e vet në të gjitha planet e bashkësisë evropiane të popujve. Nuk i duhet që ta dëshmojë përkatësinë e vet në këtë bashkësi, sepse pavarësisht nga pozita e vet gjeopolitike dhe e pranisë së religjionit islamik në shumicën e pjesëtarëve të tij, ai ka qenë dhe ka mbetur popull evropian. Ai duhet të bashkohet edhe për shkak se e drejta për vetëvendosje është njëra ndër arritjet qenësore të qytetërimit evropian, e drejtë të cilën vetë ajo e ka proklamuar dhe e cila më asnjë populli në Evropë nuk mund t'i refuzohet a t'i mohohet. Popullit shqiptar i duhet një gjë e tillë që të mund të zhvillohet vetë më tej për ta arritur nivelin e përgjithshëm të kësaj bashkësie."

## Rexhep Qosja

"Është me rëndësi të madhe që ky integrim gjithëkombëtar të sëndërtohet duke iu shmangur neoliberalizimit ekonomik që sjell fryte vetëm për klasën politike dhe oligarkinë, në njërën anë, dhe duke ndërtuar ekonominë atdhetare, që e ka parasysh jetën e të gjitha shtresave kombëtare, në anën tjetër. Një ekonomi e tillë, atdhetare, bëhet premtim se bashkimi kombëtar, bashkimi i Shqipërisë dhe Kosovës, e rrit cilësisht, e pasuron gjithanshëm jetën e popullit shqiptar. Idetë janë ato që e lëvizin botën, por, siç e ka thënë njëri prej nismëtarëve të Bashkimit Evropian, institucionet i bëjnë njëmendësi të sendërtuar ato ide. Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen dhe do të bashkohen në mënyrë klasike qoftë jashtë Bashkimit Evropian qoftë në Bashkimin Europian."

## Ismail Kadare

"Asnjë doktrinë, asnjë manipulim apo tregti politike, asnjë trysni shtetesh, lobesh apo organizmash ndërkombëtare nuk mund ta pengojë kombin shqiptar të kryejë atë që të gjithë kombet e tjerë të Evropës, plotësisht apo gati plotësisht e kanë kryer: bashkimin e tyre. Me këtë akt, populli shqiptar nuk synon asgjë të pazakontë, e nuk kërkon asgjë të veçantë: ai kërkon veç normalitetin e vet. Ky normalitet është dhunuar pa mëshirë e ai duhet të qortohet.Në familjen e popujve evropianë, kombi shqiptar është i vetmi sot që është shënjuar për të keq. Ndërsa të gjithë ecin në një mënyrë normale, ai, i prerë mizorisht, është i detyruar të bëjë rrugën si një i gjymtuar. Populli shqiptar as ka kryer krime e as ka faje për të larë përpara botës. Ndonëse ka dy mijë vjet që ekziston në këtë botë, ai as ka sulmuar kend, as ka zhdukur kend e as ka pjellë doktrina për zhdukjen e të tjerëve. Shprehje të tilla si "Shqipëri e madhe" janë një tallje e një cinizëm i pashembullt në botën e sotme. Shqipëria e tkurrur në 28.000 kilometrat e saj, është e kërcënuar të fajësohet si "e madhe" në qoftë se do të arrijë 45 ose 50 mijë kilometra, e shtete të tjera me shtrirje të përbindshme prej miliona kilometrash katrore, shtete që kanë bërë krime të frikshme ndaj botës, që kanë pjellë teori më të zeza se murtajat, që kërcënojnë njerëzimin me armë bërthamore, nuk quhen "të mëdha".Si organizmi që kërkon jetën e vet natyrale, kombi shqiptar kërkon normalizimin e vet trupor e shpirtëror."

*Botuar më: 25 shkurt 2016*

# Hallka e këputur e politikës shqiptare në Ballkan

*Editorial*

Kur më 11-12 janar të vitit 1992, shqiptarët në Maqedoni votuan për autonomi politike dhe territoriale në këtë shtet, nuk e kanë menduar se pas 24 vitesh kjo ide dhe pozita e tyre do të mbeten në vendnumëro. Në ato ditë të ftohta, me shumë sakrificë, shqiptarët votuan për idenë e tyre, votuan për veten e tyre, por në asnjë mënyrë nuk e kanë menduar se do të ketë parti shqiptare që do të promovojnë bashkëjetesën si opsion të zgjidhjes së problemit të tyre. Ata nuk e kanë menduar se do të ketë opsione politike shqiptare që favorizojnë koalicione parazgjedhore apo flirtojnë me parti maqedonase dhe individë, të cilët me mburrje e thonë se janë anëtarë të SDSM-së apo VMRO-së. Në atë kohë do të quheshin tradhtarë ose (me terminologjinë e atëhershme) shqiptarë të ndershëm.

Kanë kaluar 24 vjet nga referendumi i shqiptarëve dhe 25 vjet nga shpallja e Maqedonisë shtet i pavarur, kurse gjendja e përgjithshme e shqiptarëve në Maqedoni duket se ka mbetur në po atë gjendje që ka qenë, me pak ndryshime kozmetike, por pa ndryshime thelbësore. Janë krijuar shumë parti shqiptare (8 parti), të cilat në thelb e synojnë pushtetin, por asnjëra nuk ofron zgjidhje konkrete të çështjes shqiptare në Maqedoni, si pjesë integrale e zgjidhjes së çështjes shqiptare në Ballkan. Në prag të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme në Maqedoni, që janë shpallur të mbahen më 11 dhjetor, partitë maqedonase, si duket, janë konsoliduar, duke krijuar dy blloqe kryesore politike: SDSM-ja me disa parti të vogla dhe gjithmonë me nga një parti turke, rome e me raste edhe boshnjake dhe VMRO-DPMNE-ja me disa parti të tjera të vogla maqedonase dhe me nga një parti turke, serbe, rome dhe boshnjake. Blloku politik maqedonas duket se është konsoliduar edhe sa i përket programit parazgjedhor, që me pak ndryshime nuk dallojnë shumë nga njëra-tjetra lidhur me atë se si e shohin pozitën e shqiptarëve në Maqedoni. Maqedonasit kanë një alternativë se si e për kë duhet të votojnë. Dy partitë e mëdha shqiptare BDI dhe PDSH e kanë shpalosur me shumë drojë programin e tyre se si e shohin zgjidhjen e problemit të shqiptarëve të Maqedonisë. Derisa PDSH-ja thotë se platforma e tyre mbetet marrëveshja historike midis shqiptarëve dhe maqedonasve për ta udhëhequr këtë shtet, BDI-ja mendon se duhet një marrëveshje e re me maqedonasit për t'i shpjerë përpara proceset e filluara. Hutinë më të madhe ndaj votuesit shqiptar në Maqedoni e kanë krijuar partitë e sapokrijuara, të cilat deri më tani kanë ofruar disa opsione politike, por pa treguar se si do t'i realizonin këto opsione dhe a kanë kapacitet për

*Politika shqiptare në Maqedoni është hallka e këputur e çështjes shqiptare në Ballkan. Ajo duhet të orientohet nga pjesa tjetër e shqiptarëve në Tiranë dhe Prishtinë, për të qenë pjesë vitale e mozaikut të zgjidhjes së kësaj çështjeje.*

ta realizuar këtë. Këto parti janë vetëquajtur opozitare pa e matur akoma forcën e tyre në zgjedhje.
Lëvizja "Besa", që në themelimin e saj u trondit nga informacionet se ajo është dorë e zgjatur e politikës turke të presidentit turk Rexhep TaipErdogan dhe se financohet po nga ai.
Ajo që shtron më shumë dilema para elektoratit shqiptar është Lëvizja për Reforma – PDSH e udhëhequr nga ZijadinSela. Kjo parti del me deklarata të shumta se është për barazi të plotë të shqiptarëve në Maqedoni, por me veprimet e saj tregon se nuk do ose nuk ka kapacitet të realizojë asnjë agjendë e vetme. ZijadinSela, në një intervistë thotë se nëse partisë së tij do t'i jepej rasti për të hyrë qeveri, ajo nuk do ta bëjë këtë pa u bërë ndryshimet kushtetuese dhe pa u miratuar ligjet sipas platformës e programit të përbashkët të Aleancës për Shqiptarët (LR-PDSH, Uniteti dhe RDK) për të drejtat e plota të shqiptarëve. Kërkesat për ndryshime të kushtetutës kanë ekzistuar në vazhdimësi, por ato u bënë vetëm pas luftës së vitit 2001, në Marrëveshjen e Ohrit, shtyllat kryesore të së cilës nuk u realizuan kurrë. Anëtarë të kryesisë së kësaj partie rreshtohen, me apo pa dije, në një anë me përfaqësues të politikës së opozitës maqedonase kundër "të keqes së përbashkët VMRO-BDI". Njëjtë kanë vepruar dhe përfaqësues të Lëvizjes "Besa" në fillim të veprimit të saj si parti, kur anëtarë të kryesisë së saj u panë duke marrë pjesë në mitingjet e organizuara nga opozita maqedonase. Asnjë nga partitë e "vjetra" shqiptare nuk kanë shprehur interes e as që janë deklaruar për koalicione parazgjedhore me partitë maqedonase. Kjo gjithmonë është parë si veprim i dëmshëm ndaj faktorit shqiptar dhe dëmtim i interesit kombëtar të shqiptarëve në Maqedoni.
Shpallja e zgjedhjeve të parakohshme nuk ishte kërkesë e shqiptarëve, por ishte rezultat i krizës politike të krijuar nga SDSM-ja për të ardhur në pushtet. Krijimi i shumë partive shqiptare në Maqedoni dëmton rëndë faktorizimin e shqiptarëve dhe realizimin e agjendës kombëtare. Ndarja e votës shqiptare me partitë e vogla i defaktorizon shqiptarët politikisht, ndërkaq dëmi i krijuar nuk do të mund të riparohet deri në zgjedhjet e ardhshme. Analizat thonë se pas këtyre zgjedhjeve numri i deputetëve shqiptar në kuvend do të jetë më i ulët se ai në përbërjen paraprake. Politika zyrtare maqedonase, si duket, i ka marrë të gjitha masat që shqiptarët të gjunjëzohen në këto zgjedhje, duke kërkuar përkrahje masive nga votuesit maqedonas. Lideri i VMRO-së kërkon të ketë 63 deputetë për të mos pasur nevojë për partitë shqiptare. SDSM-ja kërkon votën e shqiptarëve për të rrëzuar këtë diktaturë, siç e cilësojnë ata, duke tentuar t'i sfidojë partitë politike shqiptare në terrenin e tyre. Sipas informacioneve, lideri i SDSM-së ZoranZaev, i cili është kryetar i komunës së Strumicës, do të jetë bartës i listës në njësinë e 6-të zgjedhore, ku është përqendrimi më i madh i votuesve shqiptarë. Po kjo njësi qe më "problematikja" gjatë sfidës së pastrimit të listave zgjedhore. Në procesin e pastrimit të listave zgjedhore, janë fshirë mbi 30 mijë votues shqiptarë.
Në njësinë e gjashtë zgjedhore gjithmonë zgjidhen nga 2-3 deputetë maqedonas, pa pasur nevojë për votën e shqiptarëve. Por, siç duket Zaevi dëshiron ta shndërrojë fitoren e tij në fitore me ndihmën e shqiptarëve, edhe pse, në fakt, në çfarëdo kombinimi të mundshëm, ai do të fitojë nga vota maqedonase. Të dyja partitë maqedonase kanë historitë e tyre të përpjekjeve të vazhdueshme për të nëpërkëmbur dhe zhbërë interesin e shqiptarëve në këtë shtet. Shumica

e krerëve të SDSM-së janë pinjollë të politikave antishqiptare në ish-Jugosllavi dhe autorë të ngjarjeve të shumta kundër shqiptarëve (helmimet e nxënësve, aksioni kundër themelimit të Universitetit të Tetovës, ngjarjet e vitit 1997 kundër përdorimit të flamurit shqiptar etj.). Nga ana tjetër, krerët e VMRO-DPMNE-së janë ata që në vitet e tyre të studimeve, si pjesëtarë të Unionit të të Rinjve të kësaj partie kërkonin dhoma gazi për shqiptarët. SDSM-ja si parti më e vjetër (pasardhëse e Partisë Komuniste të Maqedonisë) me politikat e veprimet e saj ka dëshmuar se është e interesuar thellësisht që shqiptarët në Maqedoni të shkrihen, të krijohen shqiptarë hibridë, të cilët dalëngadalë do të harrojnë gjuhën e më vonë edhe vetë identitetin. Këtë ajo e promovon përmes konceptit të kombit politik dhe deterritorializimit të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni.
Orientimi i politikës së tyre për të adresuar çështje ekonomike, pa pastruar me të kaluarën ekonomike të shqiptarëve dhe pa e ndarë kulaçin ekonomik, dëshmon se ata po përgatisin mashtrimin e madh. Kjo i bën fajtorë kolektivë dhe ideatorë kryesorë të pozitës inferiore të shqiptarëve në Maqedoni, ku përveç të drejtave të tjera u mohohen edhe të drejtat ekonomike. Sipas tyre: "Shqiptarët janë të mirë vetëm kur mbushin buxhetin e shtetit, por ata nuk duhet të bëjnë ekonomi, sepse këtë e bëjnë maqedonasit, pra pronarët e shtetit".
Kur është në pyetje interesi i shqiptarëve dhe rëndësia e tyre në këtë shtet, të gjitha partitë maqedonase janë në një mendje, duke pohuar se shqiptarët i kanë të gjitha të drejtat dhe se duhet të jenë më lojalë dhe ta duan këtë shtet të maqedonasve, sepse ata nuk kanë ndonjë shtet të tyre rezervë.
Politika shqiptare në Maqedoni është hallka e këputur e çështjes shqiptare në Ballkan. Ajo duhet të orientohet nga pjesa tjetër e shqiptarëve në Tiranë dhe Prishtinë, për të qenë pjesë vitale e mozaikut të zgjidhjes së kësaj çështjeje. Politika e shqiptarëve në Maqedoni duhet ta tregojë qartë synimin e saj dhe vullnetin e shqiptarëve në këtë shtet. Vota shqiptare duhet të jetë një referendum për t'i treguar edhe faktorit të brendshëm edhe atij të jashtëm se ata nuk duan shumë parti, por duan parti të forta, që kanë kapacitet, ekspertizë dhe njerëz që ta realizojnë këtë synim.
Shqiptarëve të Maqedonisë u duhet dialogu i brendshëm para se të dialogojnë me të tjerët. Zgjedhjet duhet ta përçojnë porosinë se sado që dikush tenton t'i ndajë, ata bashkohen, fuqizohen dhe se ata e kanë të qartë se çfarë duan. Tregu është i madh dhe politika ende më e madhe, kurse shqiptarët në Ballkan janë një faktor i madh gjeostrategjik e demografik, që nuk mund të shpërfillet. Shqiptarët në Maqedoni duhet të votojnë vetëm për këtë qëllim.

*Botuar më: 27 tetor 2016*

# Vota shqiptare – për shqiptarët

*Editorial*

Fushata parazgjedhore në Maqedoni ka dëshmuar se ambicia e sëmurë, interesi personal, klanor dhe interesa të tjera të ngushta e kanë përçarë dhe copëtuar trupin votues dhe alternativat politike të shqiptarëve në Maqedoni. Nëse nuk mëson nga historia, ajo të përsëritet. Zgjedhjet e vitit 2011 dëshmuan pikërisht këtë dhe rezultati qe në funksion të dobësimit të faktorizimit politik dhe etnik të shqiptarëve në këtë shtet pa emër. Kjo, mund të përsëritet edhe në zgjedhjet e 11 dhjetorit, nëse ne nuk nxjerrim mësime nga historia.
Është e natyrshme që shqiptarët, ashtu si të gjithë shtetasit e tjerë të presin ndryshime politike dhe jetë më të mirë. Është më se normale që të shpresojnë për shkolla më të mira, çerdhe, rrugë, mjedis të pastër, shërbime më të mira. Në qoftë se shqiptarët nuk kanë standard jetese normale, nuk kanë rrugë, nuk kanë shkolla të mira dhe shërbime të mira, fajin më të madh e kanë pikërisht të dyja partitë politike maqedonase sa herë ato kanë pasur pushtetin e që me çdo mjet dhe metodë shantazhojnë, dekonspirojnë dhe dekonsruktojnë agjendat shqiptare të partive politike shqiptare në Maqedoni. Pavarësisht se cili subjekt nga blloku maqedonas del mandatar, është dëshmuar se në agjendat e tyre fillimisht si synim, e me përfundimin e zgjedhjeve edhe si qëndrim kanë dobësimin dhe përfundimisht kthimin e palës shqiptare në një rol pasiv.

*Ne nuk kemi probleme të njëjta me maqedonasit. Problemet tona janë shumë më të thella, shumë më të rënda se të tyre. Këtu nuk kemi asnjë pikë takimi. Problemet tona lidhen me problemet që kanë shqiptarët në Ballkan dhe kjo zgjidhet vetëm më Agjendën shqiptare, me faktorizimin e shqiptarëve si tërësi në Ballkan dhe vendosjen e realitetit dhe vullnetit të mohuar shqiptar.*

Të paturit premtime humb kuptimin, mbajtja e premtimeve bëhet e paqenë, ndërkaq veprimi politik shqiptar shndërrohet në veprim politik ad-hoc dhe sipas rrethanave dhe mundësive momentale. Kjo për dy arsye: e para, politikat e shtetit maqedonas, që përpiqet me çdo kusht ta ndajë, defaktorizojë, ta minimizojë votën, fuqinë shqiptare.
Arsyeja e dytë është sepse ligji për të drejtën e mandatarit i referohet vetëm palës maqedonase, por jo edhe asaj shqiptare. Pra, fituesi i shumicës së deputetëve nga pala maqedonase mund të zgjedhë të bëjë koalicion qeveritar me cilëndo parti shqiptare që atij i përshtatet, pa marrë parasysh vullnetin e shumicës së elektoratit shqiptar. Përmes kësaj formule, jo pa qëllim, blloku maqedonas pas zgjedhjeve, fut në veprim teorinë e lojës e sidomos formulën e njohur "dilema e të burgosurit". Dilema e të burgosurit është një matricë në kuadër të teorisë së lojës, e cila konsiston në atë se përse dy individë, krejtësisht racionalë, mund të mos bashkëpunojnë edhe atëherë kur bashkëpunimi është në interesin e tyre më të mirë.

Makiaveli lidhur me politikën dhe aktorët politikë, thotë se "Politika nuk ka lidhje me moralin", që sipas një interpretimi të lirë do të thotë se nëse merresh me politikë, atëherë s'ke pse flet për moral, qoftë ky edhe fetar. Nëse i referohemi kësaj pikëpamjeje, veprimet e bllokut maqedonas janë të parashikueshme, të pritshme dhe për më tej të organizuara si të tilla kundrejt shqiptarëve. Por, e paparashikueshme dhe e pa justifikueshme është e ashtuquajtura alternativa politike brenda korpusit shqiptar, të cilat me moto autentike shqiptare, realizojnë agjenda të huaja, që kanë për qëllim imponimin e një realiteti të ri në mjedisin politik shqiptar, rrjedhimisht edhe në traditën dhe mendësinë shqiptare. Kjo ideologji është kryekëput në dëm të interesave jetike dhe strategjike të shqiptarëve, është në dëm të unifikimit të potencialit tonë mbarëkombëtar dhe realizimit të synimeve tona për t'u bërë pjesë e pandashme e familjes së madhe evropiane. Kjo ideologji neo-otomane ka synim shtrirjen e ndikimit dhe kontrollit në hapësirat shqiptare dhe në interes të të gjitha palëve tjera që duan edhe më tej ta cungojnë trungun tonë kombëtar dhe t'i defaktorizojnë shqiptarët në Ballkan.

Prej kohësh shtete me fuqi të mëdha, përmes tentativave të ndryshme kanë bërë përpjekje që ta prishin aleancën shqiptare me Perëndimin dhe t'i fusin ata në rrugën pa krye, por kjo nuk ka arritur të jetë e realizueshme. Në këtë kuadër, këto shtete stërholluan strategjitë e tyre për të arritur deri te qëllimi dhe thellësisht analizuan faktorin që mund të çojë në prishjen e kësaj aleance në mes shqiptarëve dhe Perëndimit. Përmes koluareve të shërbimeve intelegjente dhe OJQ-ve të ndryshme si pararojë e po këtyre shërbimeve përkatëse, futën në veprim formimin e subjekteve politike me bazë islamin politik. Në agjencinë ruse të informimit "Sputnik", në vitin 2014 u publikua pothuajse aksidentalisht një analizë në të cilën thuhej se faktori i vetëm i prishjes së aleancave në Ballkan është shtrirja e islamit politik. E njëjta u tërhoq nga botimi tri orë pas publikimit. Përballë këtyre përpjekjeve të dyshimta, ne si popull kemi dhënë prova dhe fuqishëm kemi marrë rrugën e orientimit gjeostrategjik, i cili ka qenë dhe është pro perëndimit, pro SHBA-ve. Andaj është e palejueshme që për shkak të interesave të lartpëremendura të ndërrohet rrjedha e historisë dhe të prishen aleancat dobiprurëse për shqiptarët. "Mbrojtësit e interesave shqiptare në Maqedoni" nuk mund të llogariten struktura të paguara nga autoritarë neo-otomanë të cilët paraqiten si "shpëtimtarë" të Maqedonisë që do ta rrëzojnë "regjimin" e Gruevskit.

Kjo s'ka të bëjë aspak me interesin e shqiptarëve në Maqedoni. Ne nuk e kemi vendosur në pushtet Gruevskin. Ata e sollën, ata le ta heqin. Divergjencat e Gruevskit dhe Zaevit jane luftë për pushtet dhe kanë një emërues të përbashkët: "Shqiptarët nuk duhet të jenë lojtarë, por spektatorë në qeverisjen e Maqedonisë, inferiorë dhe në fund krejtësisht të papërfillshëm". Ne e kemi interesin tonë. Jemi të bindur se shqiptarët në Maqedoni nuk do të vazhdojnë të jenë qiraxhinj në shtëpinë e vetë. Ka ardhur koha që të thuhet se askush nuk mund të imponojë vullnetin antikombëtar.

Agjenda shqiptare është zgjidhja e krejt kësaj mjegullnaje që ka kapluar veprimin politik të shqiptarëve në Maqedoni. Ajo, duhet shkruar, shtruar dhe në fund miratuar. Pastaj flasim për vende pune, për ekonomi, për shkolla dhe çerdhe, që nuk mund të na i ofrojë askush, nëse nuk i ndërtojmë vetë me paratë që ia japim këtij shteti.

Ne nuk kemi probleme të njëjta me maqedonasit. Problemet tona janë shumë më të thella, shumë më të rënda se të tyre. Këtu nuk kemi asnjë pikë takimi. Problemet tona lidhen me problemet që kanë shqiptarët në Ballkan dhe kjo zgjidhet vetëm më Agjendën shqiptare, me faktorizimin e shqiptarëve si tërësi në Ballkan dhe vendosjen e realitetit dhe vullnetit të mohuar shqiptar.
Vota shqiptare në Maqedoni duhet të jetë votë për faktorin politik shqiptar dhe asnjë votë, asnjë votë e vetme nuk duhet të shkojë për parti politike të etniteteve të tjera apo atyre që kanë në agjendë futjen e islamit politik brenda kombit shqiptar. Vota e tillë nuk mund të quhet ndryshe, veçse votë kundër interesit kombëtar shqiptar. Ne s'kemi nevojë për ideologji të huaja e as për kosmopolitizëm. Ne kemi nevojë për njohje të realitetit dhe rrethanave historike që sollën deri te ky realitet. Ne duhet dëshmuar se jemi këtu sepse e meritojmë, se jemi të pjekur, se dimë të zgjedhim dhe se dimë çfarë duam. Interesin tonë kombëtar, ekonomik dhe politik askush nuk mund ta mbrojë më mirë se vetë ne.

*Botuar më: 8 dhjetor 2016*

# ME TEJQYRË

# Rikthimi në gjeopolitikë

*Fatmir Arifi*

Çdo gjë që ndodh në botën e sotme, nga komuniteti i ekspertëve po përkufizohet si një krizë e sistemit politik ndërkombëtar. Natyrisht, ndryshimet janë të konsiderueshme në nivel global që nga rënia e ekonomisë, shtrirja e terrorizmit, krijimi i shteteve të reja dhe jostabile e deri te dështimi i një sërë shtetesh e kështu me radhë. Këto ndryshime kanë prekur dhe sjellë impakt të konsiderueshëm si kriza botërore e në mënyrë të veçantë: si kriza politike ndërkombëtare, kriza të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, kriza diplomatike, pse jo shpeshherë të interpretuara edhe si kriza të civilizimeve.

Por, gjithë kjo dinamikë globale nuk është si pasojë e krizës së sistemit ndërkombëtar. Nëse i referohemi nocionit "sistem", atëherë si quhet sistemi ndërkombëtar në të cilin jemi aktualisht?

Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare njeh katër sisteme ndërkombëtare: sistemin e Vestfalisë, Koncertin e Evropës, Sistemin e Versajës dhe atë të bipolaritetit të Luftës së Ftohtë. Pas shpërbërjes së këtij të fundit, bota është në anarki totale dhe praktikisht pa sistem ndërkombëtar. Prandaj edhe turbulencat e sotme në politikën globale, nuk janë si pasojë e krizës së sistemit, por si pasojë e mungesës së sistemit ndërkombëtar.

*Në qoftë se epoka, në të cilën po jetojmë aktualisht, në histori ka ndonjë funksion përcaktues, ai funksion me siguri është konfuzioni i përhapur në lidhje me atë se si ta përkufizojmë politikën bashkëkohore globale dhe prirjet e saj në të ardhmen. Duke e shtruar analizën nga ky këndvështrim, këtë gjendje do ta quanim rikthim në gjepolitikë.*

Është krejtësisht e natyrshme që ndokush nga komuniteti i ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare ta keqinterpretojë nocionin "sistem", meqenëse shpeshherë ata i janë referuar Organizatës së Kombeve të Bashkuara si sistem ndërkombëtar. Mirëpo, e vërteta logjike është se OKB është dizajnuar, jo si sistem ndërkombëtar, por si mekanizëm i sistemit ndërkombëtar, përkundër asaj se edhe si e tillë asnjëherë nuk kanë qenë një ilustrim i përsosur në rolin e saj.

Në qoftë se epoka, në të cilën po jetojmë aktualisht, në histori ka ndonjë funksion përcaktues, ai funksion me siguri është konfuzioni i përhapur në lidhje me atë se si ta përkufizojmë politikën bashkëkohore globale dhe prirjet e saj në të ardhmen.

Arsyeja është thjesht pa asnjë lloj dilemë. Ne, sot jetojmë në një botë krejtësisht të paparë dhe pa rregulla. Në këtë botë të paparë është vështirë që të thirremi në ndonjë gjë. Përderisa ne nuk e dimë se çfarë është ajo gjë, atëherë si ta quajmë ndryshe? Duke e shtruar analizën nga ky këndvështrim, këtë gjendje do ta quanim rikthim në gjepolitikë. Gjeopolitika si vizion ishte dominant në fund të shekullit XIX dhe në

fillim të shekullit XX dhe ishte e formuluar mbi një sërë besimesh nga elitat akademike dhe politike të fuqive të mëdha të asaj periudhe kohore.
Prapa këtij koncepti qëndronte logjika e dominimit gjeografik, e që në fakt barte në vete kundërshtime në mes të fuqive të mëdha. Çdo fuqi e madhe aspironte për kontrollin mbi territore të caktuara gjeografike, të cilat për një arsye apo një tjetër kishin rëndësi të veçantë.
Duhet ta theksojmë se gjepolitika, si vizion dhe si strategji, nuk mund të vihet në zbatim në çdo rajon. Gjepolitika synon rajonet e caktuara që për nga burimet natyrore janë të pasura dhe për nga shtrirja gjeografike janë të rëndësishme, por gjithsesi njëkohësisht të brishta në sistemin e qeverisjes. Në vendet me zhvillim të lartë ekonomik, vizioni gjepolitik nuk mund të jetë i zbatueshëm. Prandaj edhe logjika e dominimit gjeografik kur kombinohet me ideologji të caktuar, sjell në pah gjopolitikën.
Trekëndëshi i paqëndrueshmërisë globale
Aktualisht, në sferën globale kemi tri rajone, që për nga rëndësia bartin këtë përbërje: Azia Qendrore, Lindja e Mesme dhe Ballkani, të cilat përbëjnë trekëndëshin e paqëndrueshmërisë globale.
Azia Qendrore, ku bën pjesë edhe Kaukazi, është bërë një nga rajonet më të paqëndrueshme në sistemin ndërkombëtar. Strukturat politike shtetërore janë shumë të brishta, duke përfshirë këtu një seri konfliktesh të ngrira si rrjedhojë e shpërbërjes së BRSS-së. Përveç tjerash, ky rajon ndodhet në një zonë ku takohet civilizimi i krishterë me atë islam, të cilët kanë qenë historikisht burim i rivaliteteve dhe i fërkimeve në mes të komuniteteve dhe shteteve të ndryshme. Karakteristikë tjetër e Kaukazit është diversiteti etnik, gjuhësor dhe kulturor. Si i tillë, ky rajon është shndërruar në një nga rajonë6et më komplekse në botë për sa i përket çështjeve etnike. Gjithashtu, ky rajon përballet edhe me interesat gjeo-ekonomike të lidhura me burimet e hidrokarbureve. Baseni i Kaspikut po shton rivalitetet mes fuqive të ndryshme, të cilat po konkurojnë për t'i dominuar burimet e pasura të naftës dhe gazit natyror;
Lindja e Mesme është zona me krizën e së cilës shumë breza njerëzish janë lindur dhe janë formuar, duke dëgjuar e parë në mediume për të. Kriza në Lindjen e Mesme është një nga më të mëdhatë dhe më komplekset në historinë moderne të njerëzimit. Duhet ta theksojmë se asnjë krizë nuk lind me dimensione të mëdha, po qe se nuk ka një të kaluar historike me një sërë shkaqesh brenda saj. Në rast se këtij rajoni ia bëjmë një analizë nga perspektiva gjeo-kulturore, Lindja e Mesme, që nga shpikja e shkrimit e deri më sot ka përbërë udhëkryqin më të rëndësishëm në përhapjen e qytetërimeve të zhvilluara, dhe aktualisht është zona ku takohet Lindja dhe Perëndimi. Në rast se e analizojmë nga perspektiva gjepolitike, zona është e ndikuar nga ekuilibrat rajonalë, por në papërputhshmëri me gjeografinë fizike, e cila është e mbështetur në teza historike de fakto dhe në përkufizime politike de jure, me ç'rast ka prodhuar kontradikta të thella në mes shteteve të Lindjes së Mesme. Në rast se e bëjmë një analizë nga perspektiva dhe dimenisioni gjeostrategjik, pozita e Lindjes së Mesme është jashtëzakonisht e rëndësishme, pasi që ndodhet aty ku takohen tri kontinente: Evropa, Azia dhe Afrika.
Dhe së fundmi, në rast se e analizojmë nga dimensioni gjeo-ekonomik, zona është pikëkryqëzimi i rrugëve të komunikacionit ujor, por në të njejtën kohë dhe zona më e pasur me lëndë të hidrokarbureve.

Për sa i përket Ballkanit si njëri nga brinjët e këtij trekëndëshi të paqëndrueshmërisë globale, ai është i shtrirë në linjat e tri ish perandorive të dikurshme dhe laget nga ujërat e Detit të Zi dhe të Mesdheut. Ballkani historikisht ka qenë rajon i përplasjeve gjeopolitike si për nga rivalitetet e brendshme, ashtu dhe për nga influencat e jashtme. Gjatë epokës së Luftës së Ftohtë, Ballkani ishte si një lloj zone tamponi në marrëdhëniet midis dy blloqeve. Dy aleancat ushtarake, NATO dhe Pakti i Varshavës, duke ruajtur ekuilibrin në hapësirën evropiane, siguruan një stabilitet të përkohshëm në Ballkanin Perëndimor. Ishte e kuptueshmë se në rast të ndërhyrjes së njërës palë në njërën nga sferat e ndikimit, parimi i ekuilibrit strategjik nuk do të lejonte qëndrimin menjanë të palës tjetër.

Kështu që, në kontekst të asaj që u tha më lartë, dinamikat globale që po ndodhin sot në politikën botërore mund të shpjegohen vetëm nga prizmi gjeopolitik, me synimin për të dominuar hapësirën gjeografike para se të formësohej një rend i ri botëror.

Në këtë kuadër duhet shikuar edhe aneksimi i pa precedent nga Federata Ruse në Gjeorgji, Ukrainë dhe së fundi ndërhyrja e saj në Siri. Federata Ruse, përmes Gjeorgjisë, Ukrainës dhe së fundmi ndërhyrja në Siri, po synon të ri-konfigurojë peisazhin global përpara se të ulet në tavolinën e Rendit të Ri Botëror. Duhet theksuar se këto rajone janë ndër rajonet më vitale të planetit Tokë. Gjeorgjia bën pjesë në hapësirën e përqëndrimit të fuqisë tokësore nga njëra anë dhe nga ana tjetër është vija kalimtare ku intesifikohen konkurencat e fuqive tokësore dhe detare.

Sa i përket aneksimit të Krimesë, Federata Ruse synon ta rikthejë ndikimin në Evropën Lindore dhe ta dominojë tërësisht Detin e Zi. Nuk duhet të harrojmë se në periudha të ndryshme historike, Ukraina ka luajtur një rol të rëndësishëm në ekuilibrin në mes të Perandorisë Osmane – ruse dhe asaj polake. Për më tepër, Ukraina ishte faktori kryesor që i ka nxjerrë rusët nga gjendja e një popullate të panjohur të Detit të Veriut duke i bërë në fillim si shtet kontinental e më vonë edhe si fuqi botërore, duke u mundësuar që përmes Ukrainës të marrin pjesë si në Evropën Lindore e në Detin e Zi.

Objektivi i Rusisë në Ballkan është që përmes aleancave tradicionale sllavo-ortodokse të pengojë sa të mundet e aty ku ka mundësi, zgjerimin e infrastrukturës euro-aëtlantike dhe ndërkohë ta ruajë mjaftueshëm pozicionin e saj në zbatimin e projekteve strategjike të infrasturkutës energjetike. Është fakt i kryer tani më që Rusia ka pasur sukses në blerjen e aseteve si rafineri nafte në Bullgari e Rumani dhe një rrjet të gjerë të shpërndarjes së energjisë në Ballkan. Rusia po negocion për më shumë blerje në Rumani, Bullgari, Serbi, Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë. Ajo po zgjeron rrugët e transportit të energjisë nëpër Ballkan, Baltik dhe në Evropën Lindore. Kjo tregon se energjetika ka pushuar së qeni çështje ekonomike dhe ajo po bëhet kaq e rëndësishme strategjikisht, sa që nuk mund të kufizohet të jetë kompetencë vetëm e ministrave të ekonomisë. Ajo është shndërruar në pjesë të tërësisë së strategjisë së sigurisë kombëtare të një shteti dhe në prioritet të interesit kombëtar.

Me ndërhyrjen në Siri, Federata Ruse po implementon politikat e zbritjes në detëra të ngrohtë me synim udhëkryqin botëror të trafikut detar siç është Mesdheu. Pra, ky është një projekt ambicioz i Federatës Ruse, i cili është bërë dominant në të menduarit e strategjisë së politikës së jashtme me synim për ta

ri-kthyer Rusinë në një perandori të dikurshme. Kjo ambicje duhet të jetë një alarm për të zgjuar diplomacinë perëndimore, e cila prej kohësh e ka sygjestionuar veten se me shembjen komunizmit kemi arritur në fund të historisë dhe tani e tutje paqja qiellore do të dominojë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sjelljet e Federatës Ruse janë një mesazh i qartë për reflektim politik, diplomatik dhe strategjik, të qeverive dhe të shteteve në të gjitha rajonet evropiane, peëfshirë edhe Ballkanin përderisa marrëdhëniet e saj po i zhvillon në përputhje me logjikën e një lufte të re të ftohtë e cila shumë lehtë mund të kthehet në një luftë të nxehtë. Rivalitetet gjeopolitike dhe gjeostartegjike bartin në vete kundërthënie të mëdha që historikisht kanë qenë kombinim shpërthyes në mes fuqive të mëdha.  Andaj dhe është mëse e domosdoshme që SHBA-të të rishqyrtojnë politikën e saj të jashtme dhe marrëdhëiet me disa nga fuqitë e saj aleate. Aksi i mundshëm i konfrontimit SHBA-Rusi padyshim që do të jetë Azia Qëndrore dhe Jugore, Lindja e Mesme dhe Ballkani. Në këtë kuadër, hapësira shqiptare nuk mund të jetë e paprekur dhe e përjashtuar.

*Botuar më: 26 janar 2016*

# Dilema e sigurisë dhe dilema e integrimit

*Fatmir Arifi*

Në kuadër të konferencës vjetore të Mynihut që u mbajt në shkurt të këtij viti, e cila i dedikohet shqyrtimit vjetor të problemeve të sigurisë botërore, këtë vit lista e problematikave globale nuk u ngushtua. Vitin e kaluar, fokusi i konferencës ishte agresioni i Rusisë kundër Ukrainës, ndërsa këtë vit, përpos tjerash, u shtua dhe ndërhyrja ruse në Siri. Me një fjalë, sjelljet e paprecedenta të Rusisë ishin në qendër të vëmendjes. Nga një pjesë e analistëve politikë, debati në Konferencën e Mynihut u interpretua si fillim i një lufte të dytë të ftohtë. Pa dyshim, retorika e përdorur në kuadër të debatit të konferencës së Mynihut, në mes të përfaqësuesve të Federatës Ruse dhe euroatlantizmit të çon në krijimin e një opinioni të tillë, por thelbi i kësaj retorike qëndron krejtësisht diku tjetër. Bota nuk është më e destabilizuar se sa në çdo kohë që nga përfundimi i Luftës Dytë Botërore. Por, rrezikshmëria qëndron në atë se, përpos që nuk kemi një sistem global të profilizuar, kemi edhe mungesë të lidershipit global. Me vetë faktin që SHBA-të morën drejtimin dhe formësimin e sistemit ndërkombëtar të pas Luftës së Dytë Botërore dhe tani kanë zgjedhur këtë moment që të jenë pasive në botë, të krijon përshtypjen se vërtet po hyjmë në një konfrontim të tipit të luftës së ftohtë. Nuk duhet menduar që mungesa e lidershipit të SHBA-ve ka shkaktuar një paqendrueshmëri, por se ka inkurajuar dhe ka përkeqësuar situatën. Natyrisht, Lufta e Ftohtë, që nga fillimi i saj njihet si një nga periudhat më të rrezikshme në historinë njerëzore. Por, përderisa vetë Rusia doli të jetë e humbur nga kjo luftë, nuk ka indicie që ajo ka ambicie të rikthehet përsëri në beteja të tilla. Që nga viti 1947 deri në vitin 1989, përplasja sistematike ideologjike e dy blloqeve kishte prodhuar një garë të gjerë gjeopolitike në nivel global, deri edhe me kërcënimin e armagedonit bërthamor. Andaj, në kushtet e sotme, Lufta e Ftohtë nuk mund të përkufizohet me disa mosmarrëveshje themelore në mes Perëndimit dhe Federatës Ruse. Më konkretisht, mosmarrëveshjeve të sotme i mungojnë pesë karakteristika që e përcaktojnë Luftën e Ftohtë përtej rivaliteteve të thjeshta të fuqive të

*Tërheqja e interesave tradicionale të sigurisë që erdhën nga të dyja anët, si nga Lindja, ashtu dhe nga Perëndimi, ka nxitur shtetet Evropës qendrore të bashkohen me institucionet perëndimore sa më shpejt të jetë e mundur, për ta mbrojtur veten kundër një Rusie potencialisht të projektuar si një fuqi e madhe. Kjo çështje tek pala ruse ngjalli logjikën e "dilemës së sigurisë". Lënia jashtë e disa shteteve të Evropës Lindore, Ballkanit e deri në Kaukaz, të pasigurtë, pa ndonjë marrëveshje kolektive për sigurinë përballë një Rusie tradicionalisht agresore, prodhoi "dilemën e integrimit".*

mëdha: së pari, secila palë supozonte se fajin për konfrontim e bart ana tjetër antagoniste; së dyti, konflikti nuk është thjesht konflikt i interesave, por konflikti është si qëllim; së treti, konkurrenca në mes të dy blloqeve apo antagonistëve, nuk përfundon përderisa në njërën palë nuk do të ketë ndryshime rrënjësore apo shembje të plotë; së katërti, marrja me çështje të veçanta është më shumë transaksionale dhe jo kumulative; së pesti, konfliktet që ndodhin nuk janë të fragmentuara, por ato metastazohen në mënyrë të tillë që të gjitha çështjet janë të lidhura, ose të ndërlidhura në mes vete.

Andaj, zhvillimet dhe rivalitetet e sigurisë në mes të Perëndimit dhe Federatës Ruse bëhen më të thjeshta për t'u kuptuar se në çfarë dimensioni po ecën politika globale. Prandaj dhe apriori nuk mund të gjykojmë se bota po hyn në një luftë të dytë të ftohtë. Siç dihej mirëfilli, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara kanë mbrojtur vizione bindëse shumë të ndryshme ideologjike dhe zhvillimore lidhur me proceset shoqërore: i pari, supozonte se një botë, në të cilën "mizoria" e kapitalizmit të tregut të lirë do të përmirësohet në pronësi të përbashkët të mjeteve të prodhimit, ndërsa e dyta, ka përfaqësuar një botë të përcaktuar nga liritë që zotërojnë individët në zgjedhjen e besimit të tyre politik, ekonomik, religjioz, profesional si dhe organizatat me të cilat dëshirojnë të bashkëveprojnë. Kundërshtimi nga të dyja anët ishte i karakterizuar si parandalim nga çlirimi dhe përparimi drejt niveleve më të larta të organizimit shoqëror.

Për dallim nga ajo periudhë, sot kemi krejtësisht një pamje tjetër të botës. Pavarësisht se marrëdhëniet në mes të Rusisë dhe Perëndimit janë në nivelin më të ulët të bashkëpunimit që nga fundi i Luftës së Ftohtë, duke pasur parasysh edhe dy konfliktet që ndodhën në Ukrainë dhe Siri, pesë karakteristikave të mësipërme i shtohen edhe tri arsye themelore se pse bota nuk po hyn në një luftë të dytë të ftohtë: e para, konfrontimi aktual thjesht nuk posedon komponentët gjithëpërfshirës globalë ideologjikë dhe zhvillimorë të vitit 1947-1989; e dyta, sfida e sigurisë në Evropë dhe Lindjen e Mesme e rëndon, por nuk e kërcënon paqen në pjesë të tjera të globit; e treta, vetë Rusia është shumë më e integruar në ekonominë botërore se sa që qe ndonjëherë ish-Bashkimi Sovjetik.

Nisur nga ajo çka po ndodh tani, nuk mund të mos e pranojmë se lufta sistematike mbi rendin politik ndërkombëtar është duke bartur një dozë të madhe nga pasojat e mbivendosjes së paqartë të përfundimit të Luftës së Ftohtë në vitin 1989 dhe rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, të cilat të kombinuara bashkë, kanë prodhuar një dështim dypalësh për të akomoduar shqetësimet e sigurisë.

Nga njëra anë, Perëndimi, për një kohë të gjatë ka qëndruar indiferent në përmbushjen e vakumit gjeopolitik pas shpërbërjes së Paktit të Varshavës, si dhe ka dështuar për të bashkëpunuar me Rusinë në kuadër të institucioneve ekzistuese politike, ekonomike dhe të sigurisë, veçanërisht të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s; nga ana tjetër, Rusia ka dështuar për t'u pajtuar me fqinjët e saj duke mos i ndryshuar në thelb preferencat e saj të sigurisë, me ç'rast ka shkaktuar mosbesim rajonal për qëllime të saj.

Tërheqja e interesave tradicionale të sigurisë që erdhën nga të dyja anët, si nga Lindja, ashtu dhe nga Perëndimi, ka nxitur shtetet Evropës qendrore të bashkohen me institucionet perëndimore sa më shpejt të jetë e mundur, për ta mbrojtur veten kundër një Rusie potencialisht të projektuar si një fuqi e madhe. Kjo çështje tek pala ruse ngjalli logjikën e "dilemës së sigurisë". Lënia jashtë e disa

shteteve të Evropës Lindore, Ballkanit e deri në Kaukaz, të pasigurtë, pa ndonjë marrëveshje kolektive për sigurinë përballë një Rusie tradicionalisht agresore, prodhoi "dilemën e integrimit".
Pra, logjika e këtyre dy dilemave është shkaku kryesor i përplasjeve gjeopolitike në mes të Perëndimit dhe Lindjes. Nga këto dy logjika, Ukraina Lindore u bë viktima e parë e agresionit rus. Zgjerimi europerëndimor drejt Lindjes dhe zgjerimi euroaziatik drejt Perëndimit, Ukrainën e kthyen në objekt rivaliteti ndërkombëtar – në një betejë me lojën e shumës zero. Bashkimi Evropian (Euro-perëndimi) dhe Rusia nuk arritën të përdorin Ukrainën si një urë bashkëpunimi në mes vete, por padashje zbuluan kufijtë e sferave të influencës në raport me njëra-tjetrën, për një ballafaqim sistematik edhe në të ardhmen.
Përderisa Perëndimi ishte në gjendje për ta transformuar një pjesë të Evropës, duke përdorur pozitën e saj të favorshme të fuqisë të pas Luftës së Ftohtë, me synim krijimin e një rendi të qëndrueshëm, duke tërhequr shtetet rajonale mjaft shpejt dhe me efikasitet në sferën e saj, paralelisht, në anën tjetër, ekzistonte përpjekja e Rusisë për integrimin e saj në nivel rajonal. Përpjekjet e para e më të rëndësishme ruse për integrimin rajonal ishin gjatë viteve '90 me krijimin e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura, e cila nuk arriti të marrë ndonjë hov në nivel ndërkombëtar. Në kuadër të këtij procesi, Rusia dështoi në koordinimin e zgjidhjes së problemeve transnacionale, duke mos arritur ta shtrijë ndikimin e fuqisë së butë si një komponent për të arritur deri te pajtimi historik.
Së dyti, por më e rëndësishmja, përpjekjet e Rusisë për integrimin rajonal u zhvilluan, kryesisht, nëpërmjet strukturave euroaziatike dhe shprehimisht përfshinin institucionet politike, ekonomike dhe të sigurisë. Me këtë rast, Rusia, përkundër asaj që thelloi marrëdhëniet dypalëshe, si dhe krijoi disa grupime të vogla multilaterale, ajo nuk arriti të krijojë një përqendrim më të fuqishëm euroaziatik në duart e veta. Strukturat e krijuara si: Bashkimi Doganor Euroaziatik, i cili kishte për synim të elimininonte tarifat doganore; Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive që mburrej me reagime të shpejta e që në fakt, shtetet anëtare të saj e kishin të ndaluar të anëtarësoheshin në ndonjë alternative tjetër të sigurisë; Bashkimi Ekonomik Euroaziatik (EEU), që zëvendësoi Bashkimin Doganor me anë të harmonizimit shtesë institucional për krijimin e një zone të tregtisë së lirë dhe një fondi krize për të shërbyer si një huadhënës alternativ, në vend të Fondit Monetar Ndërkombëtar, nuk dhanë ndonjë rezultat të prekshëm.
Në kuadër të këtyre lëvizjeve dinamike, ajo që doli në pah është se zgjerimi i rendit perëndimor kontestoi drejtpërdrejt zgjerimin e rendit euroaziatik dhe anasjelltas. Ndaj dhe shtrimi i analizës në këtë dimension është më i lehtë për ta kuptuar qëllimin e Federatës Ruse në konfliktin në Ukrainë. Duhet ta theksojmë se Ukraina ishte boshti kurrizor për sukseset e Bashkimit Ekonomik Euro-Aziatik. Baza industriale e Ukrainës është jashtëzakonisht e integruar thellë në ekonominë ruse dhe potencialisht konsiderohej si kërcënim i sigurisë për Rusinë. Pa Ukrainën, përpjekjet e Rusisë për të krijuar një bllok ndërkombëtar "Euro-Aziatik", i cili do të jetë i aftë për të konkurruar në nivel rajonal me bllokqet e tjera, të tilla si BE, NAFTA, ASEAN, e kështu me radhë, edhe po të arrinte kulmin e fuqisë, ai në fund do të shembej. Dhe, aftësia e Rusisë pa Ukrainën për të rishikuar rendin ndërkombëtar të pas Luftës së Ftohtë, si udhëheqëse e Euro-Azisë, është i kufizuar në mënyrë efektive.
Për të parandaluar dobësimin relativ të saj dhe me synim për të rishikuar rendin

politik ndërkombëtar, Rusia aneksoi Krimenë me qëllim që të sigurojë asetet ushtarake dhe të ruajë aftësinë e saj projektuese në Mesdheun Lindor. Ajo përballoi sanksionet e perëndimit, sponsorizoi dhe rriti mbështetjen për separatistët në luftën civile kundër qeverisë qendrore në Ukrainë dhe tashmë ka dalë përtej saj, duke hyrë në konfliktin civil më të ndjeshëm, atë sirian, në mbrojtje të regjimit të Asadit. Pakënaqësia e Rusisë me çështjet ndërkombëtare është se ajo e konsideron veten si një fuqi e madhe dhe kërkon që në politikën e jashtme të sillet si një subjekt i pavarur, duke i përfshirë edhe aftësitë e saja për të vendosur rregullat e ndërveprimit politik dhe ekonomik ndërkombëtar, ose të paktën, të krijojë rregulla përjashtuese në raport me sjelljet e veta.
Prestigji i saj si një fuqi e madhe tradicionale dhe si shtet kryesor bërthamor nuk është komplementar me aftësitë aktuale që posedon për të ndikuar në politikën ndërkombëtare, të paktën edhe për një brez të plotë. Dhe kur prestigji nuk përputhet me përfitimet në politikën ndërkombëtare, atëherë ai shtet domosdo motivohet për të rishikuar rendin ndërkombëtar. Këtë na e dëshmoi dhe deklarata e ministrit të jashtëm rus Sergei Lavrov, i cili tha se "një reformë e rendit botëror duhet të negociohet…", duke aluduar në ndryshimin e strategjisë së "egocentrizmit të NATO-s", si kërcënim për sjelljet e saj. Synimi për të sfiduar aftësitë e aleancës Euro-Atlantike nga ana e Federatës Ruse duhet t'i rizgjojë nga gjumi letargjik shumë shtete të Bashkimit Evropian, por njëkohësisht edhe SHBA-të, për t'i zgjidhur konfliktet, pa lënë hapësirë të aderojnë qëllimet e politikës Ruse. Në të kundërtën, mosveprimi i tyre fut në lojë aktorë të tjerë, e sidomos Kinën. Atëherë, nuk na mbetet tjetër, veçse të themi: mirë se vini në botën tripolare!

*Botuar më: 29 Mars, 2016*

# Një brez, një rrugë

*Albulena Halili*

Një brez, një rrugë" është strategji zhvillimore dhe fokusi kryesor i diplomacisë kineze. E propozuar nga Kina në fund të vitit 2013, ajo ka për qëllim lidhjen dhe bashkëpunimin mes shteteve të Evropës dhe Azisë.

Strategjia "Një brez, një rrugë", përbëhet nga dy komponentë: Brezi ekonomik i rrugës së mëndafshtë dhe Rruga detare e mëndafshtë e shekullit XXI. E projektuar për investim të njëqind e katërdhjetë miliardë dollarëve, kjo strategji pasqyron synimin e Kinës për të rikthyer pozitën e saj në hierarkinë universale "Gjithçka nën parajsë", e cila për Kinën përfaqësonte rendin botëror. Në këtë rend botëror ajo vetëperceptohej si pjesa qendrore dhe e qytetëruar e hierarkisë apo "Mbretëria e mesme".

Një nga historianët më të mirë bashkëkohorë, Niall Ferguson, në librin e tij "Kur Kina sundon botën: Fundi i botës perëndimore dhe lindja rendit të ri global" shkruan se shekulli XXI do t'i përkasë Kinës. Por a do të jetë vërtet kështu?!

Kina, për nga territori, zë vendin e dytë në botë pas Rusisë, ndërkaq zë vendin e parë në botë me numrin më të madh të popullsisë me 1,38 miliardë banorë. Ajo mban po ashtu edhe një rekord në garën e madhe të fuqive, atë të ushtrisë më të madhe në botë dhe pothuajse dyqind e pesëdhjetë armë bërthamore.

Ajo që brengos të gjithë është rimëkëmbja e saj. Përdorimi i togfjalëshit "rritja e Kinës" në terminologjinë e marrëdhënieve ndërkombëtare nuk është i saktë. Kina përfaqëson një nga qytetërimet e para në botë dhe s'do mend se përpara se Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të merrnin primatin e ekonomive më të mëdha në botë, atë vend e zinte Kina. Me gjithë mitin e krijuar për cilësorin e ekonomisë më të madhe në botë, Kina nuk është ajo. Ajo radhitet e treta pas Unionit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si ekonomia e tretë në botë me Bruto Prodhim Vendor prej 10,3 milionë dollarë.

*Miqësia tradicionale shqiptaro-kineze dhe rruga e re e mëndafshtë e Kinës janë mbivendosur njëra mbi tjetrën duke krijuar edhe një hallkë tjetër të fuqishme të ekspansionit kinez në gadishull.*

Përkundër asaj që shumë studiues referojnë se qendra e gravitetit të politikës globale do të zhvendoset nga Atlantiku në Paqësor, kjo nuk i garanton Kinës perspektivën e të qenit një lidere globale. Faktorët që e kushtëzojnë Kinën që ta ketë një rol të tillë, janë si vijon:

Së pari, faktori demografik për Kinën është një sfidë jashtëzakonisht e madhe. Problemet demografike të Kinës do të vijnë si rezultat i efekteve të vonuara të politikës kineze të shekullit të kaluar – atë të lindjes së vetëm një fëmije. Kjo bën që Kina të plaket shumë shpejt. Ndaj është bërë e njohur shprehja kineze që thotë: "Vendi i ynë po plaket përpara

se të bëhet i pasur".
Sikur Kina të ishte një komb homogjen, sigurisht që ajo do të ishte njëri nga polet globale. Mirëpo, që Kina të krijojë një ekuilibër të fuqisë në kuadër të sistemit global, asaj i duhet të rregullojë balancën e minoriteteve brenda saj, e cila është një sfidë mjaft e vështirë. Në qoftë se çështja e të drejtave të njeriut nuk zgjidhet, destabiliteti mund të jetë shumë afër.
Së dyti, faktori ekonomik ka bërë që shumë studiues të besojnë se rritja ekonomike e Kinës do t'i japë fund shekullit amerikan, duke i hapur rrugë atij kinez. Përkundër që Kina për shumë dekada ka pasur një rritje ekonomike 9%, ajo nuk do arrijë as gjysmën e Shteteve të Bashkuara për gjatë gjithë shekullit XXI. Sot ekonomia e euroatlantike është e bazuar gjithnjë e më shumë në njohuritë shkencore të cilat po shndërrohen në ekonomi shërbimi e jo në aktivitete fizike. Po të kundrohet në perspektivën e burimeve energjetike, Kina varet në një masë të madhe nga resurset e jashtme natyrore. Për më tepër, Kina përbën 20% të popullsisë së tërë globit, ndërsa disponon vetëm 1.8% të rezervave botërore të naftës, gjë që e bën këtë vend tejet të varur në zhvillimin ekonomik.
I treti me radhë, radhitet faktori gjeopolitik. Azia është kontinenti me sipërfaqe më të madhe rajonale, ndaj dallimet në kultura dhe histori kanë prodhuar dy ekuilibra strategjikë. Në Azinë verilindore bëjnë pjesë: Japonia, Rusia, Kina dhe Shtetet e Bashkuara, ndërkaq aktorët kryesorë në Azinë Juglindore janë: Kina, Japonia, SHBA dhe India. Brenda këtij konfiguracioni, çdo lëvizje gjepolitike që bëhet nga secili aktor, qoftë edhe për të ruajtur status quo-në, prodhon reaksion kundërshtues nga vendet e tjera të rajonit. Në këtë kuadër të kësaj tabloje, më e shumta që Kina mund të jetë, është një fuqi rajonale, por jo edhe globale.
Së katërti, por jo më pak i rëndësishmi, është faktori teknologjik. Sado të shpejta të jenë ritmet e zhvillimit, duket se ka pak gjasa që të zvogëlohet hendeku që e ndan Kinën nga vendet e Perëndimit. Ky hendek edhe sikur mos të thellohet më tej, edhe për shumë do të mbetet mjaft i theksuar.

## *Ballkani dhe Rruga e re e mëndafshtë kineze*

Rruga e mëndafshtë qe një rrjet i lashtë rrugësh tregtare, thelbësore për ndërveprimin kulturor e që kalonin përmes rajoneve të Azisë duke lidhur Perëndimin me Lindjen, që nga Kina e deri në Detin Mesdhe. Emri i saj – Rruga e mëndafshtë vjen nga tregtia fitimprurëse kineze e mëndafshit gjatë sundimit dinastisë Han, nga viti 207 p.e.s. deri në vitin 220 e.r.. Kjo rrugë pati ndikim të madh në mirëqenien e popujve që jetonin pranë saj si dhe në marrëdhëniet kulturore, politike e ekonomike mes qytetërimeve. Rigjallërimi i kësaj rruge të lashtë, rigjallëron dhe Kinën si një nga shtetet që po përpiqet të fitojë rolin e një fuqie udhëheqëse globale.
Ajo ka filluar të shtrihet përgjatë tërë Evropës Qendrore e Lindore, duke mos anashkaluar as Ballkanin, përmes një numri të madh projektesh që fokusohen kryesisht tek infrastruktura dhe energjetika. Të gjitha shtetet e Ballkanit pa përjashtim janë partnere me qeverinë apo kompanitë kineze në projekte të ndryshme që kanë filluar apo do të fillojnë së shpejti.
Investimin e saj të parë në Evropë, jo rastësisht e ka filluar në Serbi. Ajo ka shfrytëzuar pozicionimin gjeopolitik të Serbisë për të thelluar bashkëpunimin mes tyre, sidomos atë ekonomik. Serbia pra, është kështu për Kinën një copë

toke e volitshme përmes së cilës mund të kalojë rruga e re e mëndafshit. Edhe në marrëdhëniet diplomatike, Kina e konsideron Serbinë si aleatin më të fortë në Ballkan. Ato që të dyja ndajnë mendime të njëjta për parimet e sovranitetit, sipas tyre, lidhur me çështjet e Kosovës dhe Tibetit. Kina, sikur edhe Rusia janë shprehur haptas kundër pavarësisë së Kosovës, madje ato kanë akuzuar NATO-n për shkelje të rëndë të së drejtës dhe institucioneve të së drejtës ndërkombëtare gjatë bombardimeve të caqeve serbe gjatë luftës në Kosovë.
Marrëveshje për projekte të ngjashme infrastrukturore si ndërtim rrugësh, urash e hekurudhash si dhe projekte energjetike janë lidhur me shtetet e tjera të Ballkanit e Evropës Lindor: me Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnjë e Hercegovinën, Hungarinë, Rumaninë e Bullgarinë. Investimet kineze në Greqi janë konsideruar si infuzioni kryesor për rimëkëmbjen e ekonomisë greke, si dhe ngaNew York Times dhe Wall Street Journal janë cilësuar si iniciativat e huaja tregtare më të suksesshme. Porti i Pireut ka një rëndësi kruciale strategjike për Kinën. Gjashtëdhjetë përqind të eksporteve të saj nëpër botë, menaxhohen nga ky port. Në kuadër të ritrasimit të kësaj rruge, ajo që s'befason mbetet bashkëpunimi shqiptaro-kinez, duke njohur aleancën atipike të tyre në kohën e komunizmit. Përveç projekteve infrastrukturore dhe energjetike me të gjitha shtetet tjera, këtu bën përshtypje partneriteti edhe në sferën e kulturës bujqësisë dhe importin e xeheve. Miqësia tradicionale shqiptaro-kineze dhe rruga e re e mëndafshtë e Kinës janë mbivendosur njëra mbi tjetrën duke krijuar edhe një hallkë tjetër të fuqishme të ekspansionit kinez në gadishull.
Kina nuk ka marrë pjesë ndonjëherë në farkëtimin e sistemit ndërkombëtar, ndaj shpesh ndjehet e veçuar dhe pa detyrime ndaj rregullave të rendit ndërkombëtar. Insistimi i Rusisë dhe Kinës për prani në Ballkan është pjesë e strategjisë së tyre për një rol më të madh të udhëheqësit global apo edhe ndërtuesit të rendit botëror bashkë me SHBA-të.  Nga ana tjetër synimet për prani në Ballkan janë rezultat i zbrazëtirës së lënë nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë rajon me rëndësi të madhe strategjike.

*Botuar më: 12 prill 2016*

# Dinamika e zhvillimeve globale dhe paradoksi i OKB-së

*Fatmir Arifi*

Fundi i shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI u shoqëruan me dinamika të mëdha në nivel global. Në kuadër të këtyre dinamikave ndodhën ndryshime gjeopolitike, gjeostrategjike dhe gjeoekonomike që ishin si pasojë e evoluimit të mendimit politik. Sot, i gjithë debati po shtrohet në mes të vendosjes së një raporti ndërmjet shteteve, normave të së drejtës ndërkombëtare dhe lirive e të drejtave të njeriut. Thelbi i këtij debati është: evoluimi i mendimit politik ka prodhuar dinamikat globale, dinamikat globale kanë prodhuar ndryshime gjeopolitike dhe ndryshimet gjeopolitike janë shoqëruar me rritjen e numrit të shteteve të reja. Ndërsa, OKB-ja dhe Karta e saj kanë mbetur shumë konservative, gjë që nuk është në përputhshmëri me konfiguracionin global aktual.

E drejta ndërkombëtare në kushtet e sotme është përmbledhje dokumentesh tërësisht jashtë realitetit, kur kemi parasysh kohën e kodifikimit të saj. Po ashtu edhe vetë OKB-ja, si një mekanizëm multilateral, vazhdon të jetë një arkitekturë që nuk i përshtatet trendeve të politikës ndërkombëtare në shekullin XXI.

Duke qenë si e tillë, me të drejtë shtrojmë pyetjen se a është e aftë dhe efikase OKB-ja që t'i avancojë edhe mëtutje liritë dhe të drejtat e njeriut? Nga pikëpamja praktike duhet të jemi shumë skeptikë. Arsyeja është e thjeshtë: së pari, funksionaliteti i kësaj strukture multilaterale varet nga vullneti i shteteve si anëtare të saj. Dhe më e keqja, disa nga shtetet shumë të fuqishme në kuadër të OKB-së janë shtete jo demokratike, ndërsa OKB-ja nuk ka pushtet për të imponuar dhe sanksionuar veprimet e shteteve të fuqishme.

*Një rast i tillë është ndërhyrja humanitare në Kosovë, e iniciuar nga SHBA-të dhe fuqitë evropiane që thyen parimin klasik strukturor të marrëdhënieve ndërkombëtare. Rasti i Kosovës ndryshoi për herë të parë perceptimet ndaj sovranitetit, duke lëvizur balancën gjithnjë e më shumë drejt respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, si një çështje e obligueshme e aktorëve ndërkombëtarë.*

Së dyti, OKB-ja në esencë përmban mungesë të përgjegjësisë demokratike. Demokracia, si koncept, e ka bazën te parlamentarizmi si një mekanizëm i përfaqësimit qytetar. Ndërsa Kombet e Bashkuara nuk japin përgjegjësi dhe as llogari përballë një elektorati demokratik dhe as përballë institucioneve vërtet demokratike.

Po të shtrojmë analizën edhe mëtej në dimensionin kohor, që në themelimin e saj, mekanizmi më i lartë vendimmarrës dhe më i rëndësishmi, Këshilli i Sigurimit, ishte i bazuar në supozimin se aleanca fitimtare e kohës së Luftës së Dytë Botërore do të qëndrojë së bashku

për të monitoruar dhe nëse është e nevojshme, për të zbatuar paqen botërore. Konsensusi (e drejta e vetos) i Këshillit të Sigurimit ishte dhe mbeti baza e kapaciteteve vepruese. Një nga idetë bazë të Kartës së OKB-së ishte se një sistem i sigurisë kolektive, të monitorohet dhe nëse është e nevojshme, të zbatohet nga pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Thelbi i kësaj ideje qëndron në faktin se kjo normë do të hapte rrugën në një masë të madhe për çarmatimin e botës. Dhe pikërisht këtu qëndron paradoksi i këtij institucioni. Brenda katër viteve, që nga nënshkrimi i Kartës në San Francisko-s, gara më e madhe e armatimit në historinë botërore, duke përfshirë dhe armët e shkatërrimit në masë, ishte në mes të anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Pra, nga kujdestarë të paqes dhe sigurisë, ata u bënë kërcënimi më i madh për paqen botërore. Por ky nuk ishte paradoksi i vetëm. Sot, armët konvencionale dhe sidomos armët e vogla të këmbësorisë, që janë duke u përdorur nëpër konflikte anembanë botës, të cilat llogariten si vrasëset më të madha në botë, 80% e këtyre armëve janë të tregtuara pikërisht nga disa anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit siç janë Rusia dhe Kina.

Gjatë historisë së tij, Këshilli i Sigurimit, për shumicën e kohës ishte i paralizuar nga mungesa e konsensusit në mes të anëtarëve të përhershëm të saj. Nga ana tjetër, shpejtësia e procesit të shkolonizimit nuk ishte parashikuar në San Francisko, me ç'rast lindën shumë pika fërkimi dhe konflikte në disa rajone të ndjeshme të botës si: Lindje e Mesme, Azi Jugore dhe Juglindore, në Qipro dhe më vonë në Afrikë dhe Ballkan. Këto dinamika, OKB-në dhe mekanizmin më të lartë të saj, Këshillin e Sigurimit, e nxorën tërësisht jashtë funksionit për të cilin ishte krijuar. Vetëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë u duk se Këshilli i Sigurimit më në fund mund të jetë funksional mbi parimet që ishin parashikuar në Kartën e San Franciskos. Për herë të parë u përdor kapitulli VII i Kartës kundër agresionit të Irakut mbi Kuvajt në vitin 1990. Mirëpo, në këtë fazë u bë e qartë se natyra e problemeve me të cilat do të ballafaqohen anëtarët e Këshillit të Sigurimit do të jenë tërësisht në një format tjetër. Ashtu siç nuk e kishte parashikuar Karta e San Francisko-s procesin e shkolonizimit, po ashtu nuk i kishte parashikuar as konfliktet e fjetura etnike si pasojë e Traktatit të Versajës. Konfliktet në mes shteteve u zëvendësuan me çrregullime të brendshme mes etnive. Përballë këtyre sfidave OKB-ja ishte tërësisht e pa përgatitur. Teknikat e vjetra të paqeruajtjes, të cilat ishin projektuar për të frenuar konfliktet ndërshtetërore, ishin të papërshtatshme me dhunën brenda kufijve shtetërorë. Dështimet ishin të padiskutueshme. Në këtë kuadër, e drejta ndërkombëtare, si një dokument i dalë mode, nuk përbën më kuadrin e duhur për sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare të shekullit XXI.

Sot, ndërlikueshmëria e kërcënimeve globale po zgjerohet dita-ditës. Ndërsa OKB-ja edhe pas shtatëdhjetë e një viteve të themelimit të saj i mungojnë kapacitetet vepruese për të marrë masa të menjëhershme praktike kundrejt këtyre kërcënimeve. Ngjarjet e fundit kanë treguar se komuniteti ndërkombëtar po përballet me forma të reja të rrezikut nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga mungesa e unanimitetit të Këshillit të Sigurimit për menaxhimin e krizave. Kjo problematikë ka bërë që shtetet me demokraci të zhvilluar të kërkojnë alternativa vepruese jashtë mandatit të Këshillit të Sigurimit. Praktikisht, këtu kanë zanafillën zhvillimi i tri doktrinave të NATO-s siç janë: "ndërhyrja humanitare", "lufta parandaluese", "R2P – përgjegjësia për të mbrojtur". Që të tri këto doktri-

na u zhvilluan si koncepte për sigurinë tërësisht jashtë mekanizmit të Këshillit të Sigurimit, por që në bërthamë të saj kanë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Këto doktrina vepruese parandaluan shumë diktatorë për të abuzuar me të drejtat e njeriut dhe eliminuan mundësinë e fshehjes pas sovranitetit, veçanërisht në shtete me shumë etni siç ishte edhe ish Jugosllavia. Nëpërmjet kësaj doktrine, demokracitë perëndimore jo vetëm që kishin detyrim, por ndërhynë në shumë shtete totalitare që aplikonin politika të gjenocidit, siç ishte rasti në Somali, Kamboxhia, Bosnjë, Kosovë, Timorin Lindor, Afganistan dhe së fundmi edhe në Lindje të Mesme.
Parimet e këtyre tri doktrinave të NATO-s kanë rezultuar si të pranueshme nga shumica e komunitetit ndërkombëtar. Arsyetimi është i thjeshtë: tirania nuk duhej të justifikohej. Këto doktrina kanë ndihmuar popullsi të ndryshme, të cilët jetonin në vazhdimësi në nivele të papranueshme të vuajtjeve njerëzore të shkaktuara nga politikat e qëllimshme qeveritare. Një rast i tillë është ndërhyrja humanitare në Kosovë, e iniciuar nga SHBA-të dhe fuqitë evropiane, që thyen parimin klasik strukturor të marrëdhënieve ndërkombëtare. Rasti i Kosovës ndryshoi për herë të parë perceptimet ndaj sovranitetit, duke lëvizur balancën gjithnjë e më shumë drejt respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, si një çështje e obligueshme e aktorëve ndërkombëtarë. Kjo zhvendosje e balancës po zvogëlon gjithnjë e më shumë konceptin e sovranitetit shtetëror nga njëra anë dhe nga ana tjetër të drejtat e njeriut po ia zënë vendin sovranitetit, me ç'rast është hedhur baza për paraqitjen e një kornize parimore për ndërhyrje nga jashtë kundrejt të gjithë atyre shteteve, që në emër të sovranitetit abuzojnë me të drejtat e njeriut, ndërsa OKB-ja ende vazhdon të udhëhiqet me koncepte të shekullit XX.

*Botuar më: 28 prill 2016*

# Një NATO e gatshme për një botë të paparashikueshme

*Albulena Halili*

Samiti i NATO-s që mbahet në Varshavë pritet të jetë samit me rëndësi të madhe historike në 25 vitet e fundit apo edhe që nga themelimi i kësaj organizate. Agjenda e takimit është një agjendë e ngjeshur dhe mjaft e ndërlikuar, duke filluar nga përshtatja ndaj sfidave të ndryshme të sigurisë në shekullin XXI deri te dilemat më komplekse të vendimmarrjes. Përveç se të ndërlikuara, këto sfida janë edhe të paprecedenta siç është edhe mjedisi i marrëdhënieve ndërkombëtare në të cilin jetojmë sot. Përkufizimi më i drejtë i këtij mjedisi, i cili na rrethon sot, është një botë e paparashikueshme që përballet me kërcënime që vijnë nga aktorë të kombinuar shtetërorë dhe joshtetërorë dhe një Rusie e cila, kohëve të fundit po karakterizohet me ambicie që e tejkalojnë fuqinë reale të saj.

Përshtatja ndaj sfidave të mjedisit të ri të sigurisë ndërkombëtare është shumë e vështirë, meqenëse çdo qëllim i ri apo modifikim strategjik duhet të ketë arsyetime të fuqishme dhe mbështetje morale nga anëtarët e saj, gjë e cila në shumë raste ka dështuar që të arrihet.

*Në një kohë kur kërcënimi po globalizohet është e domosdoshme që të globalizohet edhe gatishmëria e përgjigjes dhe mbrojtjes në raport me këto kërcënime. Andaj, nevoja për transformim të mënyrës së veprimit dhe përgjigjes së NATO-s dhe përshtatja e saj me këtë mjedis është e domosdoshme, për të mos thënë lidhet me vetë aspektin ontologjik të aleancës.*

Në një kohë kur kërcënimi po globalizohet është e domosdoshme që të globalizohet edhe gatishmëria e përgjigjes dhe mbrojtjes në raport me këto kërcënime. Globalizimi i kërcënimeve e bëri NATO-n dhe SHBA-të në veçanti, të mendojnë për një bashkëpunim të mundshëm me Rusinë. Por, pas ndërhyrjes së Rusisë në Ukrainë në vitin 2014, është vërtetuar se Rusia nuk heq dorë nga doktrina e saj tradicionale, ajo e gjeopolitikës perpetuale dhe rikthimit te historia. Andaj me të drejtë thuhet se shtetet mund të krahasohen me natyrën njerëzore, siç thoshte teoricienti i realizmit klasik, Morgentau. Strategjia e politikëbërjes ruse është kryekëput realiste e mbështetur në teorinë e lojës së shumës zero në raport me Perëndimin dhe Dialogu Melian i Tukitidit mund të shërbejë si një vepër udhërrëfyese në këtë rast. Sfida më e madhe e këtij samiti lidhur me Rusinë është aftësia e Perëndimit për të pranuar realitetin e ekzistimin të dy botëkuptimeve të ndryshme apo mënyrave me të cilën të dy palët e perceptojnë të njëjtën botë, dhe se kjo s'ka ndërruar. Para mbajtjes së Samitit, Rusia ka akuzuar se Aleanca Veri-Atlantike pëmes këtij samiti po provokon një garë armatimi. Madje Putin është shprehur se NATO kërkon të gjejë tek veprimet e Rusisë pretekst për të pohuar legjitimitetin dhe nevojën e

ekzistencën së saj. Në vend të kësaj ai ka propozuar krijimin e "një arkitekture të re për siguri të barabartë dhe të pandashme që do të shtrihet nga Atlantiku deri në Paqësor". Këto deklarata e mohojnë rendin ndërkombëtar ekzistues unipolar dhe dëshmojnë synimet e Rusisë për t'u bërë ndërtuese e një rendi të ri botëror sipas pikëpamjeve të saj, por në disproporcion me fuqinë e saj të vërtetë. Përderisa akoma nuk është farkëtuar një rend ndërkombëatar i pranuar përgjithësisht, me gjithë rritjen relative të saj, Rusia akoma mbetet vetëm një superfuqi potenciale, ndërkaq rendi ndërkombëtar një rend unipolar.

Sfida tjetër e aleancës ndodhet brenda vetes së saj. Brexit, apo dalja e Britanisë nga Bashkimi Evropian, ka ndikuar në masë të madhe në unitetin mes shteteve të Bashkimit Evropian, duke paralajmëruar një rend evropian të mbështetur në politikën e vjetër të kontinentit "Raisond'état". Paqëndrueshmëria politike e kësaj organizate supranacionale është një indikator i keq edhe për Aleancën e Traktatit Veri-Atlantik, e cila në vete ka të dy komponentët e vetë natyrës së organizatës: atë politik dhe atë ushtarak. Çdo nënvlerësim i njërit apo tjetrit, mund të çojë në dobësim të fuqisë së saj. Kjo sfidë ngjitet edhe më lart në listën e prioriteteve, kur kihet parasysh fakti se Lufta në Siri, implikimi rus në këtë krizë dhe luftimi i saj hibrid kanë shkaktuar valën më të madhe të refugjatëve në botë që nga Lufta e Dytë Botërore. Kriza e refugjatëve ka vënë në dukje kufijtë e brishtë të Evropës dhe jokohezionin mes shteteve anëtare të cilët, kishin hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit të shtetit të tyre në të mirë të mirëqenies e prosperitetit kontinental.
Krizat e fundit globale kanë bërë jetike nevojën që NATO të mbrohet në shumë fronte, si gjeografikisht ashtu edhe në llojllojshmërinë e veprimeve të saj. Në fillim ajo ka nevojë për krijimin e dy strategjive gjeografike: një strategji të Lindjes dhe një tjetër të Jugut. Përcaktimi i mënyrës së veprimit dhe përgjigjes duhet të përcaktohen nga veprimi dhe mënyra përmes së cilës ajo kërcënohet. Mënyra e deritanishme konvencionale e përgjigjes mund të jetë e zbatueshme vetëm në Lindje, ndaj do të ishte e pranueshme vetëm një rishikim i strategjisë së saj të Lindjes, pa pasur nevojë për krijim të një strategjie krejtësisht të re. Ndërkaq ajo mbetet e papërshtatshme për kërcënimet që vijnë nga Jugu i aleancës, meqenëse ato kanë tendencën e të qenit asimetrike. Andaj, nevoja për transformim të mënyrës së veprimit dhe përgjigjes së NATO-s dhe përshtatja e saj me këtë mjedis është e domosdoshme për të mos thënë lidhet me vetë aspektin ontologjik të aleancës.

Ky samit duhet të shërbejë si forum për të dëshmuar se NATO përkundër sfidave të saj të brendshme u qëndron  në mënyrë të padiskutueshme besnike parimeve mbi të cilat ajo është ndërtuar, solidaritetit mes anëtarëve të saj, kohezionit të brendshëm dhe sigurisë kolektive. Kështu ajo është e aftë t'ju përgjigjet me mënyrën dhe intensitetin e duhur sfidave bashkëkohore të shekullit 21, jo vetëm në hapësirën gjeografike të fushëveprimit të saj por edhe përtej.

*Botuar më: 8 Korrik, 2016*

# Kuajt trojanë të Rusisë brenda strukturave trans-atlantike

*Fatmir Arifi*

Aneksimi i Krimesë nga Rusia dhe ndërhyrja e saj ushtarake në Ukrainën Lindore, paraqesin sfidën më të madhe për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Ky veprim i Rusisë, në mënyrë të thukët, ka testuar së tepërmi kapacitetet e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, e njohur si doktrina transatlantike. Përpos disa sanksioneve ekonomike të Bashkimit Evropian ndaj Rusisë, pjesa tjetër e veprimit mbeti deklarative. Në thelb kjo tregon se BE-ja nuk ka një strategji dalëse për të parandaluar agresionin e Rusisë, edhe sikur të paraqitet kundër ndonjë shteti tjetër në të ardhmen. Tanimë është një fakt i kryer se pas triumfit të madh në Krime, politika e jashtme ruse është bërë më agresive dhe më kërcënuese përballë paqartësisë politike të BE-së. Përveç rajoneve të tjera si Azia Qendrore e Lindja e Mesme, nga kjo politikë është prekur drejtpërsëdrejti edhe Ballkani.

Raportet e Rusisë me disa shtete të Ballkanit si: Serbia, Republika Sërbska në Bosnjë dhe Hercegovinë, IRMJ, Greqia, Mali i Zi dhe Bullgaria, përkundër paqartësive dhe mungesës së theksuar të transparencës, ato po shkojnë duke u konsoliduar. Këto raporte kanë vënë në pikëpyetje strategjinë amerikane dhe garancitë e dhëna për sigurinë dhe paqëtimin e Ballkanit. Shikuar përmes këtij prizmi, strategjia, guximi dhe gatishmëria e Putinit për të ri-krijuar dhe ruajtur një sferë të ndikimit përtej kufijve të afërt të Rusisë, nuk duhet nënvlerësuar në asnjë rast.

*Përderisa në Ukrainë, Rusia, me aneksimin e Krimesë, përpos tjerash, vendosi "vijën e kuqe" parandaluese të shtrirjes së doktrinës transatlantike, në Ballkan, duke e pasur parasysh që vendimet në kuadër të BE-së dhe NATO-s, merren me konsensus të plotë, ajo synon ta çajë doktrinën transatlantike, duke i përdorur disa shtete sllave si kalë troje brenda strukturave euro-atlantike.*

Duke e pasur parasysh që në rajonin e Ballkanit beteja ideologjike e Luftës së Ftohtë ende vazhdon të jetë vijë ndarëse në mes Perëndimit dhe Lindjes, strategjia e Federatës Ruse është e dyfishtë.

Përderisa në Ukrainë, Rusia, me aneksimin e Krimesë, përpos tjerash, vendosi "vijën e kuqe" parandaluese të shtrirjes së doktrinës transatlantike, në Ballkan, duke e pasur parasysh që vendimet në kuadër të BE-së dhe NATO-s, merren me konsensus të plotë, ajo synon ta çajë doktrinën transatlantike, duke i përdorur disa shtete sllave si kalë troje brenda strukturave euro-atlantike.

Prandaj edhe përllogaritjet e Rusisë që i bën në raport me Ballkanin janë të ndryshme nga ato të aplikuara në vendet e tjera në hapësirën

ish-sovjetike. Për shembull, zgjerimi i BE-së në Ballkan nuk është kundërshtuar në atë mënyrë siç janë kundërshtuar Marrëveshja e Asocimit për Ukrainën, Moldavinë, Gjeorgjinë dhe Armeninë. Në të vërtetë, zgjerimi i BE-së në Ballkan mund t'i ndihmojë edhe Rusisë, nëse pranimi i shteteve mike të Rusisë pengon aftësitë e BE-së për të miratuar qëndrime të përbashkëta që janë në kundërshtim me interesat e Rusisë.
Marrëdhëniet e disa shteteve sllavo-ortodokse të Ballkanit me Rusinë dhe aleancat ushtarake-politike dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme janë ende pjesë e rrëfimeve kombëtare në këto shtete, të cilat kohë pas kohe po ripërtërihen përmes marrëveshjeve, qofshin ato ekonomike, politike, ushtarake, kulturore apo formash të tjera në dukje.
Padyshim, të paktën që nga fundi i shekullit XVIII, kur përshtrirja e kufijve të Perandorisë Ruse për herë të parë arriti deri në Detin e Zi, Rusia ka ndjekur një politikë të jashtme aktive në Ballkan. Në këtë periudhë, më saktësisht në vitin 1783, Rusia aneksoi Krimenë, ndërsa Gjeorgjia në atë kohë ishte vënë në mbrojtje të Rusisë.
Prioriteti kryesor strategjik i Rusisë në rajon ishte për të siguruar qasje në Mesdhe përmes Detit të Zi, duke synuar dobësimin e kontrollit osman në grykën e Bosforit dhe ngushticën e Dardaneleve.
Në kuadër të kësaj strategjie, Rusia ndihmoi dhe mbështeti kryengritjet lokale kundër sundimit osman, sidomos të popujve sllavo-ortodoksë dhe krijoi aleancën sllavo-ortodokse, ndërkaq me përpjekje të përbashkëta diplomatike, hapi rrugën kryesore për avancimin e interesave të saj në këtë hapësirë. Duke i lidhur fijet e interesave strategjike me ato etno-kulturore, ajo, jo vetëm që e shikonte veten, por shikohej edhe nga të tjerët si mbrojtëse e natyrshme e shteteve të pavarura sllave që u formuan pas tërheqjes së Perandorisë Osmane gjatë mesit të shekullit XIX.
Rëndësia e këtij roli historik të Rusisë në kuptimin e statusit të saj si fuqi e madhe, ka qenë dhe është një temë e përsëritur e përfshirjes së saj në Ballkan, si dhe karakteristikë e gjeopolitikës së saj tradicionale, të cilën studiuesi Stefan Kotkin e ka emëruar si "Gjeopolitika e përhershme ruse".
Në manifestin e tij politik, Car Nikolla II, lidhur me vendimin e Rusisë për të hyrë në luftë në mbrojtje të Serbisë, bëri një lidhje në mes nderit dhe statusit të saj si fuqi e madhe. Ai pati deklaruar se Rusia është e lidhur ngushtë me popujt sllavë me anë të besimit dhe gjakut dhe ajo është besnike ndaj traditave të saj historike, andaj nuk mund të rrijë indiferente ndaj fatit të tyre, duke shtuar se Rusia duhet ta mbrojë nderin, dinjitetin, integritetin dhe pozitën e saj në mesin e fuqive të mëdha.
Gjatë periudhës sovjetike, në terma relativë, ndikimi rus në Ballkan ishte zbehur pjesërisht. Kjo zbehje e influencës kishte ndodhur për shkak se udhëheqja sovjetike në këtë kohë pretendimet e saj për një rol kryesor i kishte bazuar në parullën e "internacionalizmit proletar" si ideologji dhe jo në besimin apo përkatësinë etnike. Por, fundi i komunizmit rriti interesin për të rindërtuar të menduarit e epokës cariste të Rusisë, duke përfshirë edhe idenë e një përgjegjësie të veçantë ndaj Ballkanit, e lidhur ngushtë me nocionet e madhështisë kombëtare dhe origjinës etnike.
Tani më tendencat për t'i përdorur faktorët etnikë dhe kulturorë sidomos në Ballkan përbëjnë boshtin kurrizor të strategjisë së politikës së jashtme ruse, që

bazohet në euro-aziatizmin dhe në rrymat e mendimit sllavofil.
Federata ruse e ka të qartë se mosmarrëveshjet etnike në rajonin e Ballkanit janë prirje të forcave historike dhe nuk fashiten lehtë, pavarësisht perceptimit në pamje të parë se këto prirje kanë pushuar përkohësisht pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Andaj, në interesin e saj ajo po punon me përkushtim në riformatimin e aleancës ortodokse sllave, e cila mbetet një rrugë e sigurt për përmbushjen e strategjisë së saj.
Rusia në mënyrë të qartë i sheh shtetet sllave në Ballkan si një aset të çmueshëm dhe të rëndësishëm në këtë luftë politike, duke përforcuar kështu pretendimet e saj për një rol udhëheqës në rajon dhe dëshirën për të ekuilibruar apo penguar programin e integrimeve euro-atlantike për rajonin.
Në kontekstin e kësaj ambicieje, dimensioni ideologjik për Putinin është i një rëndësie të veçantë, i sistemuar si kurrë më pare, që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Rusia ka edhe arsye krejtësisht të prekshme për sa i përket Ballkanit si një zonë me interes strategjik. Kjo përfshin praninë tregtare në rritje në ekonomitë e disa vendeve të Ballkanit, ku ajo ka përfituar nga programet e privatizimit, duke u bërë një investitor dhe partner i rëndësishëm tregtar.
Blerja e sektorëve të energjetikës dhe investimet ruse në këto segmente, kanë siguruar lidhje thelbësore në mes elitës shtetërore ruse dhe atyre të shteteve të Ballkanit. Një nga vlerësimet më të rëndësishme për Rusinë, është roli që rajoni luan në sistemin energjetik evropian, si një rrugë transiti për pjesën tjetër të Evropës. Një tjetër prioritet që e plotëson të parin është sprova për të kultivuar aleanca të besueshme dhe të gatshme për të mbështetur qëndrimet e saj diplomatike në forumet e rëndësishme ndërkombëtare.
Ndaj dhe përpjekjet për të nxitur marrëdhënie më të ngushta kanë qenë më të dukshme me vendet që kanë pasur lidhje më të dukshme dhe të forta historike e kulturore me Rusinë, si Serbia, Bullgaria, Mali i Zi, Republika Sërbska në Bosnjë e Hercegovinë dhe IRMJ. Por, edhe në Kroaci dhe Slloveni, Rusia ka qenë në gjendje për të çuar përpara interesat e saj dhe të sigurojë mbështetje politike të nivelit të lartë për elemente të rëndësishme që shtyjnë agjendën e saj në Ballkan. Jashtë kësaj agjende dhe rikonsolidimit të marrëdhënieve nuk ka mbetur as Greqia.
Qasja e favorshme e Rusisë është se ajo nuk mbështetet në masë të madhe në një instrument të vetëm të politikës, për të arritur qëllimet e saj. Instrumentet që ajo përdor janë të ndryshme, duke filluar nga ai energjetik, ekonomik, politik, diplomatik, ushtarak dhe në çështjet kulturore të popujve sllavë të rajonit. Këto instrumente përdoren shpesh edhe në mënyrë të kombinuar dhe përzierja e tyre është përshtatur me kërkesat e çdo tregu kombëtar.
Për dallim nga rajonet e tjera, në Ballkan Federata Ruse është mbështetur në konceptin e fuqisë së butë. Kjo rëndom ndodh sepse pa një kufi të përbashkët ose një diasporë të konsiderueshme etnike-ruse, taktikat shtrënguese që u përdorën në Gjeorgji dhe Ukrainë nuk janë të zbatueshme në Ballkan. Kështu që në vend të kësaj, Rusia është përqendruar në iniciativa të projektuara për të gjeneruar stimuj ekonomik në një nivel të lartë.
Këtu duhet përjashtuar vetëm territorin e Serbisë, respektivisht në Nish, ku Moska ka dislokuar qendrën për shërbimin e saj inteligjent për Ballkanin, dhe po synon të dislokohet ushtarakisht me bazë ushtarake edhe në Luginë të Preshevës. Rusia dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshje ushtarake pesëmbëdhjetë vjeçare, që përfshin shkëmbimin e informacionit të inteligjencës, oficerëve

ushtarakë, blerje armatimi nga Moska dhe stërvitje të përbashkëta. Po ashtu, Serbia ka statusin e vëzhguesit në Organizatën e Traktatit për Siguri Kolektive, një institucion që vepron si kundërpërgjigje e Rusisë ndaj NATO-s. E gjithë kjo gamë e gjerë kundrejt Strategjisë Transatlantike është një indikator domethënës se Rusia ka për synim ta fusë në veprim skenarin e Kubës të vitit 1962 brenda një periudhe dhjetëvjeçare.

Padyshim, Rusia ka të drejtë si çdo vend tjetër për të ndjekur interesat e saj kombëtare, por qëllimet dhe metodat e saj në Ballkan dhe gjetiu paraqesin një sfidë të veçantë ndaj vlerave demokratike e sidomos ndaj rregullave e institucioneve të dala nga parimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian në koordinim me SHBA-të duhet ta hartojë dhe ta ofrojë për miratim një strategji për Ballkanin që pasqyron interesat e përbashkëta evropiane, kryesisht duke nxitur përmbushjen e vlerave dhe normave themelore për një projekt më të gjerë të integrimit Euro-Atlantik.Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet standardit të qeverisjes, luftës kundër korrupsionit, zhvillimit të sektorit të energjetikës konkurruese si dhe bashkëpunimin më të ngushtë dhe sanksionimin e shteteve që shkelin këto norma. Qëllimi primar duhet të jetë për të garantuar progresin demokratik të rajonit dhe parandalimin e metodave të "putinizmit", të cilat po importohen dalëngadalë në Evropë nëpërmjet derës së pasme.

Ndikimi rus në Ballkan komplikon tashmë aftësitë e BE-së për të zhvilluar politika të përbashkëta të jashtme, sidomos kur bëhet fjalë për sigurinë energjetike dhe për të trajtuar sjelljen e politikës së jashtme ruse. Ambasadori i Rusisë në BE, Vladimir Chizhov, në një prononcim të tij përshkroi Bullgarinë si "Kali i Trojës" për interesat e Moskës në Bruksel. Ky deklarim i tij duket se ka disa baza të forta, pasi ndikimi pro-rus brenda partisë socialiste bullgare e ka bërë Bullgarinë, përkundër asaj që është anëtare e BE-së, të ngurrojë për të marrë në konsideratë sanksionet e rënda ndaj Rusisë, pas aneksimit të Krimesë. Një qëndrim të ngjashëm me Bullgarinë ka mbajtur edhe Greqia dhe Sllovenia, edhe pse kjo e fundit, tradicionalisht ka qenë një vend jo rusofil, por për shkak të faktit që ajo ka krijuar lidhje të ngushta ekonomike me Rusinë.

Këto probleme rrezikojnë të përforcohen në qoftë se Serbia hyn në BE me shtrirjen e saj aktuale të politikës së jashtme, si një aleat besnik dhe partner strategjik i Rusisë. Presidenti i Serbisë, Tomisllav Nikoliq ka deklaruar dhe ka mbajtur qëndrim institucional se ai dëshiron që Serbia të bëhej "shtyllë kurrizore e Rusisë në Europë". Në këtë rast ai ka mbajtur premtimin e tij për të mbështetur interesat ruse, duke refuzuar të zbatojë detyrimin e Serbisë, si një kandidat i mundshëm i BE-së, në një vijë me vendimin e kolektiv të BE-së, për të mbështetur integritetin territorial të Ukrainës dhe zbatimin e masave të sanksioneve kundrejt Rusisë. Po ashtu edhe udhëheqja e Republika Sërbskës mbajti po të njëjtin qëndrim. Ajo përdori veton e saj për të parandaluar Bosnjën e Hercegovinën nga zbatimi i masave të BE-së.

Duke pasur parasysh natyrën e gjerë dhe të pakufizuar të raporteve ruso-serbe, është e qartë se BE do të ketë probleme të konsiderueshme dhe çështje të rëndësishme për të trajtuar përpara se pranimi i Serbisë të mund të konsiderohet real. Brukseli nuk duhet ta perceptojë politikën serbe si një politikë të një vendi neutral përderisa qeveria serbe asnjëherë nuk ka pasur hezitim për t'i vënë interesat e Evropës përpara atyre të Rusisë.

Nga kjo politikë e Federatës Ruse dhe kuajve trojanë të saj, Bashkimi Evropian do të ketë konsekuenca dhe implikime të dukshme. Në rastin më të keq, ambiciet për një Rusi të Madhe, të shfaqura nga presidenti i saj Putin, si një e drejtë për t'i kthyer tokat e populluara nga rusët etnikë në mëmëdheun e tyre, qoftë edhe me forcë, kanë filluar që t'i rindezin veprimet strategjike për një Serbi të Madhe. I ashtuquajturi, miti i një kombi të "ndarë padrejtësisht", duke e marrë si shembull rastin e Rusisë nga "katastrofa gjeopolitike", e kolapsit të Bashkimit Sovjetik, është bërë një nga temat më të rëndësishme në elitat politike dhe akademike serbe, të cilat po e përhapin në masat e gjera popullore, e sidomos te minoritet serbe jashtë territorit të Serbisë.
Rreziku që Serbia mund të joshet për të kopjuar qasjen e Rusisë tani më është bërë evidente sidomos pas forcimit të lidhjeve të saj më të ngushta ushtarake me Rusinë, duke inkurajuar besimin se Moska mund të mbështesë në mënyrë aktive Beogradin në rast të ndonjë konflikti në të ardhmen, pas dislokimit në Nish dhe Luginë të Preshevës.
Kroacia, Mali i Zi dhe IRMJ janë bukur shumë të ekspozuara dhe të kërcënuara nga kjo strategji e ringjallur serbomadhe. Por shqetësimi është më i prekshëm në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Republikën e Kosovës, ku Rusia ka përdorur ndikimin e saj në favor të Serbisë në hartimin dhe më vonë në interpretimin e dy marrëveshjeve ndërkombëtare: atë të Dejtonit dhe Planin e Ahtisarit.
Që të dy këto marrëveshje, minoritetit serb, si në Bosnjë e Hercegovinë, ashtu dhe në Republikën e Kosovës i japin të drejtën e vetos, e cila po përdoret për të parandaluar qeverinë federale të Sarajevës dhe qeverinë e Prishtinës për të marrë qëndrime strategjike, qofshin ato ndryshime kushtetuese apo vendime në kuadër të përafrimit më Perëndimin. Pra, të dyja këto marrëveshje janë një kallo e favorshme, të cilat aq sa janë në duart e Serbisë, po aq janë edhe në duart e Rusisë.
Në një të ardhme të parashikuar, skenari Gjeorgjisë dhe i Ukrainës do të jetë në tavolinën e shegertit rus në Ballkan.

*Botuar më: 25 korrik 2016*

# Sfida e rendit perëndimor në Ballkan

*Albulena Halili*

Në prag të mbajtjes së referendumit të serbëve të Bosnjës, Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, dishepulli i Millosheviqit, Ivica Daçiq, paralajmëroi Bosnjën e Hercegovinën se Serbia do t'i mbrojë serbët e Bosnjës po qe se ata sulmohen ndonjëherë. Një deklaratë që të kujton doktrinën tradicionale ruse të proteksionizmit të sllavo-ortodoksëve në Perandorinë Otomane dje, e në Ballkanin Perëndimor sot.
Megjithëse Serbia dhe entitetet paraardhëse të saj, gjatë dy shekujve të kaluar, sidomos nga viti 1876 e deri në vitin 1999, ekskluzivisht kundër popullsisë shqiptare gjashtë herë kanë kryer gjenocid e spastrim etnik, asnjëherë si shtet nuk e ka pranuar peshën e fajit kolektiv dhe e as që ka dalë përpara organeve të drejtësisë ndërkombëtare për t'u gjykuar si doktrina zyrtare shtetërore e si faj kolektiv kombëtar.

Pas Luftës së Dytë Botërore, psiko-analisti i njohur Karl Jung, shkroi një ese mbi konceptin e fajit kolektiv gjerman si një dukuri psikologjike, duke theksuar se gjermanët ndjejnë faj kolektiv për krimet e bëra nga bashkëkombësit e tyre dhe kështu termi "faji kolektiv gjerman" u fut në diskursin intelektual gjerman. Edhe teologë e klerikë gjermanë patën pranuar bashkëfajësinë përmes Dekleratës së Shtutgartit mbi fajin. Një vit pas luftës, filozofi dhe psikologu Karl Jaspers ligjëratat të cilave ai u mbante studentëve i botoi nën titullin "Çështja e fajit gjerman". Ky pranim i fajit kolektiv ndihmoi Gjermaninë të ngrihet nga gërmadhat e të bëhet sot njëra nga fuqitë botërore dhe aktorët kyçë të kontinentit evropian.

*Qeveria e Tiranës duhet të reflektojë se përderisa shteti serb ka cenuar dhe po e çon drejt dështimit përmbushjen e marrëveshjeve ballkanike: Marrëveshjen e Dejtonit, Marrëveshjen e Rambujesë, e Marrëveshjen e Konçulit, të lidhura me ndërmjetësimin e SHBA-ve dhe BE-së, ky është tregues se Serbia në koordinim të plotë me Rusinë po investon në zbehjen dhe sfidimin e rendit ballkanik të vendosur nga Perëndimi.*

Për dallim nga Gjermania e pas-luftës, Serbia sot ka statusin kandidat për integrim në Bashkimin Evropian si dhe ka hapur negociatat për anëtarësim.
Gjatë gjithë diskursit medial pas-referendumian, vendor e ndërkombëtar, u tha që referendumi i mbajtur më 25 shtator në Republikën Serbe edhe përkundër refuzimit të tij nga Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës, është në kundërshtim madje rrezikon skajshmërisht Marrëveshjen e Dejtonit, u theksua mbështetja e Rusisë si "aleate e shtetit të Republikës Serbe" siç qe shprehur Dodiq, dhe qe folur për zbehjen e ndikimit të SHBA-ve dhe BE-së në Ballkanin Perëndimor.

U la qëllimshëm në harresë deklarata e lartpërmendur e ministrit serb të punëve të jashtme, e cila ndillte luftë, madje u shquan dy tendenca mjaft të theksuara.

Së pari, shteti serb u amnestua nga të qenurit i implikuar në motivimin, orientimin dhe dirigjimin e veprimeve secesioniste të serbëve.
Së dyti, u sajua një lloj pamjeje kinse ekziston një distancim dhe moskoordnim mes politikës zyrtare serbe dhe asaj ruse. E gjithë kjo e ilustruar bukur me ngjashmëritë (sic!) e politikës së kryeministrit Vuçiq me atë të Titos – ekuilibrimit mes Rusisë dhe Perëndimit.
Që të dyja këto tendenca kanë për qëllim ta paraqesin si të paqenë doktrinën tradicionale serbe të përshtrirjes territoriale, e cila në boshtin e saj ka synimin e krijimit të Serbisë së Madhe dhe dëshirën e saj të kamotshme për një port në Detin Adriatik.

Instrumenti kryesor për arritjen e këtij synimi janë serbët që jetojnë jashtë kufijve të Serbisë. Përmes tyre ajo pamundëson funksionimin normal të shteteve ku ata jetojnë, krijimin e entiteteve artificiale përmes enklavave të vendosura më herët gjatë historisë bazuar në fshatrat-kordone, për të parandaluar vazhdimësinë territoriale kompakte të popujve të tjerë. Kjo është karakteristike sidomos në trojet shqiptare.
Këtyre dy tendencave iu shtohet edhe një e tretë e që është e mbështjellë bukur mirë me petkun e politikës së fqinjësisë së mirë. Takimi i përbashkët i qeverive serbe e shqiptare është caktuar të mbahet më 14 tetor në Nish, gjatë javës së punës njëjavore të qeverisë serbe, jashtë rezidencës së saj të përhershme, Beogradit. Mediat serbe thonë që qeveria serbe gjatë javës 13-18 tetor punimet do t'i mbajë në kazermën "Knjaz Mihajlo", ndërkaq netët do t'i kalojnë si edhe ushtarët e brigadës së tretë tokësore të ushtrisë serbe në kazermën "Mija Stanimiroviq" në Nish, brigadë e cila ka qenë drejtpërdrejt e përfshirë në operacionet gjenocidale kundër popullsisë shqiptare të Kosovës.

Takimi Rama-Vuçiq në rend dite do të ketë projektet infrastrukturore nga të cilat më e rëndësishmja është auto-rruga Nish-Durrës. Sigurisht që shqiptarët do të zhgënjehen kur ta kuptojnë që rruga kalon përmes hallkave Merdare-Prishtinë-Tiranë, apo atë që e njohim si rrugë e kombit.

Po ashtu pakkujt i ka shkuar ndërmend që 14 tetori, e caktuar si datë e takimit të dy qeverive, shënon dy vjetorin e ndeshjes së futbollit Serbi-Shqipëri ku u dëshmua koncepti i fajit kolektiv serb dhe u demaskua botërisht urrejtja kolektive serbe për etnogjenezën shqiptare.
Takimi i iniciuar nga Beogradi është përfytyruar që të jetë, gjithnjë sipas tyre, jo vetëm dialog mes shteteve Shqipëri-Serbi, por dialog për raportet mes shqiptarëve e serbëve në rajon. Too good to be true – thonë anglezët. Tingëllon bukur po të mos i njihnim kaq mirë fqinjët tanë, sidomos ne të jashtëkufijve, edhe më mirë – bashkështetasit tanë të imponuar. Propozimi për dialog mes shqiptarëve dhe serbëve mund të joshë përfaqësuesit e shtetit shqiptar apo edhe shqiptarët në përgjithësi, por ajo është shëmbëlltyra e politikës jugosllave e viteve '60 dhe '70 apo krijimi i marrëdhënieve të mira me Shqipërinë, në këmbim të projekteve serbe për superioritet ekonomik mbi kurrizin e infrastrukturës rrugore e detare

shqiptare. Pra, edhe një herë urë e Serbisë drejt Evropës politike bëhet kurrizi i shqiptarëve dhe kjo si duket pa asnjë kusht të vendosur nga qeveria shqiptare.

Qeveria e Tiranës duhet të reflektojë se përderisa shteti serb ka cenuar dhe po e çon drejt dështimit përmbushjen e marrëveshjeve ballkanike: Marrëveshjen e Dejtonit, Marrëveshjen e Rambujesë, e Marrëveshjen e Konçulit, të lidhura me ndërmjetësimin e SHBA-ve dhe BE-së, ky është tregues se Serbia në koordinim të plotë me Rusinë po investon në zbehjen dhe sfidimin e rendit ballkanik të vendosur nga Perëndimi.
S'do mend që ky dështim duhet t'i brengosë mu aktorët të cilët kanë garantuar dhe kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në përpjekjet për zgjidhjen e çështjes ballkanike. Tirana nuk duhet të bëhet pre e manipulimeve serbe, a aq më pak të bëhet pjesë e politikës së saj të përshtrirjes gjeografike në Ballkan. Duhet ta kuptojmë se strategjia tradicionale ruse, ashtu si gjetiu, po sistemohet në formën e neorealizmit mësymës, edhe në Ballkan.

Republika Serbe po shndërrohet në Krime ballkanike. Pafuqia e faktorëve ndërkombëtarë perëndimorë në parandalimin e mbajtjes së referendumit në Bosnjë parashikon hapjen e Kutisë së Pandorës në Ballkan.
Insistimi i krijimit të një strukture paralele të shtetit serb brenda Kosovës, përmes Asociacionit të Komunave serbe, është një ogur tjetër i zi për rajonin. Askush nuk e di saktë, se çka krejt mund të dalë nga kjo kuti, e cila me gjasë duhet ri-pagëzohet si Kutia e Ballkanit.
Në një kohë kur të dyja pjesët e rendit perëndimor, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian përballen me sfida të brendshme që rrezikojnë thellësisht ndikimin e tyre të jashtëm, vakumi i dominimit shërben si rrethanë e favorshme për konflikte në hapësirat nevralgjike gjeografike siç është Ballkani. Kontestimi rendit perëndimor në kushtet e interregnumit global nga fuqitë e mëdha si Rusia e Kina shpërfaqet njëlloj edhe në gadishull, ku u bashkohet edhe Turqia, përmes strategjisë së saj neo-otomane. Kështu, autoritarët e mëdhenj ia mësyjnë Ballkanit duke sfiduar e zbehur tej mase rendin e deritashëm perëndimor që u synua të vendoset në Ballkan.

*Botuar më: 8 tetor 2016*

# KULT - URA

# Katër librat që duhet t'i lexojë çdo politikan përpara se të bjerë prej pushteti

*Xhemazije Rizvani*

Më poshtë janë katër libra për katër vite mandat. Një vit, një libër s'është pak, sepse politikani ka punë, ka krejt fatin e popullit në dorë, shumë probleme e pak kohë. Por kjo nuk e arsyeton, nuk e shpëton dot nga libri. Prandaj ajo shprehja e njohur amerikane për vajzat dhe librat mund të vlejë dhe për politikanët: në qoftë se lideri yt nuk lexon, mos e voto. Mos e voto se ai është i paditur. Dhe, i padituri është i rrezikshëm. Atë duhet ta keni frikë. Është një njeri që s'e përmend as edhe një libër, as ka cituar një herë të vetme një thënie të bukur, të paktën. Po t'i kërkoni prej tij dhjetë librat që i ka lexuar, pritni mos të jenë lektyrat e shkollës fillore.

*Kush lexon, keq s'mendon, thotë një urti. Njeri jo i mirë është njeriu pa libra, e që nuk lexon. Mund të jetë i tillë lideri yt që del në TV dhe nuk skuqet kur gënjen, kur bën punë të pahijshme, kur të mohon, kur ta vështirëson jetën, kur të takon rrugës e flet me ty thuajse s'ka ndodhur asgjë, pa pasur frikë nga zhgënjimi yt me të. Ta jep dorën duke u shitur i sigurt se të përfaqëson si duhet.*

Kërkoni një listë leximesh prej tyre. Kur t'i bëjnë publike listat do ta kemi më të lehtë, sepse është e thjeshtë: më trego ç'libra lexon, të të them se cili je!
Lista e librave më poshtë kanë edhe arsyet përse duhet t'i lexojnë politikanët.

## *1. Trilogjia " Orestia" , Eskili*

Çdo politikan duhet të jetë i drejtë. Kur themi i drejtë nuk e kemi fjalën për mirësinë. Hygoi thotë: "Lehtë të jesh i mirë, vështirë është të jesh i drejtë". Fjala është për drejtësinë ligjore, së cilës i detyrohet çdo i besuar nga populli. Mos të largohemi nga Eskili, i cili ndryshe është quajtur Poeti i së drejtës . Trilogjia e tij ngjizet nga dhuna dhe hakmarrja e Agamemnonit dhe përfundon me paqe orestiane, falë Eumenideve që e bëjnë gjyqin duke vënë në peshoren e drejtësisë konfliktin. Tek Eumenidet, drejtësia vendoset gjithmonë në fund të konfliktit. Konflikti është ajo e ligë të cilën e drejta përpiqet të eliminojë. Me një fjalë konflikti mbetet problemi dhe drejtësia, zgjidhja e tij.
Sipas Eskilit krimi lind krimin. Drejtësia edhe në kohën politeiste nuk ka qenë diçka që varej nga hyjnitë, por ishte njerëzore. Ajo, kuptohet, sjell paqen në mes njerëzve dhe ç'është më e rëndësishmja sjell dhe paqe me veten.
Prandaj, politikanë, nuk ndihmojnë lutjet!
Për të qëndruar në pushtet më gjatë, ndihmon korrektësia (ose idiotët) . Lexoni, që ta mësoni drejtësinë! Ajo mund të vonojë, por gjithqysh një

ditë vjen.
* Dikush do të pyesë sigurisht, pse jo Prometheun që është vepër monumentale e Eskilit?! Arsyeja është e thjeshtë, sepse një politikan kurrë nuk flijohet për popullin e tij. Prometheu do të bëjë që politikani të heqë dorë menjëherë nga leximi)

## *2. Libri i Dostojevskit "Krim dhe ndëshkim"*

Politikani nuk duhet t'i kalojë kufijtë njerëzorë. Po t'i kalojë, do t'i bartë pasojat. Ky libër na ballafaqon me ndjenjën e pendesës dhe ringjalljes shpirtërore të Raskolnikovit për të cilën shkrimtari ishte frymëzuar nga një rilindje në lëkurë gjatë internimit të tij në Omsk të Siberisë . Libri paraqet etapat e ngjalljes së një shpirti të vdekur. Raskolnikovi duke vrarë plakën AlionaIvanovën, vrau në të vërtetë veten e tij. Ai u detyrua që të shkëputet dhe të veçohet nga njerëzit. Vetë emri Raskolnikov vjen nga fjala ruse "raskol", që do të thotë përçarje, ndarje më dysh, skizëm. Për heroin e Dostojevskit, përçarja ose ndarja më dysh e tij, ishte e brendshme, ishte një lloj shkëputjeje e dëbimi, ishte një largim e tëhuajsim nga rrethi, miqtë, familjaret, gjë që është një nga dënimet më të ashpra që mund t'i përjetojë njeriu. "Ai që është 'i rrahur' në mendje e shpirt, do të jetë gjithnjë i fuqishëm", thotë Dostoja për "politikanin tonë ". A ka shpresa për këso ringjalljeje? Rrugën për te fitorja "ata" e dinë, po këshilla e plakut thotë: "Rrugës shkurt mos i bjer!" Sido që të vrasësh, nëse vret, ke vrarë veten, dhe çdo krim ka ndëshkim.

## *3. "Udhëtimet e Guliverit", Johnatan Suift*

Politikani duhet ta ketë përvojën e shumë vendeve e njerëzve. Në kohën kur u botua libri, e lexuan të gjithë nga më i madhi deri te më i vogli, nga kryeministri deri te shërbëtori. Duket si një libër për fëmijë, po ngjarjet shtrohen thuktë rreth moralit e politikës. Në udhëtimin për Liliput, Suifti thumbon oborrin dhe politikën e Anglisë. Flimnapi, ka rolin e kryeministrit. Blefusku, vendi nga ku Guliveri arratiset, është Franca. Lord Bolinbruku e shihte Evropën ashtu siç i shihte Guliveri Liliputët, si qenie të paskrupullta, komike, të paarsyeshme. Është libri më i dashur për fëmijë, i përfshirë si lektyrë shkollore, mirëpo në sfond është një kritikë e ashpër kundrejt një politike. Ky libër politikanin tonë do ta mësojë si integrohet njeriu në vende të panjohura, me njerëz të ndryshëm. Do ta bëjë atë të shikojë përtej hundës.

## *4. "Ferma e kafshëve " nga Xhorxh Oruell*

Politikani duhet ta gjejë veten në Fermën e Oruellit – "Ferma e Kafshëve" është alegoria më e famshme politike e shekullit të XX-të. Është një tregim për një grup kafshësh që revoltohen kundër padronit të tyre të keq. Ky është një personazh, tiraninë e te cilit e kishin zgjedhur vetë lloji i tyre. Kemi të bëjmë me një dramë të përsëritur në të gjitha skenat politike. "Nëse do ta njohësh mirë një njeri, jepi pushtet". Tjetërsimi është i pashmangshëm. Njësoj si korruptimi. Dhe, kjo është arsyeja përse ata shumë shpejt zhyten në humnerën që e gërryejnë

nën këmbë, derisa  e arrijnë majën e synuar të malit.
Në libër thuhet : “Të gjitha veprimet e Njeriut janë të këqija. Dhe, mbi të gjitha, asnjë kafshë nuk duhet të tiranizojë kafshë të tjera. Të dobët apo të fortë, të mençur apo të thjeshtë, ne të gjithë jemi vëllezër. Asnjë kafshë nuk duhet të vrasë kurrë një kafshë tjetër. Të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa janë më të barabarta se të tjerat”. Sidomos politikani ynë duhet ta analizojë mirë fjalinë e fundit, e cila sikur të jetë shkruar për shoqërinë, politikën dhe aktorët politikë aktualë ndër ne.
*Një sqarim i nevojshëm për shkrimin: Këta janë katër libra që duhet t’i lexojë secili, ndërsa detyrimisht secili që synon  të bëhet politikan. Ai që s’do të bëhet, le të lexojë „njeri“ në vend të fjalës „politikan“.

*Botuar më: 31 Janar, 2016*

# Kadareja poet
(Në 80-vjetorin e lindjes)

*Vjollcë Berisha*

Ismail Kadareja  është një nga shkrimtarët më të fuqishëm të gjallë në botë. Në një shikim të pavëmendshëm mund të duket kundërthënës fakti që në epiqendër të këtij shkrimi vihet poezia, ndërkohë që romani është ai që e ka bërë të pranohet në hierarkinë e letrave shqiptare si shkrimtari më i rëndësishëm, më i përkthyer dhe më i lexuar. Po ashtu, pikërisht romani është ai që ia ka përcaktuar përmasat në sistemin letrar evropian në përgjithësi, duke ndihmuar shumë si kontekst e premisë mendimi për ta parë këtë vepër si përmasë ndërkombëtare në letërsinë kombëtare.

I njohur në radhë të parë për prozën, Ismail Kadare ka shkruar e botuar disa përmbledhje me vjersha e poema. Madje, deri në botimin e romanit Gjenerali i ushtrisë së vdekur më 1963, njohjen më të madhe në Shqipërinë e kohës e ka pasur si poet. Edhe udhëtimin e ngutshëm më taksi nga vendlindja për në kryeqytet, këtë udhëtim që u bë pjesë e thashethemnajës gjirokastrite, e bëri mu për shkak të librit të tij të parë poetik. Pavarësisht nga ky fakt dhe ndonëse shumë shkrimtarë e nisin krijimtarinë e tyre duke shkruar vjersha për të theksuar më pas pjekurinë artistike, Kadareja fillimet e tij në letërsi i ka pasur në prozë. Ai e shkroi një roman qëkur ishte në gjimnaz. Madje nga veprat e fundit eseistike e autobiografike del që kishte pasur gati edhe disa romane të tjera, të cilëve ua kishte përgatitur edhe kopertinat e afishet reklamuese. Disa prej tyre, si Qyteti pa reklama e Mjegullat e Tiranës tanimë janë pjesë e opusit të botuar.  Sidoqoftë, hera e parë që e bëri gjimnazistin Kadare ta ndjejë kënaqësinë e të parit të emrit të vet mbi një kopertinë libri qe pikërisht vëllimi me poezi Frymëzime djaloshare (1954). Vëllimet e tjera poetike që botoi qenë: Ëndërrime (1957), Shekulli im (1961), Përse mendohen këto male (1964), si dhe përmbledhje të zgjedhura poetike.  Me gjithë suksesin dhe njohjen e parë  që ia dhuroi autorit, poezia mbeti gjithmonë nën hijen e prozës së tij të fuqishme, kah e cila janë kthyer të gjitha shikimet. Atë, herë-herë, duket sikur e ka lënë edhe vetë shkrimtari, duke deklaruar se s'do të skruajë më poezi dhe duke iu kthyer prapë kohë pas kohe me ndonjë krijim të ri, siç ishte, bie fjala, poezia Krishtlindjet në Nju Jork (1997), që u botua pas një heshtjeje të gjatë poetike, apo të poemës Tirana në dimër (2005), që u botua tetë vjet pas shpalljes së Krishtlindjeve… nga ana e autorit si poezia e fundit e tij.

*Megjithëse kohëve të fundit nuk po boton poezi, megjithëse tërë famën ia ka sjellë romani, Kadareja në thelb është poet. Qeliza e prozës së tij mbetet poezia.*

Këtë "dorëheqje" të shkrimtarit nga poezia, ai vetë dhe kritika e kanë sqaruar si një averzion që më shumë do t'i jetë imponuar nga rrethanat,

nga koha e totalitarizmit, kur poezia ishte krenaria e gjithë kampit socialist… Në çdo vëllim do t'i këndohej partisë, socializmit, kongreseve, gjë që nuk ndodhte me zhanret e tjera letrare. Këtë taksë e paguante vetëm poezia. Romani, duke iu nënshtruar rregullave ngulfatëse të realizmit socialist, dilte nga radha e veprave të përjetshme, sakrifikonte vlerat artistike, por nuk qe i shtrënguar t'i thurte lavde Partisë, komunizmit, klasës punëtore, mjafton të mos dilte nga skema zyrtare e krijimit.
Averzioni mund të kishte lindur edhe thellë në ndërgjegjen e Kadaresë në kohën kur ishte student në Moskë dhe kur poezitë e tij botoheshin dhe lexoheshin me ëndje (natyrisht duke ia vënë në ballë atë shenjën që e bartnin të gjithë librat poetikë) , ndërkohë që romani i tij i parë dergjej i fshehur, pa e pasur as edhe një lexues, mu për shkak të këtij sistemi dhe të atyre njerëzve që lejonin botimin e poezive.
Por, a ishte ky një averzion i mirëfilltë që rezultonte me ikje të përhershme nga vargu? S'do mend që jo. Nuk duhet ndonjë sy i mprehtë për të vënë re rrugën vajtje-ardhje që bën Kadareja nga poezia në prozë. Për shembull, një numër i madh i poezive kanë qenë bërthama të romaneve të tij të mëvonshme. Por, ka ndodhur edhe e kundërta. Bie fjala, ndalimi i veprës Përbindëshi, polli poezinë Laokoonti. Kjo vajtje-ardhje e përhershme e Kadaresë nga poezia në prozë (si ai që sapo ka lënë një vend dhe kthehet për t'u çmallur), si dhe poetika e prozës së tij, s'flet veçse për një varësi të këtij shkrimtari nga poezia; s'ndërton veçse imazhin e një poeti që vazhdon të thotë edhe sot e gjithë ditën: stacioni im i fundit – poezi. Megjithëse kohëve të fundit nuk po boton poezi, megjithëse tërë famën ia ka sjellë romani, Kadareja në thelb është poet. Qeliza e prozës së tij mbetet poezia. Ky vështrim i shpejtë  synon të shtojë ca mendime në studimet që i janë bërë poezisë së Kadaresë, e veçanërisht vëllimit poetik që vjen ndryshe në letrat shqipe, vëllimit Shekulli im, me të cilin Kadareja vjen më i formuar si poet dhe vjen për ta ndryshuar për së mbari mënyrën e vjershërimit që jepte shpirt në Shqipërinë e viteve '50.
Një arsye tjetër e madhe për t'u marrë me poezinë është edhe natyra e veçantë e saj, e cila sa hap e mbyll sytë mund të të shkasë nga duart, me ç'gjë bëhet më sfiduese dhe e ysht çdo studiues drejt saj.
Sado që tek flitet për Kadarenë, ndërmend të bie romani, grotesku, diktatura, narratorë nga më të ndryshmit, kapituj, qindra fletë librash, prapë se prapë një sy i vëmendshëm, fare lehtë, do ta vërente prezencën e Poetit në atë "arkitekturë" të vështirë romani; do të vinte re se si poezia, ashtu pa bujë, gati naive, qëndron pranë prozës madhështore të tij, mu si ai krijuesi që ka bërë punën e vet dhe është tërhequr t'i shikojë të tjerët tek zihen për autorësinë.
Kur flitet për anën estetike të  poezive të tij për historianët e letërsisë numërimi fillon nga vepra e tretë poetike, përkatësisht nga vepra Shekulli im (1961), e cila vepër bëri një kthesë të beftë jo vetëm në krijimtarinë e Kadaresë, por edhe në gjithë poezinë tonë bashkëkohore. Poezia shqiptare e kohës, veç "folklorizmit të realizmit socialist", "kishte edhe një përbërës të folkutfshataresk", atë të një poezie të quajtur "me frymë popullore". Në vitet '60 Kadareja vjen me një poezi të revoltës ndaj këtij "klorofili" poetik, me një poezi qytetare, me një vjershërim me fytyrë të re si nga aspekti tematik, ashtu edhe nga aspekti i leksikut poetik e i figurave inovative, të pakonsumuara dhe tërësisht urbane. Nëse historia e poezisë, sipas poetit dhe studiuesit Valeri Brjusov, është historia e përsosjes së

mjeteve të saj, mund të themi lirshëm që Kadareja, bashkë me poetët novatorë të brezit të vet, përkatësisht vargjet e tyre, paraqet paradigmë brenda kësaj historie.
Vepra "Shekulli im" u botua në kohën kur për herë të parë në letërsinë shqipe po debatohej për probleme esenciale të letërsisë dhe pikërisht kjo përmbledhje ishte njëra nga objektet mbi të cilat debatohej. Ishte ai debati i famshëm midis traditës dhe novatorizmit në letërsinë shqipe, ku diskutohej për probleme esenciale të letërsisë, estetikës. Libri kritikohej për dekadencë, për një poezi të përçudnuar, pa rimë e metër, e sidomos kritikohej për figura të reja, "të çuditshme", të cilat nuk i njihte poezia tradicionale që po shkruhej atëbotë në Shqipërinë shtetërore.
Në këtë vepër Kadareja, me shpërthimet e veta krijuese, theu konvencën dhe u radhit në radhën e shkrimtarëve novatorë, duke e vënë përballë grupin tjetër të shkrimtarëve tradicionalistë. Këta të fundit u përpoqën të jepnin argumente të vlefshme për t'i dalë zot mënyrës tradicionale të vjershërimit dhe jo vetëm kaq, ata i fajësuan rëndë "të rinjtë" (në grupin e të cilëve bënin pjesë edhe DritëroAgolli e Fatos Arapi), i quajtën antikombëtarë, dekadentë, kozmopolitë etj., cilësime këto mjaft të rrezikshme për një vepër artistike dhe për autorin e saj në Shqipërinë diktatoriale, komuniste, në të cilën tanimë ishin formësuar konditat e krijimit letrar sipas modelit sovjetik (madje paksa më rigoroz se ai sovjetik) dhe në të cilën realizmi socialist ishte metodë zyrtare e krijimit artistik.
Po edhe "të rinjtë", duke përfituar nga ca rrethana zbutëse politike-shoqërore të diktaturës, i vunë përpara "të vjetrit", i tallën dhe i fyen pa mëshirë.
Përkundër të gjithë shkrimtarëve të brezit të tij, Kadareja është i vetmi që ka lindur në qytet dhe krijimtaria e tij letrare mbështillet tërësisht nga një vetëdije qytetare. Qyteti si qytetërim, si kulturë, ka vendin e tij mbizotërues në veprën kadareane. Tema e qytetit, ardhur në trajtat më origjinale, përveç faktit të të qenit pasardhës i një familjeje të vjetër gjirokastrite, që lë shenjë në tematikën e veprës së tij, në formimin e vetëdijes qytetare të shprehur me vargje, vjen e nxitur edhe nga përvoja e re jetësore që do t'i shfaqet parasysh djaloshit të sapodiplomuar të letërsisë, i cili do ta fitojë të drejtën për një studim pasuniversitar në Institutin "Gorki". Me këtë të drejtë studimi ai do të fitojë edhe rastin e njohjes me një botë tjetër të madhe, me një qytetërim tjetër, përkatësisht të njohjes me shijen e lirisë, gjë që nuk kaloi pa lënë shenjë në kujtesën, karakterin, formimin dhe krijimtarinë e shkrimtarit të madh të së nesërmes.
Nëse impulsi qytetar gjenetik kishte hapur me kohë tek ai shtegun për tema me vetëdije qytetare, përvoja moskovite hapi shtigje të reja, jo vetëm në shkallë tematike, por edhe mundësinë e krijimit të një poezie me fytyrë krejtësisht të re edhe për nga leksiku poetik dhe figurat e shprehjes poetike. Ndonëse në pamje të parë ky leksik i ri dukej i ftohtë dhe jo i zakonshëm për kohën, madje edhe apoetk, ai në të vërtetë qe një freski për tërë vjershërimin e viteve '50, për uniformizmin dhe konvencionalizmin që mbizotëronte atëbotë në poetikën shqiptare. Ndonëse fjalët e tipit: konservë, metropol, sputnik, agjensi, projektim, retinat e televizorëve, grushte shtetesh, ultimatum, diplomat, ashensor, semafor, trotuar, tramvaj, metro, reklamë, aeroplan etj. , apo figurat-krahasime të tipit, malësori me këmbët si kompas; vërtitem rrugëve si cigarishte në dhëmbët e mërzisë e të ngjashme – u cilësuan dekadente dhe të papranueshme për kohën, sot pikërisht ato tërheqin vëmendjen e lexuesit dhe bëjnë historinë e poezisë

sonë bashkëkohore si vëzhgim i procesit të përsosjes së figurave të saj. Shekulli i Ismail Kadaresë, mbase i paralajmëruar në vitin 1961 me vëllimin "Shekulli im" nuk është vetëm shekulli i dy iksave të mëdhenj që solli aq shumë ndryshime në botë, ai para së gjithash është shekulli i artit kadarean, në të cilin art u dëshmua si i pari, me format e reja që solli, si sintezë e njohurive sistematike mbi letërsinë, mitologjinë, traditën e pasur të këngës popullore shqiptare, të modeleve të veçanta të krijimit etj. Në radhën e poetëve, shkollën e të cilëve e ndoqi Kadareja, krahas poetëve tanë (siç ishte bie fjala Migjeni), duhet përmendur edhe poetët BertolBreht, UoldUitman, JanisRicos, dy Polet e letërsisë: Pol Valeri dhe Pol Eljar, si dhe poeti rus Vladimir  Majakovski, të cilët qenë modele ligjërimi për poezinë kadareane për gjysmë shekulli me radhë.

*Botuar më: 25 Shkurt, 2016*

# Në fillim ishte Njëshi…

*Xhemazije Rizvani*

Gjatë kthimit prej pune, rrugës vërejta një ngutje njerëzore të pazakontë, që pavetëdijshëm të ndillte të ndjekësh turmat. Ora po shkonte drejt njëshit, ngutja ishte për Njëshin, sepse siç thuhej në këto anë, xhumaja ishte dita e tij. Për një kalimtar të rëndomtë me biçikletë, afër të tridhjetave, femër, me çantë në shpinë, është veç e premte, megjithëse kjo ditë kishte një lidhje të pashmangshme me të, arsye për të cilën herë-herë zemërohej me atë që e pagëzoi me atë emër, që do ta bartte si fatkeqësi tërë jetën. E xhumaja dhe Njëshi ishin relikte të shumë krijesave që jetonin ferrin, jo nga temperaturat e larta të një qyteti jashtëzakonisht të ndotur, por nga një skutë e brendshme, e skëterrshme prej ku vinte lemeria që përditë i zvogëlonte sa herë rrekeshin ta kërkonin Zotin. Sa më i madh u shpërfaqej Ai, aq me i vogël bëhej njeriu.

Në mesin e krejt asaj ngutjeje, ma zuri syri dhe Gentin, një nxënës timin të çiltër, siç janë krejt fëmijët në moshën trembëdhjetë vjeçare. Dy shokët e tij rendnin para sikur po i ndiqte djalli, ndërkaq Genti turrej prapa tyre. Ç 'duhej të kishte ndodhur? Prej kujt donin të shpëtonin? Kush i ndiqte? Ndalova me kujdesin si të një nëne që shqetësohet për fëmijën e saj të pakujdesshëm, kur kalon rrugën. Genti s'ndalej. Doemos më duhej ta zbuloja përse rendte si një Marathonomak, djaloshin i cili thoshte se do të bëhej mjek një ditë, që shkruante esetë më të bukura, që e donte leximin por jo mjaftueshëm sa të kishte mësuar guximin për ta flakur një ndrojtje të panevojshme, të cilën ia konsideroja si ves. Ndalova bri rrugës, matanë, Genti me shokë. U ndal i fundit. Mori frymë thellë, i kërrusur para një porte, dhe më pas u fut brenda. E dallova menjëherë, ishte porta e Xhamisë së Pashës dhe djemtë ishin vonuar "për të falur xhumanë".

*"Flas me perëndinë, por qielli është një hapësirë boshe."*
*- SylviaPlath*

Sa do kisha dashur që Zoti vërtet të ishte aty dhe ta shihte dëshirën e etshme me të cilën e kërkonin estragonët dhe vladimirët. S'lodhej Genti, sepse besonte vërtet se Krijuesi ishte më afër tij në atë lëvozhgë të fortë rrenash. Atë nuk e ndiqte kush, ndryshe nga shumë të rritur që i shtynte ndërgjegjja me katrorë të zinj, ose joshja nga premtimet banale për botën e përtejme, siç i bëjnë rëndom politikanët, në "fushatën e opiumëve". Genti e kërkonte Zotin, nuk donte të rrojë pa të, siç nuk munden krejt fëmijët pa diçka surreale. Në fund të fundit, lutjet s'i kanë bërë dëm kujt, pavarësisht se nga lutjet askush nuk ka jetuar. I brishtë Genti për të kërkuar ngulmthi adresën e Zotit. Më vinte t'i them se Ai kish' kohë që s'banonte aty, por ka moshën kur nuk i vjen turp se qan.

Atëbotë, kur e dija ku ishte, ngrija kryet përpjetë dhe saora më fanitej një fytyrë me sy të mëdhenj, me duar sa të një kuçedre (mbaj mend se asokohe kisha frikë ta krahasoja kësisoj), me hundë si të Pinokut, me këmbë sa të një dinozauri, i cili po të zemërohej me mua, fare thjesht mund të më shkelte. Zoti im ish' pak i çuditshëm, por zemrën e kishte të madhe dhe rrumbullake sa një glob. S'mund të kishte zemër me skaje, me një formë si e jona ku u vriten brinjët atyre që hyjnë. Ai dashuronte më shumë se ne. Ishte i gjithëpushtetshëm, vetmitar dhe virtytin që prore ia kam pasur zili – i mëshirshëm, falte më shumë sesa mund të gabonim. Fakti që s'më ka shkelur deri më sot, i bie se nuk më është zemëruar përse e kam përfytyruar ashtu siç nuk lejohet dhe mund mos t'i pëlqejë. E di edhe arsyen, sepse unë kurrë nuk iu luta, vetëm e falënderoja për gjithçka. Aq shumë më mbushte rituali i falënderimit sa që nganjëherë më vinte sikur më trazonte lehtë me dorën e madhe për të më thënë: „sot nuk më falënderove që je gjallë, që e ke familjen shëndosh, që nuk të shkela më këmbë." Këtë të fundit përherë e thoshte me shaka. Kishte më shumë madhështi, sesa na e detyrojnë sot në vendet kah e kemi kërkuar. Para tij s'më është dashur të fsheh shumë gjëra, të shtirem si në teatër. Kisha vetëm një fytyrë, atë të gëzimit që ishte kah perëndimi.
Sa paqe ka një botë me një Zot që ty të ka zgjedhur t'i rrish më afër, të flasësh me të. Të dërguarit e Zotit duhet të kenë qenë të tillë, fëmijë të përjetshëm që nuk janë lutur për egoizëm, por i janë falënderuar që nuk fle, se mos ndodhin të këqijat në botë. Sa do të doja t'i tregoj Gentit për natën kur Atë e zuri gjumi (dhe kur kisha frikë ta zëvendësoja me një përemër dëftor ose çfarëdo). Nuk me trazoi si gjithnjë për falënderimet, nuk me foli më. Vendosi ta ndërrojë vendbanimin dhe unë ula kokën përdhé. Atë ditë e sot unë humba qetësinë që mbase Genti e ka. Kushedi a e ka përfytyruar ndonjëherë si unë. A është kjo arsyeja që e kërkon me aq ngulm dhe mendon se do ta gjejë, në vendin ku më së paku mund të jetë?!
Mjerë ai që (nuk) ka besuar… "And the rest was silence."

*Botuar më: 20 mars 2016*

# Na të birtë e shekullit të ri

*Xhemazije Rizvani*

Erinia di vetëm këngën e trishtimit, të melankolisë, të dorëzimit. Rini plakë që mendimet i ka si puçrrat e këqija të pubertetit. Nëse doni ta ndryshoni botën, thonë që së pari duhet ta frymëzoni rininë. Frymëzimi i tyre jemi ne, që në vend të kritikave, duhet të japim modele.

Të rinjtë nuk e duan jetën. Vuajnë nga sindroma e depresionit kronik. I thoni një të riu t'ju listojë ca arsye përse duhet dashur jeta dhe do ta shihni se s'kanë asnjë. Pyesni përse akoma janë gjallë, përse akoma nuk e kanë vrarë veten? Ballafaqojini me jetën, me të vërtetën. Ndihmojini të jenë në sot dhe në tash. Nxirrni nga „parajsat artificiale" ku janë katandisur si strucë egoistë, pa kurrnjë arsye.

Frymëzojeni rininë!

U thoni se jeta s'ka për të ndryshuar, janë ata që do të ndryshojnë . S'ka për t'u bërë kurrë e lehtë, por janë ata që do te bëhen më të fortë. Ata mund t'ia dalin, përderisa i mbijetojnë çdo ditë tetëorëshit shkollor .

U thoni se vuajtja i bën burra, i bën njerëz. U thoni ta përdorin fjalën e saktë, për ndjenjën e saktë. Le të përdorin fjalën „nuk dua„ në vend të fjalës „nuk mundem„, „nuk jam përpjekur sa duhet„ në vend të fjalës „nuk di„. Trandeni shpirtin dhe mendjen e tij. Alkooli dhe droga nuk u japin fund problemeve. As koha i ndryshon gjërat, në qoftë se ata nuk vënë gisht mbi to.

Ndizni motorët!

Rini, zgjidh ku do të mbërrish dhe nisu! Është ora jote!

Rruga do të jetë e vështirë, prandaj duhet ta bësh pikërisht ti. Po të ishte e lehtë, të gjithë do ta kishin bërë.

Dashurohu me veten sot dhe ndërgjegjësohu!

O brezi i demokracisë, i patatinave dhe i Facebook-ut, plotësoni mangësitë që keni, njihi vlerat kombëtare që përditë po të vihen në diskutim nga tendenciozët keqbërës që jua kanë shuar ndërgjegjen. Më thoni cili komb në botën moderne i ka kthyer shpinën historisë?! Është më shumë se e tmerrshme t'i shtrosh një pyetje historie a gjeografie për Atdheun, një të riu. Ata shëtisin botën, por nuk njohin Atdheun e tyre. Nuk e duan Atdheun e tyre. E si mund te duan diçka që nuk njohin?!

*„Rini, thueja kangës ma të bukur që di„*

O brez i humbur thellë në ekranet e telefonave, kompjuterëve, i –padeve, mjaft imituat atë që ju pëlqeni dhe ju bën perëndimor. Krijoni diçka tuajën për ta imituar të tjerët. Gjithë jetën do të mbeteni kopjues të shkollës dhe të huajës. Çka do të ngelet prej jush në këtë botë, përveç shumimit të vetvetes, që mund të jetë një dëm global?!

O ti i ri, që kujton se i di të gjitha, që më shumë shërbehesh me Google-n se librin. Je një brumë pa tharm, që do "diplomën", por jo dijen. Është koha t'i ndizni motorët!

Ju duhen tri lloje antidepresantësh, urgjentisht:
libra historie, libra letërsie dhe  krejt të tjerët.

* Në fund të rrugës ka për t'ju pritur një Malarme,  që do t'ju thotë diçka për jetën  dhe librat, por ju mos ia vini veshin.
Thueja kanges rini … !

*Botuar më: 1 prill 2016*

# Për dashurinë dhe Grujën e parë…

*Xhemazije Rizvani*

Kush ka rënë në dashuri për herë të parë e merr me mend se çfarë „ausente“ është ajo. Ka që kanë rënë për së dyti, për së treti , ç'rëndësi ka? Nga e para kanë filluar. Krejt këndojnë, shkruajnë dhe flasin per atë të parën, që e kemi idealizuar edhe ne (mos gënjehemi), e kemi menduar të butë, të këndshme, përvojë e re që ta zbulon një vetvete të re. Ditën pasi bie në dashuri nuk je më në tokë, i sheh njerëzit nga lart, diçka të mban pezull në hapësirë, në ajër, në kozmos. Të ngre në qiell dhe nuk mendon për asgjë. Nuk mund të punosh, nuk mund të lexosh, nuk të shkohet askund, fillon i urren të gjithë njerëzit e panevojshëm rreth vetes që ta duash „atë“ më shumë. Beketi te "Dashuria e parë" thoshte "Nuk mbaja mend ditën kur vdiq babai dhe data të rëndësishme si kjo, por mbaja mend ditën, orën, minutën kur ajo u largua". Pastaj e gjeti zgjidhjen, e kërkoi dhe e mori pranë vetes duke arsyetuar "vetëm kur atë e kisha afër, mund të mendoja për gjithçka tjetër. Një lloj lehtësimi për ata që, siç i quan Dostojevski, bien në dashuri si një "mëzat", se edhe burrat gjeni të parën dashuri si ne e kanë pasur. Mund të thuhet se krejt dashuritë e para ngjajnë për nga ndjesia, por nuk e di a ngjajnë dashuritë për pushtetin, sidomos ajo e atyre që obsesionohen pas Grujës. Politikanët tanë sillen me pushtetin si me dashnoren e parë. I rrijnë besnikë, i binden, nuk ia ngrenë zërin. Sa bëjnë ta ndërrojnë pak tonin, menjëherë hasin në ashpërsi dhe bëjnë sikur s'ka ndodhur gjë. E takojnë ditën tjetër me lutjen që mos jetë turrivarur. E "ajo", si ajo bushtra inteligjente që e ka kuptuar se "terren i pushtuar" është qëmoti, synon terrene të tjera. Pra, fillon flirti, koketimi me rivalë të tjerë. "Dashnori" që e ndjen veten të rrezikuar karshi dashnores së parë, tromakset, tronditet, kjo s'mund t'i ndodhë atij, se pa të s'mund të jetë ai që është , aty ku është dhe, si pasojë, dihet, i hidhet në sulm rivalit në vend se ta lërë dashnoren e keqe që nuk e do, që e shfrytëzon, që ia punon prapashpine, që e nxjerr leshko para të tjerëve. Dashnori është i zjarrtë dhe shpesh natën vonë i tregon se gjithçka kishte bërë për të pa menduar (se ku ka tru me gjithë atë dehje), vetëm ta mbajë afër vetes. Të tjerët e xhelozojnë. Ai e ka humbur racion, e udhëheq sentimenti. S'ka kush përreth që t'i thotë se gabon, se do të kalojë edhe kjo, se duket haptazi se është e njëanshme. Se veç jep e asgjë nuk merr. Po ku te beson ai?! Hec e thuaji dhe ke për të parë sa njeri dashakeq që je, që mezi pret radhën t'ia zësh "dashnoren". Se për këtë të vjen më keq ty, që s'je në vendin e tij që ta përjetosh krejt atë luks , hmmmmm. Si mund të rrojë pa të? As mos ia thuaj! Do të jetë një asgjë, një askush. Ia ka pirë sorra mendtë. Provoni t'ia çelni sytë dhe do t'ju thotë si një idealist "merri sytë e mi

*Ditën pasi bie në dashuri nuk je më në tokë, i sheh njerëzit nga lart, diçka të mban pezull në hapësirë, në ajër, në kozmos.*

dhe shihe". Sa shumë e kishte ëndërruar atë, shumica nga ju e dini . Nuk kishte fjetur natën, frymshëm e kishte dëshiruar ditën, e kishte menduar shpesh veten me të, të pandashëm, duke i bërë premtimin "derisa vdekja të na ndajë, le të dalë ku të dale". Atij nuk i intereson integriteti që i cënohet, liria që i mohohet , e rëndësishme është kur të shfaqet në publik të jetë me të, ndihet më i fortë kur atë "me nder me thanë" e ka afër, pavarësisht që bie erë shumë. Të dy kundërmojnë. U zgjata pak. Të shkojmë te fundi i kësaj lumëmadhes dashni. Eh, përvoja e bën të veten, e dini dhe këtë. Një ditë romanca përmbyset. "Dashnorja" e le për interesat e veta, jo se ka gjetur më mirë, por se s'ka çfarë merr më prej atij që e ka boshatisur. Tashmë thotë se nuk i pëlqen se nuk kishte kërkesa, nuk e dinte kush ishte, kishte mungesë vetbesimi, personaliteti, e fyu si krejt ata që ku gjejnë shesh, bëjnë përshesh. Mori krejt çfarë deshi prej tij, e shpërdoroi me një fjalë dhe në fund për ta denigruar më shumë i tha "nuk jemi të nivelit të njëjtë, ti ke ardhur nga mali, unë kam rrënjë në qytet. A do Gruja një të tillë afër vetes? Gruja është me përvojë. E ka të lehtë të bëjë me "dashnorin" ç't'i teket. I arrin të gjitha qëllimet pa fare mund. Dashnori i qe përgjëruar: "Vetëm mos më lër, ç'të duash do të bëj për ty". Gruja moti e kishte nuhatur rëndësinë që ia kishte ofruar, kishte kuptuar që zëvendësim s'kishte. Dinte si t'i "zhvirgjëronte dashnorët", i zhvaste dhe i hidhte si letra tualeti të papërdorshme, pa përdorur ndonjë teke. Pas shumë vitesh dashnori pa sesi Grujakoketonte me gjithë ata dashnorë të rinj përreth njëherësh dhe iu kujtua dashuria e parë. Zakonisht kur na kujtohet dashuria e pare, qeshim me krejt ato gjëra të pamendta, e harrojmë të qeshim me atë që e provuam. Qeshte dhe Beketi, Dostojevski. Krejt gjenitë kanë qeshur. Vetem se dashnorit tonë, çuditërisht i erdhi të qante, të ulëriste, të ndërronte lëkurën, t'i shkulte flokët, të hapej toka e ta përpinte, ç'nuk i erdhi . I erdhi plasje, sepse kishte rënë në dashuri me njeriun e gabuar dhe zakonisht pas dashurisë së parë me njeriun e gabuar shumica e mendojnë vetëvrasjen, këtë më së miri e dinë adoleshentët. Ish-dashnori vendosi në fund të bëhej poet dhe kopjoi do vargje prej një tjetri "ke vdekur prej kohësh, i vdekuri nuk vetëvritet". Ish-dashnori ngushëllim të vetëm e ka faktin që nuk ishte i vetëm. Ata janë shumë.

*Botuar më: 16 prill 2016*

# Mbi librin, arkitektin gjenial të personalitetit njerëzor

*Vjollcë Berisha*

Kanë kaluar disa vjet qëkur nuk punoj më në librari, qëkur i kam "shpëtuar" asaj ndjenje gërryese të qëndrimit përpara një rafti plot libra me trishtimin e beftë se jeta s'të del për t'i lexuar të gjithë, trishtim ky që të vjen shpesh, pothuajse përditë, me të njëjtën fuqi shtypëse dhe ti e gjen veten duke ëndërruar si kalama për ndonjë mundësi teknologjike për thithjen e të gjitha fletëve me një frymë.
Unë nuk bëj pjesë tek ata njerëz që mund t'i lexojnë "librat" në kompjuterët e tyre, për të cilët libri përherë i ka faqet e bardha (me të bardhën e njëjtë, të pandryshueshme) dhe përherë rrezaton të njëjtën dritë ekrani. Jam ende nga ata "anakronikë" që krijojnë një kimi me librin si objekt, me ngjyrën e letrës, trashësinë e peshën e saj, llojin e shkronjave, hapësirën mes rreshtash, ngjyrat e kopertinës, shuma e të cilave është faza hyrëse e kënaqësisë që do të pasojë. Kjo mbase e bën të dallueshëm përshtypjen e një leximi nga një tjetër kur bëhet fjalë për botime të ndryshme, që dallojnë vetëm teknikisht, nga jashtë. Kjo bën të mundur që shijimit t'i shtohet edhe shqisa e prekjes, e bën të mundur që dashuria të depërtojë prej gishtave.
Nuk bëj pjesë tek ata njerëz që e shohin të zezë të ardhmen e librit, që thonë se ka më shumë shkrimtarë se lexues, që mendojnë se libri po katandiset pothuajse në një stoli shtëpie a lokali pa u shfletuar kurrë. Kjo s'mund të jetë e vërtetë, të paktën s'mund të jetë një e vërtetë e përgjithshme që e përfshin të tërën, të paktën jo për kombin tim, i cili jo shumë larg nga kjo kohë, ka pritur para dyerve të librarive njësoj si në radhën e qumështit, ka përlarë gjithë tirazhin e shtëpisë botuese vetëm për disa orë të ditës, i ka groposur librat si gjënë e çmuar në dhé për ta shpëtuar nga djegia, konfiskimi, ka rrezikuar t'i huazojë librat e ndaluar e t'i përcjellë fshehtas dorë më dorë si gjënë e rrezikshme, ta lexojë në grup që ai të bëjë më shumë rrugë, të kalojë në duart e më shumë njerëzve që e presin… Kjo është pak a shumë lidhshmëria jonë historike me librin, pa përmendur udhën todriane të shkronjave, pa përmendur burgjet, hetimet, lotët pas konfiskimit, pa përmendur nënat që i kanë asgjësuar diku prapa shtëpie

*Kjo s'mund të jetë e vërtetë, të paktën s'mund të jetë një e vërtetë e përgjithshme që e përfshin të tërën, të paktën jo për kombin tim, i cili jo shumë larg nga kjo kohë, ka pritur para dyerve të librarive njësoj si në radhën e qumështit, ka përlarë gjithë tirazhin e shtëpisë botuese vetëm për disa orë të ditës, i ka groposur librat si gjënë e çmuar në dhé, për ta shpëtuar nga djegia, konfiskimi, ka rrezikuar t'i huazojë librat e ndaluar e t'i përcjellë fshehtas dorë më dorë si gjënë e rrezikshme, ta lexojë në grup që ai të bëjë më shumë rrugë, të kalojë në duart e më shumë njerëzve që e presin…*

librat e djalit, nga frika se ai po bie në burg, se ata “po ia hanë kryet”…
Unë nuk bëj pjesë tek ata njerëz që thonë se nuk ka lexues, unë them që mungojnë rekomandimet e drejta. Mungojnë rekomandimet e drejta për lexime shtesë në shkolla, mungon lista e drejtë e lektyrave që përputhet me botëkuptimin e shkollarit të ditëve të sotme, shkollarit për të cilin edhe shiriti i filmit është i tejkaluar. Rekomandime këto që mund ta tërhiqnin në botën e leximit, mund t’ia hapnin dyert përgjithmonë, shumë më lehtë se me temat klishe të hartimeve “Libri – shoku më i mirë”. I mirë, po, por dikush duhet t’ua prezentojë, t’i njohë me atë shok, t’i bëjë ta duan, mbase dhe të mos munden pa të. Natyrisht që me rekomandim nuk nënkuptoj vetëm atë që duhet bërë në shkolla (ajo është e para), por këtu kam parasysh aktivitetin e përgjithshëm të institucioneve, bibliotekave, shtëpive botuese, mediave, kritikëve të librit, të cilët e kanë detyrën e rëndë e fisnike të prezantimit dhe afrimit të librit me lexuesit.
Sot kur shkruhet e botohet kaq shumë, ky rekomandim është më i nevojshëm se kurrë, jo vetëm për lexuesit e rinj, por edhe për lexuesin e profesionalizuar për ta fokusuar vëmendjen kur gjendet përpara grumbullit të madh e të përditshëm të botimeve, jo rrallë, edhe pa kritere.
Sot, në Ditën Botërore të Librit, më rri mbi krye mirënjohja gjigante ndaj librave të fëmijërisë, përrallave të gjyshes, vjershave të Agim Devës, RifatKukajt, Vehbi Kikajt dhe një batalioni të tërë poetësh që s’i kam parë me sy, por që i kam njohur e dashur shumë; ndaj fabulave të Ezopit, përrallave të La Fontenit që më mësuan të ëndërroj. Kjo mirënjohje nyjëton në mua një urim që mund të tingëllojë skematik, por që ka brenda dëshirën që bota të bëhet më e butë duke lexuar. Uroj ta duam edhe më shumë Librin, të reflektojmë më tepër dhe të bindemi se çdo libër i ri i lexuar, më tepër se edhe një titull në listën që kemi, është një bulevard më shumë në botën tonë të brendshme, është një qetim i përhershëm i përbindshave që i rrisim përbreda, ne, njerëzit e vdekshëm.

*Botuar më: 23 prill 2016*

# Njerëzimi nuk i meriton poetët

*Xhemazije Rizvani*

Poezinë e Bajrajt e kam lexuar si gjimnazist dhe nëpërmjet saj kam kuptuar jo vetëm vuajtje njerëzore, po edhe histori politike dhe vizion për një botë më të mirë. Më ka rastisur që të lexoj autorë të tjerë paralelisht me Bajrajn dhe kur kthehesha te poezia e tij, më dukej që sapo e kisha ndezur një Marlboro pasi e kisha fikur paraprakisht një Bozhur.
Uran Krasniqi, gazetar
Xhevdet Bajraj, një poet i cili në të gjitha poezitë e tij shpreh një melankoli që e mbulon tërë qenien e vet si brenda, ashtu dhe jashtë saj. Ai na bën edhe ne të flasim me poezinë e tij që jo rrallë ka dhembje, mall, dashuri për atdheun që e ka larg.
Albulena Zylbeari, profesoreshë e gjuhës shqipe
Poezi që prekin një dimension tjetër të tragjedisë dhe shembjes njerëzore. Herë ajo shfaqet si një komedi e zezë që qesh me dhembjen, siç qesh egoja e pamëshirshme jona dhe në fund, pasi e kupton, të rrëqeth të tërin.
Kushtrim Zendeli, lexues i pasionuar librash, stomatolog i diplomuar

*Në një ditë të bukur qershori, në një përpjekje për intervistë me poetin, siç e quajnë tashmë, shqiptaro- meksikan XhevdetBajrën, doli një bashkëbisedë krejt spontane që s'është intervistë dhe as poezi.*

**Xhevdet Bajraj:** U iki intervistave. Përtoj ta braktis Rahovecin dhe pse e ndjej veten si në moçal.
Me shkrim më duket se bëj art, ndërsa kur flas, më duket sikur jam i çmendur. Më komod e ndjej veten buzë artit se buzë çmendurisë. Nganjëherë s'di pse më duken e njëjta gjë.

**Xhemazije Rizvani:** Ju poetët jeni pak të çuditshëm…

**Xhevdet Bajraj:** Pak jo, por shumë të çuditshëm, shyqyr që jemi aq pak hahaha…

**Xhemazije Rizvani:** Prej nga buron "çudia" te poetët?

**Xhevdet Bajraj:** Nga ndjenjat.

**Xhemazije Rizvani:** Cila? Ne "të tjerët" s'jemi krejt pa ndjenja.

**Xhevdet Bajraj:** Perceptimi, guximi për ta parë botën në mënyrë të veçantë, si dikur në fëmijërinë e njerëzimit.

**Xhemazije Rizvani:** Mos keni ndonjë ndjenjë tepër ju poetet. Si duken

gjërat prej atij këndi?

**Xhevdet Bajraj:** Mbase dhe e kemi. Na dhemb jeta edhe kur nuk duhet.

**Xhemazije Rizvani:** Kjo është vërtet e çuditshme. E keni përjashtuar lumturinë?

**Xhevdet Bajraj:** Jo. Jemi gjithmonë në kërkim të saj. Përderisa e kërkojmë, jemi të lumtur, apo përpiqemi të jemi. Ku ta di?! S´di ç´të them për botën në përgjithësi. Njerëzimi nuk i meriton poetët (piktorët dhe kompozitorët), edhe pse të gjitha këto njeriu i bart me vete si peshqesh që nga origjina. E meritojnë veç një përqindje shumë e vogël e njerëzve.

**Xhemazije Rizvani:** Cilët?

**Xhevdet Bajraj:** O, Këtu fut sa të duash, por le të jenë ata që vuajnë dhe ata që dashurojnë. Se s'di pse e kam ndjenjën sikur jemi duke e bërë intervistën hahaha…

**Xhemazije Rizvani:** Pse nuk e keni ndjenjën se po bëjmë një poezi për shembull? Ç'ka me tepër se kjo bashkëbisedë poezia? A është e zorshme ta shkruash?

**Xhevdet Bajraj:** Kjo është e bukura e të shkruarit dhe jo kamera. Edhe pse s´ia kam frikën kamerës.
Poezia ka shumë më tepër se kjo bashkëbisedë. Është e tërë jeta, jo veç e individit, por e të gjithë llojit njerëzor.

**Xhemazije Rizvani:** Ju jeni profesor i poezisë. A mund te ma mësoni poezinë? Dua ta shkruaj me çdo kusht?

**Xhevdet Bajraj:** Normal që mundet.

**Xhemazije Rizvani:** A është kusht ta duash aq sa unë e dua poezinë?

**Xhevdet Bajraj:** Po, është. Bile është njëri nga kushtet kryesore, ndërsa një tjetër është vetëdija se jemi të vdekshëm. Kur e di këtë, ke një mundësi ta shkruash jetën tënde për ata që do të vijnë.

**Xhemazije Rizvani:** Po? E nëse është dashuri e njëanshme: unë e dua, ajo (poezia) nuk më do?
**Xhevdet Bajraj:** Poezia i do të gjithë, përveç atyre që shtirren poetë.

**Xhemazije Rizvani:** Cilët poetë i do më shumë dhe i ke lexuar? Ta shoh mos qëndron suksesi te gjërat që lexoni?

**XhevdetBajraj:** Nuk qëndron puna tek autorët, por te poezitë e veçanta. Kjo do të ishte njëra anë e medaljes, kurse ana tjetër është tek autorët që nuk e kanë asnjë perlë, por vepra e tyre shndërrohet në perlë.

**Xhemazije Rizvani:** E si behen, pra, të veçanta? Si kjo? Mbase tani dukem tamam si ata studentët tuaj të bezdisshëm që presin në radhë për t'u bërë poetë.

**Xhevdet Bajraj:** Ka poezi apo vargje që ta ndryshojnë jo veç poezinë, por edhe jetën. Nganjëherë këto të dyja më duken një. Jo gjithmonë autorët më të mirë, apo poezitë më të mira, sipas kritikëve, të ndryshojnë jetën.

**Xhemazije Rizvani:** Si ta ndryshojnë jetën njëherë?

**Xhevdet Bajraj:** Dërgoma poezinë tënde më të mirë (sipas teje).

**Xhemazije Rizvani:** Nuk e kam shkruar ende.

**Xhevdet Bajraj:** Padiktueshëm ta ndryshon. A e ke lexuar I huaji të Kamysë? Zgjohesh një mëngjes dhe e ndjen që nuk je i njëjti person, që lisin që e ke para dyerve të shtëpisë të duket sikur e sheh për herë të parë…

**Xhemazije Rizvani:** E kam lexuar jo vetëm pse kemi lindur në ditën dhe muajin e njëjtë me Kamynë, më 7 nëntor.

**Xhevdet Bajraj:** Sa mirë! Ndërsa unë me Markezin.

**Xhemazije Rizvani:** Nëse do të kërkoja ca këshilla për ata që duan të bëhen poetë?
**Xhevdet Bajraj:** Duhet t'i lexojnë poetët. Veç poeti i lexon poetët edhe Zoti, nëse ekziston. Është shumë e lehtë të shkruhet poezia, veç është i rëndë kërkimi brenda vetes.

**Xhemazije Rizvani:** Atëherë i bie se edhe Hitleri ka qenë poet. Ai e ka dashur poezinë, bile dhe ka shkruar disa sosh.

**Xhevdet Bajraj:** Jo, por e ka pasur guximin e poetit, apo ka dashur të identifikohet me ta. Poezia është si jeta, e konsumove apo jo, një është. Është një lloj hakmarrjeje ndaj vdekjes.

**Xhemazije Rizvani:** Kanë filluar shumë ta shkruajnë poezinë. Aq sa më duket se secili do që të vdesë si poet.

**Xhevdet Bajraj:** Ka shumë pak poetë. Do që kanë vdekur mbahen mend për 4-5, apo 2-3 poezi, do për një libër, për fat të keq. Jo bre, tingëllon keq, por po e them ndryshe. Te jeta janë do roje të dritës, por dritën e kanë pas shpine, kurrë nuk e shohin. Apo, një lloj i poetëve do të ishte ky që gjithmonë e shohin errësirën, madje e kafshojnë errësirën dhe për ndryshim nga bletët, prodhojnë dritë. E ka pas thënë këtë dikush moti…

**Xhemazije Rizvani:** Ju cili jeni?

**Xhevdet Bajraj:** Për fat të keq, ky që e përshkrova. Albatrosi dhe "Himni i

bukurisë" të Bodlerit ma kanë ndryshuar jetën, por Bodleri s´është poeti im i prefeeruar. Pastaj, Neruda dhe "20 këngë dashurie dhe një këngë pikëllimi", por, po ashtu, s´është poeti im i preferuar.

**Xhemazije Rizvani:** Pse nuk janë?

**Xhevdet Bajraj:** Sepse duhen lexuar ne moshë të caktuar si shumë poetë apo prozatorë.

**Xhemazije Rizvani:** Në cilën moshë lexoheshka "Albatrosi" , "Himni i bukurisë"?

**Xhevdet Bajraj:** Bodleri duhet të lexohet prej moshës 17 deri më 22-vjeçare, apo 25, maksimumi 27.
Varet nga inteligjenca dhe përkushtimi. Sidoqoftë, ai është njëri nga ata që e ka ndryshuar njëherë e përgjithmonë poezinë evropiane. Ka figura tek ai që edhe një plak e le pa frymë, por nuk është aty esenca.

**Xhemazije Rizvani:** Cilat poezi lexohen pas moshes 30-vjeçare?
**Xhevdet Bajraj:** Eh, nuk janë të gjithë poetët për të gjithë ata që vijnë. Nëse je lule kaktusi, ti do ta duash shkretëtirën, nëse je lule mëngjesi, ti do ta duash veç dritën e mëngjesit, nese je…. Për këtë arsye desha t´i lexoj 5 poezi tuat.

**Xhemazije Rizvani:** Ju premtoj që do t'ua dërgoj sapo t'i shkruaj.

**Xhevdet Bajraj:** Përndryshe i përshtatem çdo studenti, apo përpiqem të bëjë këtë. Shkruan prozë atëherë?

**Xhemazije Rizvani:** Unë jam pakëz student i komplikuar, nuk i bëj detyrat e shtëpisë. E kisha fjalën për ato 5 poezitë.

**Xhevdet Bajraj:** Atëherë s´do të mësosh asgjë nga intervista.

**Xhemazije Rizvani:** Pse? Kjo bashkëbisedë poezi është?

**Xhevdet Bajraj:** Edhe kjo është poezi. Kjo bashkëbisedë është sepse jam i mërzitur, Vjollca shkoi në Prishtinë, i thashë që do t´i bashkangjitem nesër, bën shumë vapë dhe sepse më keni pritur shumë bukur në Tetovë.

**Xhemazije Rizvani:** Paskeni arsye që jeni i mërzitur, edhe pse s'dukeni njeri i lumtur, këtë e thotë dhe Vjollca (bashkëshortja)?

**Xhevdet Bajraj:** Cili njeri normal mund të duket i lumtur kur e di që edhe 50 vjet do të shndërrohet në një grusht dhé, ndersa nuk do t´i kujtohet asgjë nga kjo botë. Madje as se ka pasur dhembje dhëmbi, as se i është dridhur ndonjëherë zemra nga frika a dashuria.

**Xhemazije Rizvani:** Vërtet e tmerrshme. Po ka dhe gjëra për të cilat mund të jesh i lumtur që harrohen, mbulohen, si të thuash!?

**Xhevdet Bajraj:** Natyrisht, por ato nuk e bëjnë një njeri të lirë. Njeriu i zakonshëm është i humbur, si të them. Jemi ai apo ajo në çfarë na ka shndërruar botëkuptimi aktual për jetën në rrethin në të cilin jetojmë. Jemi ajo çka kanë dëshiruar prindërit tanë, farefisi, rruga, shkolla, religjioni . Të jesh artist do të thotë të rebelohesh ndaj të gjitha këtyre që i përmenda dhe të mbetesh njeri. Ç´është jeta në fund të fundit?! Mund të përgjigjemi në këtë pyetje me citate dhe kjo nuk do të na bëjë që ta kuptojmë. OktavioPaz në një poezi thotë: kur dy veta shikohen në sy, lind një botë. Njeriu sot as nuk ka kohë ta vështrojë, e aq më pak të mendojë për botën. Lexoje një poezi të Kavafisit, Itaka quhet apo Fundi i botës nga Çesllav Milloshi, janë dy nga poezitë që i përdori në fillim të çdo semestri. Mbase e di që Kavafisi ishte grek që veç një vit apo më pak ka jetuar në Greqi, edhe atë para se të vdiste, d.m.th. si plak.

**Xhemazije Rizvani:** Secili në mendje ka një Itakë ku do të mbërrijë.

**Xhevdet Bajraj:** E ka greku tjetër, NikosKazanzaqis një roman në vargje kur Odiseu kthehet në Itakë dhe mërzitet aty, kështu fillon libri. Spanjisht është La últimatentación de Cristo.

**Xhemazije Rivani:** Shqip është Krishti kryqëzohet përsëri. Është pak cinik Nikosi aty.

**Xhevdet Bajraj:** Por, e ka logjikën e vet, se në roman e kryqëzojnë një aktor nga teatri që e formojnë refugjatët, d.m.th. e kryqëzojnë politikanët lokalë të një vendi të vogël. Cinik po, por i mrekullueshëm. Nuk e paskam ditur që e kemi të përkthyer në shqip.

**Xhemazije Rizvani:** Si nuk e paskeni ditur? Ju s'jetoni shqip më?

**Xhevdet Bajraj:** Jetoj njerëzishëm. Domethënë kafshërisht.

**Xhemazije Rizvani:** Ashtu rrojmë të gjithë, përderisa tanimë askush nuk kryqëzohet.

**Xhevdet Bajraj:** Jo të gjithë. Shumica jetojnë si personazhe në teatrin e kukullave, ose janë perzonazhe të një libri që s´e hap kush, ndërsa nuk e marrin guximin të rebelohen, qoftë edhe të ikin nga libri. Shkrimtari i mirë i ndjek ata. Tani më duhet të iki. Ishte bisedë e mirë, më shpëtove ditën…

**Xhemazije Rizvani:** Falemnderit shumë, profesor!

Botuar më: *28 Qershor, 2016*

# Në Korçë të shkosh… Për "KoKo Festën" të shkosh…

*Xhemazije Rizvani*

*Mbresë udhëtimi*

"O Korçë e dashur , për ty këndoj unë serenatë…", përherë e kemi kënduar edhe përpara se ta shohim, ia e kemi ndjerë në vargje magjinë, në poezi të poetit kur thotë: "nëse kitara s'ka lindur në Korçë, atëherë Korça nga kitara është." Korça e abetares së parë, e shkollës së parë, e serenatave, e romancave. Vetëm në Korçë ballkonet kanë kuptim, janë dëshmitare të shumë dashurive poshtë së cilave janë kënduar gjithë ato serenata dhe janë dridhur aq shumë zemra natën vonë. Korça e festivaleve, e karnevaleve, e gëzimit, haresë, kërnackave, birrës së vendit dhe rakisë së pjekur. Korça e Naum Veqilharxhit, Thimi Mitkos, e Çajupit, e Asdrenit… Korça e himnit kombëtar. Korça e Hafëz Aliut, Qiriazëve, e gjithë atyre këngëve që i ka bërë të mbajnë cilësorin e një vendi. Çfarëdo që të thuash për Korçën të duket pak. E kanë quajtur Paris të vogël, i kanë thurrur gjithë ato lavde e vjersha, e kanë lartësuar për besën dhe mikpritjen. Njeriu fisnik i këtyre anëve thotë se më së shumti në siklet është ndier, kur s'e ka pritur mikun siç ka dashur, por siç ka mundur. Nëse trupi shqiptar do të kishte një zemër, pa dyshim ajo Korça do të ishte. Korça të bën të ndihesh si në shtëpi. Sapo futesh në të gjen njerëz të ngrohtë, me shije të kultivuar që e kanë ruajtur po atë fisnikëri. Edhe kur flasin, korçarët këndojnë.

*Të shkosh patjetër! Për të parë se si një qytet të rrëmben dhe do atje shtëpi të kesh. Fillon dhe ëndërron në qytetin që vetë është një ëndërr, një mbetëreshë që dremit në sup të një mali.*

Në Korçë të shkosh patjetër, por të shkosh në kohën kur mbahet Festivali Mbarëkombëtar i Komedisë "KoKo Fest" i lexon ata njerëz me entuziazëm. Ndiqe vitin tjetër këtë festival dhe ke për të parë etjen e njerëzve për kulturë. Në një teatër që është në rikonstruksion, që po të jesh nga fundi i sallës dhe përjashta bie shi të vështirësohet dëgjimi, po të jesh anësh merr të ftohtët dhe sëmuresh keq për sa kohë zgjat festivali. Jam e sigurt se në të gjitha qytetet tjera shqiptare në ato kushte jo vetëm që s'do të mbushej salla, por askush nuk do të rrezikonte të futej. Publiku korçar jo vetëm që e ndiqte përnatë këtë festival, po dhe futej gjysmë ore më herët për të siguruar një vend, sepse në kohën kur fillonte shfaqja, një pjesë e madhe ngelej në këmbë. Kurrë s'kisha parë dashuri të tillë për teatrin. Publik kritik që di kur qesh, e kur hesht, kujt i duartrokitet dhe kur duartrokitet. Publik i mençur që i respekton deri në fund artistët, u ngrihet në këmbë. KoKo Fest-i ishte nën udhëheqjen e drejtoreshës Zamira Kita, për të cilën gjithandej flitej për drejtimin e mirë të

punëve në këtë institucion. Ndoshta pse është aktore edhe vetë dhe më mirë se ajo nuk e di ç'i duhet një teatri për të qenë teatër. I pranishëm në sallë ishte dhe zëvendëskryeministri Niko Pelleshi, ish-kryebashkiaku i Korçës të cilin drejtoresha e Teatrit të Shkodrës Rita Gjeka, e vuri para aktit të kryer ngaqë publikisht e denoncoi bisedën e mëhershme me të kur i kishte premtuar se do ta ndihmonin dhe Teatrin e Shkodrës për rikonstruksion. Ja, kështu bëhen këto punë.
E para, zgjidhni një të profesionit për udhëheqje teatri dhe e dyta, le të jenë femra të zgjuara si Zamira dhe Rita që punojnë me përzemërsi pa nevojë përfitimesh materiale. Në natën e fundit të festivalit publiku dhe gjithë pjesëmarrësit e shfaqjeve garuese prisnin në ethe vendimin e jurisë, të përbërë nga emra të mëdhenj aktorësh si: Ndriçim Xhepa, Yllka Mujo, Refet Abazi, Bujar Lako e Ema Andrea. Juria njëzëri vendosi që pothuajse të gjitha çmimet t'ia ndanin shfaqjes „Shërbetori i dy zotërinjve" të Teatrit të Prizrenit, e cila u shpall edhe shfaqja më e mirë e festivalit. Po ashtu edhe regjisorit që e kishte vënë në skenë këtë vepër, Kushtrim Bekteshit nga Shkupi iu nda çmimi për regjinë më të mirë. Për aktorët e mrekullueshëm të kësaj shfaqjeje shkuan edhe katër çmime tjera, edhe atë për: Ernest Malazogun (aktori më i mirë në rolin kryesor), Xhejlane Tërbunjën (aktorja më e mirë në rolin kryesor), Muhamed Arifin (aktori më i mirë në rol dytësor) dhe Hajat Toçillën (artistja e re më e mirë). Dy çmime të tjera shkuan për aktorët Rita Gjeka (aktorja më e mirë në rol dytësor) dhe Nikolin Fërketa (për artistin e ri më të mirë), që të dy aktorë në shfaqjen "Danimarka – toka jonë" të teatrit "Migjeni" të Shkodrës. Juria ndau edhe një çmim special për Niki Petritin, për kompozimin e kolonës zanore në shfaqjen "Doktor Shuster" të teatrit "Andon Zako Çajupi" të Korçës, shfaqje kjo e përgatitur nga regjisori nga Qëndrim Rijani nga Kërçova. Pra, gjithsejt nëntë shfaqje ishin në zemër të trupit shqiptar.
Pasi përfundojnë emocionet e përzgjedhjes mes gjithë asaj dyndjeje, takon njërëz nga krejt qytetet shqiptare dhe më pas vjen festa me miq, me kitarë, diku afër bulevardit "Republika". Një rrëqethje, një ndjesi e rrallë. Ky ishte bashkimi, ajo ëndrra e kahmotshme shqiptare që ndodhte brenda një ëndrre me emrin Korçë. Mikel Bica një këngëtar korçar me dy të tjerë na shtruan pak serenata „nga shtëpia" si mikëpritës që dinë të jenë, dhe natyrisht asnjë korçar nuk të lë të largohesh pa e dashur atë qytet magjik ku përherë lë diçka prej vetes, diçka të rëndësishme që do të të bëjë të kthehesh e ta kërkosh.
Kapaku i mbrëmjes ishte kur filluan këngët për Prishtinën që pak i njihnin andej, dhe ca këngë që ata i këndonin dhe që ne të këtej kufijve pak i njihnim. Zëri na shkonte për mrekulli bashkë, por çka të këndonim kur pak ishim dëgjuar, fare pak ishim njohur e shumë e kishim dashur bashkimin pa bërë gjë për të. Ajo tavolinë fliste shumë, një komedi e zezë po luhej jashtë garës së madhe të skenës. Por, sakaq, kitara i nxori ca tinguj qe paralajmëronin atë këngën që u këndua njëzëri "Dua më shumë Shqipërinë…". Oh perëndi! Nuk e imagjinoni dot! Zërat vinin prej gjithandej, nga shkallët si në teatrot antikë, nga e majta – e djathta, lart- poshtë, një zë hyjnor shquhej në tymin e duhanit që ngjante me retë ballkanike, ishte zëri i Kelit. Ndryshe kishim dashururar gjithçka, ne vinim nga qytete pa serenata, po kur përmendet Shqipëria bëhemi një zë, një gojë, e duam siç dashurohet nga malli, siç nuk e kanë dashur ata që përherë e kanë pasur, që kurrë nuk iu ka munguar. Tashmë fjalët mjegullojnë në retë ballkanike, nuk mundem asgjë, s'mundem ta trupëzoj atë ndjesi të atyre netëve korçare. Vetëm u përpoqa më kot. Asaj mbrëmjeje isha lodhur duke pirë, dehja filloi që

në momentin e krekosjes në kalimin kufitar Qafëthanë ku përherë tregoj vetëm kartën e identitetit dhe pëshpëris “Në djall kufijtë!”. Atje shemben ata. Shkoni në Korçë më mirë! Shkoni në shtator kur mbahet Koko Fest-i dhe keni për të parë për çfarë po ju flas.

*Botuar më: 19 shtator 2016*

# Ngashërim në vargje nga krahjeta e babait

*Mbresë nga leximi i vëllimit me poezi "Nga mështeknaja e babait me mallëngjim" të Linditë Ahmetit*

*Vjollcë Berisha*

Ky është zëri kumbues që përshëndet nga qendra e botës së ndjeshmërisë krijuese, nga mështeknaja e babait, prej nga të gjitha zërat tringëllojnë mallëngjyeshëm, ku banon uni lirik që i përshkon athshëm e plot vjeshtë, si në dizë gështenjash, të gjitha poezitë e këtij vëllimi, që vjen si kartolinë e gjatë dërguar me entuziazmin e atij që sapo ka bërë shëtitjen më mbresëlënëse në botë e herë si harlisja e ëmbël e atij që ka degdisur në strehën e sigurt ku banon dashuria e vërtetë, në lirishtë, në kullën e vogël prej fildishi, të rrethuar me lule Iris Illyrica.

Jehona lirike që përhapet në këtë vëllim poetik është nga të rrallët tinguj që kanë prerë biletë kthyese: herë thithet nga lexuesi si mesazh unik, plot dhimbje e drithmë, që vjen nga mështeknaja ku priten dy ndjeshmëri krijuesish, dy jetë artistësh, dy talente që e ushqejnë njëra-tjetrën për ta mrekulluar akëcilin lexues me thellësinë e mendimit dhe bukurinë e fjalës. Është kjo pikëprerja që e nxjerr mështeknajën nga të qenit atdhe i një babai të rëndomtë. Herë kjo jehonë përthithet nga lexuesi, jo si zë nga mështeknaja, por si një udhëtim i jashtëzakonshëm në të, në prillin që vlon gjithandej, në Erosin që thithet si frymë, ku të bëhet që i dëgjon hapat e tu tek kërcasin mbi gjethe me frikën se mos zgjohet trishtimi i shtrirë nën to, ku të bëhet se pas pak do t'i trembësh zogjtë në degë të mështeknës, ku, siç ndodh përherë në krijimtarinë e Linditës, të duket se po rend në lashtësi, në figurat mitike, në shtresat më të sigurta të etnisë dhe qytetërimit evropian.

Ky vëllim poezish lexohet si një metaforë gjigante e dhembjes, vetmisë krijuese, ndjeshmërisë, e kushteve për jetë të Muzës, që edhe në këtë libër qe tejet bujare me këtë krijuese të talentuar.

Leximi i këtij libri nuk të bën të jesh thjesht një turiste kureshtare ndaj një vendi atraktiv, por të ngjitet si dyll derisa t'i biesh kryqetërthor mështeknajës, pyllit të dendur, mikrouniversit ku zotërojnë ligje të tjera, të vjetra, gjysmëhyjnore, ku janë përshkruar me një planimetri të saktë të gjithë banorët e pyllit, ku bën vjeshtë e përhershme edhe kur është prill, ku Eoli fryen dhe ndërron kaptinën që s'dallon dhe aq nga ajo paraprakja.

Rrekja për ta studiuar këtë vepër me rregullat e prera të cilësdo metodë klasike letrare është një punë e huqur që në fillim, pasi llupa që do ta zmadhonte thelbin e tij duhet të jetë nga arka e instrumenteve me të cilat i kemi parë përrallat, elementet fantastike në letërsi, shtresat mitologjike. Së këndejmi, studiuesi i kësaj vepre domosdo të bëhet gati për një interpretim ku do t'i shkasin duarsh mjetet bazë me të cilat është mësuar t'ia mësyjë një vepre. Në radhë të parë do t'i pështjellet koncepti i kohës, jo vetëm i saktësimit të ngjarjes, por i shpejtësisë së rrjedhës, që herë duket se shtrihet brenda një nate të vetme, kur subjekti lirik pret Eonë që të dalë nga terri i mundimshëm, herë si një sekondë shikimi

nga frëngjitë e kullës në mështeknajë, e herë si shekuj të gjatë që prekin në një kohë mitike, ku pylli s'është pyll i Kësulëkuqes lozonjare, i ujkut dhe shtëpisë së gjyshes, por është pyll i nimfave, hyjnive, insekteve, kandrrave, merimangave, kaçubave, zogjve, barit të qumështit, luleve Iris Illyrica dhe i një duzine qeniesh që e popullojnë atë e që janë larg shikimit të rëndomtë të një njeriu të zakonshëm.
I gjithë libri pulson nga dëshira për të bërtitur, për ta braktisur pyllin dhe në rastet më të rënda kur subjekti lirik flet nga brenda trungut plot insekte që hanë, prapë se prapë një dritë e hollë futet dhe e ndriçon pyllin, prill është në kalendarin e botës, por vjeshtë e përhershme bën në mështeknajë.
Në të gjithë atmosferën që i ngjet një ëndrre, me personazhet e Olimpit, ku edhe subjekti lirik vetë është një Driadë në zemër të pyllit, shfaqet një personazh prej mishi e gjaku, një personazh i rrokshëm: Babai. Hapat e tij në mështeknajë e bëjnë prej vërteti hapësirën, i tutin shpirtrat dëmtorë. Kjo është prania më reale në vepër, e kudondodhshme, fryma që i kupton, i di të gjitha dhe endet padiktueshëm, me përpjekjen për të krijuar situata të reja, dalldisëse që e largojnë mendjen nga dhimbja e pyllit, "babait i intereson bukuria e mështeknajës, thotë poetja, por, "ndonëse babai shpërndan ëndrrën e bukur në këtë/ mbretëri magjepsëse si gjithmonë/ bota e pyllit ka rendin e vet."
Vatra kuptimore FRIKË merr në këtë vepër një nuancë tjetër që s'i përgjigjet shqetësimit nga një e keqe që mund të vijë dhe masave që merren për mbrojtjen nga ajo. Këtu frika ka të bëjë me ikjen, me braktisjen. Midis dy qenieve atë e bijë është FRIKA, jo frika e zakonshme fëmijërore nga autoriteti i babës, por frika e mungesës, e humbjes.
Frika që vjen e cytur nga bota mashkullore (Babai, Miku, djaloshi fqinj dhe emëruesi i përbashkët: Hermesi) gjithnjë ka po këtë kuptim të dytë, këtë kuptim që ia dhanë ikjet e që ia mësuan subjektit lirik mënyrën sublime të qëndrimit vetë përballë Erosit.
Erosi, një nga elementet më të vështira për trajtim në poezi, pa rënë në rëndomësi dhe në shpërthim ndjenjash apo ornamentikë të tepruar, në poezinë e Lindita Ahmetit shfaqet i kompletuar, fqinjëson me hyjnoren, aq sa të krijon përshtypjen që janë zotat ata që po goditen nga shigjeta e Erosit, janë hyjnitë ata që po dashurojnë. Kjo qasje e ngrit poezinë e Linditës në fuqinë e një epi, në paprekshmërinë e rrëfimeve mitologjike. Edhe në situatat më romantike poetja nuk i përkëdhel ndjenjat, por i trondit ato. "Një tërmet i vogël ndodh në botën e nimfës kur shigjeta e Erosit bie në supin e saj", thotë Lindita.
Edhe pengesat që dalin para dashurisë janë të po këtij niveli. Mikun të cilit i dedikohet letra nga mështeknaja e kanë zënë peng forcat që ia shkojnë njeriut, është peng zotash, ndoshta një peng Hadi, gjë që e bën këtë libër të zgjatet prapë midis dy shtyllash tematike universale që i falin përjetësinë librit, siç janë Erosi dhe Tanatosi. Edhe pritja, kërkimi, pikëllimi janë përtejnjerëzore, janë lufta e pabarabartë dhe a priori e humbur karshi Hadit. Megjithatë, subjekti lirik i poezive, siç duket, shijon pritjen deri në pikën e fundit, pasi bota e ndjeshme merr kënaqësinë që i duhet edhe nga gjërat që s'vijnë, nga gjërat që lehtësisht bëhen brumë i veprave të ardhshme letrare.
Mështeknaja është shëtitja magjepsëse që e bën këtë vëllim poezish një poemë të pritjes me të gjitha nuancat e saj. Është ky toponimi më origjinal i sajuar nga kjo poete e talentuar, që shënjon njëherësh strehën ku fshihet nga për-

ditshmëria dhe botën e letërsisë, krijimtarisë, botën e metaforave, studion e babait që është prona e përbashkët e dy krijuesve, dhe, nga ana tjetër, jo rrallë, personifiikimin e dhimbjes, pritjes, asgjësë, prej nga shpesh dalin në poezi cilësorët: pyll nëmur, pyll që kridhet në vetmi, por edhe pyll i butë, mështeknajë e shenjtë etj.
Nisur nga kjo mund të sjellim përfundimin që Mështeknaja është atdheu i trishtimit dhe prehjes njëkohësisht, është vendi që të bën ta urresh dhe të të marrë malli njëkohësisht, është bashkëjetesa e hyjnive me kandrrat, nimfave me kaçubat e marimangat vejushë. Mështeknaja është toponimi më origjinal i krijuar në letërsinë shqipe, një vend që mbase ekziston thellë në ndërgjegjen e poetes, apo është pikëprerja e botëve të dy artistëve atë e bijë, që mund të ndajnë gjithçka e mund ta ujisin pa fund njëri-tjetrin mu si në vargjet kushtuar njërës nga figurat kryesore të librit, lules Iris Illyrica:

*Iris ilirica*
*Ne ujitemi ndërsjelltazi*
*e mbetemi gjallë.*

Ky libër që tani ka zënë kryevendin ndër vëllimet që janë botuar dhjetë vitet e fundit në hapësirën tonë kulturore. Strukturimi i veçantë, rimarrja e motiveve në të gjitha poezitë (që më pëlqen t'i quaj këngë), bartja e personazheve, madje edhe vargjeve, e bën këtë libër të vijë ndryshe jo vetëm përballë veprave të autorëve të tjerë, por edhe përballë krijimtarisë së vetë poetes. Unë e përjetoj si një zhanër të ndërmjetëm midis këngës, poezisë lirike, prozës poetike dhe letërkëmbimit më lirik të mundshëm. Ndonëse dy letrat poetike, që e mbështjellin si një ambalazh melankolik librin, janë shkruar në prill, mua më vjen se dëgjoj kërcitjen e gjetheve të vjeshtës gjithandej.
Lindita është një poete e vetëdijshme për mjetet e punës së saj dhe për vlerën e tyre. Kur them mjetet, kam parasysh mjetin kryesor të shkrimtarit, gjuhën. Ajo është një kërkuese fanatike në gjuhë, prandaj fjalitë e saj tingëllojnë aq shqip, neologjizmat e saj janë shumë në numër dhe figurat e veçanta jo rrallë i formon nga kombinime të reja fjalësh që paraqesin, veç të tjerash, edhe prurje për leksikografinë tonë. Bien në sy tri poezi të shkallës eksperimentale, por që ia kanë dalë mbanë shumë mirë, ku përmes aliteracionit në një faqe të plotë libri, arrin ta ruajë kuptimin, ndjeshmërinë dhe lidhjen e poezive me njëra-tjetrën. Janë këto tekste që mund t'i interesonin edhe një gjuhëtari të kujdesshëm e që paraqesin një pasuri edhe për fondin tonë të fjalëve. E për historinë tonë të letërsisë është pa dyshim një nga prurjet më mbresëlënëse, një nga veprat kanonike të ardhshme, që do ta zërë vendin e merituar në fondin e letërsisë shqipe.

*Shënim: Titulli është i redaksisë.*

*Botuar më: 27 dhjetor 2016*

# PËRKOQISJE LETRARE

# Tash po nisemi

*Jusuf Gërvalla*

Tash po nisemi në mundshim të heshtim pak
E të flemë. Po jemi lodhur. Këmbët të ënjtura
Nën tryezë. Koka që rëndon. Aspirinë?
Tash po nisemi? U bë vonë. Edhe ylli i fundit
Ra përmbi tryezë.
Jemi bërë si planeti që kërkon ta pranojnë
Si palaço të punojë
Në cirkun e verdhë.
Unë hënë e zbehtë ai diell i zjarrtë
-që të dy prej letrës së verdhë-
Që me nesër na pret takim' i ri, bisedat për shëndetin
Dashurinë, poezinë.
E mbaruam bisedën mbi sëmundjen e poetit shëndetlig
-të ngrihemi, u bë vonë në këtë tavernë
Vetëm tym duhani e fjalë që shkëlqejnë
Prej fjalësh të pathëna
Dhe prej mëlçisë së zezë.
Shtrati i madh nën një çati diku do të ftohet
Në pritjen e vet
Rrugicat e përgjumura ritmin e mugën dritareve
Të fikura derdhin kot
Si një pikë në det
Jemi si yje
Në qiell.
Tash po nisemi në mundshim të heshtim pak
Dashuria s'është ilaç as helm.
Me kokën time e krijoj
Me duart e mia dhe eci nëpër planet.
Natën e mirë:
Mua më duhet të shkoj atje prej nga mund t'ju gjej.

# S'kemi pasur vetëm orë të mira

*Vjollcë Berisha*

Nuk kemi pasur vetëm orë të mira, i dashur.
A s'të bie ndërmend si e çartëm ndonjë ditë
Si ia ngritëm flokët përpjetë
E bëmë t'i grithë faqet e veta?!
Si i futëm disa orë të jetës në një park lodrash
I rrotulluam derisa ua morëm mendtë
Pastaj i lëshuam të ecnin të lira
Dhe fshehtazi u zbavitëm me rënie-ngritjet e tyre?!

A s'të bie ndërmend, i dashur, si e kryqëzuam natën
Dhe s'deshëm t'ia dinim
Kur i kaluam kaq orë në të njëjtën dhomë
Pa u përqafuar.
Si e detyruam lëkurën të bëjë jetë asketi për javë të tëra
Dhe qeshëm kur ajo vuante?!

U grindëm, i dashur, dëshirës ia mbyllëm me dorë
Gojën dhe hundën derisa dha shpirt.
Pastaj e qamë.
Pastaj u mësuam ta ringjallim.
E deshëm, e mbajtëm mirë,
Pa erdhën ato ditë të lojtura, u grindëm, e vdiqëm.

Nuk kemi pasur vetëm orë të mira, i dashur.

# Pasaporta

*Agim Vinca*

Ma morën pasaportën.
Më thanë: ke qenë në Shqipëri.
Po, kam qenë, u thashë.
Pa vizë dalëse, më thanë.
Pa vizë dalëse, u thashë.
Ja vula «Qafasan», më thanë.
Qafëthanë, u thashë.
Më pyetën për arsyet.
Kam njëqind sosh, u thashë.
Kaq.
Më bënë gjyq.
E më dënuan paq.
Pastaj më morën në burg
e më futën në qeli.
Dhjetë ditë e dhjetë net rresht.
Që të vë mend, sigurisht.
Por, kot. Kot e kanë.
Gjykatës, policë e ç'janë.
Se unë, përsëri,
Ngado që të nisem do të arrij tek ti
Rrugë tjetër s'di
Shqipëri!

*Vorea Ujko (1918-1989)*

# Këngë arbëreshe

I
Ti vjen nga deti i kaltër
e sell në sy
qiej të largët.
Ti vjen nga toka
ku fjalët janë të lashta
posi zakonet e valleve
bujare si gjaku yt
t'ëmbla si mallëngjimi
të ngurta si puna jote.
Ti jeton dhe ecën
Dhe nuk çuditesh
Se të lindin në gojë
Si lule ë mëngjes.
Ti nuk thua fjalë.

III
Ti vjen nga toka
që askush s zotëroi.
Ti je si gur lumi
ku shket stuhia,
i rrahur si deti
i tronditur si toka.
unë i njoh stinët e tua:
një stinë e shkëlqyer
lufta e gjatë
kur e vetme dhelkë –
shpata jote në dorë.
një stinë e gjatë
errësira dhe heshtja.
Ti je mal e lodër lufte.

VI
U nise menatet
me këndimin e gjelit
e u ktheve mbrëmanet
me vajtimin e kukuvajkës.
E gjithmonë shijet e tokës
e ti i buzëqeshur shortës.

VII
Fryma jote dhe gjaku

kanë shijen e tokës
fryma jote e gjaku
kanë shijn e lisave
fryma jote dhe gjaku
kanë shijen e maleve
kanë shijen e luftës.
Ti lirove tokën
vetëm për të luftuar
ne gjithmonë luftuam
pse kemi lerë për luftën
dhe luftën e kemi në gjak.

X
Një agim i madh të pret
e do të gjesh fjalët
që tash nuk i thua.
Do të jesh një agim i kthjellët
e gjithçka do të këndojë në diell.
Vreshta, lumi, shtëpia
zemra jote e fryjtur
do të këndojë në diell.
Ti je rrënjë e fortë
e ushtria jote s'ka ushtarë
pse janë të gjithë kapidanë
Tungjatjeta, more vëlla.

# Arbëreshi në Ulqin

Dëgjoj muzikën e natës
kur suvala ra
çdo ngjyrë u shua
e hëna u përul
mbrapa lisave.
Këtu unë s'kam shtëpi
dhe nuk ndihem i huaj.
Në ballë do ta puthja
vashën që troket në derë
dhe pyet në gjuhën time
nëse dëshiroj kafe.
Ndoshta ajo mendon
se gjuhën e kam nxënë
për udhëtim nëpër botë
dhe nuk e di fshetësinë
që çelet nga gjaku.

# GJË(RA)EGJËZA

# Pangrami shqip

*Mensur Mamuti*

*GËNJEU RRETH ZGJEDHJEVE E U ZHDUK SA IU LEXUA QËLLIMI YNË, FUSHATA: "EC, HIÇ PA B0RXHE".*

PANGRAMI është fjali holoalfabetike, apo fjalia e formuar me përdorimin e të gjitha shkronjave të alfabetit, të paktën një herë. Fjala PANGRAM rrjedh nga greqishtja dhe përbëhet nga dy fjalë:pan – çdo dhe gramma – shkronjë. Gjatësia e pangrameve varet nga numri i shkronjave të një alfabeti. Për dallim nga gjuhët tjera, alfabeti ynë përmban tridhjetë e gjashtë shkronja, prandaj pangrami i ndërtuar në gjuhën shqipe është më i vështirë dhe si rrjedhojë e saj, fjalia është më e gjatë.
Pangrami më i njohur, pa dyshim, është ai në gjuhën angleze:

"THE QUICK BROWN FOX JUMPS OVER THE LAZY DOG".

Pangrami i mëposhtëm, i sjellë për herë të parë në PanAlbanica është shtatëdhjetë e dy shkronjësh ka të bëjë me zgjedhjet:

"GËNJEU RRETH ZGJEDHJEVE E U ZHDUK SA IU LEXUA QËLLIMI YNË, FUSHATA: "EC, HIÇ PA BORXHE".

Pangrami i vetëm që është hasur në gjuhën shqipe në internet, është ai i përbërë nga njëqind e njëmbëdhjetë shkronja, i botuar në vitin 2011 nga një autor me emrin Fatos:

"ZHAPIKU I GJELBËR NJOMZAK NGA SHPORTA E VJETËR PREJ XUNKTHI U HODH SI RRUFE NË QIELL TË PASTËR, PRANË CA DRUVE TË ÇARË E XHAMAVE TË THYER".

Kjo mund të jetë edhe një ide që fjala pangram, e cila nuk ekziston në fjalorin tonë, të përfshihet në të, si një fjalë e re.

*Botuar më: 25 mars 2016*

# Rebusi

*Mensur Mamuti*

Është e njohur anekdota për Volterin dhe Fridrikun e Madh. Ata të dy i dërgonin njëri- tjetrit porosi me rebuse.

Jeta është rebus.
Planifikimet, pritjet dhe ëndrrat, janë rebus për çdo moshë. Dallimi është te akti; rinia gjendet para aktit të veprimeve, ndërsa më të moshuarit, para aktit të kryer.
Të parët pyeten SI të veprojnë, ndërsa të dytët SI është dashur të veprojnë.
Truri është ai i cili gjithmonë në kërkim të zgjidhjes, ndërsa pikëpyetja është ajo që e ngacmon trurin.
Jeta, me të vërtetë, është rebus dhe ne jemi elementet e tij.
Ç'është, në të vërtetë, rebusi?
Rebusi është një lloj gjëze, e cila jepet me anë të imazheve. Fotografia, shenjat, numrat apo shkronjat janë elementet e rebusit.
Me zgjidhjen e rebusit fitohet një fjalë ose fjali.
Fjala rebus rrjedh nga latinishtja rebus (shumësi i fjalës res ("gjë")).
Fjalori i gjuhës shqipe (www.fjalori.shkenca.org/), thotë kështu:

REBUS m. libr.

Gjëegjëzë, në të cilën paraqitet me vizatime, me shifra, me shkronja a me shenja të tjera një fjali ose një shprehje, që duhet gjetur. Rebus numrash. Zgjidhja e rebusit.
2. fig. Diçka me përmbajtje të ngatërruar e të pakuptueshme, që duhet zgjidhur; diçka e vështirë për ta zbërthyer a për ta kuptuar.

Nuk dihet me saktësi kur është paraqitur rebusi i parë. Në Greqinë dhe Romën e lashtë janë kalitur monedha me rebuse me figura njerëzish dhe qytetesh të rëndësishëm.

Mendohet se fjala rebus rrjedh nga shekulli XV dhe është marrë:
ose nga fraza e Picardie-ut de rebus quaeferuntur, e përdorur në një gjëzë satirike, që do të thotë "në lidhje me gjërat që po ndodhin",
ose nga fraza verbissed rebus, që do të thotë "jo me fjalë, por me gjëra (vepra)".

Është e njohur anekdota për Volterin dhe Fridrikun e Madh. Ata të dy i dërgonin njëri- tjetrit porosi me rebuse. Më poshtë është vizatimi i Fridrikut, dërguar Volterit:




Figurat në këtë rebus (në frengjisht) paraqesin: Deuxmains (dy duar) sous (nën) p (kjo në frengjisht lexohet "pé") à (në) cent (qind) sousscie (nën sharrë). Kështu, zgjidhja e rebusit është: Demainsouper à Sanssouci? (Nesër në darkë në Sansusi?)

Ndërsa përgjigja e Volterit ka qenë: Ga!

Ga! paraqet rebus shkronjash, i cili zbërthehet në Gé grand, A petit! (G e madhe, a e vogël). Kjo e jep zgjidhjen J'ai grand appétit! (Kam apetit (oreks) të madh!). Sot, rebuset i hasim në revista e gazeta të ndryshme, si detyra për të kaluar kohën e lirë.
Rebusi shembull:
(5,1,?)

Zgjidhja:

Figurat në këtë rebus janë: PATATE E GRA.
Kllapat mbi rebus tregojnë gjatësinë e fjalëve të zgjidhjes. 5 = patate, 1=e, 3=gra. Kështu, zgjidhja e rebusit paraqet veprën e Fatos Arapit "Patat e egra".

Në tekstin e radhës do të njihemi me elementet e rebusit, llojet dhe rregullat si zgjidhen çdonjëra nga to.

*Botuar më: 25 prill 2016*

# Elementet e rebusit

*MensurMamuti*

Rebuset paraqiten me anë të imazheve. Çdo imazh paraqet një pjesë të zgjidhjes.
Imazhet, zakonisht radhiten nga e majta në të djathtë, mirëpo ka edhe raste kur radhitja është e kundërt (rebusi palindrom). Në rastet e tilla imazhet lexohen drejt, ndërsa zgjidhja e rebusit bëhet nga ana e kundërt (lexohet së prapthi).
Mbi çdo rebus, në kllapa, gjenden numra (një apo më tepër), të ndara me presje; p.sh. (3,4). Kjo do të thotë se rebusi përbëhet prej dy fjalëve: fjala e parë përmban 3 ndërsa e dyta 4 shkronja.
Nëse në rebus paraqiten dy fotografi të njëjta, atëherë fjala që kërkohet është në shumës.
Në rastet kur nuk ka mundësi të fitohet rebus nga emrat e plotë të imazheve, atëherë mund të hiqen disa shkronja, edhe atë në fillim ose në fund të fjalës përkatëse.
Në rastet e tilla vendohet apostrofi, varësisht nga vendi ku hiqen shkronjat (para apo në fund të fjalës) dhe nga numri i shkronjave të hequra (për një shkronjë vendohet një apostrof, për dy shkronja, dy apostrofë…)
Nuk është e pëlqyeshme të vendosen shumë apostrofë.
Për rebuset e vështira vizatohen kutiza ndihmëse për shënim të zgjidhjes së rebusit.
Ka raste kur, bashkë me rebusin, jepet çelësi numerik ndihmës. Numrat e paraqitur te çelësi e tregojnë gjatësinë e fjalës (së imazhit) përkatëse.
Fotografitë, në rebus, mund të paraqiten në disa mënyra: mund të jepet vetëm fotografia dhe të kërkohet emri e mbiemri i personazhit, vetëm emri, vetëm mbiemri apo nofka e tij.

Zgjidhja e rebusit:

(lo)PË – LL – U MBI A – K – ROB – AT = PËLLUMBI AKROBAT
Rebusi në fotografi është i kombinuar me shkronja, apostrofë dhe figura. Poashtu, përveç kllapave ndihmëse, janë përfshirë edhe kutizat dhe çelësat ndihmës.
Figurat mund të kenë sinonime. P.sh. te rebusi i dhënë, termi që kërkohet është rob, mirëpo në rebuse tjera, atë mund ta emërojmë edhe si: i robëruar, peng, me

pranga…
Figurat mund të kenë interpretime të ndryshme. P.sh. shenjën "+" mund ta përdorim si: plus, e, edhe, dhe, me. E njëjta vlen edhe për shenjat tjera të pikësimit. Gjatë përpilimit të rebuseve, veçanërisht të atyre me shkronja, mund të përdoren foljet, parafjalët, lidhëzat dhe pjesëzat (është, janë, në, nën, mbi, me, pa, për, pranë, sipër, lart, poshtë, anash. si, ka, s'ka…).

*Botuar më: 14 maj 2016*

# Llojet e rebuseve

*Mensur Mamuti*

Rebuset mund të paraqiten në më tepër lloje dhe secili nga to i ka rregullat e veta të zgjidhjes.

*Rebusi anagramor*

Te rebusi anagramor, së pari zbulohen figurat, pastaj me shkronjat e atyre fjalëve formohen fjalë të reja.
Për ndihmë, zakonisht jepet çelësi numerik i figurave (fraza), që tregon gjatësinë e emërtimit të figurës si dhe çelësi i anagramit, që tregon radhitjen e shkronjave që merren nga figura.




**Fraza:**
4 (GJAHU). GJ=1, A=2, H=3, U=4.
1 (I). I=5
4 (PESHQ). P=6, E=7, SH=8, Q=9.

**Zgjidhja: GJUHA SHQIPE**
1 (GJ), 4 (U), 3 (H), 2 (A), 8 (SH), 9 )Q), 5 (I), 6 (P), 7 (E).

*Rebusi përshkrues*

Te ky lloj i rebusit problemi përshkruhet me fjalë dhe jo nëpërmjet të imazheve. Rebusi përshkrues shpesh paraqitet me vargje anagramore.

Zgjidhja: **DASHURIA**
trim delesh – **DASH**, barku bosh – **URIA** = sevdaja – **DASHURIA**

## *Rebusi palindrom*

Te ky lloj i rebusit, figurat e dhëna lexohen drejt, ndërsa zgjidhja lexohet nga prapa (nga e djathta në të majtë).
Te rebusi palindrom nuk vlen rregulli i fjalëve (fjalive) palindrome, ku fjala apo fjalia lexohet njëjtë në të dyja anët.




Fraza: **AR, TEL**
Zgjidhja: **LETRA**

## *Rarebusi*

Zgjidhja e rarebusit bëhet me përdorimin e apostrofeve.
Prej fjalëve të fituara nga figurat e dhëna, hiqen po aq shkronja sa është numri i apostrofeve. Pastaj, shkronjat e hequra grupohen dhe shënohen në fund të zgjidhjes, të cilat, lexuar bashkë me grupin e shkronjave të mbetura, e japin zgjidhjen.




Fraza: **KAL(i), OR(a)**
Zgjidhja: **KALORia**

*Rebusoidi*

Rebusoidi është i ngjashëm me rarebusin. Dallimi qëndron te renditja e fjalëve të hequra nga figura. Këtu shkronjat nuk grupohen, por radhiten menjëherë pas fjalës, nga e cila janë hequr ato shkronja.

Fraza: **RA(ma), NA(to)**
Zgjidhja: **maRAtoNA**

*Rebus shkronjash*

Rebusi i krijuar vetëm me përdorimin e shkronjave quhet Rebus shkronjash. Zgjidhja e këtij lloji të rebusit fitohet nga interpretimi i marrëdhënieve në mes të shkronjave. Në rebuset e tilla rol të rëndësishëm luajnë parafjalët: në, mbi, nën, për, te…




**Zgjidhja e rebuseve:**

1. n'X (është) Ë, n'Ë (është) S = NXËNËS
2. n'X (është) Ë, n'Ë (është)S, I = NXËNËSI

*Botuar më: 29 nentor 2016*

# Pangrami i përkryer

*Mensur Mamuti*

*DHELPRA CUBË FUTEJ ZVARRË NË QULL XEHESH ME GJETHE. Ç'U ZHGËNJYE, D0 SUXHUK.*

Në tekstin paraprak thamë që pangrami është përpilimi i një fjalie me përdorimin e të gjitha shkronjave të alfabetit të paktën një herë (zanoret), ndërsa bashkëtingëlloret vetëm nga një herë.
Pangrami është gjimnastikë e vërtetë për trurin. Me ngacmim të 'proceseve të fjetura' të trurit mund të fitohen fjali interesante.
Pangram i përkryer quhet anagrami i alfabetit; përdorimi i të gjitha shkronjave vetëm nga një herë. Mirëpo, për shkak të disproporcionit në relacionin bash-këtingëllore – zanore (29:7), kjo gjë është e pamundur. Prandaj është i lejuar përdorimi i zanoreve më shumë herë.
Pangram i mirë është fjalia (që ka kuptim) e formuar me numër sa më të vogël të shkronjave. Mirëpo kjo nuk merret parasysh në raste kur fjalia, edhe pse ka më tepër shkronja, është më mirë e formuluar.
Pangrami i mëposhtëm, ashtu si ai i anglishtes: "THE QUICK BROWN FOX JUMPS OVER THE LAZY DOG", protagonist e ka poashtu dhelprën.
Fjalia përmban 51 shkronja dhe është pangrami më i shkurtër në gjuhën shqipe deri tani.

Ju propozojmë lexuesve që të formojnë pangrame dhe t'i dërgojnë në adresën tonë.

*Botuar më: 6 dhjetor 2016*

# SPORT

# Historiku i futbollit dhe topi në Tetovë

*Bujar Sinani*

Futbolli është një lojë, e cila na preokupon gjatë tërë kohës. Nuk duhen bërë analiza të thella për të arritur tek përfundimi se ky sport na ka bërë për vete dhe kjo lojë sa na dëshpëron, aq edhe na ngazëllen dhe na lumturon.

Po, ku e ka zanafillën e vet futbolli? Cili është vendi ku kanë filluar të luajnë për herë të parë? Ku janë tetovarët në këtë mes? Kur dhe kush kanë qenë të parët, të cilët e kanë gjuajtur topin e futbollit në Tetovë? Fillimisht supozohej se ishte Anglia vendi ku ka lindur futbolli. Megjithatë, hulumtimet e mëvonshme zbuluan fakte, të cilat hodhën dyshim mbi idenë se kanë qenë anglezët ata të cilët e kanë shpikur të parët futbollin. Sipas një versioni francez, fillet e futbollit e afrojnë këtë lojë me ragbin, fillet e të cilit janë gjetur në Francë. Ata të cilët u munduan t'i gjejnë gjurmët e futbollit, të cilat çonin prapa në shekullin e mesëm, vërtetuan se futbolli ka qenë një lojë me të cilën janë marrë edhe grekët e vjetër, edhe romakët e vjetër… madje edhe kinezët qysh para erës së re.

Pa marrë parasysh se disa provinca franceze janë munduar të dëshmojnë se futbolli së pari ka filluar të luhet tek ta, kjo e drejtë i takon Normandisë. Në fakt, loja të cilën e kanë luajtur normanët ka qenë shumë e ashpër. Nëpër fshatra, ata e kanë gjuajtur topin dhe kanë luajtur aq ashpër, saqë nuk kanë pasur kujdes për pasojat, të cilat shpeshherë kanë qenë dhëmbë, brinjë apo edhe gjymtyrë të thyera. Kjo, ka qenë arsyeja për të cilën është shpallur e ndaluar.

*Të dhënat flasin se topi i parë në Tetovë është sjellë diku në vitin 1916, kurse klubi i parë i futbollit shqiptar është themeluar në vitin 1941, me emrin "Skënderbeu."*

Megjithatë, janë anglezët ata të cilët I kanë shënimet dhe të dhënat më të vjetra për futbollin. Ai është bërë aq popullor, saqë është praktikuar rregullisht nëpër festa dhe organizime të ndryshme lokale. Me kalimin e kohës, futbolli është bërë më pak agresiv. Anglezët kanë qenë të parët, të cilët e kanë organizuar futbollin modern, ashtu siç e njohim ne sot. Shoqata e parë futbollistike është formuar në Angli në vitin 1855. Ky ka qenë ekipi futbollistik "Sheffield". Viteve në vijim, klube apo ekipe futbolli janë formuar edhe në shtete të tjera të Evropës. Njëzet vjet pas Anglisë, klube futbolli janë formuar në Holandë, pastaj në Danimarkë, në vitin 1822 në Zvicër, ndërsa tri vite më vonë në Gjermani, ndërsa në vitin 1890 në Çekosllovaki. Ekipi i parë futbollostik në Austri është formuar në vitin 1894. Duke e ndjekur këtë ritëm, futbolli arrin edhe në vendet e Ballkanit.

Të dhënat flasin se topi i parë në Tetovë është sjellë diku në vitin 1916. Që atëherë të rinjtë kanë filluar ta gjuajnë topin dhe viteve në vijim

janë formuar edhe klube futbollistike, ndërsa si klub i parë i futbollit përmendet Luboteni, i cili e ka marrë emrin nga maja e Malit Sharr. Më vonë janë formuar edhe klube të tjera në nivel rajonal dhe lokal.
Asokohe, shqiptarët kanë pasur qasje të kufizuar në klubet ekzistuese, të cilët janë themeluar nga ana e maqedonasve. Fakti se kanë qenë të diskriminuar dhe se është dashur të përmbushin disa nevoja elementare jetësore, përpara se të merren me sport, nuk ua ka shuar dëshirën për të luajtur dhe për t'u ballafaquar në fushën e "blertë". Për t'u përfaqësuar në mënyrë më të denjë dhe më masivisht, është dashur të presin deri në vitin 1941, përkatësisht sezonin 1941/42 kur është themeluar klubi futbollistik shqiptar "Skënderbeu".
Ky klub futbollistik, i cili ishte emëruar sipas heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioiti Skënderbeu, kishte grumbulluar rreth vetes shumë të rinj futbolldashës, të cilët kishin pritur me vite për këtë moment. Megjithatë, si shumë iniciativa të asaj kohe, të cilat kishin pasur për qëllim zhvillimin e frymës sportive te shqiptarët, janë shuar si rezultat i represionit komunist të ushtruar asokohe. Si rrjedhojë, klubi futbollistik "Skënderbeu" i Tetovës, funksionoi vetëm tre vjet. Lojtarët e "Skënderbeut", si: Fadil FauziLatifi, SejfullaSejfullai, AliSulejmani, Muarem-Jusufi, Alil Baxho e shumë të tjerë duhej ta ndërprisnin aktivitetin e tyre ose të inkuadroheshin nëpër klubet ekzistuese joshqiptare.
Edhepse numri i futbollistëve dhe entuziastëve shqiptarë ka qenë i vogël, ndërsa numri i klubeve i kufizuar apo i papërfillshëm, lojtarët si: Qani Pagria, NijaziFanda, Birush Qypi, XhelalMahmudi-Zoti, ReshatTajqexhiu, Xhemal Kazazi, MustafaGulak, AbdullaAdilçe, Fadil Latifi, SejfullaSejfullai, AliSulejmani, Alil Baxho, NizamedinJumniu, Hadi Kazazi, IlmiBallanca, Fadil Arsllani, SherefArsllani, SulejmanEjupi-Takara, JusufEjupi-Takara, Xhelal Qypi, MuaremNafiaga-Kasapi, HalilKartali, SherefRoshi, IbraimShukriu-Javri, Husein- Zebec, ByranGjakovica, Osman Tairi, RezakIbraimi, EkremNeziri, FuatMurtezani, MesutSharko, Shaban Ramiz- Gugo, IdrizIdrizi, ImerIbraimi dhe HarunJakupi, të cilët kanë luajtur jo vetëm për klubin futbollistik "Skënderbeu", por edhe për klubet tjera në Tetovë në vitet para, gjatë dhe pas luftës së dytë botërore, nuk duhet harruar sepse ata kanë qenë nismëtarët e lojës së futbollit, dhe të njëjtët duhet kujtuar me pietet sepse kanë dhënë një kontribut të veçantë për fillimet e kësaj loje magjike, e cila viteve dhe dekadave në vijim do të pushtojë zemrat e shumë e shumë gjeneratave adhuruesish.

*Botuar më: 3 janar, 2016*

# Shqiponjat "pushtojnë" Francën për herë të parë

*Bujar Sinani*

Federata Shqiptare e Futbollit është krijuar më 6 qershor të vitit 1930, ndërsa është anëtarësuar në FIFA në vitin 1932. Në vitin 1934, Shqipëria u ftua të marrë pjesë në Kupën e Botës, por për shkak të problemeve ekzistuese asokohe, ajo e refuzoi ftesën.

Pas Luftës së Dytë Botërore, futbolli përfitoi nga sistemi komunist duke qenë se u fut nëpër shkolla, nëpër ndërmarrje, ndërsa u përhap edhe nëpër qytete e fshatra. Shteti e mbështeste ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e futbollit, ndërsa rezultatet nuk vonuan shumë. Ekipi kombëtar debutoi me ndeshjen e luajtur gjashtëmbëdhjetë vjet pas themelimit të FSHF-së, duke e "shkelur" ekipin e Malit të Zi me rezultat 5:0. Në po të njëjtin vit, ekipi kombëtar merr edhe një trofe shumë të rëndësishëm – Kupën ballkanike.

Duke i marrë parasysh mjetet modeste të cilat i ka pasur në dispozicion ekipi kombëtar shqiptar, rezultatet e arritura në ndeshje të caktuara, e kanë nxjerrë në pah karakterin luftarak dhe garues të lojtarëve të saj.

Në vitin 1965, shqiponjat nxorën një barazim në fushën e vet kundër Irlandës së Veriut, duke i dhënë kështu fund shpresave të irlandezo-veriorëve për kualifikim në Kampionatin Botëror. Dy vite më pas, Gjermania Federale, do ta pësojë të njëjtin fat në ndeshjen e luajtur në Tiranë dhe do t'i mbyllë kështu dyert për kualifikim në Evropianin e vitit 1968.

*Pas përcaktimit të grupeve për ekipet pjesëmarrëse në banketin francez, ku Shqipëria do të përballet me Zvicrën, Francën dhe Rumaninë, pritjet dhe shpresat për kalimin e fazës së grupeve janë të mëdha, ndërsa lojtarëve dhe ekipit të trajnerëve të udhëhequr nga Xhani de Biazi, ju ngelet që këtë vit të mbarë për ne, ta përmbyllin edhe me një rezultat tjetër historik, kësaj here në arenën sportive*

Rënia e regjimit komunist pati ndikim edhe mbi futbollin dhe sportin shqiptar në përgjithësi, pasi që individët më të mirë dhe më të shkathët u larguan drejt vendeve perëndimore. Si pasojë e këtyre ngjarjeve dhe ikjes së sportistëve dhe futbollistëve, ekipi kombëtar në njërën anë u dobësua, por nga ana tjetër solli trajnerë dhe seleksionues të huaj, të cilët ndihmuan në ngritjen e cilësisë së ekipit dhe arritjes së rezultateve pozitive në garat ndërkombëtare.

Gjatë ndeshjeve eliminatore për Euro 2004, Shqipëria fiton kundër Rusisë dhe Gjeorgjisë, ndërsa barazon me Irlandën dhe me Zvicrën, duke ngelur e pamposhtur në "kalanë" e vet. Gjatë fazës eliminatore për Kupën Botërore të 2006-ës, kombëtarja shqiptare mundi në Tiranë kampionin evropian, Greqinë me rezultatin 2 :1, ndërsa luajti një ndeshje pa gola kundër Portugalisë në terren të saj.

Cilësia e ekipit kombëtar do të jetë në rritje të vazhdueshme, ndërsa rezultatet nuk do të mungojnë.

Më 7 shtator 2014, kombëtarja shqiptare e nis shkrimin e historisë, kur në fazën eliminatore për Euro 2016, mund Portugalinë me rezultatin 1:0 në fushë të saj, duke i ngjallur shpresat për kualifikim në fazën finale të turneut evropian, i cili do të mbahet në vendin e gjelave. Sa për parantezë, më 13 qershor të vitit 2015, Shqipëria e mundi Francën me golin e Ergys Ka në një ndeshje miqësore të luajtur në "Elbasan Arena".
Pas tetë ndeshjeve të luajtura në fazën eliminatore për Euro 2016, nga të cilat katër fitore, dy barazime dhe dy disfata, ëndrra shqiptare për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane të futbollit u bë realitet, pas fitores në ndeshjen e fundit të zhvilluar kundër Armenisë.
Disa ditë më vonë, kapiteni i kuqezinjve, LorikCana, i cili llogaritet edhe më francezi prej shqiptarëve, pasi që pjesën më të madhe të karrierës e ka kaluar në klubet si "Olimpik Marsej" dhe "PSZH", ndërsa luan me Nant-in, në Twitter pati shkruar : "Shkojmë në Francë për t'i treguar vlerat tona dhe për ta kaluar fazën e grupeve".
Futbolli është një sport shumë i përhapur në Shqipëri. Në raste të caktuara kombëtarja shqiptare ka dëshmuar se mund të jetë në nivelin e ekipeve, që konsiderohen si shumë më cilësore. Për herë të parë në historinë e saj, Shqipëria arriti të kualifikohet në Kampionatin Evropian, i cili këtë verë do të mbahet në Francë.

*Botuar më: 2 Shkurt, 2016*

# Shqipëria, kjo «mace e zezë» për francezët

*Bujar Sinani*

Eradhitur në pozitën e 42-të në klasifikimin e FIFA-s, në aspektin teorik, Shqipëria mund t'ia kishte zili Francës për shumë gjëra, këtu përfshirë trofetë e fituara apo edhe lojtarët të cilët aktivizohen me ekipet më të mira evropiane. Në gjashtë ndeshjet e realizuara kundër Francës, Shqipëria ka pësuar në katër takime, edhepse në dy ndeshjet e fundit, avantazhi i ka takuar ekipit tonë kombëtar.

E radhitur në vend të dytë në grupin e parë kualifikues, me 4 fitore, 2 barazime dhe 2 humbje, Shqipëria e tregoi qysh në ndeshjen e parë të Kampionatit Evropian, se nuk është aty rastësisht. Duke u mbështetur mbi një mbrojtje me përvojë  dhe te një repart mesfushe i cili është mjaft solid, seleksionuesi italian i kombëtares, Xhani De Biazi, ia doli që ekipin tonë kombëtar ta kualifikojë për EURO 2016, duke e shkruar kështu historinë e futbollit shqiptar. Për Shqipërinë dhe shqiptarët, kjo është një arritje e madhe, ndërsa për këtë arritje, strategut italian iu dha edhe shtetësia shqiptare.

Me një vendosje 4-1-4-1, ish trajneri i Udinezes ose Torinos, për pak sa nuk e eliminoi Zvicrën në ndeshjen e parë të Shqipërisë në Euro2016, ndeshje kjo e zhvilluar në stadiumin Boller në Lens. Edhe përkundër largimit të LorikCanës me karton të kuq që në minutën e 36-të, Shqipëria dëshmoi një agresivitet dhe lojë superiore karshi zvicerianëve. «Forca e Shqipërisë mbështetet mbi lojën ekipore dhe sensin e sakrificës» – pati deklaruar De Biazi fill pas ndeshjes.

Një ndeshje e "ndërlikuar"

Për francezët, ekipi shqiptar nuk është anonim dhe duke filluar nga ndeshjet përgatitore në kuadër të eliminatoreve për Kampionatin Evropian, ata kanë qenë të paralajmëruar për cilësitë e kundërshtarit të tyre të sotëm. Që nga barazimi i parë në ndeshjen e luajtur në Ren në nëntor të vitit 2014, deri te disfata e pësuar në Elbasan në qershor të 2015-tës, seleksionuesi francez DidieDeshomp mesa duket nuk e ka gjetur akoma zgjidhjen përkatëse kundër formacionit shqiptar. Njëri ndër lojtarët e ekipit kombëtar francez, MusaSisoko, dy ditë para ndeshjes pati deklaruar: «Kjo do të jetë një ndeshje e ndërlikuar. E njohim mirë kombëtaren shqiptare, cilësitë dhe dobësitë e saj. Është një ekip shumë kompakt, i cili mbrohet mirë dhe që di të luajë me topin».

*"Kjo do të jetë një ndeshje e ndërlikuar. E njohim mirë kombëtaren shqiptare, cilësitë dhe dobësitë e saj. Është një ekip shumë kompakt, i cili mbrohet mirë dhe që di të luajë me topin".*

Duke u bazuar te fakti se reparti sulmues i ekipit tonë kombëtar nuk është nga më të rrezikshmit, në letër, Franca teoretikisht do të duhej t'ia dalë pa problem në këtë takim. Megjithatë, dy ndeshjet e fundit miqësore me Francën dhe sidomos ndeshja e parë e Shqipërisë në Euro

2016 kundër Zvicrës, gjatë së cilës zhvilloi një lojë shumë të mençur, ngjallin shpresë për një rezultat pozitiv nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër i frikësojnë francezët. Nuk është e rastit që ata në mediat e tyre e kanë cilësuar Shqipërinë – një «mace të zezë».

*Botuar më: 15 qershor 2016*

Shkrimet e autorëve jo gjithmonë pasqyrojnë qëndrimin e rrjetit *PanAlbanica*.

*"Unë nuk pajtohem me atë që thua, por do ta mbroj deri në fund të drejtën tënde për ta thënë atë"*

*– Evelyn Beatrice Hall*

SEPTENTRIO.

OCCIDENS.

ORIENS.

MERIDIES.

En tibi, formosæ sub forma Europa puellæ
Vivida fœcundos pandit vt illa sinus.

Rides Italiam dextra Cimbrosq; sinistra
Obtinet, Hispanum fronte geritq; solum.

Pectore habet Gallos, Germanos corpore gestat
Ac pedibus Graios, Sauromatasq; fouet.